Prof.Dr. ISAK SHEMA

STERJO SPASSE

JETA DHE KRIJIMTARIA LETRARE

Dituria 2015

Prof.dr.sc. Isak Shema

STERJO SPASSE

JETA DHE KRIJIMTARIA LETRARE

© 2015. Autori

Botuesi *Dituria 2015*

Redaktore
Dr. Besa Shema - Luzha

Recensues
Prof. Dr. sc. Liman Matoshi
Prof. Dr. sc. Bashkim Kuçuku

Kopertina
Prof.dr.sc. Lulëzim Lajçi

Përgatitja kompjuterike
Fatos Shema

ISBN

Prof. dr. sc. ISAK SHEMA

STERJO SPASSE

JETA DHE KRIJIMTARIA LETRARE

Dituria 2015

Prishtinë
2016

Prof. dr. sc. ISAK SHEMA

STERJO SPASSE

LA VIE ET L`OEUVRE LITTÉRAIRE

Dituria 2015

Prishtina
2016



isakshema.com

LIBRI BOTOHET RASTIN E 76- VJETORIT TË LINDJES DHE 56- VJETORIT TË VEPRIMTARISË ARSIMORE, KULTURORE DHE SHKENCORE TË AUTORIT TË MONOGRAFISË

PARATHËNIE

Botimi i monografisë *Sterjo Spasse- jeta dhe krijimtaria letrare* pasuron studimet historike letrare të letërsisë shqiptare dhe është në funksion të hartimit të Historisë së letërsisë bashkëkohore shqipe. Shkrimtari Sterjo Spasse (1914-1989) lindi në Gllomboç nga një familje me kombësi maqedonase. Ka jetuar, ka zhvilluar aktivitete arsimore, kulturore dhe ka krijuar veprat letrare gjatë shekullit XX. Opusi letrar i tij është shumë i pasur dhe ka zgjuar interesimin e lexuesve dhe të studiuesve të letërsisë.

Sterjo SpasseS lexuesit shqiptar e kanë njohur me verat e fazës së parë të krijimtarisë letrare, të botuara gjatë viteve tridhjetë. Proza tregimtare dhe dy romanet e para *Nga jeta në jetë, Pse?!* dhe *Afërdita* janë

lexuar nga shtresa të ndryshme të lexuesve. Lidhur me prozën e tij janë shkruar edhe vështrimet e para kritike letrare. Prozën e Sterjo Spasses e kam lexuar si nënës, ndërsa më vonë edhe si studes. Sterjon e kam njohur si lexues që nga fillimi i viteve pesëdhjetë si nxënës i progjimnazit dhe më vonë si normalist në Shkollën Normale të Prishtinës që nga viti 1954. Si student i Fakultetit Filozofik të Prishtinës (1960-1964) për veprat e disa shkrimtarëve shqiptarë kam shkruar hartime dhe punime seminarike. Studimin më të plotë për këtë shkrimtar dhe për veprën e tij letrare e kam hartuar në vitin 1967 me titullin *Pikëpamjet sociale në veprimtarinë e Sterjo Spasses.* Teksti është përkthyer në gjuhën serbokroate. Kjo është temë e magjistraturës, e punuar gjatë studimeve pasuniversitare në Drejtimin e Letërsisë në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Beogradit dhe është mbrojtur në vitin 1968. Studimi është botuar më vonë në dy numra të parë të revistës Jeta e re të Prishtinës në vitin 1969. Sterjon e kam takuar në Tiranë në vitin 1970 gjatë vizitës së parë në Shqipëri. Me ftesë të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë kam qëndruar një muaj në Shqipëri për qëllime studimi. Sterjo Spasse ka vizituar Kosovën në vitin 1975. Përshtypjet e veta gjatë qëndrimit në Kosovë i ka paraqitur në formë ditari dhe si tekst i ka përmbledhur në librin *Letra nipit tim Arijan* (përshtypje udhëtimi në Kosovë, Maqedoni).

Në pjesën e parë të këtij botimi monografik kushtuar Sterjo Spasses, shkrimtarit të shquar të letërsisë bashkëkohore shqiptare, botohet versioni i parë i studimit në gjuhën shqipe të përdorur atëherë, para se të zbatohej në Kosovë gjuha standarde e shqipes. Pas këtij versioni shtohet punimi i botuar në gjuhën standarde në librin *Aspekte të letërsisë* (1985). Në vazhdim përfshihen punimet dhe vështrimet letrare për jetën dhe krijimtarinë letrare të Sterjo Spasses. Bibliografia *Sterjo Spasse (1929-2014)* e Prof. Dr. Ilinden Spasses, jetëshkrimi dhe veprimtaria e autorit të monografisë vendosen në pjesën e dytë.

Botohet edhe *Intervista e vogël* me titullin *Tema e parë nga letërsija shqipe,* të cilën e ka bërë me mua gazetari dhe shkrimtari ,Vehbi Kikaj, dhe e ka botuar në Gazetën *Rilindj*a të datës 24 prill 1967.

PJESA E PARË

Veprat:

“Në krahët e një femre”, tregime 1934

“Kurorë rinije”, tregime 1934

“Pse?!”, roman 1935

“Nusja pa duvak”, tregime 1944

“Ata nuk ishin vetëm”, roman 1952

“Afërdita përsëri në fshat”, roman 195

“Buzë liqenit”, roman 1965

“Sokolesha”, 1966

“Të fala nga fshati”, 1968

“Zjarre”, roman 1972

“Zgjimi”, roman 1973

“Pishtarët”, roman 1975

“Ja vdekje, ja liri”, roman 1978

“Kryengritësit”, roman 1983

“O sot, o kurrë!”, roman 1989

“Letra nipit tim Arian në Tiranë nga Maqedonia dhe Kosova”, 1975, etj

I. PIKËPAMJET SOCIALE NË VEPRIMTARINË E STERJO SPASSES

(Dorëshkrim)



Letërsia artistike shqipe gjatë zhvillimit të vet kaloi një rrugë relativisht të gjatë. Ajo u krijue nën kushtë ekonomiko-shoqnore e politike specifike të jetës së popullit shqiptar gjatë shekujve. Megjithëkëtë, ma në fund, fitoi fizionominë e një letërsije të zhvillueme në të cilën janë të përfaqësueme të gjitha gjinitë letrare. Si e tillë, arti i fjalës së kuhur në letrat shqipe, në të cilin i prezantohet lexuesve dhe gjenerata onere me epitetet që i shkojnë për shtat vetëm letërsisë e cila ka përjetue me lulzue në lulishtën e madhe të letërsisë botnore. Poezia, proza dhe drama shqipe, ridomos në dhetëvjetshet e fundit, po vijnë gjithnji e ma tepër tue u ngritë artistikisht. Vepra letrare artistike, jo vetëm që po i ofrohet turmave gjithnji e ma të mëdha të lexuesve shqiptarë dhe atyne që e njohin gjuhën shqipe, por edhe lexuesve të tjerë në shumicë gjuhë të botës.

2

Shumica e veprave letrare u ribotuen në gjuhën shqipe edhe nga disa herë, e disa prej tyne pamë dritën e botimit në gjuhët e huaja si: në frengjisht, rusisht, gjermanisht, anglisht, në serbokroatisht e në gjuhët e popujve të Jugosllavisë, në shumë gjuhë të vendeve socialiste dhe kapitaliste. Përkthimet nga gjuha shqipe po priten me mirëseardhje nga lexuesit dhe garojnë e interesuemë letrare në botë.

Literatura shqipe e përkthyeme në tridhjetë gjuhë të popujve sovjetikë në BRSS rritën që prej vitit 1950 arritën një tirazh prej gati dy milion ekzemplarë.(1) Prej mase gjashtëdhjetë veprave letrare të përkthyeme në rusisht kritika e huaj i pritë mirë edhe nga përkthimet artistike të poetëve dhe prozatorëve shqiptarë të afirmuem si ato të: Vaso Frasherit, Çajupit, Migjenit, Migjenit, Sterjo Spasses, Dhimitër Shuteriqit, Fatmir Gjatës, Shefqet Musarajt etj. Veprimtari e ngjashme u ndërmorën edhe në vendet tjera. Romanet e Sterjo Spasses të përkthyeme në përmbledhjetë gjuhë të huaja po e përfaqësuan letër-

shqipe denjësisht edhe para publikut të huaj e lexues.

Nga ana tjetër, interesimi për studimin e gjithësmanës të kësaj letërsie po shtohet dita-ditës. Shumë studiues të paraqitur në Kongresin e parë ndërkombëtar të studiuesve të Europës Jug-lindore, që u mbajt në Sofje në verën e vjetit 1966, i cilësuan kualdue Akademikës në tonën. Në seksionin e letërsisë shumica e komunikatave bën-shin fjalë për letërsinë artistike shqipe.

Edhe kritika letrare shqipe u ngrit komba-dorash. Ajo në disa tona, edhepse relativisht ese, po e jep fjalën e vet përkitazi me krijimet artistike letrare; veç e veç, për vlerën e tyne artistike, përkitazi me përfaqësimin e zhanreve dhe drejtimeve letrare. Problemet e shkencës së letërsisë gjithashtu gjinden në fokusin e studimeve kritike.

Tue dhanë vlerësime për krijimet artistike të-kohës, edhe atëherë kur të disa autorë gjejë ndonji tendencë reaksionare dhe jo e shëndetë, kritikët shqiptarë të cilët nuk shin gjithmonë edhe kritikë konjeksionin e zanafillës dhe shpesh.



Fragment nga dorëshkrimi i punimit të magjistraturës, 1967

II.

Isak Shema

PIKËPAMJET SOCIALE NË VEPRËN E STERJO SPASSËS

Me rastin e botimit të veprave të tij. Prishtinë 1968

Sterjo Spasja që nga fillesa e krijimtarisë letrare, në tregimet e shumta dhe nji varg romanesh me të cilët pasunoi letërsinë shqipe, trajtoi nji tematikë të shumduershme e edhe tematikë shoqnore; ai njiherit paraqiti edhe pikëpamjet e veta sociale, që janë edhe objekt studimi në punimin tonë — tash, me daljen e kompletit të veprave të tij te na.

Për të studjue tanë këtë vepër komplekse të Sterjo Spasses, që e krijoi gjatë nji kohe relativisht të gjatë, duhet pasë parasysh edhe kushtet historike-shoqnore të shoqnisë shqiptare — në nji anë, dhe vetë rrugën jetsore të shkrimtarit — në anën tjetër. Sepse, mbas leximit të tanë veprës letrare, fitohet mbresa se të gjithë këtë krijimtari artistike, aq sa e ka kushtësue vetë prirja e autorit, disponimi dhe përgatitja e tansishme e tij për të trajtue nji tematikë të shumduershme, e ka kushtësue edhe klima e përgjithshme shoqnore. Nga se krijuesi si individ asht vetëm pjestar i shoqnisë, atëherë vepra letrare asht jo vetëm krijim individual, por njiherit edhe produkti i shoqnisë apo i grupit shoqnor ku ai ban pjesë.

Vepra letrare e Spasses u krijue gjatë dy epokave: para luftës çlirimtare, kur autori shkroi simbas metodës së realizmit kritik, dhe mbas saj, deri në ditët tona, kur ai përqafoi metodën e realizmit socialist. Prandaj, Spasse konsiderohet me të drejtë edhe si themelues i letërsisë shqipe të realizmit socialist. Studjuesit e njoftun të kësaj letërsije: Razi Brahimi, Koço Bihiku etj.,

tue ba fjalë për veprën letrare të këtij prozatori, kanë cekë vetëm këto dy faza të krijimtarisë letrare. Por, tanë kjo veprimtari e paraluftës, që filloi që prej vjetit 1929 dhe deri më 1944, nuk asht e nji fryme; vërehet sidomos nji dallim i madh ndërmjet veprave deri në vjetin 1935 dhe t' atyne të mavonshme. Krijimet artistike të kësaj periode dallohen shum përkah trajtimi i temave dhe përkah paraqitja e ideve. Veprat që shkroi Spasja deri më 1935 janë krijime të fazës së parë letrare, ku dominon nji rrymë e ndieshme pesimiste. Në disa tregime dhe në romanin *„Pse?! . . ."* shprehen në mënyrë të fuqishme edhe ide nihiliste t' autorit.

Faza e dytë e krijimtarisë letrare të Spasses përfshin veprat e krijueme gjatë periodës 1936—1944. Kjo asht krijimtari realiste humanitare dhe utilitariste. Në te shprehet nji optimizm i fuqishëm jetsor, çmohet shum njeriu si qënije shoqnore dhe paraqiten ide të shëndosha përkitazi me progresin e përgjithshëm shoqnor. Prej këndej edhe përfundimi ynë, se kritikët e përmendun në studimet e tyne nuk i kanë marrë parasysh ndryshimet esenciale kualitative në metodën krijuese të shkrimtarit dhe as ato sa i përket mbrendisë së veprave letrare të Spasses, që u shkruen para luftës së fundit. Mendojmë se konkludimi që në veprimtarinë e paraluftës duhen dallue dy faza asht ma i plotë dhe ma i drejtë. Mbas luftës çlirimtare vijon nji veprimtari edhe ma e frytshme. Veprat e kësaj periode i përkasin fazës së tretë krijuese të Sterjo Spasses.

Në këtë punim, opusi letrar i Spasses po studjohet vetëm nga nji aspekt i ngushtë: paraqitja e pikëpamjeve sociale në veprën letrare artistike, tue u dhanë edhe të çmuemit e vleftës artistike të tanë veprës. Nëpërmjet t'analitikës shkencore do të bahet klasifikimi i tanë kësaj veprimtarije komplekse letrare në tri faza. Në këtë mënyrë mund të përcaktohet shum ma lehtë pranija e ideve sociale në këto faza të krijimtarisë veç e veç. Në kuadër të tyne do të konstatojmë se në çfarë mase janë dhanë ato pikëpamje sociale të shkrimtarit në secilën vepër letrare, që prej tregimeve dhe nevolave të para e deri te veprat voluminoze si janë romanet e tij bashkëkohore. Padyshim kështu do të vërehet ma mirë edhe ngritja graduale e shkrimtarit gjatë vjetëve dhe rruga evolutive e paraqitjes së pikëpamjeve të tij sociale.

I

„Duhet ba thirrje për jetë dhe punë,
e jo për vdekje."
(M. Gorki)

Sterjo Spasse, djalosh nandëmbëdhetë vjeçar, mësues i nji fshati mjaft të mbrapambetun, botoi gjatë kohës së regjimit famëkeq zogist në Shqipni, më 1935, romanin e vet të parë: *„Nga jeta në jetë: Pse?!..."*. Ai me moton e romanit: *„Bota e Hiçit, prej Hiçit, për Hiçin Rrotullohet rreth qëllimit të Hiçit"* jo vetëm që nuk bante thirrje „për jetë e punë", si thot G o r k i zamadh, por me sy çelë, në pikë të ditës, shifte vetëm errësinë e asgja tjetër. Mohonte gjithçka të vlefshme, ma në fund edhe jetën. Kështu kaloi ai në pesimizëm, por e përlanë njiherit edhe dallgët e nihilizmit.

Në të njajtën kohë jetoi e veproi edhe M i g j e n i, mësues e poet, gjithashtu i nji fshati të vuejtun shqiptar, i cili kalonte nji jetë të padurueshme. Por, Migjeni nuk ra në humnerën e pesimizmit. Këtu edhe qëndron aftësia e poetit, me u rrekë me temat shoqnorë dhe mos me u përmbytë nga moti i lig i kohës, sepse njeriu që rrokulliset në horizontin e nëntokës, as që e sheh ma diellin e hanën, qiellin e yjet, gjelbrimin e njerëzit, lulen e vashën, jetën dhe lumtuninë.

Gjon Zaveri i Sterjo Spasses në romanin *„Pse?!..."* nuk kalon jetën e nëntokës, por jetën e andrallave. Atij i vërviten në kokën e cila „filozofon" vetëm mendime e pyetje dhe pyetje e mendime. Edhepse ndonjiherë shkundullohet nga ato mendime të kobshme, e duket se në fytyrë i lëviz gjaku i jetës, i çilen sytë me pa të mirat dhe të këqijat e jetës dhe shoqnisë; mandej i mveshet syve përsëri shum shpejt nji lëbyrë dhe atëherë i turbullohet mendja dhe shpirti, por mbahet i alivanosun dhe prapë e kaplojnë mendime dhe vetëm mendime, — filozofi pafund, sa edhe të zezat e vdekjes, deri në fundin tragjik.

N'at kohë pësuen fat të njejtin tragjik edhe protogonistët kryesorë të disa veprave të tjera shqipe. Dija e romanit të H a k i S t ë r m i l l i t *„Sikur t' isha djalë"* nuk shpëtoi nga vdekja tragjike. Po as Memli, heroi i veprës së G ë r b l l e s h i t: *„Gremina e dashurisë"* nuk u largue dot nga pushka shpaguese. Në vend që t'u hapej rruga drejt jetës, ata i gjykon koha në lulzimin e rinisë, me ngashërim e buzë të shkrumueme u fiket jeta. Edhe shum fytyra të tregimeve të para të Spasses, të botueme para romanit të mohimit dhe mbas tij, në të shumtën e herës i pret nji mbarim

tragjik. Tregimi i parë me titull: *„Dashuria e pafat"* (botue në gazetën „Zëri i Korçës" më 1930) përshkruen fatin tragjik të bashkëshortëvet. Proza në fjalë i paraprin nji vargu hartimesh tjera prozatore, që si temë të tyne kanë plagët shoqnore që shkaktojnë përmbytje në jetën e individëvet. Tue u dhanë kështu jeta e vështirë e vogjëlisë, mbrapambetunia shoqnore, gyrbeti, hakmarrja, skamja e vorfnia, bestytnitë e kohës dhe antagonizmat klasore, trajtohet nji problematikë sociale mjaft aktuale. Fati i protagonistëve të këtyne prozave ishte njiherit edhe fati i familjeve të vorfna shqiptare dhe grupeve shoqnore. Vogjëlia, si shtresë shoqnore që „hiqte të zitë e ullinit", bante mbi kurriz të tana garrametet e jetës së vështirë.

Kjo ishte koha kur Sterjo Spasse, ende pa ndonji përvojë të gjatë letrare e pa nji njohje të thellë të kontradiktave shoqnore të kohës, kur ndikimi i letërsisë reakcionare të perëndimit kishte ba të vetën, në prozat e veta ma tepër ofronte tablo të nji jete të vështirë. Prandej, shkrimtarit nuk i shkoi për dore me u marrë me trajtimin e nji tematike të gjanë shoqnore, e aq ma tepër me i shtrue pikëpamjet e veta sociale në nji roman. Tash, nëpërmjet të kësaj prizme duhet spjegue edhe devijimi i Sterjos në fazën e parë të veprimtarisë letrare.

G o r k i, tue ba fjalë për vështirsitë në të cilat has shkrimtari gjatë shkruimit të nji romani social dhe gjatë përgatitjes së tij gjithanshme, në mes tjerash shkruen: „...që të shkruhet në kohën tonë nji roman i mirë social, shkrimtari duhet të ketë fuqi krijuese të gjeniut dhe njohuni të gjithanshme të jetës. Ky asht nji prej shkaqeve që letërsia devijon prej realizmit kah misticizmi, prej realitetit kah fantazia, prej rrugës së vështirë të trajtimit të çashtjeve sociale kah problemi i të qenunit individual, dhe në shkretinën e paplleshme të çashtjeve botnore"[1]).

Për të njejtat vështirsi në krijimtarinë e vet letrare n' atë kohë ban fjalë edhe vetë shkrimtari: „Jua them sinqerisht se në periudhën e rendit feudalo-borgjez kur unë fillova të shkruaj, m'u desht të kapërcej shumë kontradikta të brendëshme. Këto kontradikta ishin të paevitueshme në periudhën kur letërsia e së shkuarës errësonte mendimet e shkrimtarëvet".[2])

Shkreptimat e fuqishme letrare të romancierit Spasse u dukën mbas vjetit 1936, kur filloi të shkruejë fragmentet e romanit

---

1) M. Gorki: *O literaturi*, Beograd, 1949
2) S. Spasse: *Njëmbëdhjetë vjetë në atdheun tim të lirë*., Shqipëria e re, 11—12, Tiranë, 1955

në të gjitha nivelet, kundërthaniet klasore që paraqiten, janë landë e veprës realiste. Por, shkrimtari të gjitha këto nuk i jep vetëm si fakte a ndodhi të nji kohe apo vendi. Me anë të mjeteve artistike, me mjeshtri naracioni, ai zgjon te lexuesi ndjenjen e përjetimit të thellë të fatit të herojve si pjestarë të shoqnisë, prandej shkrimtari veçanërisht duhet ta njohi epokën në të cilën jeton. Ai, meqenëse asht vërejtës i drejtpërdrejtë i të gjitha oscilimeve shoqnore, në të shumtën e herës, si individ, hyn edhe vetë në vallen e kohës. Vetëm si i tillë mund të shprehë edhe pikëpamjet e veta në veprën letrare artistike. Në të kundërtën, sidomos në fillimet e veprimtarisë letrare, pa nji njohje të gjithanshme të jetës shoqnore, shkrimtari nuk asht në gjendje me i paraqitë me bindje pikëpamjet progresive që kushtëzon koha. Në këtë mes luejnë rol të randësishëm edhe faktorë tjerë: zhvillimin ekonomiko-shoqnor e kulturał, jeta politike në vend e jasht tij, ndikimi i filozofisë së kohës, tradita kulturore dhe letrare etj.

Spasja, si shum shkrimtarë të tjerë, e nisi veprimtarinë e vet letrare në kohën e regjimit të Ahmet Zogut. Qysh në bankat e normales, kur nuk ishte ma tepër se shtatëmbëdhetë vjeç, filloi t'i trajtojë disa tema me frymë patriotike. Proza „*Kreshnikja shqiptare*" (botue në revistën „Normalisti" më 1913) ka si heroinë vajzën guximtare — Fatimen. Ajo, me heroizmin e saj të pashembullt, arrijti me u shpague kundra anmikut grek që ia kishte plagosë të fejuemin, Ahmetin. Në nji hartim tjetër të këtij lloji autori ngre nalt patriotët shqiptarë, luftarët për të drejtat kombëtare e sociale. Ishte koha kur Zogu me ndjekësit e vet, mbasi përmbysi qeverinë demokratike të Fan S. Nolit, vendosi diktaturën mbretnore në Shqipni. Kështu ishin zhdukë shum rreze shprese për nji progres të përgjithshëm shoqnor. Ekonomia e vendit vorfnohej gjithnji e ma tepër. „Në buxhetin financiar të vitit 1926—1927 parashihej që shtatëdhetë e pesë përqind të t'ardhunave të shpenzoheshin për mbajtjen e forcave ushtarake dhe t' aparatit shtetnor, dhe vetëm njizet e pesë përqind për zhvillimin e ekonomisë, për ndërtime botore, arësim, kulturë, shëndetësi e tjera. Vetëm presidenti i Republikës, A. Zogu, shpenzonte ma tepër se ç' shpenzotnte bashkarisht ministria e shëndetësisë për gjithë shërbimin mjeksor të Shqipnisë dhe ministria e bujqësisë për gjithë nëpunësit dhe kuadrat bujqësore të vendit".[4])

---

4) *Historia e Shqipërisë*, II — Tiranë. 1965

në të gjitha nivelet, kundërthaniet klasore që paraqiten, janë landë e veprës realiste. Por, shkrimtari të gjitha këto nuk i jep vetëm si fakte a ndodhi të nji kohe apo vendi. Me anë të mjeteve artistike, me mjeshtri naracioni, ai zgjon te lexuesi ndjenjen e përjetimit të thellë të fatit të herojve si pjestarë të shoqnisë, prandej shkrimtari veçanërisht duhet ta njohi epokën në të cilën jeton. Ai, meqenëse asht vërejtës i drejtpërdrejtë i të gjitha oscilimeve shoqnore, në të shumtën e herës, si individ, hyn edhe vetë në vallen e kohës. Vetëm si i tillë mund të shprehë edhe pikëpamjet e veta në veprën letrare artistike. Në të kundërtën, sidomos në fillimet e veprimtarisë letrare, pa nji njohje të gjithanshme të jetës shoqnore, shkrimtari nuk asht në gjendje me i paraqitë me bindje pikëpamjet progresive që kushtëzon koha. Në këtë mes luejnë rol të randësishëm edhe faktorë tjerë: zhvillimin ekonomiko-shoqnor e kulturał, jeta politike në vend e jasht tij, ndikimi i filozofisë së kohës, tradita kulturore dhe letrare etj.

Spasja, si shum shkrimtarë të tjerë, e nisi veprimtarinë e vet letrare në kohën e regjimit të Ahmet Zogut. Qysh në bankat e normales, kur nuk ishte ma tepër se shtatëmbëdhetë vjeç, filloi t'i trajtojë disa tema me frymë patriotike. Proza „*Kreshnikja shqiptare*" (botue në revistën „Normalisti" më 1913) ka si heroinë vajzën guximtare — Fatimen. Ajo, me heroizmin e saj të pashembullt, arrijti me u shpague kundra anmikut grek që ia kishte plagosë të fejuemin, Ahmetin. Në nji hartim tjetër të këtij lloji autori ngre nalt patriotët shqiptarë, luftarët për të drejtat kombëtare e sociale. Ishte koha kur Zogu me ndjekësit e vet, mbasi përmbysi qeverinë demokratike të Fan S. Nolit, vendosi diktaturën mbretnore në Shqipni. Kështu ishin zhdukë shum rreze shprese për nji progres të përgjithshëm shoqnor. Ekonomia e vendit vorfnohej gjithnji e ma tepër. „Në buxhetin financiar të vitit 1926—1927 parashihej që shtatëdhetë e pesë përqind të t'ardhunave të shpenzoheshin për mbajtjen e forcave ushtarake dhe t' aparatit shtetnor, dhe vetëm njizet e pesë përqind për zhvillimin e ekonomisë, për ndërtime botore, arësim, kulturë, shëndetësi e tjera. Vetëm presidenti i Republikës, A. Zogu, shpenzonte ma tepër se ç' shpenzotnte bashkarisht ministria e shëndetësisë për gjithë shërbimin mjeksor të Shqipnisë dhe ministria e bujqësisë për gjithë nëpunësit dhe kuadrat bujqësore të vendit".[4])

4) *Historia e Shqipërisë*, II — Tiranë. 1965

Katundaria dhe vogjëlia qytetare mbante mbi shpinë gjethe shfrytëzimin e egër feudal. Sterjo atëherë ishte dhetëvjeçar dhe kalonte nji jetë shum të mundimshme e në skamje. Ai, si shkruen Fatmir Gjata me rastin e 50-vjetorit të lindjes së autorit — „ishte një djalosh i imtë, veshur me shajak t'ashpër që endet në tezgjahet fshatarake, kthehej në mbrëmje vonë nga fusha në shtëpi. Por ai nuk shtrihej në dyshek për t'u çlodhë e për të fjetur. Ngarkonte kalin me dy thasë qymyr dhe, që nga fshati me emrin Gllomboq, merrte rrugën e gjatë për në Korçë. Ecte tetë orë në kambë, natën pa hanë, me shi a me dëborë, dhe ndaj të gëdhirë mbërrinte në qytet. Aty pastaj gjithë ditën bridhte rrugicave duke bërtitur: „Kush do qymyr!" dhe i binte bretku gjersa gjente myshterinjtë. Po ky djalosh që rrinte vazhdimisht i menduar punonte në fshat arat e beut. Po ky djalosh kulloste bagëtinë dhe terë ditën e ditës, nga do që i hidhte sytë, vështronte vetëm ujrat e liqenit. Dhe po ky çunak, po në këtë moshë të mitur, u pajtua si shërbëtor në një han të qytetit, jo me lekë, jo me rrogë, por vetëm sa për të fjetur në ndonjë nga grazhdet e hanit".[5] Që nga hapat e parë të jetës, Sterjua e shijoi mirë idhtësinë që shkakton vorfërija dhe shtypja shoqnore. Familja e tij nuk ngihej as me bukë misri. Në katundin e Spasses „kishin hedhur rrënjë të thella varfëria, shtypja, urija padrejtësia shoqërore, përbuzja dhe tirania". Aty (në Gllomboq dhe në Nivicë)- vijoi mësimet fillestare në shkollën greke. Më 1925 u ba nxanës i shkollës së parë të krahinës së Prespës që u hap në Goricë të Madhe. „Familja e tij shum e vorfër, si dhe familjet e tjera fshatare, mezi mbaheshin në jetë. Uria kërcnohej si asnji herë ma parë". Baba i Sterjos, kujdestar i nji familje me 38 antarë, meqenëse në vendlindje nuk gjeti shtegdalje nga kjo gjendje e vështirë ekonomike, muer disa herë me radhë rrugën e gjatë të gurbetit për Amerikë e gjetiu. Prej andej kthehej i falimentuem si shum bashkëvendas të tij. Taksat shtetnore, obligimet e shumta, „borxhi mbi borxh dhe fajdeja ndaj begut e çifligarët", shtoheshin për ditë e ma tepër.

Gjendja ekonomike e shoqnisë shqiptare të kohës së Zogut ishte ma se e mjerueme. „Rrënimi i ekonomive të vogla dhe ngritja e numrit të të papunëve solli shtimin e borxheve. Gjendja e borxhlijve u ba e vajtueshme, kurse ajo e uhadhanësve jashtë-

---

5) F. Gjata: *Shkrimtari Sterjo Spasse*, Nendori, 12, Tiranë 1964

zakonisht e privilegjuar, sepse kërkesat e mëdha për borxhe ngritën përqindjen e kamatës. Gjatë këtyne viteve, në shum raste, fajdeja arrijti deri në 100 përqind. Të llogarituna përafërsisht, borxhet e fshatarëve në vitin 1933 qenë rreth 20 milion franga ari, gati sa ishte edhe buxheti i shtetit".[6] Këtë gjendje të mjerueshme Spasja,si edhe Migjeni e shum shkrimtarë të tjerë e paraqet me mjaft realizëm në veprat e veta. Shumica e krijimeve artistike letrare të kësaj periode flasin për këtë jetë të vështirë të vogjëlisë së katundit e të qytetit.

Në shum tregime dhe artikuj të Sterjo Spasses, tue fillue që prej botimit të shkrimit të parë më 1929 në revistën. „Normalisti" me titull *„Kush duron, trashigon"*, gjithashtu paraqitet jeta e vështirë e skamnorëvet. Nxanësi i Shkollës normale t' Elbasanit u ba qysh atëherë bashsëkpuntor i gazetave dhe revistave t'asaj kohe, si: „Zëri i Korçës", „ABC", „Rilindja" dhe „Bota e re". Shpeshherë ai nënshkruhej edhe me pseudonimet Zaveri, Stespa, Mburimi, Gj. Zaveri, Hamleti i Shqipes, etj. Tue shkrue për plagët shoqnore të shoqnisë së kohës së tij, herë-herë ngriti zanin dhe kritikoi të metat e shoqnisë. Jeta e fshatarit të vorfën, të mbytun në bestytnitë shekullore, tragjeditë e mërgimtarëve, fejesat dhe martesat jo harmonike — në nji anë, dhe ndamjet tragjike të të rijve — në anën tjetër, preokupojnë shkrimtarin e ardhshëm. Ai, meqenëse bante jetë skamnori, vaji për ta i rrinte në buzë.

Fshatari mërgimtar Pavlloja dhe e shoqja Dina, janë fytyra fatkeqe të tregimit të parë të Spasses — *„Dashuri pa fat"*, që u botue më 1930 në gazetën „Zëri i Korçës". I njajti fat i pret edhe të fejuemit në novelën — *„Përmbi varrin e dashnorit"*. Marjana, vajzë fshatare, për shkak të humbjes së të dashtunit, ban vetëvrasje tue u hedhë në liqen. *„I mërguemi"* asht titulli i novelës së botueme në revistën „Illyria" më 1934, ku përsëri, në formë monologu, mërgimtari shpreh brengat e veta jetsore në vendin e huej dhe mallin e madh për jetën e kalueme në fshatin e lindjes. Tue lexue novelën *„Në pragun e vdekjes"*, të botueme në revisten „Normalisti" më 1934, me dhimbsuni të posaçme lexuesi ndjek edhe fundin e jetës së vajzës vorfanjake fshatare, Afërditës.

Në krijimtarinë e Spasses nga jeta e fshatit hasim mjaft elemente autobiografike. Jeta e mundimshe e fshatarit, në novelën *„Babai"*, ka shum gjasa të jetë vetë gjallnimi i plakut Spasse.

---

6) *Historia e Shqipërisë*, II, Tiranë 1965

Prindi i rraskapitun, nëpër mot të lig me fërfëllazë e borë, shkon në qytet për të shitë nji barrë dru e për t'u kthye sa ma parë me pak miell, si shpëtimtar i vetëm i fëmijvet. Dhe ashtu shumë ditë. Por, kur kthehet i sëmunë, i drejtohet vetvetes: „Mirë sot! Po nesër?" Pyetja „por nesër?" me të cilin autori e mbyll prozën e vet *„Babai"* (të botueme në revistën „ABC" më 1936) ndëgjohej aso kohe prej shum e shum skamnorëve anembanë vendit. Ishte koha kur misrit i thureshin apoteoza. Si me e mbajtë fryмën në ditët e vështira? Uria që kërcnohej si përbindsh, shkurtonte pa mëshirë jetën. E tanë kjo gjendje kaotike, që ishte si pasojë e politikës avanturiste të mbretit Zog e të bashkëpuntorëve të tij, si reakcion kishte paknaqësinë e masave, pakënaqësia që fillon të shtohej e të merrte përpjestime të gjëra në dimrin e vitit (1927—1928) ... Mjerimi gjatë atij dimri arrijti kulmin. Uria përfshinte të gjitha krahinat dhe sidomos fshatarsinë e malsive të veriut"...[7]) Deri më 1935, jo vetëm që nuk u përmirsue gjendja e popullsisë, po u keqsue edhe ma tepër dhe „zija e bukës mori përpjestime katastrofale. At vit grumbulloheshin me mijra vetë, me gra dhe fëmijë, të zbathur e të zhveshur, përpara dyerve të prefekturave dhe nënprefekturave dhe kërkonin misër. Turma të uritunish dhe qindra fëmijë sileshin nëpër rrugët e qyteteve duke lypur bukë. Zija e bukës preku jo vetëm krahinat e varfëra por edhe rrethet bujqësore të vendit".[8])

Mjerimin e skamnorëve t'untë t'asaj kohe Spasja e përshkroi me mjeshtri të madhe në prozë me tematikë nga jeta e katundit. Të kësaj tematika janë edhe skica e Migjenit *„Legjenda e misrit"*, proza e Nonda Bulkës *„Intervistë me malsorin"* dhe ajo e Shefqet Musarajt *„E mjera"*. *Deri sa* M i g j e n i përshkruen malsorin që bjerr shum cilsi të karakterit të tij para nëpunësit që shpërndan misër, „misër për fëmijë t'untë", N o n d a B u l k a përshkruen mjaft dhimbshëm malsorët që me buzët e shkrumueme nga uria nuk kanë ma buzëqeshjen e dikurshme krenare e tradicionale, kurse M u s a r a j përshkruen rropatjet jetsore të nanës me tre fëmijë, të cilët mjerimi i kishte pjekë para kohës.

Shumica e këtyne krijimeve artistike, tue trajtue nji tematikë shoqnore të kohës, nxtshin forcat progresive t'i rezistojshin regjimit në fuqi. Prandej, me të drejtë konsiderohen si akuza të

---

7) *Historia e Shqipërisë*, II — vepër e cituame.
8) Ibid

Prindi i rraskapitun, nëpër mot të lig me fërfëllazë e borë, shkon në qytet për të shitë nji barrë dru e për t'u kthye sa ma parë me pak miell, si shpëtimtar i vetëm i fëmijvet. Dhe ashtu shumë ditë. Por, kur kthehet i sëmunë, i drejtohet vetvetes: „Mirë sot! Po nesër?" Pyetja „por nesër?" me të cilin autori e mbyll prozën e vet *„Babai"* (të botueme në revistën „ABC" më 1936) ndëgjohej aso kohe prej shum e shum skamnorëve anembanë vendit. Ishte koha kur misrit i thureshin apoteoza. Si me e mbajtë frymën në ditët e vështira? Uria që kërcnohej si përbindsh, shkurtonte pa mëshirë jetën. E tanë kjo gjendje kaotike, që ishte si pasojë e politikës avanturiste të mbretit Zog e të bashkëpuntorëve të tij, si reakcion kishte paknaqësinë e masave, pakënaqësia që fillon të shtohej e të merrte përpjestime të gjëra në dimrin e vitit (1927—1928) ... Mjerimi gjatë atij dimri arrijti kulmin. Uria përfshinte të gjitha krahinat dhe sidomos fshatarsinë e malsive të veriut"...[7]) Deri më 1935, jo vetëm që nuk u përmirsue gjendja e popullsisë, po u keqsue edhe ma tepër dhe „zija e bukës mori përpjestime katastrofale. At vit grumbulloheshin me mijra vetë, me gra dhe fëmijë, të zbathur e të zhveshur, përpara dyerve të prefekturave dhe nënprefekturave dhe kërkonin misër. Turma të uritunish dhe qindra fëmijë sileshin nëpër rrugët e qyteteve duke lypur bukë. Zija e bukës preku jo vetëm krahinat e varfëra por edhe rrethet bujqësore të vendit".[8])

Mjerimin e skamnorëve t'untë t'asaj kohe Spasja e përshkroi me mjeshtri të madhe në prozë me tematikë nga jeta e katundit. Të kësaj tematika janë edhe skica e Migjenit *„Legjenda e misrit"*, proza e Nonda Bulkës *„Intervistë me malsorin"* dhe ajo e Shefqet Musarajt *„E mjera"*. *Deri sa* M i g j e n i përshkruen malsorin që bjerr shum cilsi të karakterit të tij para nëpunësit që shpërndan misër, „misër për fëmijë t'untë", N o n d a B u l k a përshkruen mjaft dhimbshëm malsorët që me buzët e shkrumueme nga uria nuk kanë ma buzëqeshjen e dikurshme krenare e tradicionale, kurse M u s a r a j përshkruen rropatjet jetsore të nanës me tre fëmijë, të cilët mjerimi i kishte pjekë para kohës.

Shumica e këtyne krijimeve artistike, tue trajtue nji tematikë shoqnore të kohës, nxtshin forcat progresive t'i rezistojshin regjimit në fuqi. Prandej, me të drejtë konsiderohen si akuza të

---

7) *Historia e Shqipërisë*, II — vepër e cituame.
8) Ibid.

tij",[10]) Këto ngjarje kaq tronditëse shoqnore nuk i parajiti në fazën e parë të krijimtarisë artistike. Disa vjet ma vonë ai do të shkruej për jetën shoqnore në të kaluemen, tue dhanë vepra voluminoze. Në nji numër të madh prozash të shkurta, që autori i quen proza alegorike a novela, gjithashtu përshkruen gjendjen sociale të shoqnisë shqiptare dhe shprehet për çlirim nga ajo gjendje. Në prozën *„Zëri i zemrës së trëndëfilit"*, botue në revistën „Ars" të Korçës më 1930, shkruen: „Në kraharorin tim bëj zetarën burrëreshë e trime. Zemra ime rreh dhe zëri i saj është: Liri, Liri! Ky zë është një mjë herë më i fortë se zëri i zemrës suaj, o armiq! . . ."

Spasja këtu shprehet për liri sociale. Trandafili i lënduem simbolizon vegjëlinë e pafajshme që, në të vërtetë, asht guximtare dhe ka nji moral ma të fortë se „armiqtë", shfrytzuesit e çdo lloji. Në nji prozë tjetër me titull *„Përralla e lumit"*, të botueme më 1933 në gazetën „Kosova" në Kostancë, me ngashërim ban pyetje: „Kur, o zot, kanë për të pushuar vajet e ulurimat e popullit të robëruar shqiptarë?". Hamleti i Shqipes (pseudonimi i autorit) i urrente pa masë të pasunitë, që silleshin pa brenga, tue kalue në gazmend nëpër kafehane e bulevarde të kryeqytetit. N'anën tjetër, të vorfnit dergjeshin t'untë nëpër trotuare. Në prozën e vet u drejtohet shkamnorëve: „Hej mumje egjyptiane t'ekspozuar në bulevardin e pispillosur, qeshni e buzëjeshni edhe ju!".

Nga të dyja këto proza shihet qartë qëndrimi i shkrimtarit ndaj klasave shoqnore antagoniste, dhe pikëpamjet e tij si intelektual janë njikohësisht mjaft aktive. Me kalimin e kohës, në veprën e tij vërehet nji farë shtimi gradual i urrejtjes ndaj shtypësve, tiranisë dhe padrejtësisë. Në dy përmbledhjet e para të tregimeve: *„Kunorë rinije"* dhe *„Në krahët njij femne"* kryesisht nuk shtrohet ndonji problematikë interesante shoqnore. Në ndonjenën prej këtyne prozave, si në tregimin *„I mërguemi"*, tue ba fjalë për gurbetin, shprehet malli i madh për gjithçka që i takon vendlindjes.

Më 1935, në prozën alegorike *„Pellgu"* autori, tue shprehë mllefin kundër kalbsinave të kohës dhe shtypësve, tregon rrugën drejt ardhmënisë së lumtun të njerëzisë: „. . . Por, më së fundi, helmi do të ketë të sosur, gjembushkat e ferushkat mund të hi-

10) F. Gjata: *Shkrimtari S. Spasse*, artikull i cituem

dhen në lendinë për t'u kthyer në vjollca e trëndafila dhe atëherë pelgu, ehu! — pelgu me gjëmbat e me ferrat e katranosura do të mbulohet nën shkëmbenjtë e shekullit, se atje lart, sipër tyre, po ndihet pa rreshtur jehona ... e njerëzisë së pastër".[11])

Në këto proza të para e mandej edhe në romanet e mavonshme Spassja godit zakonet e mbrapshta të shoqnisë shqiptare, të cilat ishin pengesa serioze në rrugën drejt përparimit të përgjithshëm.

Autorët e veprave të letërsisë realiste shqipe të kësaj periode shquhen për kah tematika shoqnore. Por — në letërsinë shqipe kritikën e dukunive negative në shoqni e hasim edhe te romantikët, që kanë shkrue shum ma heret. Antagonizmat ndërmjet shtresave shoqnore u vunë në dukje në letërsi që nga pjesa e parë e shekullit XIX. De Rada e shenon për bukuri diferencimin ndërmjet shtresave shoqnore të shoqnisë s'atëhershme. Edhe poetët tjerë mbas tij trajtojnë disa tema sociale mjaft aktuale të kohës së tyne. Naim Frashëri, disa vjet ma vonë, në veprën *„Bagëti e bujqësi"*, gjithashtu ve në pah dallimin e madh ndërmjet të pasunve e të të vorfënve. Por, ai mendonte se shtresat antagoniste shoqnore duhet t'afroheshin nëpërmjet të mirëkuptimit reciprok. Të pasunit, simbas tij, duhet me u dhanë të vorfënvet. Këtu Naimi paraqitet utopist. Mandej, edhe Mjeda dhe shkrimtarë të tjerë u rrekën të trajtojnë ngjarje me tematikë social në veprat e tyne. Ndër realistët shqiptarë që trajtuen këtë tematikë në nji platformë ma të gjanë, konsiderohet me të drejtë Çajupi. Ai, si shkruen Vojislav Dançetoviq në studimin përkitazi me veprën e Çajupit: „Në radhë të parë qëllon zakonet e mbrapambetuna katundare të vendlindjes së vet. Sidomos tehun e mprehtë satirik të tij e drejton kundër burrave që të gjitha punët e randa të shtëpisë dhe të katundit i lanë pa mëshirë mbi kurriz të grues... Nji problem kryesor (si edhe Sterjo Spasja në tanë veprën e vet — I. Sh.) e sheh në gjendjen e vështirë familjare të mërgimit. Për shkak të vështirsive ekonomike t'atdheut të robnuem, mashkujt me shumicë shkojshin si puntorë-krahu jashtë atdheut, që të fitojnë bukën".[12])

Spasja, ashtu si Çajupi e shkrimtarët tjerë para tij, çon zanin kundër martesave të mbështetuna n'interesin material dhe kund-

---

11) V. Dançetoviq: *Andor Zoko Çajupi* — Vepra, Prishtinë, 1963
12) V. Dançetoviq: *Andor Zoko Çajupi* — Vepra Prishtinë, 1963

ra dukunive të tjera negative individuale dhe shoqnore. Në nji seri punimesh ai paraqiti mjaft probleme, dhe jo vetëm që shprehet për zgjidhjen me çdo kusht të tyne, por tue i tregue me gisht shkaktarët dhe bartësit e dukunive negative në familjen shqiptare, njiherit edhe i dënon.

Si bir fshatari, ai i kishte pa prej s'afërmi të gjitha dukunitë mbrapanike në shoqninë shqiptare. Tue reague ashpër, si intelektual dhe edukator, Spasja hyni në vallen e atyne që damkosin çdo gja të damshme e konzervative. Më 1930 botoi prozën *„A do ta shof"*, ku bariu Bojko, i fejuem me nji vajzë që s'e kishte pa kurr, ishte tejet i shqetsuem për fatin e vet. Megjithse jeta konzervative në fshat asht paraqitë me mjaft fuqi dhe realisht, çka asht karakteristikë e autorit, në këtë prozë nuk janë dhanë edhe konfliktet e tjera të shumta në kuadër të familjes shqiptare. Nga teksti i prozës lexuesi fiton përshtypjen se autori brengoset shum për fatin e të rijve.

Spasja nuk i la pa kritikue as mendjelehtët e qytetnuem para kohe, sidomos ata që shkolloheshin apo kalojshin nji kohë ma të gjatë jashtë vendit, në qytetet e perëndimit. „Ndërkaq, qytetërimi i sipërfaqshëm përparon, të rinjtë bijnë viktimë, ditët kalojnë mënxyrë dhe qytetërimi i vërtetë ngulçon nën modën e fundit të sjelljeve e të pillimeve", shkruente prozatori ynë në novelën alegorike *„Dallëndyshe, ktheja ndryshe, moj... Zonjushe!"*, të botueme në „Rilindja" më 1935. Penda e tij ishte e mprehtë edhe kundër hipokrizisë shoqnore të kohës. Në prozën *„Te praku i dy botëve"* përballë hipokritëve ve luftarët e denjë të hipokrizisë: „Njerëzit që luftojnë Hipokrizinë janë të zbehtë, të krusur, të përbuzur, të pangopur me punë, melankolikë, t'ashpër dhe qëndrojnë larg dëfrimeve. Numri i antarëve është i vogël, përfundimi i djersës së tyre është fare i pakët, çpërblim hiç. Me gjithë këtë punojnë, vuajnë dhe luftojnë! Çudia më e madhe është se këta duan të vdesin jo për pasuri, jo për dëfrim; as për prehje, por... për të vërtetën e Botës së tërë!..." Nji kamxhik tjetër u bie edhe bixhozxhijve, gazetarëve mendjelehtë e rrenacakë t'asaj kohe, fajdexhijve, nëpunësve ryshfetxhij, studentëve mendjemëdhej, vajzave kurtizane, mësuesve konzervativë e të plogët etj.

Kontributi i Sterjo Spasses në damkosjen e të metave individuale dhe shoqnore, kontribut qe i ndieshëm edhe në prozat tregimtare të dhetvjetëshit të tretë të këtij shekulli, u shtue edhe ma tepër në romanet e mavonshme.

Lavrimi dhe pasunimi i prozës artistike shqipe asht meritë e posaçme të Spasses. Kur u botuen romanet e tij, proza shqipe nuk kishte ndonji rrugë të gjatë. „Ndoc Nikaj — si shkruen R a z i B r a h i m i — futi në historinë e letërsisë sonë vitin 1899, me botimin e të parës romancë në gjuhën shqipe. Para tij, proza shqipe ishte shumë e pazhvilluar, që të mos themi se nuk ishte dukur ende në fushën letrare".[13]) Këtë rrugë të nisun e vazhdon edhe ma tutje Ndoc Nikaj me romanet e veta. Ai më 1913 vazhdon të botojë veprat e tij të shumta në prozë. Prandaj, me të drejtë merret si prozatori ma i frytshëm deri në mbarimin e Luftës së dytë botnore. Që nga fillimi i shekullit XX shquhet si prozator M i h a l G r a m e n o, i cili trajtoi nji tematikë interesante shoqnore, tue kultivue i pari novelën shqipe. Me Gramenon për herë të parë njerëzit e shtresave të varfëra të shoqërisë, me brengat e tyre, nisin të zënë kaq vend në letërsinë shqiptare. Novelat e Gramenos u çelnin kështu rrugën romaneve të Nikajt që do të botoheshin menjiherë pas tyre (1913—1924)"[14]).

Me novelat *„Oxhaku"* dhe *„E puthura"* Gramenua paraqit antagonizmat klasore të shoqnisë shqiptare të kohës së tij. Novelisti asht i bindun se marrëdhaniet ndërmjet shtresave e klasave shoqnore të ndryshme ishin shum t'acarueme. Në kohën e tij, martesa e të vorfnit me të pasunën dhe anasjelltas, në raste shum të rralla, realizohej me sakrifica të mëdha. Ndër familjet patriarkale kishte si pasojë tragjedi të padëshirueshme familjare. Tue ba fjalë për veprën e Gramenos, Spasja shkruen se „ideja qëndrore" e shkrimtarit në novelën *„Oxhaku"* ka qenë „të tregonte se bashkëpunimi dhe miqësimi i klasës feudale me fshatarësinë e varfër me anë të martesave do të sillte paqë e lumturi në Shqipëri".[15]) Edhe Spasja në fillim nuk kishte të njajtat pikëpamje si Gramenoja. Mendonte se martesat e tilla edhe ma tepër shkaktojnë largimin e klasave shoqnore ndërmjet tyne sepse kishte nji urrejtje të pashembull ndaj klasës shfrytzuese feudale. Spasja e adhuronte pa masë Gramenon si patriot dhe shkrimtar. Veçanërisht e çmonte shum si pamfletist të talentuem; prandaj, në fazën e parë të krijimtarisë letrare, ndoqi rrugën e tij. Vetëm se, derisa autori i *„Kryengritjes shqiptare"* kishte ma tepër prir-

13) R. Brahimi: *Shënime letrare*, Tiranë 1965
14) Dh. Shutariqi: *Historia e letërsisë shqipe*, II, Tiranë 1965
15) S. Spasse: *M. Grameno dhe proza e tij*, parathanie e veprës „Kryengritja shqiptare", Tiranë 1959.

je për të trajtue tema patriotike, Spasja kacafytej me problematikën sociale të kohës. Mbas Gramenos shtekut të çelun në lamën e letërsisë u nis Foqion Postolli dhe gjenerata e periodës 1930—1940. Megjithate, në letërsinë shqipe t'asaj kohe ndihej nji shterpësi, për të cilën ban fjalë edhe Spasja në prozën alegorike „*Shterpësi letrare*" (botue në gazetën „Drita" më 1938): „... Bota letrare e jonë, sot për sot, është e ndrydhur mbrenda në disa dhomëza të tilla të thjeshta e të shpërndara an'e kënd Shqipërisë. Këto dhomëza ruajnë nga ndonji rreze të zbehtë të poezisë e të prozës së re kombëtare. Le t'i banim dyert e këtyne dhomëzave dhe le të ndjekim çap pas çapi me kërshëri dritën e këtyre rrezeve e do të shohim pastaj se sa shumë të kënaqur kemi për të qenë nga prodhimi i ynë letrar".

Në këtë periodë „librat që botoheshin mbrenda një viti mund të numroheshin me gisht. Të çudit fakti që n'ato vite janë botuar shum libra fetare, sidomos nga kleri katolik dhe ai musliman. Disa prej tyre ishin vepra letrare me subjekte nga historia e fesë, kurse shumiva ishin traktate fetare".[16])

Gjatë regjimit absolutist të Zogut binte në sy nji farë kaosi e ndihej nji farë atmosfere mbytëse edhe në jetën kulturore të vendit. Zhvillohej nji luftë e ashpër ideologjike ndërmjet elementeve demokratike e përparimtare — në njenën anë, dhe atyne reakcionare, përfaqsuesve të regjimit në fuqi — n'anën tjetër. Presioni nga ana e aparatit shtetnor ishte i madh dhe i padurueshëm. Aq sa ishte i pamëshirshëm shfrytëzimi ekonomik e social ndaj masave të gjana, aq ishte edhe presioni ideologjik e politik në rradhët e intelektualëve. Tanë kjo e forconte rezistencën kundra regjimit. Intelektualët përparimtarë ndiqeshin e troturoheshin zi e ma zi. Pendat letrare t'asaj kohe ishin izolue nga jeta politike e vendit. Çajupi shkruente atëherë vargjet e fundit jashtë atdheut. Noli qe arratisë n'Europë e, ma vonë, u vendos përgjithmonë n'Amerikë. Vargu mjedian ishte ndërpre; poeti merrej me gjuhësi. Për ta shue revolucionarizmin e Migjenit, ministria e atëhershme e arsimit e kishte transferue në nji katund të lanë, në Pukë. Por Migjeni, edhe i izoluem kështu, nuk u dorëzue. Shpirti i tij revolucionar nuk u shue.

Shkrimtarë të gjeneratës së tridhetës, si Haki Stërmilli, mbyteshin në burgje si elementë të rrezikshëm. Edhe Spasja

16) N. Jorgani — artikulli i cituem

sa ishte normalist qe burgosë nga ana e nji agjenti, por qe lirue mbas nji jave. „Ky ishte pagëzimi i parë i Spasses në luftën kundër padrejtësisë shoqërore, peshën e së cilës ai vazhdonte ta ndjente edhe ma tepër" — shkruen bashkëkohësi i tij, Fatmir Gjata.

„Në letërsinë tonë t'asaj kohe nisi nji luftë e hapët ndërmjet drejtimeve të ndryshme krijojnjëse, një luftë që u pasqyrue edhe në letërsi, por që u shpreh parasegjithash në vetë krijimtarinë letrare. Kërkimi i shtigjeve të reja letrare ishte në rend të ditës, dhe nuk diktohej prej ndikimeve të jashtme, aq sa përcaktohej prej zhvillilmit shoqëror e letrar të vendit. Ishte kohë kontradiktash të medha e të ashpra ekonomike, ideologjike dhe shoqërore".[17]) Në këtë atmosferë shoqnore, përveç atyne që ishin përfaqsues të letërsisë zyrtare pseudopatriotike, ishin edhe ata të rrymës progresive: Gaspar Pali, Kolë Mirëdita, Migjeni, Qemal Stafa, Nonda Bulka, Dhimitër Shuteriqi, Petro Marko, Sterjo Spasse, Kristaq Cepo, Andrea Varfi etj. Në Jugosllavi, gjithashtu në kushte shum të vështira të popullit shqiptar t'asaj kohe, Esad Mekuli thurte vargjet e poezive të tij të njoftuna me tematikë sociale. Derisa Migjeni qante me lotë hallet e skamnorëve dhe çonte zanin kundër hipokrizisë dhe shfrytëzimit, kishte edhe pseudo poetë reakcionarë që i kushtonte hymne trashigimtarit të fronit mbretnor dhe fashizmit italian.

Shkrimtarët përparimtarë të letërsisë demokratike merreshin me trajtimin e ngjarjeve sociale, që „përbën një prej kontributeve ma të mëdha të letërsisë së asaj kohe, si në kuptimin ideologjik ashtu edhe në ate artistik".[18]) Në shumicën ev eprave të shkrimtarëve të këtij brezi shihet qartë edhe fryma revolucionare. Kishte poetë si Andrea Varfi, që tue ndie nji shpresë për çlirim të afërt nga gjendja e vështirë sociale, shkruente më 1932:

„Mos je dallgë e gjithësisë,
që të vjetrën shëmb mbi dhe,
për të shkrepur ditë' e re, gaz
i gjithë njerëzisë?"

(„SHIH SI RREH")

17) R. Brahimi: *Shënime letrare*, Tiranë 1965
17) R. Brahimi: Vepra e cituesme

I njajti poet, në vjershën *„Puntorët"*, shkruen më 1935, jep kushtrimin ma të guximshëm të kohës:

„Të çojmë grushtin! Minat botës vjetër!
Se ne do të farkëtojmë përmbi dhé
Një botë ma të mirë: botën tjetër!"

Në këtë grup shkrimtarësh u dallue posaçërisht Sterjo Spasja me idetë e tij sociale të shprehuna në krijimet letrare artistike. Si mësues fshati të mbrapambetun (Derviçan të Gjirokastrës) që ishte izoluem „me natyrë t' egër, larg ambientit të shkollës, ku mësuesi i ri kalloi rininë e parë, larg jetës kulturore dhe për ma tepër i deziluzionuar nga realiteti i hidhur feudalo-borgjez nga shtypja dhe varfëria, autori nis e shkruen romanin *Pse?!...* që e mbaroi në fillim të vjetit 1933".[19]) Aty shkrimtari shprehte reagimin e vet dhe t'intelektualëve tjerë ndaj realitetit, ndaj shoqnisë, që dallga famkeqe zogiste e kishte hedhë në qreminë. „Merita kryesore e Spasses është se kapi një temë me karakter shoqëror dhe i vendosi ngjarjet në kohën e tij, pa u shtyrë në të kaluarën".[20]) Mbas njizet e dy vjetësh, që prej kohës kur ishte hartue vepra, vetë autori evokonte kujtimet e tij në lidhje me aktivitetin letrar të kohës së perëndueme, e njiherit përcaktonte se me çfarë motivacioni kishte shkrue romanin *„Prej jetës në jetë: Pse?!..."*. N'artikullin *„Njëmbëdhjetë vjet n' atdhe të lirë"* (botue në „Shqipëria e Re", nr. 12, 1955), ai shkruen: „Në vitin 1933, kur isha akoma i ri, botova romanin tim të parë *Pse?!...* Në te u përpoqa ta pasqyroj atë kaos që kish pushtuar një pjesë të rinisë intelektuale, që kish humbur shpresën dhe besimin më një të ardhme më të mirë. Heroit tim kryesor jeta i dukej aq e randë dhe errët, sa që kjo e çoi në urrejtje ndaj gjithë njerëzimit. Ai nuk vëren disa anë pozitive të jetës, dhe arrin deri në nihilizëm, në vetëvrasje, duke mos u përpjekur të fillojë luftën kundër rrethit feudalo-borgjez, i cili e çoi ate deri në një fund tragjik".

Pra, e vërteta asht se Spasja faqet e romanit i shkroi në kohën kur posa doli nga bankat shkollore. Jeta i dukej ma pelin se kurrnjiherë ma parë. Fshati i mbrapambetun ku punonte, mbytej në skamje. Askund nuk gjindej dot shpëtimtari i fshata-

19) N. Jorgaqi: Artikulli i cituem
20) Ibit

rëve. Injoranca, padia, konzervativizmi, zotnojshin ndër fshatarë. N'anën tjetër, ai kishte pa vetë shtresat e vorfna qytetare si ishin „katandisë" e zvarisë në pus të pafund. „Opinga" shtrydhej nga shfrytëzuesit e pashpirt. Edhe vetë autori kalonte nji jetë të vështirë. Familja e tij nuk shihte ditë të bardhë. Dëshprimi nga kjo gjendje e kishte molisë djaloshin dhe gati e kishte hudhë nga binarët e jetës. „Dëshprimi, — nënvizon Lenini — asht karakteristikë e klasave që janë në mbarim e sipër... Dëshprimi asht karakteristikë e atyne që nuk i kuptojnë shkaqet e së keqes, nuk shikojnë rrugës tjetër dhe nuk janë të zotët të luftojnë".[21]) Nji dëshprim i tillë kishte kaplue padyshim edhe Sterjon që shprehet mjaft bukur në veprën e tij letrare.

Jeta njerzore asht mjaft komplekse, kur me plot vuejtje e mundime, e kur plot shend e lumtuni. Dramaticiteti jetsor e flak qenien njerzore herë në disfatë e herë në triumf. Vuejtjet, gëzimi, idhnimi, vaji e gazi, urrejtja e dashunija, dëshprimi dhe shpresa, janë manifestimi i vetë jetës. Mirëpo, dëshprimi pa masë i njeriut në jetë s'asht tjetër veç shkrumb i pasosun, nji përshëndetje e fundit me të mirat e jetës. Dëshprimi i pafund e ban njeriun pesimist dhe për te s'ka as dritë e as nuk gjëndet kund shteg e mënyrë jetese. Spasja, tue pasë ende nji kuptim të trubullt mbi botën dhe shoqninë e kohës kur shkroi romanin, nuk qe i vetëdijshëm se perspektiva e re hapet vetëm kur qenia shoqnore si individ dhe shoqnija si tanësi, tue ba përpjekje të përditshme, me sekrifica e vuejtje, me humbje e ngritje të mundimshme, marshon drejt t'ardhmes ma të bukur. Por, edhe nëse vetë Spasja ka qenë i vetëdijshëm për të gjitha këto, ai gjatë atyne viteve shifte se çdo përpjekje e intelektualëvet për përparim dhe perspektivë përfundonte me persekutime të organeve qeveritare. Çdo shpresë për nji jetë ma të lumtun ishte vetëm iluzion. Për Spassen „si për të gjithë rininë intelektuale përparimtare, ishin vite kur thërmoheshin si kala prej rëre ëndrrat dhe shpresat e bukura, dhe vendin e tyre e zinte deziluzioni i plotë e i gjithanshëm. Jeta e kish goditur rëndë Spassen dhe kish shtruar para tij pikëpyetjen e madhe: Pse të ndodhin të gjitha këto?... Sterjo Spasja nuk e gjeti dot dhe s'kish si ta gjente n'atë kohë përgjigjen e *pse-së* që i dilnin përpara në çdo hap që bënte".[22])

---

21) V. I. Lenin: *O kulturi i umetnosti*, Kultura, Beograd 1957
22) N. Jorgaqi — artikulli i cituem

Në të tilla rrethana jetsore, i nxitun nga shoqnia së cilës i takonte, para romanit në fjalë shkroi tregimin *„Te varri i botës!..."*, që edhepse i botuem ma përpara në përmbledhjen e parë të tregimeve *„Kunorë Rinije"*, u përfshi edhe në faqet e romanit *„Pse?!..."* dhe padyshim shërbeu si tharm që „të vijë" edhe ma shpejt brumi i romanit. Autori në veprën letrare shpreh skepticizëm përkitazi me jetën dhe shoqninë njerzore. Këtu, atij për të parën herë i rrëshqet dheu nën kambë. Jetën e sheh si nji vorr të pafund. Tue u kapë edhe për ndonji degëze të filozofisë dekadente të kohës, dyshimi, përkitazi me vleftën e jetës, i shtohet edhe ma tepër. „Shiko dhe mendo, e pastaj, po qe se do, vepro. Atje je ti, por edhe s'je ti! Jeton, por edhe s'jeton... Myster o jetë, o vdekje! O jam,... o s'jam!", shkruen skeptiku në prozën *„Te varri i botës"*.

Si u pa, autori i romanit të përmendun ishte plagosë randë nga realiteti i hidhët shoqnor i kohës dhe s' gjente shërim. Çka asht edhe ma keq, si e pohon edhe ai vetë, u „helmue" edhe ma tepër tue lexue sidomos Niçen, Leopardin, Cvajgun etj. Ai kishte lexue shum edhe ma parë, por me leçitjen e veprave të disa shkrimtarëve reakcionarë, e bragtisi rrugën e fillueme ma parë. N'at kohë lexonte edhe shkrimtarët rusë e sidomos Tolstoin. Problemet që e preokupojshin tani kishin formue nji rreth mjaft të gjanë. N'epiqendrën e ideve të tij qëndronte çashtja e kuptimit t'ekzistencës së njeriut si individ dhe shoqnisë. Disa kritikë, si Vangjo Nirvana, Nasho Jorgaqi etj. në studimet e tyne mundohen me e spjegue notën dominuese të pesimizmit të Spasses në romanin *„Pse?!..."* si ndikim të thjeshtë të filozofisë reakcionare e pesimiste europiane. Ata potencojnë veçanërisht ndikimin e Niçes në shkrimtarin e ri, tue e pagëzue veprën e tij si fryt të filozofisë niçeane.

Niçeja — që asht nji ndër filozofët me botëkuptime të zymta — ka ndikue pa dyshim në autorin e romanit të mohimit. Sa i përket pesimizmit të Spasses mund të thuhet me siguri se ai asht i tipit niçean. Filozofi gjerman, Neçeja, shkruente: „Përse të jetojmë? Gjithçka asht smirë! ... Me jetue don të thotë me u djegë, e jo me u ngrohë".[23]) Por shkrmtari gjerman nuk ndikoi në romansierin e ri shqiptar me tanë sistemin e tij filozofik. Vetëm nji anë e filozofisë niçeane pati ndikim në veprën letrare të

---

23) F. Niče: *Kako je govorio zaratustra*, Beograd 1914

Spasses. Mohimi i vleftave morale e materilae të shoqnisë, skepticizmi ndaj jetës, nënçmimi i botës femnore etj. mund të konsiderohen si pikëtakime të këtyne dy shkrimtarëve. Mirëpo, urrejtja ndaj qenies njerzore, që shprehet me fuqi në veprën e Niçes dhe ideja e tij mbi rolin e Mbinjeriut nuk asht e pranishme në romanin e parë të Spasses.

N'anën tjetër, sa i përket qëndrimit inferior ndaj femnës që shprehet në roman, mund të konstatohet se autori ndoqi rrugën e Niçes dhe Shopenhauerit. Spasja atëherë lexonte shum. Nga shkrimet e tij kuptojmë se prej Tolstoit kishte lexue romanin *„Ringjallja"* dhe veprën *„Sonata e Kreutzerit"*. Spasja bani për vehte sidomos konceptin themelor e Tolstoit: „mos i kundërshto të keqes me dhunë" — koncept që asht i pranishëm në veprën letrare të romancierit tonë.

Nëpërmjet të ditarit, që asht forma ma e lehtë e prozës, autori përshkruen fatin tragjik të Gjon Zaverit, heroit kryesor dhe të personazheve tjera të romanit. Zaveri, meqenëse ishte shkëputë nga çerdhja familjare e fshatit, në qytet kishte njoftë edhe anën tjetër të medaljes së jetës. Gjoni, „nga që ka jetuar shumë kohë në qytet dhe për më tepër nga studimet që ka bërë, i ka humbur pothuaj të gjitha karakteristikat dhe zakonet e natyrës fshatare. Ai na paraqitet nga fillimi deri në fund si tip i një intelektuali me mendime dhe shprehi që ndryshojnë shumë nga ata të fshatit tonë" — shkruen N. Jorgaqi. Prej këndej, fytyra e heroit kryesor na duket e pabindshme në nji ambient tipik shqiptar, si paraqitet në roman.

Tani të shohim çfarë mendimesh i sillen vërdallë nëpër kokë protogonistit të romanit. Që nga fillimi ai paraqitet me bindjen se jeta e kësaj bote asht kotësi pa fund. Në nji formë gradacioni, ai së pari e bind vetëveten se jeta, teatri i madh i kësaj bote — si e quen ai botën me të gjitha gjallesat — jo vetëm që asht e çuditshme, por edhe pa kuptim. Këtë përfundim ai e nxjerr tue ndjek ndryshimet e mëdha në natyrë e shoqni dhe tue filozofue si nji shkollar i mësuem. Simbas tij, çdo krijesë asht dënue me shkatrrim, pra — edhe njeriu. Prandaj ç'i duhet vazhdimi e jetës? Këtu duhet dallue për cilën ban aluzion autori. Për jetën në tansi? Ai në të vërtetë shpreh mendimin se çdo hap në jetë asht kotësi. Por po marrim parasysh dhe ate që nuk asht shkrue në roman por në ndonji shkrim tjetër të tij, atëherë do të konkludojmë se asht kotësi vazhdimi i jetës së mundimshme, ku vogjë-

lia luen, në këtë „teatër të madhh", rolin e atij që kinse gjallnon. Nga proza e tij *„Bota u çthur"* (botue më 1935 në revistën „Ilyria") mësojmë se autori asht kundër jetës së mundimshe, ku mbretnon shfrytzimi dhe padrejtësia. Simbas tij, njeriu duhet të jetë shum i qëndrueshëm. Ai shkruen: „...të rrosh, po, të rrosh si një kreshnik ndërmjet egërsinash: puno për ideal, fol për të vërtetën, shkel mbi kërma pa mëshirë, dhe lufto çpifjen, gënjeshtrën!... Të rrosh, po, të rrosh deri sa të krijohet një jetë e re me njerëz të rinj... Do t'i vërtitem pyellit edhe unë, mënxyrës do t'i them stop! Ujin e trubullt do ta shterroj, gremina e kthepa, gjëmba e çdo gjë me këmbet e mija do t'i shtyp; do ta shlyej njollën mbi baliln e vulosur edhe do të hidhem atje larg, ku valon flamuri i lavdisë..."

Por, për fat të keq, nji qëndrueshmëni e tillë e intelektualit nuk ishte e mundëshme në shoqninë e atëhershme. Prandaj, edhe në roman, heroi jo vetëm që nuk përpiqet me qëndrue i pamposhtun prej stuhisë, por madje dorzohet vetë, pa ba ndonji akcion të vlefshëm.

Konflikti në vepër ngrihet përnjiherë. Protagonisti çfaq pakënaqsinë ndaj jetës e shoqnisë. Prindëve nuk u jep pëlqimin për fejesën e tij me vajzën fshatare, Afërditën. Dashuninë e karakterizon gjithashtu pa kuptimtë. Simbas tij, dashunia reale jo vetëm që nuk përmban asgja të vlefshme e njerzore, por asht edhe e damshme. „S'ka pse të hyjë në zemër dashuria e një vashe, e një femne." Dashunia ideale (platonike) asht e vetmja së cilës i falet Gjoni i turbulluem shpirtnisht. Në moshën e lulzimit të rinisë ai nuk e përfill dashuninë e Afërditës, fshatares së bukur, me të cilën dëshirojnë ta fejojnë prindët. Në të njajtën mënyrë, tue nënçmue femnën si qenie shoqnore, rrefuzon dashuninë e zonjës P., të nji grueje e cila e dashunon marrëzisht. Mandej s'e përfill as dashuninë e të bukurës Polé, vajzë qytetare së cilës i lind dashunia ndaj këtij djaloshi të pashëm. Zaveri luen rolin e nji kuklle shum të kandshme, por e cila s'ka zemër për të dashunue. Në roman ngjan të kemi mjaft elemente autobiografike. Edhe vetë autori, si pohojnë bashkëkohanikët e tij, pati në kohën e rinisë disa mospajtime me rrethin familjar. Prindët e martuen jo me vajzën që ky dashunonte, por me nji tjetër të cilën ai s'e kishte njoftë kurr ma parë. Prandaj, edhe reagimi ndaj martesave të tilla, ku prindët kanë fjalën kryesore asht shprehun plot fuqi.

II

Faza e dytë e veprimtarisë letrare të Sterjo Spasses përfshin kirjimet artistike hartue gjatë periodës 1936—1944. Në këtë kohë, që prej vjetit 1939, autori fillon të botojë novelat e përmbledhjes *„Nusja pa duvak"* dhe fragmentet e romanit *„Afërdita"* dhe disa tregime të tjera. Disa vjet ma vonë ai do të botojë edhe pjesën e dytë të romanit në fjalë, me titull *„Për jetën e re"*. Më 1956 veprën e botoi në tanësi, me titullin e ri *„Afërdita përsëri në fshat"*. Meqenëse romani u botue në kohën kur Spasja shkruente simbas metodës së realizmit socialist, ai tash hyn në fazën e tretë të krijimtarisë letrare. Prandaj, për këtë roman do të bajmë fjalë posaçërisht në kaptinën e tretë të këtij punimi.

Përmbledhja tjetër e novelave *„Nusja pa duvak"*, që autori e quen trilogji, konsiderohet si proza ma e bukur e letërsisë shqipe. Ajo asht akuzë kundër jetës patriarkale, kundër martesave të kurdisuna artificialisht — në saje të disa kodeve të Kanunit në Malsi. Me rastin e botimit të novelës së parë të trilogjisë *„Nusja pa duvak"* (në „Shkëndia" më 1941) u botue edhe ky shënim i Redaksisë: „Në disa vende të Matit ka qenë ky zakon: po t'ishin p.sh. në një shtëpi tre vëllazër e qëllonte që vdiste ndonjë nga ata më të vegjlit, atëherë të renë e tij e mirrte për grua i biri i vëllajt të madh, por duke pasur të drejtë të martohej më vonë edhe me një tjetër. Rreth këtij zakoni të rrallë, Sterjo Spasja zhvillon novelën e tij."

Sa dëshprim të madh shkaktoi vendimi i Ymer Agajt për t'u martue e kunata e ve katërdhetëvjeçare — Zejnepeja, me të birin e tij — Ahmetin, i cili ishte vetëm njizetvjeçar. Grueja e shtyeme në moshë e që Ahmeti e quen nanë, nuk i ban ballë këtij dëshprimi të madh. Prandaj rrëke lotësh i shkojnë për faqe, para Ahmetit i cili kishte pritë i lumtun të martohej me Merushen e bukur e të dashun. Me nji realizëm të fuqishëm në novelë asht dhanë edhe Hoxhë Efendiu. Me formulën e tij karakteristike „Zoti është i math", ai aprovonte nji martesë të tillë të pakuptimtë.

Martesa e Veli Bashës, i cili kishte kalue të pesëdhetat, me Merushen shtatëmbëdhetvjeçare — me që simbas mendjes së plakut duhej gjetë nji grue prej oxhaku — asht paraqitë gjithashtu me nji realizëm të fuqishëm. Në novelë kemi edhe kësaj here luftën e zakoneve të mykuna. Pjesë tjetër e trilogjisë, *„Shemra"*,

asht prozë ku shihen për bukuri përpjekjet e plakut që të realizojë me çdo kusht qëllimet e veta, pa u bazue aspak në normat morale që duhet të çmoheshin.

Mbresë të posaçme na le edhe tregimi „*Nusja*". *Dhandri* i ri, Rebiu, ditën e dasmës e pret me padurim shoqen e jetës që nuk e kishte pa kurr. Si i ri, ai shpresonte se fati do t'i ketë caktue nji nuse e cila do t'i pëlqente me të vërtet; por ditën e dasmës ai u habit pa masë: nusja ishte e vërbët. Tronditi jo vetëm djaloshin, por edhe tanë familjen e tij. Tue u gjetë ndërmjet dy zjarreve përcluese: fatit të tij cub dhe kanunit fuqiplotë e traditës konzervative familjare, i kumbojshin në veshë fjalët e t'jatit, Gani Agajt: „Mendo-e mirë nderën e oxhakut dhe gjakun para se të vendosish. Ky asht fati i yt!".

Fragmentet e romanit „*Afërdita*" u botuen në revistat dhe gazetat e kohës që prej marsit të vjetit 1939 dhe zgjuen interesim të madh ndër lexuesit. Më 1944 vepra u botue në tanësi, dhe qysh asaj kohe u ribotue disa herë. Ajo edhe sot konsiderohet si vepra ma e lexueme në letërsinë shqipe. Ky roman, mbas dymbëdhetë vjetësh, u botue edhe ndër ne dhe bani për vehte nji publik të gjanë lexuesish. Vepra „asht nji prej atyne veprave të letërsisë shqipe, që na ngazllejnë në nji mënyrë të posaçme, kryesisht me idenë e bukur dhe kuptimplote, funkcionale në çdo pikëpamje, e mandej edhe me shum elemente të tjera që e shprehin dhe e nxjerrin në dritë këtë ide, me soditjen graduale dhe inventive t'asaj që duhet trasformue artistikisht, që duhet thurrë për t'u krijue nji atmosferë përkatëse, me zhvillim gradual dhe të bukur të tezjës kryesore..."[24])

Spasja ishte edhe vetë mësues katundi. Problemet e arsimit i dinte mjaft mirë. Rrethanat e vështira jetësore të fshatarëve dhe mungesa e dijes dhe arsimimit të tyne, sa kishte shqetsue mësuesin e ri, aq ma tepër e kishte shty të reagojë ndaj kësaj gjendjeje. Nga nji regjistrim që kishte ba ai vetë në katund, kuptojmë se vetëm rrallë e tek gjëndej ndonji që dinte shkrim e lexim. Intelektualit dhe mësuesit, sinqerisht të shqetsuem edhe nga kjo statistikë, i lind ideja që në veprën letrare të trajtojë nji temë shoqnore shum aktuale për shoqninë shqiptare të kohës: arsimin dhe edukimin e masave fshatare. Kjo njiherit ishte prob-

24) H. Mekuli: *Sterio Spasse: „Afërdita"*, Jeta e re, 3, 1965

lematikë e afërt për shkrimtarin që, mbasi i kishte shpëtue stuhisë së filozofisë pesimiste, braktisi pikëpamjet e mbrapshta përkitazi me jetën dhe shoqninë. Autori përqafon optimizmin jetësor gorkian dhe ecën gjurmave të tij; prandaj, në romanin e tij të ri nuk qëllon ajo mjegullë e dendun e pesimizmit — që u ndihej në romanin e maparshëm. Por, tue idealizue fytyrën e heroinës kreysore dhe tue e konsiderue ate bartëse të gjithçkaje që asht progresive, mbërrijti me e entuziasmue lexuesin me sukseset e mrekullueshme të mësueses së re në ngritjen arsimore të fshatarëve. Sterjo Spasja në këtë kohë, nëpërmjet të veprës letrare, shpreh mendimin se arsimi asht faktori kryesor për transformimin progresiv të shoqnisë e posaçërisht për transformimin e shoqnisë shqiptare. Kjo ide i shërben njiherit si bazë stabile, mbi të cilën vendoset tanë subjekti i romanit. Ai, në këtë mes, nuk i merr në konsiderim edhe faktorët e tjerë gjithashtu shum të randësishëm, që luejnë rol vendimtar në zhvillimin e gjithmbarshëm të shoqnisë. Autori asht i angazhuem kryekreje me sëndërtimin e idesë themelore të romanit. Besimin ma të madh e ka në „motrat dhe vllazërit arsimtarë", të cilëve edhe ua kushton veprën, si „Kunorë adhurimi i mirënjohjeje".

Misionin e arsimit të masave, që ai e çmon si ma të randësishëm në shoqni, ia beson gjeneratës së re t'intelektualëve — që e përfaqson vajza e re Afërdita. Ajo ishte bijë e nji familjeje të vorfën qytetare. Qysh në fëmini, bashkë me prindët, kishte kalue nji jetë skamnore. Ditët e kandshme shkollore i kishin lanë kujtime të bukura e të pashlyeshme. Me nji fantazi të vrullshme, sa ishte e re, ngrite pallate të mrekullueshme e lulishte për jetën e ardhshme. Shpresonte se posa ta kryente shkollën, jo vetëm për vete që do t'i siguronte nji jetë të lumtun, por do t'u ndihmonte edhe prindëvet që kalojshin ditët e vështira të pleqnisë.

Por, dallgët e jetës e fërfëlluen mësuesen e re larg çerdhes familjare dhe Korçës që e donte aq shum. E ndan prej shoqeve më të cilat kishte kalue çaste aq të bukura. Ministria e arsimit e kishte emnue mësuese në nji katund shum të mbrapambetun, në Grykas. Romani nis me udhtimin e mundimshëm t'Afërditës drejt fshatit, që „kudo i dilte i shëmtuar, i lënë në mëshirë të zotit, dhe dora e njeriut s'kishte lojtur nga vendi as një gurr".

Që prej ditës së parë të punës, mësuesja e re dhe pa përvojë kupton se puna me fshatarë nuk do të jetë aspak e lehtë. Ajo

e autorit, aftësia e tij që në veprën letrare të skalitë një tip të tillë aq të dashun. Spasja, nëpërmjet të romanit, don me theksue me fuqi se arsimit të deriatëhershëm jo vetëm që i kishte kalue koha, por ai ishte edhe pengesë e madhe për përparimin e shoqnisë shqiptare. Për tanë sistemin e arsimit, mendonte ai, janë të domosdoshme të bahen ndryshime rranjësore. Simbas tij arsimi kërkon njerëz të rij, me pikëpamje të reja e përparimtare dhe metoda të reja pune. Në Grykas dhe në katundet tjera të mbrapambetuna shkollat ekzistojshin vetëm sa për sy e faqe. Për shkollën e vjetër të Grykasit në faqet e romanit bahet ky përshkrim: „Shkolla e fshatit është e mbuluar me thekërishte, me dy dritare si vrima hambari, me një derë t'unjtër si derë koteci, e ngrehur gjysmë mbi mur e gjysmë mbi garth. Orenditë janë shtatë banga të ndrequra si mos ma keq... Katër shufra thane e xhunga xhunga të vena n'ato kamare simbolizojnë disciplinën e njëherëshme shkollore". Mësuesit e gjeneratës së vjetër, si ishte ai i Grykasit, Zoti Remka dhe të tjerët, jo vetëm që gjatë punës së tyne nuk kishin arrijtë me i ngritë të tjerët në fshat, por edhe vetë kishin ra në nivelin e fshatarëve pa shkollë. Mësuesi „në të dhënunit mësim kishte... metodën e vet: një shufër të gjatë thane e xhunga-xhunga e mbante si të vetmin ndihmës të tij pedagogjik. Edhe shuplaka e fortë ishte një mjet tjetër nxitës. Bota mendore për Zoti Remkon kishte kalue kufijtë e përsosmënisë". Fytyra e vrazhdë e Remkos asht shprehë në roman me nji realizëm të fuqishëm. Ai përfaqsonte njeriun e pagdhendun, mësuesin pa takt pedagogjik, e njiherit gjeneratën e vjetër t'arsimtarëve. Si i tillë, ai kishte futë frigë te vocrrakët e pafajshëm. Në kët jetë anemike të katundarëve të vorfën, mësues si Remokja, që në roman asht dhanë si fytryë e urrejtun, përfaqsonte edhe nji parazit tjetër që jetonte në kurriz të tyne.

Ryshfetet që u jepeshin nëpunësve e gjindarmëve dhe detyrimet tjera ndaj organeve t'administratës shtetnore kishin lindë pasiguri dhe frigë për fshatarë ndaj njerëzve të huej, e sidomos ndaj njerëzve të qytetit. Prandaj, në fillim, fshatarët kishin të njajtin qëndrim dhe njifarë urrejtjeje ndaj „daskalicës" së tyne të parë. Spasja don me e theksue në këtë rast këtë moment mjaft të randësishëm e karakteristik të psikologjisë së katundarit të shfrytzuem, urrejtjen e tyne ndaj qytetarëve shfrytëzues.

Në roman janë dhanë dy shtresa shoqnore, ku secila prej tyne ka botën e vet specifike. Katundarët dhe qytetarët qeveri-

e autorit, aftësia e tij që në veprën letrare të skalitë një tip të tillë aq të dashun. Spasja, nëpërmjet të romanit, don me theksue me fuqi se arsimit të deriatëhershëm jo vetëm që i kishte kalue koha, por ai ishte edhe pengesë e madhe për përparimin e shoqnisë shqiptare. Për tanë sistemin e arsimit, mendonte ai, janë të domosdoshme të bahen ndryshime rranjësore. Simbas tij arsimi kërkon njerëz të rij, me pikëpamje të reja e përparimtare dhe metoda të reja pune. Në Grykas dhe në katundet tjera të mbrapambetuna shkollat ekzistojshin vetëm sa për sy e faqe. Për shkollën e vjetër të Grykasit në faqet e romanit bahet ky përshkrim: „Shkolla e fshatit është e mbuluar me thekërishte, me dy dritare si vrima hambari, me një derë t'unjtër si derë koteci, e ngrehur gjysmë mbi mur e gjysmë mbi garth. Orenditë janë shtatë banga të ndrequra si mos ma keq... Katër shufra thane e xhunga xhunga të vena n'ato kamare simbolizojnë disiplinën e njëherëshme shkollore". Mësuesit e gjeneratës së vjetër, si ishte ai i Grykasit, Zoti Remka dhe të tjerët, jo vetëm që gjatë punës së tyne nuk kishin arrijtë me i ngritë të tjerët në fshat, por edhe vetë kishin ra në nivelin e fshatarëve pa shkollë. Mësuesi „në të dhënunit mësim kishte... metodën e vet: një shufër të gjatë thane e xhunga-xhunga e mbante si të vetmin ndihmës të tij pedagogjik. Edhe shuplaka e fortë ishte një mjet tjetër nxitës. Bota mendore për Zoti Remkon kishte kalue kufijtë e përsosmënisë". Fytyra e vrazhdë e Remkos asht shprehë në roman me nji realizëm të fuqishëm. Ai përfaqsonte njeriun e pagdhendun, mësuesin pa takt pedagogjik, e njiherit gjeneratën e vjetër t'arsimtarëve. Si i tillë, ai kishte futë frigë te vocrrakët e pafajshëm. Në këtë jetë anemike të katundarëve të vorfën, mësues si Remokja, që në roman asht dhanë si fytryë e urrejtun, përfaqsonte edhe nji parazit tjetër që jetonte në kurriz të tyne.

Ryshfetet që u jepeshin nëpunësve e gjindarmëve dhe detyrimet tjera ndaj organeve t'administratës shtetnore kishin lindë pasiguri dhe frigë për fshatarë ndaj njerëzve të huej, e sidomos ndaj njerëzve të qytetit. Prandaj, në fillim, fshatarët kishin të njajtin qëndrim dhe njifarë urrejtjeje ndaj „daskalicës" së tyne të parë. Spasja don me e theksue në këtë rast këtë moment mjaft të randësishëm e karakteristik të psikologjisë së katundarit të shfrytzuem, urrejtjen e tyne ndaj qytetarëve shfrytëzues.

Në roman janë dhanë dy shtresa shoqnore, ku secila prej tyne ka botën e vet specifike. Katundarët dhe qytetarët qeveri-

tarë ishin në kundërshtim të përhershëm ndërmjet veti. Gjendja e fshatarëve ishte mjaft ev është rë, prandaj asht krejt e natyrshme edhe rezistenca e tyne ndaj nji pozite të tillë. Por, kjo rezistencë në vepër nuk u shpreh si e organizueme.

Në roman asht dhanë për bukuri natyra, njeriu dhe jeta e fshatit. Mjafton me kujtue përshkrimin që ban shkrimtari për qiraxhiun fshatar, i cili e sjell Afërditën në Grykas:

> Qiraxhiu, që dukej aq i çuditshëm nga qyteti e nga fusha, tani i përshtatej natyrës së këtyne vendeve. Nëpër këto kthepa, veç opingave të tija vrima-vrima nuk mund të shkelte këpucë qytetari, sidomos toket e qytetarkavet. Rrobja e shajaktë e qiraxhiut shpeshherë rrëmbehej nga ferrat e nga shkarpat, por nuk këputej. Vetëm tani Afërdita filloi të kuptojë se pse e kishte udhëheqësi i saj atë mjekër të paruar, ato këmbë të mëdha e të mbathura me opinga vrima-vrima, atë veshje të shajaktë e t'arnuar që më që dhe ato duar të mëdha, të zeza dhe plasa-plasa. Ashpërsia e vendit e bënte t'ashpër çdo njeri: qiraxhiu ishte tipi i gjallë i kësaj natyre kaq t'egër"...

Fshatarët, si shtresë shoqnore, jetojshin në natyrën e ashpër, e cila linte gjurma ndikimi në formimin e tyne. Si paraqiten në roman, ata jetojnë në skamje. Në shumicën e votrave të tyne vorfnia ishte e pranishme përherë. Marrëdhaniet e vjetrueme patriarkale dhe bestytnitë e damshme, myku shekullor, si dhe shkalla e ulët e arsimit s'i linte të mëkamben nga ajo gjendje e mjerueshme. Tue gjallnue n'oaza jetsore, larg qendrave të zhvillueme dhe larg çdo ndikimi të kulturës së kohës, kur kujdesi i qeverisë së atëhershme për jetën e vegjëlisë gati mungonte fare, ata nuk kishin mundë me marrë rrugën e nji përparimi shoqnor.

Ndër fytyrat ma reale të fshatit bijen në sy: Kryeplaku, Xha Vasili (plak nga fshati), Vita, Shpresa, Drita (vajzë fshatare) etj. Për çudi, fytyra e nanës s'Afërditës asht dhanë shum e zbehtë, por asht tipizue plot fuqi Teto Kata, magjistare, që konsiderohet ndër fytyrat ma të qëllueme në roman mbas protagonistes kryesore. Magjistarja, përfaqsuese e brezit të vjetër të fshatit, mundohet me mish e me shpirt me kundërshtue depërtimin e së resë. Afërdita ishte ba për te therrë në sy, prandaj ajo mundohet me çdo mjet ta paraqitë si shum të rrezikshme për fshat. E zhytun në bestytnitë e mbrapshta, ajo asht kurdoherë në „shërbimet" e magjistares.

Spasja, ashtu si në punimet e maparshme letrare, il ufton të gjitha dukunitë negative në shoqninë shqiptare t'asaj kohe, damkos me fuqi sidomos zakonet mbrapanike të katundit.

Në kohën kur Spasja shkroi romanin *„Afërdita"*, anë e mbanë Shqipnisë, sidomos nëpër qytetet e zhvillueme, ekzistonte nji shtresë e formueme intelektualësh, arsimtarësh përparimtarë. Nga romani kuptojmë se arsimi në qytet kishte përparue mjaft shpejt. Arsimtarët përparimtarë të kohës, mvarësisht nga rrethanat në të cilat gjindeshin, punojshin me zell për ngritjen e të gjitha shtresave shoqnore. Nji punë vetëmohuese n'arsim kishte ba edhe vetë Sterjo Spasja gjatë gati dhetë vjetëve, por simbas tijë — katundi kishte mbetë larg sferës së aktivitetit të tyne. Prandaj, në roman shpreh mendimin se për ngritjen edhe të katundarëve asht e domosdoshme që të gjitha forcat progresive të drejtohen kah katundi. Rol të madh duhet të luejshin sidomos arsimtarët:

> „Arsimtari në fshat është mësues i fëmijvet dhe i popullit... ay është advokat, mjek, gjykatës, agronom e ballsam i brengavet të përditshme të fshatarit. Vetëm mësuesi, si nji pishtar i vërtetë, do t'u ndriçojë rrugën fshatarëve drejt përmirësimit të jetës, drejt çdukjes së zakoneve të këqija edhe drejt jetës së re".

Autori shpreh mendimin se kontributi i arsimtarëve progresivë, e sidomos atyne qytetarë, në ngritjen dhe arsimin e fshatarësisë ka nji randësi vitale për zhvillimin e gjithëmbarshëm të shoqnisë shqiptare, prandaj merr si protagoniste të veprës nji fytyrë të çiltër nga qyteti, e cila, në saje të mbështetjes që gjeti në motrat dhe vllaznit tjerë arsimtarë nga mbarë vendi, mbërrijti me u ba shembëll e arsimit shqiptar. Në raportin që kishte përgatitë „Lëvizja e Re Arsimore", për t'ia dërgue Zotit Inspektor dhe Ministrisë s'arsimit, shkruhej: „...Zonjusha Afërdita Skënderaj është nji mësuese ideale. Ajo është një mburje e një nder për arsimimin tonë. Çdo fjalë, sado e qëlluar qoftë, është e pafuqishme për të lavduar veprat e saja të shkëlqyeshme të kryera në shkollë e në gjirin e fshatarëve. Shkolla e saj është shembëll pune, shembël metode, shembëll rregulli. Është shkolla që na duhet..."

Tue u kunorëzue kështu puna e mrekullueshme e Afërditës, qëllohet për vdekje ana kundërshtare, e cila gjithnji qe pengesë e madhe në tanë punën e gjatë e të mundimshe të saj deri te sukseset e lakmueshme. Sidomos u godit randë Zoti Inspektor. Ai,

jo vetëm që nuk kishte kontribue në mirëvajtjen e punës së mësueses, por i kishte qitë edhe pengesa të pakapërcyeshme. Dënimet, inspektimet dhe masat tjera që kishte marrë ndaj mësueses, bashkë me qëndrimin nënçmues që kishte pasë ndaj saj, kishin qenë hapa shum të gabueshëm e të damshëm në punën e tij si inspektor. Ai kishte veprue njisoj edhe me shum e shum arsimtarë të tjerë. Prandaj, i tronditun thellë, shkruen dorëheqjen tue e konsiderue vetveten të paaftë për punën që ban. Me këtë akt t'inspektorit, Spasja do me theksue se e tanë shtresa e nëpunësve në qeverin zogiste ishte tue krye nji mision të damshëm për shoqninë shqiptare të kohës. N'anën tjetër, akuzë e rreptë çohet edhe kundër nji shtrese intelektualësh të tjerë, arsimtarëve të plogët e reakcionarë, që në roman përfaqsohen prej Gjokës, mësuesit të dikurshëm të Afërditës, dhe Cufit. Me këto dy fytyra, autori na jep dy gjenerata arsimtarësh. Brezi i vjetër, që në roman e përfaqson nji mësues i shtymë në moshë, që kishte krye qe sa e sa vjet misionin e randësishëm në shoqni, por që nuk ishte ma as energjik me hy në vallen e kohës së re, ku shtroheshin kërkesa të reja e revolucionare. N'anën tjetër Cufi i takonte brezit të ri t'arsimtarëve. Por ai, në roman, përfaqson arsimtarin që nuk përfillte përpjekjet e arsimtarëve të rij për nji përparim shoqnor. Me qëndrimet e tij të mbrapshta, të nji mësuesi të paformuem e liafazan, ai paraqitet ma tepër si i damshëm se sa i dobishëm. Në roman asht e ndritshme sidomos fytyra e mësuesit përparimtar e njiherit kushëri i Afërditës, Yllit. Ai mund të merret shum lehtë si protagonist kryesor i veprës. Në të vërtetë, deri me daljen e romanit „*Afërdita*", në letërsinë shqipe nuk kemi pasë as nji fytryë femne të cilës i besohet nji mision i naltë shoqnor. Autori zgjodh si protagonist nji femën e cila, në nji formë shum të natyrshme, do të depërtonte edhe në botën femnore të katundit shqiptar dhe do të ndihmonte në përmirsimin e pozitës së femnës në shoqni. Prandaj Afërdita nuk paraqitet në roman si fytyrë reale por e idealizueme, ashtu si edhe ekzistonte në mendjen e shkrimtarit.

Sterjo Spasja e kishte pa edhe vetë se pozita e femnës në familjen patriarkale dhe në shoqni ishte shum e vështirë. Sidomos në katund, femna ishte e ngarkueme me punë shum të randa edhe jashtë shtëpisë. Bajtja e shkarpave për te ishte punë shum e randë. Autori në roman jep kushtrimin: „litari duhet të çduket për femrën ... nuk durohet më skllavëria e litarit ... Po-

shtë skllavëria! Në zjarr — litarët". Këtu ai shprehet për liri dhe ngritje të gjithanshme të femnës, për emancipimin e saj në shoqni.

Kah fundi i romanit, atëherë kur ideja themelore e veprës sendërtohet deri në përplotni, autori shpreh mendimin se duhet me u çmue posaçërisht bashkëpunimi i ngushtë dhe i përhershëm ndërmjet arsimtarëve përparimtarë në kryemjen e misionit aq të randësishëm shoqnor. Sepse, triumfi i Afërditës në Grykas dhe Pishas dhe mrekullitë e saj në lamën e arsimit dhe edukatës, në ngritjen e femnës shqiptare, paraqiten edhe si fitore e tanë arsimit të ri shqiptar. Kjo bamuni e entuziasmon lexuesin dhe e angazhon maksimalisht të hidhet n'anën e fuqive progresive, për përparimin dhe lulëzimin e përgjithshëm të shoqnisë.

Në fazën e dytë të krijimtarisë letrare hyjnë edhe nji numër i konsiderueshëm tregimesh, novelash (novela alegorike) dhe pamfletash që autori i kishte shkrue që prej vjetit 1935. Në këtë kohë, Spasja qe bindë edhe vetë se në romanin *„Pse?!..."* kishte rrëshqitë si njeri dhe shkrimtar në nji teren shum të rrezikshëm, prandaj nisi nji krijimtari utvilitariste e me ide të shëndosha. Të këtilla krijime artistike të kësaj kohe janë, bie fjala: *„Profeti"*, *„Fati i Mitit"*, *„Kristina"*, *„Babaj"*, *„Kujtimet e fundit"*, *„Një mall që prej së largu"*, *„Heronjët e arësimit"*, *„Duke pritur"*, *„Malësori i vogël"* e tj. Në këtë fazë të veprimtarisë talentin e tij të fuqishëm si prozator autori e tregoi me përmbledhjen e novelave *„Nusja pa duvak"*, në të cilën paraqitet jeta realiste e fshatit pa kurrfarë idealizimesh. Në thurjen e ngjarjeve dhe ngritjen e konflikteve në novela ai asht shum objektiv, prandaj edhe novelat e kësaj përmbledhjeje çmohen si ndër ma të bukurat në letërsinë shqipe. Ato trajtojnë nji tematikë sociale mjaft aktuale në kohën kur i hartoi autori. Shkrimtari shprehet kundër dukunive negative, sidomos kundër martesave që, tue u vazhdue nji traditë e vjetër, nuk synohej nji jetë e lumtun bashkëshortore. Spasja njiherit ngreh zanin edhe kundër zakoneve të tjera mbrapanike të shoqnisë shqiptare dhe shprehet për nji shërim të gjithanshëm nga këto plagë shum të damshme. Dallohet sidomos novela *„Nusja pa duvak"*, ku me nji realizëm të fuqishëm tregohet tragjedia e jetës bashkëshortore. Përkah vlefta artistike e tyne, novelat e kësaj përmbledhjeje janë krijimet ma të bukura të Spasses deri në daljen e romanit *„Afërdita"*.

(Vijon)

Isak Shema

PIKËPAMJET SOCIALE NË VEPRËN E STERJO SPASSES

Vijim nga numri i parë

III

Mbas luftës së dytë botnore letërsia shqipe u pasunue edhe me vepra të tjera, të cilat kanë nji vleftë relativisht të naltë artistike. Ajo mori kështu rrugën e lulzimit të matejshëm. Poezia në fillim u zhvillue ma tepër, e mandej edhe proza. Gjatë luftës dhe në vitet e para të mbasluftës u kultivue ma shum proza tregimtare e shkurtë. U botuen shum përmbledhje tregimesh e novelash. Romani, si formë ma e gjanë dhe ma e vështirë e krijimit artistik, u zhvillue ma vonë. Dhimitër Shuteriqi qe autori i romanit të parë të mbasluftës — *„Çlirimtarët"*. Mandej u botuen edhe romanet e Sterjo Spasses: *„Ata nuk ishin vetëm ..."*, *„Afërdita përsëri në jshat"*, *„Buzë liqenit"* etj. Numri i titujve të romaneve të letërsisë shqipe u shtue ma vonë edhe me veprat e shkrimtarëve të tjerë të njoftun. Ndër ta shquhen sidomos: Fatmir Gjata *(„Përmbysja"*, *„Këneta"*, *„Armiqët" I, II)*, Kin Dushi *(„Udha e Velanit")*, Thoma Kacorri *(„Për Mëmëdhenë")*, Vedat Kokona *(„Në valët e jetës" I, II, III)*, Petro Marko *(„Hasta la vista"*, *„Qyteti i fundit"*, *„Stina e armëve")*, Shefqet Musaraj *(„Para agimit")*, Ali Abdihoxha *(„Një vjeshtë me stuhi"*, *„Tri ngjyra të kohës")*, Hasan Petrella *(„Kronikë e viteve të paharruara")*, Jakov Xoxa *(„Lumi i vdekur" I, II, III)*, Ismail Kadare *(„Gjenerali i ushtrisë së vdekur"*, *„Dasma")* etj.

Tiranë, 1974

Në Jugosllavi gjithashtu kemi nji gjeneratë shkrimtarësh, të cilët me romanet e tyne u afirmuen si krijues të frytshëm, tue e pasunue kështu edhe ma tepër letërsinë shqipe në tanësi. Ma të njoftunit ndër ta janë: Sinan Hasani (*„Rrushi ka nisë me u pjekë", „Nji natë e turbullt", „Ku ndahet lumi"*), Hivzi Sulejmani (*„Njerëzit"*), Rexhai Surroi (*„Besniku"*), Azem Shkreli (*„Karvani i bardhë"*), Ramiz Kelmendi (*„Kur kositen livadhet"*), Rexhep Zogaj (*„Kurrgja e jashtëzakonshme"*), Nebil Duraku (*„Murgesha"*), Murat Isaku (*„Dielli e din rrugën e vet"*), Nazmi Rrahmani (*„Malsorja"*). etj.

Por, ndër shkrimtarët e këtij brezi, asht e ndritshme sidomos fytyra e Spasses. Romanet që shkroi ai në fazën e tretë të veprimtarisë së vet letrare, përkah vlefta e tyre artistike, konsiderohen ndër veprat ma të bukura të letërsisë shqipe.

Fragmentet e romanit të parë të letërsisë së realizmit socialist në letërsinë shqipe (*„Ata nuk ishin vetëm . . . "*) filluen të botohen që nga kallnori i vjetit 1949 në revistat letrare të kohës. Si kuptojmë nga nji shënim në revistën „Literatura jonë" (nr. 7, shtator 1949), vepra mbante titullin *„Harbutët"*. Në atë numër botohej fragmenti: *„Bereqeti i fshatarëve"*, dhe ky shënim i Redaksisë: „. . . kjo pjesë është marrë nga doreshkrimi „Harbutët", roman nga Sterjo Spasse. Në këte roman përshkruhen vuejtjet e fshatarit e të puntorit shqiptar nga bejlerët, nga qahajllarët, nga fajdexhinjtë, nga tregtarët, nga nëpunësit, kryetari i komunës, post-komandanti, xhandari, taksidari e nga tërë kompleksi i regjimit feudalo-borgjez të Zogut. Këtu vihet në dukje degjenerimi i klasës së bejlerëve, dekompozimi i regjimit, po njëkohësisht edhe rezistenca e puntorëve dhe e fshatarëve të frymzuar nga mendimet progresiste të Ali Kelmendit, që është një ndër protagonistët e romanit. Ngjarjet zhvillohen në Korçë dhe në një fshat të saj."

Vepra ishte e përshkueme nga nji ndjenjë revolucionare, për çlirim social të shtresave të shtypuna. Përkah trajtimi i temës, paraqitjes së protagonistëve e aktivitetit të tyne dhe përkah përfundimi i saj, vepra i përngjan shum romanit të Gorkit *„Nëna"*. Heroi kryesor i romanit, Gjika, i përngjan shum Pavlit të Romanit *„Nëna"*. Vepra e Gorkit dhe protagonistët e tij përmenden disa herë në romanin e Spasses.

Ideja për të shkrue nji vepër, ku do të paraqitej realisht jeta e fshatarëve të vorfën dhe lufta për çlirim nga shfrytzimi i pamëshirshëm feudal, i lindi autorit shum ma heret, atëherë kur

pa me sy tragjedinë e Goricarëve. Por atëherë shkrimtari nuk e kishte zotnue mirë mjeshtrinë e të thurrunit artistik të ngjarjeve aq komplekse, si ishte paraqitja e strukturës shoqnore të shoqnisë shqiptare dhe kundërthanjeve klasore. Këte do ta bajë ai vetëm disa vjet ma vonë, kur ideja e dikurshme kristalizohet për bukuri.

Tue përmendë edhe tragjedinë e Goricarëve në roman, autori jo vetëm që shprehet për çlirim të fshatarëve të vuejtun, por, njiherit, jep edhe kushtrimin që vegjëlia të çohet në luftë të rreptë kundër shtypësve shekullor:

> „Mjaft nën skllavërinë e tij! I bëjmë temenara si kafshët, si skllevërit! Na ka mbrehur si qetë: na rrëmben kafshoren e gojës, na merr nderin, na pi gjakun kurdoherë, kurse ne e presim dhe e përcjellim me peqe e me hejvalla! Ai na rreh, ai na shtyp, kurse na e përkëdhelim. S'kemi kujt t'i ankohemi për këto të zeza. Të gjithë hajdutët me çizme janë nëpër punërat e qeverisë. Ne e pamë me sy hatanë që pësuan Goricarët. Flakën njëmijë vetë nga shtëpitë e tyre, nga toka e tyre e punuar denbabaden, me djersën e me gjakun e tyre, për hatrin e një beu! Ja, kjo është qeveria! Ajo mbahet me bejlerë dhe është e bejlerëve! Hajduti hajdutin mbron, jo njerëzit e ndershëm, jo fukaranë si ne! Prandaj të mos presim shpëtim as nga Zoti, as nga qeveria. Të drejtat tona duhet t'i ruajmë ne vetë me duart tona, me djersën tonë, me gjakun tonë!"[26])

Romani u botue në tanësi më 1952 dhe me këte rast shkrimtarit iu dha çmimi i Republikës për roman ma të mirë. Autori i entuziasmoi edhe njiherë aq shum lexuesit, sa, si shkruen Fatmir Gjata — „vetëm rrethet letrare të nxënësve të Shkodrës i kanë dërguar autorit 450 faqe dorëshkrime ku shprehin falënderimet e tyre".

Në këtë roman, si askund tjetër në letërsinë shqipe, shprehet dashunia e madhe e shkrimtarit ndaj popullit, ndaj njerëzve të thjeshtë, fshatarëve leckamanë, që përfaqsohen me Gjikë Shpatin, Xha Karoveshin, Ndrekon e shum të tjerë. Aty, njiherit, shprehet urrejtja ma e madhe ndaj shfrytëzuesve të çdo lloji, ndaj

---

26) Sterjo Spasse: *Ata nuk ishin vetëm...*, Botim i dytë, Tiranë, 1960, fq. 24—25.

gjakpirësve, të cilët s'ngihen me gjakun e fshatarëve të pafajshëm e, të mjeruem. Autori, me nji fuqi të madhe shprehëse, paraqet të gjitha kontradiktat shoqnore. Në nji ambient tipik shqiptar, me ngjyrën e kohës, tue qenë i pranishëm përherë altruizmi i njeriut ndaj njeriut, por edhe urrejtja e madhe ndaj klasës shfrytzuese, paraqiten të gjitha tragjeditë e mëdha e të vogla, individuale dhe shoqnore. Sidomos „opinga" asht paraqitë në roman si shtresë shoqnore shum e përvujtun, por edhe ma progresive në shoqni. Ajo, tue e ndi mbi kurriz tanë barrën e shfrytzimit të pamëshirshëm, jo vetëm që nuk mposhtet si shtresë shoqnore, e as që thyhet moralisht, por dita-ditës bahet ma tepër e vetëdijshme për gjendjen në të cilën ndodhet. Tue pa shembullin e vllazënve në vendet e tjera, ringjallet, organizohet si shtresë shoqnore, i rreh me fuqi gjaku kryengritës, i shtohet guximi e fuqia. Para lexuesit, në çdo faqe të romanit, fytyrat e vegjëlisë vijnë tue u ba ma të dashtuna. Ato rriten si shpresat e tyne për çlirim. Konfliktet ndërmjet shtresave sociale bahen gjithnji ma të hapuna. Fshatarët, në përleshjet e përgjakshme me beun, qahjallarët, përfaqsuesit e organeve t'administratës dhe me të gjithë elementet e tjerë reakcionarë në fshat, mbërrijnë t'u japin shfrytzuesve grushtin e fuqishëm shkatrrues e njiherit u tregojnë se erdhi edhe koha e re: „... Edhe të gjithë fshatarët — me Gjikë Shpatin në krye — ndonse prisnin zbërthimin e një stuhie të furishme — ndjenin sikur u agonte në thellësirat e zemrave të tyre një mëngjez me diell."

Ndër fytyrat ma të vrazhda në roman paraqiten: Kapllan, beu, Rako Ferra dhe Kara Mustafa. Ata njiherit janë edhe ndër fytyrat negative ma të realizueme të prozës shqipe. Me nji fuqi të madhe artistike paraqiten kundërthaniet klasore në shoqninë shqiptare gjatë kohës së sundimit zogist. Migjeni dhe Haki Stërmilli rravizuen jetën e vështirë në katundin shqiptar të asaj kohe. Mabs tyne Spasse asht i pari që në veprën letrare, me nji realizëm të fuqishëm, rravizon jetën e shoqnisë shqiptare ndërmjet viteve 1930—1936.

Që prej hartimit të romanit *„Afërdita"* e deri te thurrja e fragmenteve të veprës *„Ata nuk ishin vetëm ..."* kishte kalue nji kohë mjaft e gjatë. Mbas luftave të përgjakshme çlirimtare, në shumicën e vendeve ballkanike dhe në shum vende të tjera europiane, ishte përmbysë njiherë e përgjithmonë nji sistem i vjetër shoqnor. Masat e gjana dhe elementet progresive të shoqnisë i

kishte kaplue optimizmi i jetës së re. Shoqnia socialiste ngrihej me entuziazëm. Shkrimtari i përjetoi thellë të gjitha këto ndryshime. Ideja e dikurshme që në veprën letrare të paraqitej jeta e mundimshme e fshatarëve dhe vogjëlisë iu kristalizue vetëm mbas gati dhetë vjetësh. Ai edhe shum ma parë, atëherë kur shkroi romanin *„Pse?! ..."*, kishte mendue për çlirimin e fshatarëve nga thundra shtypëse. Por, atëherë nuk kishte pasë gjetë kurrfarë shtekdaljeje për çlirim të vegjëlisë. Disa vjet ma vonë, në romanin tjetër, *„Afërdita"*, kishte mendue se transformimi i shoqnisë mvaret vetëm nga aktiviteti i pandërpremë i arsimtarëve dhe intelektualëve. Mirëpo, me kalimin e viteve, shkrimtari e kishte ndërrue botëkuptimin e tij mbi transformimin progresiv të shoqnisë. Prej këndej shohim njifarë evolucioni në rrugën e formimit të vetë Spasses si shkrimtar, e njiherit nji farë evolucioni në paraqitjen e pikëpamjeve të tij sociale në veprën letrare.

Ma në fund, në romanin *„Ata nuk ishin vetëm ..."* autori mendon se për transformimin progresiv të shoqnisë rolin vendimtar e luen vegjëlia, vetë „opinga" — si e quen ai shtresën e shtypun. Ajo vetëm me luftë t'organizueme, mundet me vu temelet e nji shoqnie të re, ku nuk ka shtypje e as shfrytzim. Padyshim, kjo paraqitje e këtillë e pikëpamjeve të shkrimtarit pasqyron edhe zhvillimin progresiv ideor e artistik të tij. Në këtë mes ai shkon edhe ma larg. Luftën çlirimtare të vegjëlisë nuk e merr t'izolueme mbrenda kufijve të fshatit apo qytetit, e as mbrenda kufijve të nji shteti. Ate luftë ai e konsideron si qërim hesapesh ndërmjet klasave shoqnore të mbarë rruzullit të planetës sonë. Prej këndej edhe titulli simbolik i romanit: *„Ata nuk ishin vetëm ..."* shpreh idenë e autorit se në luftën çlirimtare duhet ngritë të bashkueme përherë të gjitha forcat progresive, për të realizue çlirimin e përbashkët.

Derisa në romanin *„Afërdita"* paraqitej jeta e shoqnisë shqiptare gjatë dhetëvjetëshit të tretë të shekullit tonë, që don të thotë gjatë viteve para revolucionit socialist në Shqipni, në romanin tjetër *„Afërdita përsëri në fshat"*, me nji realizëm të dukshëm, pasqyrohet koha e luftës çlirimtare dhe ajo mbas çlirimit nga thundrat anmike. Afërdita, mësuesja e dikurshme e Grykasit, e vazhdon përsëri misionin e saj shum të randësishëm shoqnor, si mësuese dhe aktiviste e shqueme. Si kryeprotagoniste e romanit mban tiparet e nji fytyre të çiltërt e revolucionare. Asht kjo nji nanë revolucionare e tipit gorkian në trollin shqiptar, por

edhe intelektuale e ngritun, e cila jeton e vepron në rrethanat e tjera shoqnore. Ajo, meqenëse ia kishte kushtue tanë rininë e vet ngritjes së gjithanshme të fshatarëve e krejt pak ishte brengosë për jetën e saj personale, kishte mbërrijtë me i falë jetën e re fshatit të mbrapambetun. Në vendin ku punonte mësuesja, çdo gja kishte pasë lulëzue. Rreze të jetës së re shkëlqejshin në fytyrat e fshatarëve, në fytyrën e Afërditës.

Por, kësaj jete iu ndërpre hovi. Okupatori kishte shkelë atdheun e Afërditës. Çdo gja e kishte kapë flaka e luftës. Nji jetë e vështirë, në skamje e mjerim, i ishte vërsulë përsëri votrave fshatare. Tymi i zi i luftës kishte nxi gjithçka — tanë jetën.

N'ato ditë të vështira, anë e mbanë vendit, organizoheshin forcat revolucionare për çlirimin e atdheut. Rradhët e luftarëve të lirisë shtoheshin ditaditës. Mbas shum konflikteve familjare, edhe Afërdita kishte vendosë të marri pjesë në lëvizjen çlirimtare. Edhe kësaj rradhe ajo ven në plan të parë fatin e shoqnisë shqiptare në tanësi, e jo jetën personale.

I shoqi, Lekë Gurakasi, ishte skeptik, sa i përket suksesit të luftës kundër anmikut ma të fuqishëm. Ai, jo vetëm që vetë nuk asht i gatshëm për luftë, por dëshiron ta pengojë edhe Afërditën. Në konflikt me te ai thonte: „... E kush, ne që jemi një grusht e, sakaq, po u kapëm fytpërfyti, e maruam të tërë! Pastaj ç'më duhet Shqipëria shkrumb e hi! Atëherë me se? Me të mirë, me edukatë, me shkollë: të zgjojmë masën dhe herëherë t'u japin nga nji grusht hundëve barkmëdhejve, si ishte rasti i demonstratave të mëdha të bukës në Korçë ..." Ja këto, ishin parimet kryesore që shtronte Leka për luftën. Ai (Leka) në roman asht nji figurë kontradiktore. Përfaqson ma tepër intelektualin e tërhequn nga jeta shoqnore, i cili brengoset ma tepër për jetën e qetë familjare. Në fillim ai nuk paraqitet njeri i akcionit. Si i këtillë përfaqson ma shum brezin e intelektualëve skeptikë, të cilët bajnë nji jetë të mbyllët. Në qëndrimin e tij të luhatshëm shkakton që, pa pritë e pa kujtue, të shëmbet kështjella bashkëshortore shum e çmueshme e tyne. Dy shokë të jetës: Afërdita dhe Leka ndahen, tue marrë secili rrugën e vet.

Vite të vështira kalojnë. Afërdita shquhet shum si luftare për çlirimin e vendit. Mbas çlirimit kthehet përsëri me fytyrë kah katundi. Në vend që të marri ndonji pozitë të naltë udhëheqëse në kryeqytet, ajo vendos të shkojë përsëri në katund, atje ku kishte kalue nji pjesë të gjatë të jetës.

Romani nis me shkuemjen e Afërditës në katund, me zhvillimin e shiritit të kujtimeve të jetës së kalueme. Sa momente idhnimi e gëzimi i kujtoheshin! Por, ate e shqetsojnë menjiherë dhe ma tepër votrat e rrënueme të fshatarëve, vdekja e sa e sa luftarëve dhe nxanësve të saj të dikurshëm. Tani Afërdita gjindet përsëri në frontin e luftës, por të nji lufte tjetër: për mëkambjen e jetës së re në fshat, për krijimin e marrëdhanjeve të reja në katund e në shoqni. Ate, si fytyrë të ndritshme, lexuesi e gjen deri në faqet e fundit të romanit kur jo vetëm që, së bashku me të gjitha fuqitë e tjera progresive shoqnore mbërrin me ngritë nji jetë të re e të lumtun në katund, por përtrin edhe jetën bashkëshortore me Lekën, i cili gjithashtu kishte pasë marrë pjesë në luftën çlirimtare.

Autori edhe në këte vepër nuk largohet ende nga ideja e tij e projektueme në *„Afërdita"*: arsimi asht faktor kryesor për transformimin progresiv të shoqnisë. E njejta ide themelore paraqitet edhe në romanin *„Afërdita përsëri në fshat"*, i cili, përkah vlefta artistike dhe kompozicioni i qëlluem, asht hap përpara në veprimtarinë letrare të Spasses.

Por, autorin e preokupon edhe nji çashtje tjetër: Menjiherë mbas përfundimit të luftës, kur pushteti shtetnor nuk ishte stabilizue sa duhet, pozita shum të randësishme kishin zanë edhe njerëz, pjesëmarrës të luftës, por të cilët nuk ishin të arsimuem sa duhet. Ata ishin shum të rezervuem ndaj shtresës intelektuale dhe shprehshin njifarë mosbesimi ndaj tyre. Për nji dukuni të tillë Spasse ban fjalë në romanin *„Afërdita përsëri në fshat"*.

Pirron, kryetarin e këshillit të katundit, e kishte kaplue dëshira për pozitë të naltë në shoqni. Vetveten e konsideronte shum ma të vlefshëm në shoqni se sa të tjerët. Edhe ndaj Afërditës kishte marrë nji qëndrim urrejtjeje. Ndaj saj dhe intelektualëve të tjerë të formuem i kishte lindë nji pabesi e madhe. Në nji rast ai i thotë shokut të vet Stefanit: „More, mos u rrëmbe shumë nga fjalët e Afërditës. Ajo është me shkollë, e nga njerëzit me shkollë të mos presim shumë! Këtë luftë e bënë punëtorët e fshatarët, ata që s'dinin të shkruanin as emrin e tyre e jo këta të shkollës! (...) Ne e kemi për detyrë t'i bëjmë sytë katër! Më i rrezikshëm në këto kohëra është një njeri me shkollë ... njerëzve të mësuar s'ua heq dot trutë e rrezikshëm nga koka!". Megjithate, autori këtë çashtje, edhepse në roman e shtron në këtë mënyrë, i jep krejt zgjidhje tjetër. Elementet si Pirroja dhe për-

faqsuesit e klasës shoqnore feudale-borgjeze që dekompozohej i humbin të gjitha pozitat dhe privilegjet në shoqni. Shkatrrimi i tyne që prej temelit kushtsoi lindjen e marrëdhanjeve të reja shoqnore.

Në romanin *„Afërdita përsëri në fshat"* Spasse nuk shtron ndonji çashtje tjetër sociale aq të randësishme, sepse ai drejtpërdrejt angazhohet për realizimin e idesë së vet themelore: në jetë dhe punë kërkohet me doemos qëndrueshmëni e madhe. Sakrificat në këtë rrugë jetësore shum të vështirë janë të pashmangshme. Çdo epokë, nga përmbysjet e vogla dhe të mëdha në shoqni, nga lindja e forcave që kanë kërkesa të reja, kushson kundërthanje përkatëse ndërmjet klasave shoqnore antagoniste. Autori i ven vetvetes qëllim që t'i paraqesë realisht të gjitha kundërthanjet e ashpërsueme edhe ma tepër mbas mbarimit të luftës. Secila shtresë shoqnore, mvarsisht nga synimet e veta, ban rezistencë gjegjëse ndaj anës kundërshtare. Katundaria e vobekët, si përshkruhet në roman, ishte ngritë e organizueme kundër shfrytëzimit të matejshëm, për barabarsi shoqnore. Për të ngritë jetën e re në katund ishte e domosdoshme që fshatarët t'i japin edhe goditjen e fundit vdekjepruese shfrytzuesve të pashprit dhe të gjithë anmiqve të vendit. Fitorja e tyne në krye me mësuesen fisnike, Afërditën, në roman paraqet njiherit triumfin e forcave progresive të shoqnisë.

Afërdita, shembëlltyra e femnës shqiptare në letërsinë shqipe, asht skalitë me fuqi edhe në këtë vepër. Ajo në të vërtetë, asht mësuesja e maparshme e Grykasit, por e kalitun nga ditët e luftës çlirimtare. Gjatë aktivitetit të saj asht e qëndrueshme dhe vigjilente, e matun por edhe e guximshme, e qetë, por në disa momente mjaft e vrullshme. Ajo asht kurdoherë në shërbim të turmave të gjana. Idealet e saj janë shkri me ato të katundarisë përparimtare dhe të gjitha fuqive progresive. Si e tillë, ajo përfaqson një ndër fytyrat ma të bukura të realizueme të femnës në letërsinë shqipe. Megjithate, në romanin *„Afërdita përsëri në fshat"*, si dhe në pjesën e parë të veprës *„Afërdita"* — asht lanë mbas dore paraqitja e botës së mbrendshme e sidomos ajo intime e kryeprotagonistes së romanit. Kjo ka shkaktue padyshim, që fytyra e idealizueme e femnës, së cilës i asht besue misioni shum i randësishëm të mbesi e paraqitun në mënyrë të njianëshme. Ajo mbetet edhe ma tutje rrëfyese e rrugës ma të

drejtë që sjell kah jeta e re, për nji perspektivë të shkëlqyeshme individuale dhe shoqnore.

Ndër fytyrat e realizueme ma mirë, përveç Afërditës që paraqitet mjaft revolucionare, janë rravizue me fuqi edhe disa fytyra negative nga katundi — Llaçi Driza, Cufe Beu, Hysen agë Tërfili, Vërtoku etj. Këta janë, që të gjithë, përfaqsues të klasës shfrytzuese. Ditët e vështira për ta vijshin njena mbas tjetrës. Megjithate mbaheshin ende, tue shpresue se do të kthehej prap dita e tyne. Tue qenë ma të pasunit në katund, e njiherit fajdexhij të pashpirt, s'dorëzohen lehtë. Rrënimi ekonomik dhe shoqnor i tyne paraqet edhe shkatrrimin e tanë klasës së cilës i takojnë. Leckamanët, me optimizmin e tyne ndaj jetës së re, u japin shfrytzuesve të dikurshëm goditjen ma të fuqishme.

Padyshim, fytyra e Llaçi Drizës asht realizue me matuni të madhe. Ai përfaqson qenjen njerzore të pangopun me pasuni dhe të holla. Në jetën e tij ka qenë përherë ma e randësishme pasunia, paraja dhe fajdeja se sa çdo gja tjetër. Ai asht rritë i tillë. Zemra i bahet mal si kopracit, kur numron të hollat e shumta. Meqenëse paraqitet si anmik i përbetuem i depërtimit të së resë, për t'iu shmangë kundërshtimeve të hapta, din të përdori taktikën e njeriut që din të gjindet. Asht përfaqsues tipik i kullakut, bashkëpuntor i denjë i anmikut që kishte pasë zaptue vendin. Por me fillimin e luftës, ai me njenën dorë mbahej edhe në forcat e reja, të cilat ishin në skenën e shoqnisë shqiptare. Njenin prej djemve të vet Driza e kishte inkuadrue në lëvizjen çlirimtare. Driza asht pikturue si tip djallëzor dhe shum i zgjuet. Si anmik, nuk vepron kurr haptazi, pos përdor si vegla të verbëta të tjerët: Vërtokun, Mitrin, Teto Katën. Synon të bajë për vehte madje edhe Pirron, shërbëtorin e dikurshëm, i cili kishte sigurue me kohë nji pozitë të naltë në shoqninë e re.

Karakteristike asht prezentue edhe fytyra e Hysen agë Tërfilit. Atij i janë shembë idealet e dikurshme. Me rastin e tronditjeve të mëdha shoqnore, ai gati nuk paraqitet ma si mbrojtës i interesave klasore. N'ato ditë të pleqnisë i shtohet oreksi për të kalue edhe ndonji ditë të lumtun. Nji brengë e vjetër e mundon ate si asnjiherë ma parë: me sigurue trashëgimtarin e vet legjitim. Për ta realizue këtë dëshirë, ai derdh pasuninë dhe bjerr dinjitetin e vet si përfaqsues i nji klase të pamposhtun deri atëherë. Cenë Metës, nji leckamani nga katundi, të cilin aga e njifte edhe ma herët, ia kërkon për grue të bijën shtatëmbëdhe-

të — vjeçare, Mirushën. Sa shpresa të reja i lindin përnjiherë Hysen agë Tërfilit, po nuk i realizohet asnjena prej tyre. Kjo fytyrë negative asht paraqitë mjaft komplekse. Jeta intime e tij asht diçka e kundërt me ate shoqnore. Ai edhe në familjen e vet kalon jetë të ndytë. Si kryetar familjeje lëshohet në marrëdhanje intime me të shoqen e nipit të vet. E kaluemja e ndytë gjithashtu kishte lanë gjurma të pashlyeshme në ndërgjegjen e tij. Si i tillë, ai përfaqson shfrytzuesin tipik të klasës së degjenerueme.

Ndër fytyrat e shumta të katundarisë së vorfën asht realizue me sukses sidomos ajo e Xha Nelos. Jeta e vështirë e skamje e përhershme, sa e kishte raskapitë plakun aq edhe e kishte ba të qëndrueshëm. Me nji optimizëm të madh jetsor ai shikonte ardhmëninë e gjeneratave të reja. Me bujarinë e madhe që kishte, ai dinte me i afrue njerzit. Prej këndej fytyra e plakut në roman na del shum e dashtun dhe simpatike. Idila e dashunisë në katundin shqiptar asht përshkrue realisht e me vërtetësi artistike. Ambienti i kandshëm i natyrës asht përshkrue në vepër me nji lirizëm të dalluem.

Spasse, sa pat mbarue së shkruemi romanin *„Afërdita përsëri në fshat"*, filloi të hartojë edhe nji roman të ri me titull *„I urituri"*, në të cilin gjithashtu shtjellohet nji tematikë nga jeta e katundit. Romanin e shkroi derisa ishte në Moskë, gjatë vjetit 1959. Atje ai kaloi dy vjet tue studjue letërsinë n'Institutin „Maksim Gorki" dhe u njoft ma mirë me shkrimtarët sovjetikë. Studjoi me kujdes sidomos letërsinë e realizmit socialist. Posaçërisht e entuziasmuen veprat e Gorkit, Fadejevit, Shollohovit dhe atë të shkrimtarëve të tjerë. Me interesim të posaçëm kishte lexue romanin e Shollohovit „Ledina e lavrueme", ku paraqitej procesi i vështirë i kolektivizimit në Bashkimin Sovjetik. Ideja e dikurshme iu kristalizue shpejt, prandaj që prej vjetit 1959 filloi të botojë fragmentet e para të romanit. Atëherë romani mbante titullin „I urituri" dhe zgjoi interesim të madh ndër lexuesit. Autori e përpunoi rishtazi veprën dhe më 1965 e botoi në tanësi me titullin e ri „Buzë liqenit". Në këtë vepër ai përshkruen përpjekjet e katundarisë e njiherë edhe kontradiktat shoqnore në nji katund të Malsisë, me rastin e kolektivizimit të bujqësisë gjatë vjetëve 1956 — 1957.

Në Shqipni, simbas Spasses, revolucioni nuk kishte përfundue me ngadhnjim të luftës çlirimtare. Për t'u ngritë jeta e

re kishte fillue beteja e rreptë për ngritjen e kooperativës në katund.

Lajmi për themelimin e kooperativës në Pishas i kishte shqetsue pleq, e të rij, të pasun e të vorfën. Të gjithë i kishte kaplue nji rrënqethje e papritun. Furtuna e furishme e kishte zanë tanë katundin, i cili mbas çlirimit kishe kalue pak vjet të qeta. Katundarët e shtypun mizorisht vjet me radhë, ishin mëkambë pakëz. Ata, ma në fund, mbas reformës agrare, kishin ba tokë, shtëpi e bagëti. Buka e misrit i kishte shpëtue nga urija vdekjepruese. Disa prej katundarëve si Spiro Gurrëmadhi, i cili në roman paraqitet si fytyrë shum e vrazhdë, mbrenda pak vjetësh kishte mbërrijtë me u pasunue shum. Si i tillë ishte edhe kundërshtari ma i rreptë i kooperativës. Si me e braktisë Gurrëmadhi tanë at pasuni „të fitueme me djersë". Etja e madhe për t'u pasunue edhe ma tepër, kokëfortësia dhe brutaliteti tepruem në jetën familjare, i japin atij pamjen e përbindëshit.

Edhe kryetari i këshillit të katundit, Jani Qimekuqi, meqenëse i ishte luhatë pozita që prej ardhjes së Gjergjit të Kacorajve (heroit kryesor) si sekretar t'organizatës bazë, kishte kalue në taborrin e Gurrëmadhit e të Pilo Dinakajt, njenit prej anmiqve të përbetuem të sistemit të ri shoqnor. Në roman së pari ngrihen konflikte individuale ndërmjet fshatarëve. Por, ato mandej marrin nji karakter të gjanë dhe përfshijnë tanë katundin, të cilin e trondisin që nga temeli. Spasse në roman shpreh mendimin se ngritja e jetës së re bie mbi kurriz të brezit të ri dhe elementeve të tjerë progresivë në katund dhe jashtë tij. Brezin e të rijve e përfaqson në vepër Gjergji. Ai asht pikturue si fytyrë simpatike e rinisë përparimtare. Tue u paraqitë edhe dashunia e tij ndaj Marinës, të bijës së Gurrëmadhit, autori i ashpërson edhe ma tepër kundërthanjet ndërmjet shtresave antagoniste shoqnore. Konfliktet ngrihen njeni mbas tjetrit. Në katund vlon nji jetë shqetsuese. Shum shpresa të kahershme shuhen e lindin të tjera.

Me nji aftësi të rrallë krijuese autori e paraqet realisht jetën e katundit, kundërthanjet ndërmjet shtresave shoqnore, mentalitetin e katundarit dhe mbrapambetuninë e tij. Nëpërmjet të veprës shkrimtari grish rininë dhe të gjitha fuqitë progresive që të hyjnë në vallen e jetës së re, ku si asnji herë ma parë, pa shtypje e shfrytzim, ishte e hapun perspektiva individuale dhe ajo shoqnore.

Paraqiten për bukuri edhe shum idile dashunie në katundin buzë liqenit. Liqeni, si përherë, me pamjen pitoreske që ka, i magjeps të dashunuemit. Korijet dhe ambienti i kandshëm u afron të rijve entuziasmin jetsor. Asht paraqitë me fuqi sidomos dashunia e çiltërt, por edhe shum e pengueme ndërmjet Gjergjit dhe Marinës. Historia e gjatë e kësaj dashunie, edhepse asht në shum momente e kurdisun artificialisht, mbetet përherë në funkcion të vetë idesë kryesore të romanit.

Autori, tue dashtë me sendërgjue idenë themelore se ma të bindëshme, ngreh shum konflikte të tjera edhe në kuadër të familjes së Gurrëmadhit. Spiros i bahen kundërshtarë të përjetshëm edhe fëmijt e vet. Hieja e tij shkakton frigë e urrejtje kudo që gjindet. Përfundimi tragjik i jetës së Gurrëmadhit dhe shpëtimi i papritun i Marinës nga duert e grabitësve, asht në roman nji zgjidhje fatlume. Mbas përmbysjes së reakcionit mjaft të fuqishëm në katund, vehen temelet e kooperativës së re. Për jetën e re lindin edhe shpresa të reja.

Vepra, marrë në tanësi, asht edhe nji kontribut i madh letrar i Sterjos. Por, nuk e përfaqson kurrsesi zenitin e veprimtarisë letrare të tij. Pika kulminante në rrugën e gjatë të krijimtarisë së romansierit tonë duhet t'i takojë ndonji vepre, të cilën Spasse do ta shkruejë ma vonë, meqenëse romani „Buzë liqenit" nuk e ka vleftën artistike të veprës „Ata nuk ishin vetëm ..." apo edhe të romanit „Afërdita përsëri në fshat". Kompozicioni i veprës, si tanësi artistike, asht cenue nga disa pjesë të tepërta, të cilat në vend se me krijue lidhje të natyrshme të ngjarjes kryesore me ato epizodike, i ndërprejnë rrëfimet dhe zhvillimin e akcioneve të protagonistëve dhe antagonistëve në roman. Këto janë, në të vërtetë, disa histori dhe parahistori të shkurta apo të gjata, të cilat ndriçojnë diçka nga e kaluemja e fytyrave të romanit, por që edhe e ndërprejnë dinamizmin e zhvillimit të ngjarjeve. Në këtë mënyrë lexuesi e humb interesimin për ta përcjellë fillin e ngjarjes kryesore dhe fatin e herojve. Autori, si duket, veprën e shkroi mbrenda nji intervali të shkurtë kohe. Edhe në prezentimin e fytyrave Spasse në këtë roman nuk asht përherë bindës. Gjergjin (heroin kryesor) e paraqet mjaft naiv, sa i përket dashunisë që ndjen ndaj Marinës. Nji naivitet i tillë nuk i përgjigjet moshës së protagonistit dhe as rolit që luen ai në shoqni. Megjithate ai, si hero i romanit, mbetet simpatik, i arsyeshëm dhe mjaft energjik n'akcionet që ndërmerr. Paraqitja

e shum peripetive mbi jetën dhe fatin e Marinës nuk asht e bindshme.

Fytyrën e Major Llazit autori në fillim e ka tipizue jo të natyrëshme. Por, ma vonë mbërrin me e skalitë po si skluptori truporen e ekspozueme. Ate e paraqet ma të gjallë, jo njeri që „filozofon", por njeri t'akcionit. Në këtë mënyrë ate e rradhit ndër fytyrat pozitive në roman.

Me aftësi të rrallë artistike autori ka tipizue fytyrën e Pilo Dinakajt, i cili, si kullak, bashkë me klasën e tij, kishte ndjerë grushtin e fuqishëm dhe shkatrrues. Por, kishte shpëtue i gjallë, dhe, si nji ujk i vjetër, mbahej edhe ma tutje shum i rrezikshëm. Nëpërmjet të tij asht prezentue tradhtari që mbetet përgjithmonë kundërshtar i vegjëlisë dhe i depërtimit të marrëdhanjeve të reja në katund. Ate e mban në jetë shpresa se do të kthehen prap ditët e tij të dikurshme. Në roman janë paraqitë edhe mjaft fytyra komplekse si ajo e Nunit (të birit të Gurrëmadhit). Ai, i tronditun thellë nga fati i së motrës, Marinës, nga urrejtja e madhe që ndjen ndaj babës së tij zemërgur, ua jep flakën të gjitha të mbërrimeve të Gurrëmadhit dhe në këtë mënyrë kushtson tragjedinë e tij.

Romani „Buzë liqenit", sikur të mos i kishte këto pak të meta, do t'ishte padyshim vepra ma e bukur e Spasses. Megjithate, edhe kështu si asht, me paraqitjen dinamike të zhvillimit të ngjarjeve, me përshkrimet realiste të jetës së katundit shqiptar gjatë dhetë vjetëve të fundit dhe me stilin e rrjedhshëm e të natyrshëm, ajo e ngazllen lexuesin mjaft. Qëndrimi përherë altruist i autorit t'angazhuem, i cili shprehet për progresin ma të shpejtë të mbarë shoqnisë shqiptare, e angazhon maksimalisht lexuesin që të përqafojë gjithçka që asht progresive dhe e vlefshme për lulzim të përgjithshëm shoqnor.

IV

Sterjo Spasse zhvilloi nji veprimtari të gjatë letrare. Ai pat fillue të shkruejë në nji moshë të re. Së pari shkroi nji mori tregimesh dhe novelash e mandej, në moshën nandëmbëdhetë vjeçare, edhe romanin e tij të parë. Edhepse jetoi e veproi në kushte mjaft të vështira, i dhuroi letërsisë shqipe vepra voluminoze me nji vleftë mjaft të naltë letrare artistike. Ai krijon edhe

sot, tue e rrumbullaksue kështu aktivitetin shumvjeçar në lamën e letërsisë. Si prozator ka formue fizionominë e shkrimtarit me nji aftësi të rrallë krijuese.

Krijimet e fazës së parë letrare të Spasses nuk kanë vleftën artistike të atyne që shkroi ma vonë. Autori në fillim, pa nji përvojë të gjatë në lamën e krijimtarisë artistike, pa nji njohje të gjithanshme të letërsisë shqipe dhe asaj botnore dhe pa nji botëkuptim stabil mbi botën dhe shoqninë, nuk ishte në gjendje me trajtue tema komplekse. Prozat e shkurta dhe novelat e para janë ma tepër skica jete, ku paraqiten fytyra të zbehta e të parealizueme mirë. Tematika e shtjellueme asht mjaft e ngushtë. Edhe nëse janë shtjellue disa tema sociale, nëpërmjet tyne janë shqyrtue ma tepër problemet individuale se sa ato të karakterit të gjanë shoqnor. Konfliktet ndërmjet personazheve nuk janë paraqitë aq tronditëse. Gjuha e shkrimtarit nuk asht aq e pasun. Sa i përket pastërtisë së gjuhës ka pasë mjaft lëshime. Autori në fillim përdori elbasanishten me mjaft elemente të toskënishtes. Por, ma vonë, e zotnoi mirë edhe toskënishten letrare. Mjetet shprehëse artistike në hartimet e para të Spasses ishin të pakta. Megjithate, këto krijime si edhe ato të tanë brezit të 30 tës mbesin nji kontribut i madh në kohën kur, sa i përket krijimtarisë origjinale, ndihej nji shterpësi e madhe letrare.

Por, me kalimin e viteve, tue perfeksionue gjithnji e ma tepër mjeshtrinë e të thurunit artistik, autori në vepër ngriti arkitekturën e kompozicionit ma të plotë. Që prej botimit të romanit „Afërdita" vërejmë se Spasse çdo pjesë të veprës e shkruen me nji matuni të madhe. Në krijimin e tij artistik, me përjashtim të romanit të fundit, nuk vërehen ma pjesë të tepërta, përsëritje të ndonji historie mbi jetën e protagonistëve, por edhe as nuk ndeshen zbraztina eventuale. Çdo kaptinë thuret me përpikni dhe funkcionalitet. Ngjarja kryesore dhe epizodat që e mishnojnë ate paraqiten me nji harmoni të madhe shprehëse. Kompozicionin e veprës letrare e përsos edhe ma tepër në veprat që i përkasin fazës së tretë të krijimtarisë letrare. Romani „Ata nuk ishin vetëm..." shquhet me kompozicionin ma të plotë në letërsinë shqipe. Çdo kaptinë e tij asht e lidhun organikisht me tanësinë, e cila, si e tillë, me përmbajtje e ide interesante, me arkitekturë të qëllueme, e ngazllen lexuesin. Edhe romani tjetër: „Afërdita përsëri në fshat" ka gjithashtu nji kompozicion të qëlluem. Vepra si tanësi dhe pjesët e saj veç e

veç janë thurë natyrshëm. Romani mbyllet me nji epilog, që në të vërtetë asht rezyme e sukseseve t'Afërditës në fshat.

Tipizimi i ambientit, sidomos në këto romanet e fundit, asht ba me ngjyrna realiste. Asht ky ambient tipik nga katundi shqiptar, ku „jetojnë e veprojnë" personazhet. Por jo vetëm kaq. Me nji aftësi artistike aty paraqiten mënyra e jetesës, zakonet e katundit, thesari i çmueshëm popullor, përshkrimi i veshjeve — ornamentika popullore, idila dashunore e katundit e tjera. Me nji fjalë, asht pasqyrue tanë jeta e fshatarsisë.

Natyra, n'anën tjetër, në veprën e Spasses ndikon mjaft mbi vetë zhvillimin e ngjarjeve dhe tipizimin e personazheve. Përshkrimet e bukura të natyrës, pejzazhet e mrekullueshme të katundit, pamjet pitoreske të liqenit dhe kodrinave të gjelbrueme ndihmojnë për tipizimin e natyrshëm të fytyrave dhe paraqitjen e botës së mbrendshme të herojve. Në këtë mënyrë asht paraqitë ma bukur edhe e tanë atmosfera shoqnore.

Për çudi, romani i fundit „Buzë liqenit", i cili gjithashtu ka nji vlerë të naltë artistike, përcillet nga disa të meta, që i përkasin ma tepër anës kompozicionale. Romani qe botue në vazhdime në revistën „Nëndori" dhe me atë rast autorit iu banë disa vërejtje. Spasse e përpunoi veprën mandej rishtazi e me kujdes dhe e botoi të përmirsueme. Nëse krahasohen dy variantat e romanit „Buzë liqenit" mund të vërehen shum ndryshime. Megjithate, edhe kompozicionin e variantës së dytë e çthurin disa digresione që kanë të bajnë me jetën e kalueme të protagonistëve, të cilët nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me ngjarjet dinamike të romanit. Prandej, këto pjesë të panevojshme, e pengojnë dhe e ngadalsojnë zhvillimin e natyrshëm t'akcioneve. Çdo fytyrë ka së paku nga nji parahistori, e disa prej tyne edhe ma tepër. Lexuesi, tue analizue digresionet e shumta, fiton përshtypjen se në romanin e fundit të Spasses asht paraqitë i njejti sfond jetsor si edhe në romanin „Ata nuk ishin vetëm . . .". Kjo, padyshim e pengon autorin që pjesët e tjera të romanit t'i lidhi me nji funkcionalitet të duhun. Këto histori dhe parahistori nga e kaluemja e fytyrave të romanit, autori i hartoi me qëllim që të ndriçojë edhe ndonji fazë të maparshme të jetës së protagonistëve e që të ndikojë ma me fuqi në konflikte t'ashpra.

Tipizimi i ambienteve asht përshkrue me nji realizëm dhe gjallni të posaçme. N'ambientin tipik shqiptar, nëpërmjet të konflikteve, protagonistët dhe antagonistët tregojnë fytyrën e tyne

të vërtetë dhe shprehin botën e tyne të mbrendshme mjaft komplekse. Në saje t'aftësisë kreative të Spasses asht paraqitë në mënyrë reliefe edhe psikologjia e qenjes shoqnore.

Gjatë fazës së parë të krijimtarisë letrare, Spasse përdori nji stil mjaft të ndërlikuem. Shpeshherë, për shkak të trajtimit të disa temave komplekse, në kohën kur nuk kishte përvojë të gjatë letrare, stili i tij ishte edhe konfuz. Por, që me romanin e vet të parë „Prej jetës në jetë: „Pse?! ...", ai dëshmoi se ka formue nji stil të zhdërvjellë e të rrjedhshëm. Gjatë kësaj kohe, në tregimet e shumta dhe në roman, dallojmë përdorimin e fjalive të shumta eliptike, nëpërmjet të cilave, me nji notë të theksueme, autori rrëfen mendimet dhe filozofinë e tanësishme, e njiherit paraqet edhe jetën komplekse të personazheve. Në këte mënyrë, fytyrat çfaqen edhe me botën e tyne të mbrendshme, e cila në nji masë, i kushtson edhe akcionet e tyne. Jeta e protagonistëve, sidomos në fazën e parë të veprimtarisë letrare, paraqitet mjaft enigmatike dhe nëu kjo e shton kureshtjen e lexuesit që ta presë me padurim zgjidhjen e fatit të herojve. Vokacionet e shumta, përsëritjet e fjalëve dhe fjalive në kuadër të periudhës, janë elemente të naracionit impresiv, të cilat i ndeshim në veprat e fazës së parë të krijimtarisë letrare të Spasses.

Me kalimin e viteve, autori e përsos edhe ma tutje stilin e veprës letrare, kujdeset ma tepër për zgjidhjen dhe përdorimin e mjeteve të shumta artistike shprehëse. Me aftësi të rrallë përdor krahasimet, metaforën, epitetin, personifikimin, simbolin dhe shum figura të tjera. Kujdeset me përkushtim të pasunojë gjuhën, të gdhendi fjalën dhe fjalinë, të përdorë deri në përpikni format e drejta të fjalës artistike. Kujdes të posaçëm i kushton ndërtimit sintaktik të fjalisë. Gjuha e tij asht shum e pasun, veçanërisht në romanet e fazës së tretë, ku përdoret ma saktësisht, me qëllim t'individualizimit të personazheve. Në nji mënyrë të kondenzueme përshkruhen ngjarje të shumta në roman, çfaqet bota e mbrendshme e personazheve dhe thuren përshkrime të bukura të natyrës.

V

Veprimtari e tanësishme e nji shkrimtari mund të studjohet nga të gjitha aspektet e në përplotni, vetëm atëherë kur ajo ka përfundue, kur autori në veprën letrare e ka thanë edhe fja-

lën e vet të fundit. Studjuesi në këtë rast asht në nji pozitë ma të sigurtë, sepse tanë atë vepër letrare të rrumbullaksueme përgjithmonë e studjon nga nji distancë relativisht të gjatë kohe. Kështu kanë veprue edhe kritikët ma në za gjatë studimit të shkrimtarëve ma të famshëm botnorë dhe veprave ma të njoftuna të tyne.

Por, kjo nuk do të thotë se studimet kritike që bahen mbi veprimtarinë e pafinalizueme të nji autori janë thjeshtë, në kuadër të tanë kritikës letrare. Sepse, edhe këto paraqesin nji kontribut në lamën e kritikës dhe shkencës së letërsisë. Pa dyshim, ato mund të plotsohen e korigjohen edhe ma tutje. Në këtë mënyrë u caktohet vendi i merituem, mvarsisht nga vlefta e tyne dhe karakteri i tanë veprës letrare që studjohet.

Në këtë punim asht studjue veprimtaria letrare e pa përfundueme në tanësi e Sterjo Spasses, sepse shkrimtari ynë edhe tash e tutje krijon vazhdimisht. Por, si kuptojmë nga disa shënime t'autorit dhe të bashkëkohësve të tij, përveç veprave të botueme, ai ka në dorëshkrim edhe disa vepra: tregime, novela dhe nji roman. Studjuesit i intereson posaçërisht fakti: cilës fazë të krijimtarisë letrare i takojnë ato krijime, çfarë karakteri kanë, cila tematikë asht shtjellue në to, çfarë mendimesh janë shprehë edhe për ç'arsye autori nuk i botoi as deri më tash. Atij i intereson veçanërisht edhe vlefta e tyne artistike. Prandaj, në studimet e matejshme mbetet të studjohet me kujdes edhe kjo veprimtari e heshtun e Spasses.

Nëpërmjet të këtij studimi asht konstatue prezenca e pikëpamjeve sociale të Spasses në veprën e tij letrare, tue u shënue kronologjikisht (mvarësisht nga përpilimi dhe botimi i veprave) paraqitja e tyne në veprat letrare artistike. Në këtë drejtim asht vërejtë nji farë ngritjeje graduale e shkrimtarit, sa i përket aftësisë së tij krijuese; asht pasqyrue rruga evolutive e formimit të botëkuptimit t'autorit mbi botën dhe shoqninë dhe asht përcaktue (përafërsisht) prezenca e pikëpamjeve sociale në veprën e tij letrare.

Në fazën e parë të krijimtarisë letrare (1929-1935) në kohën kur shkrimtari ishte në nji moshë të re, pa përvojë të gjatë letrare, por edhe atëherë me nji talent të shquem, pa botëkuptim stabil mbi botën dhe shoqninë në tanësi, pa njohjen e domosdoshme e të thellë të kontradiktave shoqnore të kohës, shkroi ma tepër proza të shkurta, tregime dhe novela, në të cilat shtrohe-

shin disa tema dite mbi jetën e vështirë të shoqnisë s'atëhershme. Qysh në hapat e parë ai u afirmue me trajtimin e disa temave nga jeta e katundit. Së pari u muerr me trajtimin e pak temave patriotike e mandej kryesisht me lavrimin e nji tematike sociale. Ishte koha kur autori nuk i kishte mbushë ende të njizetat. Gjatë regjimit monarko-absolut të Zogut në Shqipni, Spasse dhe e tanë gjenerata e tridhetës, shkruente nën kushte shum të vështira. Dënimet dhe persekutimet ishin masat e fundit që pengojshin të shprehunit e lirë të fjalës artistike. Megjithate, nga kjo periodë Spasse na dhuroi me dheta tregime e novela në të cilat, jo vetëm që paraqiti gjendjen e vështirë të shoqnisë s'atëhershme shqiptare e sidomos ate të katundarëve të vuejtun, por edhe tanë klimën shoqnore të kohës. Në nji platformë të gjanë, tue e paraqitë jetën realisht, shkrimtari kritikon të metat e shoqnisë. Edhe atëherë shprehet për nji progres të përgjithshëm shoqnor. Me shkrimet e veta nxiste forcat progresive t'i rezistojshin regjimit në fuqi. Tue pasë nji besim të madh në çlirimin ma të shpejtë të vegjëlisë, Spasse me prozën „Pellgu", asht ndër të parët e gjeneratës së tij, i cili tregon edhe rrugën drejt ardhmënisë ma të lumtun të „njerëzisë së pastër", si i quen ai masat progresive të shoqnisë shqiptare. Simbas tij, mbas çlirimit nga shfrytzimi i pamëshirshëm feudal-borgjez, mbas kalimit të nji rruge të vështirë e „plot me gjemba", ku nuk përjashtohet edhe mundësia e sakrificave të shumta, dhe me përpjekje ma të madhe në t'ardhmen, do t'ishte i mundshëm progresi shoqnor kaherë i dëshiruem. Por, për fat të keq, autori mbas pak vjetësh si intelektual u deziluezionue nga shoqnia. Nga se kishte kalue nji jetë të vështirë personale e ma tepër kishte pa edhe vetë vuejtjet dhe persekutimet tronditëse të vegjëlisë, ishte demoralizue në jetë. Me nji fjalë, shkrimtari ishte dorzue, kishte përqafue idetë e damshme pesimiste dhe nihiliste. Me romanin „Pse?!..." ai mohon gjithçka edhe jetën. Paraqitja e ideve pesimiste në roman e lëndoi pak fizionominë e shkrimtarit dhe la gjurma të pashlyeshme. Romani, në të vërtetë, asht nji protestë e fuqishme, e ngritun kundër asaj jete të mundimshme e të mbrapambetun të shoqnisë shqiptare. Në te mbizotnon ma tepër nota e fuqishme pesimiste. Por autori në disa pjesë të romanit e ngren prap zanin për nji përmirsim të gjendjes së përgjithshme të shoqnisë, për nji përparim kulturor e shoqnor, për emancipim të domosdoshëm të femnës shqiptare.

Romansieri ynë vetëm në veprat e fazës së dytë, mbasi mësoi nji rrugë të re krijuese e jetësore, nëpërmjet të veprës letrare i paraqiti pikëpamjet e veta sociale të shëndosha për përmirsimin e gjendjes shoqnore. Në romanin „Afërdita" ai shpreh mendimin se: arsimi duhet të jetë faktori kryesor për transformimin progresiv të shoqnisë. Simbas tij, randësi vitale për zhvillimin e gjithanshëm të shoqnisë shqiptare paraqet kontributi i arsimtarëve progresivë nga qyteti. Por, në vepër autori ban fjalë edhe për faktorë të tjerë, të cilët e pengojnë çlirimin dhe përparimin e masave të gjana. Ai demaskon religjionin dhe bestytnitë e kota, që kishin lëshue rranjë të thella në botëkuptimin e njerëzve të mbrapambetun. Strukturën e përgjithshme shoqnore dhe ate të familjes shqiptare, të kaluemen e vështirë, administrimin qeveritar absolut, ndikimin e politikës, kulturës dhe filozofisë reakcionare nga perëndimi, Spasse i paraqet si faktorë të tjerë, të cilët kanë kushtsue nji gjendje të padëshirueshme të shoqnisë shqiptare.

Mbas revolucionit socialist letërsia e realizimit socialist u kultivue edhe në Shqipni. Sterjo Spasse e shkroi romanin e parë të kësaj letërsie me titull „Ata nuk ishin vetëm...". Mandej pasojnë edhe veprat e tjera të të njejtit autor dhe ato të shkrimtarëve të tjerë. Gjatë kësaj kohe romasieri ynë, tue iu përmbajtë deri në përpikni tipareve të romanit të realizimit socialist, shkruen ma tepër për jetën e re dhe ndërtimin e socializmit. Në këte mënyrë parashtron njikohësisht nji koncepcion të vet mbi progresin e shoqnisë socialiste në përgjithsi. Në këto vepra pikëpamjet sociale janë prezente pjesërisht. Megjithate, edhepse autori i ka shtrue vehtes nji qëllim tjetër, — të paraqesi marrëdhanjet e reja në shoqninë socialiste, — në veprën letrare shtroi edhe pikëpamjet sociale të maparshme, por të shkoqituna mvarsisht nga kushtet shoqnore të reja dhe kërkesat e kohës.

Me kalimin e viteve mendimi i autorit mbi transformimin progresiv të shoqnisë u ndryshme. Ma në fund, në romanin „Ata nuk ishin vetëm..." ai mendon se rolin vendimtar për çlirimin dhe progresin e përgjithshëm shoqnor e luen vetë vegjëlija, „opinga", si i quen ai shtresat e shtypuna. Vetëm me luftë t'organizueme ato munden me i vu temelet nji shoqnie të re, ku nuk ka shtypje as shfrytzim. Në këtë mënyrë ajo mundet të niset drejt përparimit të gjithanshëm shoqnor. Në romanin tjetër „Afërdita përsëri në fshat" autori konstaton për së dyti se arsimi

asht faktor shum i randësishëm për zhvillimin ma të shpejtë e progresiv në shoqni. Ai, ma tutje, nënvizon se në jetë dhe punë kërkohet medoemos nji qëndrueshmëni e madhe. Sakrificat në këtë rrugë të gjatë jetsore e shum të vështirë të shoqnisë janë të paevitueshme.

Për nji progres të vërtetë shoqnor, simbas Spasses, rol vendimtar luen edhe personi i epokës gjegjëse historike, i cili asht i pajisun me virtyte të nalta dhe i cili duhet t'i takojë pa tjetër masave të gjana. Fytyra të tilla në romanet e Spasses janë: Afërdita („Afërdita" dhe „Afërdita përsëri në fshat"), Gjikë Shpati („Ata nuk ishin vetëm..."), Gjergji („Buzë liqenit").

Duhet konstatue gjithashtu se të gjitha këto ide sociale në veprën letrare artistike nuk janë paraqitë të sistemueme, por parashtrue mvarsisht nga ngritja e vetë shkrimtarit dhe nga rrethanat e përgjithshme shoqnore të kohës. Ato ishin shum aktuale për kohën kur Spasse i shpreh në veprën letrare, e mbetën t'atilla edhe në ditët tona. Me të tilla ide shquhet veçanërisht vepra „Afërdita" e cila, si vepër letrare, ka luejtë e luen edhe sot nji rol të randësishëm, sidomos në ngritjen e vetëdijes së rinisë, sepse ate e angazhon maksimalisht që të bajë përpjekje për nji progres të përgjithshëm shoqnor.

Prandaj, vepra letrare e Sterjo Spasses, për hir të vleftës së saj të naltë artistike-letrare, lexohet shum dhe i ngazllen lexuesit. Në këtë mënyrë ajo kryen edhe nji mision shum të randësishëm shoqnor: me idetë e shumta progresive (tue përjashtue romanin „Pse?!..." dhe ndonji prozë tjetër, ku mbizotnon nota pesimiste) e posaçërisht me pikëpamjet sociale të shprehuna me mjeshtri të madhe artistike, edukon dhe angazhon lexuesit për progresin e përgjithshëm shoqnor, për jetën e re e ma të lumtun. Si e tillë, me nji notë të thellë humanitare, ajo u mbetet breznive për gjithmonë si dhuratë e shtrejtë.

STERJO SPASSE
PSE ?!
ROMAN

BIBLIOTEKA SHKOLLORE
STERJO SPASSE
ATA NUK ISHIN VETËM...
(Roman)

STERJO SPASSE
AFËRDITA
PËRSËRI NË FSHAT


STERJO SPASSE
O SOT,
O KURRË
roman

III

JETËSHKRIMI I SHKRIMTARIT STERJO SPASSE

SHËNIME MBI JETËSHKRIMIN E SHKRIMTARIT STERJO SPASSE[28]

I - FAMILJA - FËMIJËRIA - RINIA E TIJ

Sterjo Spasse ka lindur më 14 gusht të vitit 1914 në katundin Gllomboç, buzë liqenit të Prespës, rrethi i Korçës. I ati quhet Spase Niço dhe është i biri i Niço Pavle. E ëma e t'i atit është nga Bezmishti. E ëma e Sterjos quhet Mara, e është e bija e Pando....nga Shulini. Sterjo-ja ka edhe tre vllezër, Joshen, Stojanin dhe Andonin. I pari dhe të fundit kanë vdekur me kohë. Ka edhe dy motra, të madhe Trënda, më e madhja ndër fëmijët, jeton në Zaroshkë; kurse tjetra, Lena jeton në Cerje me familjet e tyre. I ati Spase kishte edhe tre vllezër të tjerë e një motër. Sterjo-ja i vogël vegjëlinë e rininë e ka kaluar

28 "Jetëshkrimi i shkrimtarit Sterjo Spasse", botohet për herë të parë dhe pa ndryshime, ashtu si e ka lënë në dorëshkrim.

Gllomboç

në një familje të madhe patriakale me gjyshër, me xhaxhallarë, me nuse xhaxhallarësh e kusheri e kusherira e nuse e dhëndurë të tyre e fëmijë të tyre, që e përbënin familjen e tij gjer më 1930 rreth dyzet e ca vetë, e që banonin në dy dhoma. Si gjithë bashkëfshatarët edhe familja e Sterjos ishte çifçi e punonin çifligun e bejlerëve Behxhet, Syrja e Skëndo Pojani, që banonin në Korçë. Të gjithë pjestarët e familjes punonin në bujqësi, në blektori, digjnin qymyr e thëngjill e fshehurazi mirreshin edhe me peshkëtari. Por çdo punë, sidomos të bujqësisë bëhej nën urdhërat e nën mbikqyrjen e nën kontrollin e sejemenëve e të kullauzëve të bejlerëve. Nga ana ekonomike familja ishte shumë keq, prandaj veç punëve si çifçi meshkujt detyroheshin të merrnin rrugën e kurbetit në kohën e Turqisë shkonin nga vëndet e Ballkanit, kurse në kohën e rendit feudo-borgjez nëpër kurbetet tej oqeaneve. Në jubilenun e 70-vjetorit të lindjes së shkrimtarit, që u bë më 22 e më 23 shtator 1984, midis të tjerave në fjalën e tij theksoi edhe këto: "...Nga familja ime dhe e gruas sime kanë ngrënë me vite këto kurbete baballarët tanë, xhaxhallarët, kushërinjtë e një nga vëllezërit e mij...Le këtë: dheu i Amerikës së zezë na hëngri babanë e gruas sime dhe një kushëri tim të parë". Thënë më shkurtaz se krahina,e Prespës vuante nga varfëria, nga shfrytëzimi i feudalëve, të fajdexhinjve e të nëpunësve të rendit feudoborgjez. Gjer në vitin 1924 kjo krahinë ishte nën sundimin e Greqisë; pastaj, nga vjeshta e vitit 1924 u bashkua me Shqipërinë. Atëherë vërshuan në këtë krahinë edhe bejlerët, pronarët e çifligjeve të fshatrave. Sterjo Spasse klasën e parë e të dytë e bëri në shkollë greke, në fshatin e tij në Gllomboç: kurse, klasën e tretë në shkollën fillore greke në katudnin Nivicë, që është edhe sot brenda kufijve greke. Këto ishin vitet shkollore 1921-1924. Në vitin 1925 Sterjoja, në muajin prill, vajti në shkollën e parë shqipe, që u hap në Goricë të Madhe, me mësues Pandeli Sinën, bir i mësuesit dhe patriotit të shquar

rilindas korçar, Thanas Sinës. Në këtë shkollë, për disa muaj, Sterjoja mori mësimet e para në gjuhën shqipe. Në vjeshtën e po këtij viti, i ati Spasse, i shtyrë nga nevojat e jetës, edhe nga mësuesi Pandeli, e pajtoi Sterjon si shërbëtor te Hani i Napuçës në Korçë, han që u quajt më vonë Hani i Shuleve. Në këtë han, Sterjoja si çirak pastronte ahuret nga bajgat e kafshëve, shiste bar të thatë myshterinjve e bënte shërbime të ndryshme. Por, njëkohësisht, në vend të ndonjë shpërblimi si rrogë, - të zotërit e hanit e lejonin Sterjon të shkonte në shkollë në klasën e katërt fillore. Vitin tjetër vazhdoi përsëri si çirak, por në hanin e Alo Beut. Edhe në këtë han bënte po atë punë, sepse edhe atë vit pronarët, në vend të shpërblimit, e lejonin të shkonte në shkollën plotore nr. 4, ku kishte bërë klasën e katërt e që si ndërtesë ka qenë te vendi ku u ngrit më vonë monumenti i Luftëtarit Kombëtar. Drejtor ishte Nikollaq Mitace, fizikisht pak i çformuar, por shumë i matur e shumë i zoti i punës si arsimtar dhe si administrator; ndërsa në klasën e katërt, si mësues ka patur Riza Halitin, edhe ai i kujdesshëm për nxënësit. Me qenë se Sterjoja shkonte shumë mirë me mësimet, personeli i shkollës me drejtor Mitacen në krye, vendosi që në vend të klasës pestë, i dhanë të drejtën që të vazhdonte klasën e gjashtë plotore, ku, sipas lëndëve ka pasur edhe mësues të ndryshëm, si Ilo Mitkë Qafzezin, i njohur tanimë si historian. Sterjoja, edhe pse kishte përsipër gjithë ato hamallëqe si çirak në han, shkonte shumë mirë me mësimet dhe mësuesit e morën me sy të mirë. Nga krahina e Sterjos nuk kishte asnjë bashkëfshatar, as me shkollë të mesme as në bukë të qeverisë. Kjo gjendje e krahinës dhe aftësia e djalit e bëri personelin arsimor, që t'i krijonin mundësi Sterjos për të vazhduar shkollën e mesme me bursë. Ndërhynë në prefekturë, ku ndihmoi me gjithë shprit patrioti e mësuesi i shquar i Rilindjes, Nuçi Naçi, që ishte nëpunës në pleqërinë e tij në atë prefekturë. Me dëshirën e frymëzimin e vetë Nuçi Naçit u vendos, që Sterjoja

të mos vazhdonte as lice, e as ndonjë shkollë tjetër të mesme, por shkollën Normale të Elbasanit, që të bëhej mësues, një profesion aq i nevojshëm i kohës. Me rekomandimin edhe të drejtorit të Liceut, prof. Sotir Papahristos për drejtorin e shkollës Normale, që ishte prof. Aleksandër Xhuvani, - djaloshi Sterjo u nis për në Elbasan me ato robe shajaku që mbante edhe si çirak hani dhe, pas një provimi në hartim, vazhdoi shkollën si bursist në vjeshtën e vitit shkollor 1927-28.

II - SI NXËNËS NË SHKOLLËN NORMALE

Në shkollën Normale, veç mësimeve të përditshme, u aktivuzua shumë edhe në veprimtaritë jashtëshkollore. E ndjente vetvetiu nevojën për të shprehur mendimet e tij e me vite, në klasat e fundit, u bë korrespodent zyrtar me libreza i gazetës antizogiste "Shqipëria e re", që botohej në Kostancë të Rumanisë, si dhe në gazetën "Ora", që botohej në Tiranë. Në korrespodencën e tij trajtonte probleme letrare, artistike dhe sprotive të ndryshme, sidomos me pseudonimin Stespa. Me shkrimet e tija ra në kundërshtim edhe me organizatorin fashist italian De Fuçien, se Sterjoja shkruante nëpër gazetat edhe për konfliktet e rinisë elbasanase dhe e normalistëve me organizatorin, që ishte edhe si komandant i paraushtarakëve. Prandaj, një ditë organizatori italian De Fuçia e burgosi Sterjon, në prillin e vitit 1931. Atëhere nxënësit e Normales protestuan hapur, saqë u detyruan të venin nga Tirana dy inspektorë të lartë të oborrit mbretëror për ta qetësuar çështjen. Pas dhjetë ditësh Sterjon e nxorrën nga burgu, por sakaq, Ministria e Arsimit shpërndau një qarkore të datës 17 prill 1931, me anën e së cilës urdhëronte që asnjë nxënës i shkollave të mesme të mos guxonte të shkruante nëpër gazetat, se ndryshe i pritej bursa dhe përjashtohej nga tërë shkollat e Shqipërisë.

Por nxënësi Sterjo kishte natyrë të shqetësuar dhe me pseudonime të ndryshme përsëri vazhdonte të shkruante, madje mori edhe iniciativën, që në këtë amulli të rinisë shqiptare të krijohej shoqata "Bashkimi i studentëve të shkollave të mesme" duke shkruar artikullin e parë për këtë çështje ai vetë në gazetën "Ora" të prillit të këtij viti (1931). Pas tij, ranë dakort e shkruan edhe shumë nxënës të shkollave të tjera të Shqipërisë. Më në fund u krijua një komision i veçantë nga përfaqësuesi i këtyre shkollave dhe i bënë një lutje Ministrisë së Arsimit për t'i lejuar që të krijonin këtë bashkim. Por Ministria e Arsimit i ndaloi rreptësisht. (Për këtë shih gazetën "Ora" e muajit qershor të vitit 1931).

Sterjoja vazhdoi shkollën duke qenë edhe editor (redaktor) i revistës "Normalisti", organ i nxënësve të shkollës Normale. Më 10.XI.1930 maturantët e vitit 1932 krijuan shoqërinë "Normalisti Shëtitës 1932" me qëllimin pedagogjik, që kur të mbaronin shkollën, të bënin shëtitje nëpër Shqipëri sipas parimit "Që të duash atdheun, duhet ta njohësh me parë atë". Si sekretar i përhershëm i kësaj shoqërie u zgjodh "Themeluesi i kësaj shoqërie ST. Spasse", si pohon në faqen 18 "Libri i Kujtimeve i Normalistit Shëtitës 1932", botuar me 1933 në shtypëshkronjën "Shkodra". Dhe këta maturantë, sa mbaruan maturën, ia arritën qëllimit, duke përdorur si shpenzime kuotat që paguanin çdo muaj vite me radhe, si dhe ndihmën e ndonjë konvikti. Botuan edhe librin e kujtimeve.

III. NË JETËN PRAKTIKE:
A - PARA ÇLIRIMIT

1 - KRIJIMI I FAMILJES: Sterjo Spasse u martua i ri me Nikolina Llazo, bashkëfshatare. Martesa u bë, në Gllomboç më 27 korrik 1933. Prej kësaj martese, sot ka vajzën Afërdita

(mjeke), djalin Ilinden (punonjës në Institutin e Studimeve Pedagogjike) dhe Marjana, teknike e mesme në Institutin e projektimeve nr. 4 të Tiranës. Të gjithë këta janë të martuar e me fëmijë. E shoqja, Nikolina në fshat ka punuar në bujqësi, kurse në Tiranë, që në vitin 1945 ka qenë tezgjahiste në Kooperativën Leshpunuese të Tiranës e më vonë si punëtore në ndërmarrjen Artistike Migjeni të Tiranës.

2 - MËSUES NË DERVIÇIAN, VOSKOPOJË, KORÇË:

Në shtator të vitit 1932 Sterjoja u emërua mësues në shkollën fillore të Derviçianit të Dropullit, Gjirokastër. Aty shërbeu gjer në muajin nëntor të vitit 1934. Edhe duke qenë mësues, ai vazhdonte të studionte gjuhën greqishte dhe në nëntor të vitit 1934 dha edhe provimet e stazhit në Normalen e Elbasanit, një provim që ja shtonte kulturën pedagogjike si arsimtar, por edhe rrogën. Merrte pjesë në aktivitetin e arsimtarëve përparimtarë të Gjirokastrës, edhe duke dhënë diçka materiale, por edhe duke marrë pjesë aktive në organizimet e ndryshme, si në inagurimin e varrit të mësuesit të madh rilindës, Koto Hoxhit në Qestorat të Lunxherisë, në përurimin e monumentit të Çerçiz Topullit në Gjirokastër, në çfaqje theatrale e në manifestime të ndryshme. Po në Derviçian shkrojti romanin e tij të parë "PSE?!..." (1933) dhe fragmentin e tij të parë e botoi në gazetën e Gjirokastrës "Demokratia" më ...1934.

Në vitin shkollor 1934-35 u transferua si kryemësues në shkollën fillore të Voskopojës. Kurse në vitin shkollor 1935-36 u transferua në Korçë, më parë si mësues në shkollën Mashkullore nr. 2 e më vonë, në vitet e tjerë, gjer më 1940 si drejtor në shkollën Mashkullore nr. 3 të Mitropolisë, po në Korçë.

Gjatë kësaj periudhe, Sterjoja vazhdonte të zhvillonte aktivitete të ndryshme shkollore e letrare: krijoi dhe drejtoi pranë inspektorisë së arsimit "Bibliotekën pedagogjike", gjë e re për rrethin e Korçës; mbante mësim jete të hapura e konferenca pedagogjike, shëtitje mësimore në natyrë me nxënësit; shërbeu si sekretar i Entit Kombëtar të Korçës në kryesi të degës së letërsisë, që ka patur si kryetar prof. Kostaq Cipon e anëtar Ilo Mitkë Qafzezin etj. Njëkohësisht vazhdonte të shkruante reportazhe e tregime në shtypin e përditshëm e periodik të kohës, si në revistat e Korçës "Arsi", "Flaga", "Rilindja", "Bota e re", "Nomralisti" i Elbasanit, "Illyria" e Tiranës etj. Më 1935 në shumë numra të "Gazetës së Korçës" botoi si nënfletë romanin e tij të parë "PSE?!..." Po në këtë gazetë, në shumë numra të saj, botoi si nënfletë më 1936 përmbledhjen e gjerë të romanit "Të mjerët" të Viktor Hygoit, përkthyer nga frëngjishtja.

Më 1940 Sterjo Spasse u transferua nga Korça në Tiranë pranë Komisionit Teknik të Arsimit, ku ishin si anëtarë Aleksandër Xhuvani, Andon Deda, Karl Gurakuqi etj. Pas disa muajve u transfrua pranë inspektorive të arsimit të prefekturës së Tiranës me detyrën e Drejtorit Didaktik (Iloj ispektori arsimi) dhe pati rastin të inspektojë tërë shkollat fillore të kryeqytetit e të fshatrave të Tiranës, të krahinës së Shëngjergjit e të krahinës së Matit.

B - PARA ÇLIRIMIT

1 - Familja e Sterjos në Gllomboç, buzë liqenit të Prespës ku banonin prindërit e gruaja e tij, ka qenë bazë e përhershme partizane.

2 - Sterjoja në Tiranë, simpatizonte Lëvizjen Nacionalçlirimtare. Gjatë verës së vitit 1944 kaloi në Korparmatën e parë, ku komisar ishte shoku Hysni Kapo. U aktivizua në

sektorin e Axhit-propi (shih dokumentin "Dëshmi e Shtabit të Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare") që ndodhet në Arkivin e shkrimtarit).

Ende pa u çliruar Tirana, me një grup të vogël mësuesish ilegalë, Sterjoja si delegat i arsimtarëve të prefekturës së Tiranës vajti po ilegalisht në Kongresin I të Arsimtarëve Antifashistë në Korçën e sapoçliruar, që u mbajt më 22-24 Nëntor 1944. Sterjoja atje diskutoi për problemet aktuale arsimore, u zgjodh edhe antëtar në kryesinë e organizatës "Bashkimi i Arsimtarëve Antifashistë shqiptarë", ku bënin pjesë arsimtarë të tillë si prof. Aleksandër Xhuvani, Shaban Arra, Siri Shapllo, Kadri Baboçi, Kolë Paparisto, Aleks Buda etj. (Shih librin: Historia e Arsimit dhe e Mendimit Pedagogjik shqiptar") - 1988 - Instituti i Studimeve Pedagogjike".

C - GJATË NDËRTIMIT TË SOCIALIZMIT

1 - Gjatë vitit shkollor 1945-1946 Sterjoja vazhdoi si mësues i gjuhës shqipe në shkollën Pedagogjike Femërore të Tiranës. njëkohësisht ishte edhe redaktor i revistës së parë pedagogjike të Pasçlirimit "Shkolla e re", që e nxirrte një grup shokësh me Kahreman Ylli, Siri Shapllo, Qibrie Ciu, Lirak Dodbiba, Sotir Paparisto dhe ai.

2 - Më 1946 gjer më 1954 Sterjoja punoi pranë Ministrisë së Arsimit, në fillim si shef i seksionit të shkollave shtatëvjeçare, pastaj edhe të shkollave të mesme, ku drejtoi përgatitjen e programeve dhe të teksteve shkollore të gjuhës e të letërsisë për këto shkolla për zbatimin e Reformës Arsimore.

3 - Më 1954 u transferua në Lidhjen e Shkrimtarëve si shef i seksionit të prozës, njëkohësisht edhe si një nga redaktorët e më vonë si një nga anëtarët e kolegjiumit të revistës letrare "Letërsia jonë" dhe më vonë "Nëntori" dhe të revistës pedagogjike "Arsimi popullor" të Ministrisë së Arsimit.

Mjaft vite ka vazhduar si shkrimtar profesionist. Tani është në pension.

Ç - STUDIMET QË KA KRYER:

1 - Shkollën fillore e ka bërë greqisht e pastaj shkollën plotore në Korçë. Ka kryer shkollën Normale të Elbasanit më 1932 dhe provimet e stazhit i ka dhënë më 1934.

Ka vazhduar me korrospodencë studimet pedagogjike në Magjistero të Firencës, pa mbaruar vitin e fundit. Ka kryer kursin dyvjeçar të Universitetit të Natës të Marksizmit-leninizmit në Tiranë. (1954).

Ka kryer kursin e lartë për letërsi pranë Institutit të Lartë Maksim Gorki në Moskë (1958-60).

D - DETYRAT SHOQËRORE

1 - Është një nga iniciatorët e grupit për krijimin e Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë (1945) (Shih shtypin e kohës).

2 - Që me krijimin e Lidhjes së Shkrimtarëve më 1945 e gjer më sot (1989) është anëtar i Komitetit Drejtonjës.

3 - Ka qenë i zgjedhur vite me radhë si anëtar i Këshillit Popullor të kryeqytetit dhe si anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të rrethit të Tiranës.

4 - Ka qenë disa herë i dërguar jashtë shtetit si përfaqësues i shkrimtarëve të Shqipërisë, herë vetëm e herë me shokë. etj.

5 - Ka qenë nënkryetar i shoqatës së miqësisë Shqiptaro - Kineze.

DH - AKTIVITETI PEDAGOGJIK

Sterjo Spasse veç aktivitetit praktik si mësues, si drejtor shkolle e si inspektor arsimi, ai ka shkruar edhe shumë artikuj e studime lidhur me problemin e arsimit që në rininë e vet e

deri në moshë të shtyrë; njëkohësisht ka qenë edhe një nga redaktorët e revistave pedagogjike "Normalisti", "Shkolla e re", "Arsimi popullor" etj. Një pjesë të shkrimeve pedagogjike i ka përmbledhur e botuar në librin "Reflekse pedagogjike", botuar më 1987 nga Instituti i Studimeve Pedagogjike.

Gjatë Reformës Arsimore (1956) botoi për shkollat shtatëvjeçare e të mesme këto tekste që patën disa ribotime rreth një çerek shekulli:

1 - Antologjia për klasën e parë të shkollës unike; (1946);

2 - Antologjia për klasën II, III, të shkollës unike me shënimet e duhura (1946).

3 - Literatura e huaj për shkollën e mesme (1947).

4 - Elementet e para të teorisë së letërsisë (1951).

5 - Letërsia e huaj (Vëll. I, 1951) me bashkëautor Mahir Domin.

6 - Letërsia e huaj, vëll. II, 1953, me bashkëautor Mahir Domin.

7 - Gramatika e gjuhës shqipe (1951) për shkollat shtatëvjeçare me bashkëautor Lirak Dodbiba.

8 - Antologjia e letërsisë shqipe në frëngjisht për shkollën e Partisë..., me bashkëautor Nonda Bulka.

9 - Folklori shqiptar - dispencë për shkollat e mesme (1949)

10 - Reflekse pedagogjike (përmbledhje studimesh pedagogjike) 1987.

11 - Puna në shkollë (1016 faqe) me bashkëautorë arsimtarë dhe redaktor kryesor Sterjo Spasse (1987).

E - AKTIVITETI LETRAR:

1 - Krijimtaria origjinale:

a: PËRMBLEDHJE TREGIMESH

1 - Kunorë rinie (1934)

2 - Në krahët e një femne (1934)
3 - Nusja pa duvak (1944)
4 - Të fala nga fshati (1958)
5 - Kurorë rinie (1963)
6 - Sokolesha (1966)

b: ROMANE
1 - Pse?!... (1935)
2 - Afërdita (1944)
3 - Ata nuk ishin vetëm (1952)
4 - Afërdita përsëri në fshat (1954)
5 - Buzë liqenit (1965)
6 - Zjarre! (1972)
7 - Zgjimi (1974)
8 - Pishtarë (1975)
9 - Ja vdekje, ja liri (1978)
10 - Kryengritësit (1983)
11 - O sot, o kurrë! (1989)

Shënime 1: Romani "Afërdita përsëri në fshat" me titullin "Për jetën e re" është botuar më parë në revistën "Nëntori" nr. 11, 1954.

Romani "Buzë liqenit" me titullin "I urituri" është botuar në variantin e parë në revistat "Nëntori", "Zëri i popullit", 4.X.1959 dhe në gazetën "Zëri i rinisë", 26.XII.1959.

Romani "Zjarre" me titullin "Ne jemi shumë" është botuar në revistën "Nëntori".

Shënimi 2: Në vitin 1968 Shtëpia botuese "Rilindja" në Kosovë, botoi në 8 vëllime krijimtarinë letrare të Sterjo Spasses me titullin "Kompleti Sterjo Spasse".

Në vitin 1980 Shtëpia botuese "Naim Frashëri" botoi krijimtarinë letrare të Sterjo Spasses në serinë e veprave letrare në 9 vëllime.

Shënime 3: Krijimtaria letrare-pedagogjike e butuar në shtypin e përditshëm e periodik të kohës para e pas çlirimit por që nuk janë përfshirë në vëllime më vete, janë këto si vëllime:

1 - Probleme të letërsisë shqipe.
2 - Probleme të letërsisë së huaj
3 - Gjenia e popullit tonë në krijimtarinë e tij folklorike.
4 - Me sy e me zemër nëpër Shqipëri (reportazhe)
5 - Në krahët e shqiponjës (tregime për fëmijë)
6 - Mik në dhe të huaj (reportazhe për udhëtimet jashtë shtetit

Shënim 4: Doreshkrime të gatshme!

1 - Qesh e ngjesh (roman satirik) 1964
2 - Dafina e Agroni (roman) 1975
3 - Banori i Yllit Vega në tokë
4 - Dhashuria (vëllim me tregime)
5 - Në krahët e shqiponjës (tregime për fëmijë)
6 - Letra nipit tim Arjan (përshtypje udhëtimi Kosovë, Maqedoni).

c: KUJTIME DHE TREGIME

1 - Në tokën kineze, 1958 (bashkë me shkrimtarin Fatmir Gjata)

II - PËRKTHIME

Veç tregimeve e poezive të ndryshme të botuara në shtypin e kohës, sidomos nga bullgarishtja, Sterjo Spasse, si libër më vete ka përkthyer edhe këto:

1 - Të mjerët - roman i Viktor Hygojt - përmbledhje e gjatë e botuar në shumë numra, si nënfletë ne Gazetën e Korçës më 1936.

2 - Nën zgjedhë - roman i Ivan Vazovit botuar më 1960.

3 - Kasollja e xha Tomit - Roman i Harriet Beecher - Stowe, Tiranë 1943.

4 - Nusja - Roman nga Gjeorgji Karasllavovi, botim nga bullgarishtja më 1957.

5 - Albena - Tregime të zgjedhura të Jordan Jovkovit, botuar më 1966.

6 - Antologjia e poezisë bullgare (redaktuar nga Sterjo Spasse e ku ka të përkthyera nga ai poezi nga bullgarishtja, veç përkthimeve nga poetët e tjerë shqiptarë).

III - ÇMIMET QË KA MARRË

1 - Çmimi i Republikës i kl. II, për romanin "Ata nuk ishin vetëm" (1953)

2 - Çmimi i parë në konkurset letrare: a) për "Afërdita përsëri në fshat" (1954), b) për vëllimin me tregime "Të fala nga fshati" (1958), c) për romanin "Buzë liqenit" (1958), për romanin "Zgjimi" 1974.

IV - DEKORATAT QË KA MARRË

1 - Urdhëri Flamuri i Kuq i Punës kl. I (1975)
2 - Urdhëri Naim Frashëri kl. II (1970)
3 - Urdhëri i punës i kl. II
4 - Medalje pune (për arsimin)

V - MËNYRA E TË SHKRUARIT

Sterjo Spasse ka theksuar në shtyp e në intervista të ndryshme të botuara se shkrimtarit më parë duhet t'i zijejë në kraharor e tërë indet e trupit e të trurit dashuria për çdo gjë pozitive shoqërore dhe urrejtja për çdo gjë negative shoqërore. Pa dashuri e pa urrejtje s'ke si ngjall personazhe, momente historike, momente aktuale të bukura a të shëmtuara, pejsazhe, episode të jetës reale, qofshin ato aktuale e historike. Natyrisht

në radhë të parë veç talentit, shkrimtari duhet të përpiqet, që të pasurohet edhe me kulturë të përgjithëshme edhe më kulturë të veçantë si është letërsia dhe arti në përgjithësi. Për këtë ai duhet të dijë gjuhëra të huaja dhe të jetë lidhur ngushtë me jetën e përditshme, me realitetin e me çdo shtresë shoqërore. Prandaj ai duhet të shëtisë shumë, të njohë qendra të ndryshme pune, vende, tipa njerëzish, duhet të jetë i lidhur me shtypin e përditëshëm e periodik, duhet të lexojë shumë veprat më aktuale të kohës së vet e të lidhet ngushtë si ushqim të përditëshëm me traditat letrare-artistike e historike të vendit të vet po se po, por edhe të popujve të tjerë. Mbresat e këtyre njohurive të shumta e të gjithëfarëshme përpunohen në mënyrë të vetëdijshme e të pavetëdijshme në ndërgjegjen e shkrimtarit e vjen një kohë, që do të ndjejë nevojën për t'i ringjallur ato mbresa me anën e krijimtarisë letrare. Atëhere ai ka përcaktuar shpesh herë edhe në mënyrë të pavetëdijshme temën, qëllimin, tabanin letrar ku do të mbështetet vepra si themelet e një ndërtese e do fillojë ta shkruajë veprën. S'ka rëndësi orari i punës: në shkruan ai ditën a natën, në vetëm e në mes kalla-bëllëku, me orar a pa orar a me teka të ndryshme intime si është kafeja, cigaret, pijet etj. Natyrisht Sterjoja e ka fjalën për shkrimtarë, jo për grafomanë.

VI - PËRKTHIME TË VEPRAVE TË STERJOS NË GJUHË TË HUAJA:

Disa nga romanet e nga tregimet e tij janë përkthyer e botuar në rreth njëzet gjuhëra të huaja.

VII - BIBLIOGRAFI PËR KRIJIMTARINË E S. SPASSES

1. Jup Kastrati: Bibliografi e prozës së Sterjo Spases. (1929-1961) - Në librin: "S. SPASSE: Kurora e rinisë" - Tiranë, 1963.

2. Jup Kastrati: Bibliografi tematike mbi krijimtarinë e Sterjo Spasses 3 - Në ndihmë të historisë së letërsisë shqipe. - buletini: "SHKODRA", Nr. 1-5, 1965

3 - Isak Shema - Ibrahim Rugova: - Bibliografi e kritikës letrare shqiptare" - 1944-1974 - Prishtinë, 1976.

4. Zhaklina Naqellari - Dodona Dhima - Ilinden Spasse: - Bibliografi: "Krijimtaria e Sterjo Spasses" 1929-1988. (Dorëshkrim)

Tiranë - 1989, Mars.


STERJO SPASSE
fördita

IV.

KRIJUESI, VEPRA LETRARE DHE SHOQËRIA

Shkrimtari Sterjo Spasse është njëri ndër krijuesit më të shquar të letërsisë së sotme shqiptare. Veprimtarinë letrare e filloi me tregimin „Kush duron, trashëgon", të botuar në nëntor të vitit 1929. Që atëherë po mbushen pesë dekada e gjysmë dhe shkrimtari Spasse po krijon edhe më tutje intensivisht, duke iu kushtuar kryesisht romanit. Figura poliedrike e këtij romansieri na del edhe më interesante kur, krahas veprimtarisë letrare, merret parasysh edhe kontributi i tij i rëndësishëm që dha në fusha të tjera të kulturës dhe të arsimit shqiptar.

Ai qe mësues i dalluar, përkthyes i disa veprave të letërsisë së huaj, hartues i teksteve shkollore, tregoi interesim të veçantë për studimin e letërsisë popullore, shkroi studime dhe artikuj për gjuhën dhe për letërsinë shqiptare. U muar me publicistikë, shkroi reportazhe dhe udhëpërshkrime, shumë kohë u interesua për problemet e pedagogjisë dhe të zhvillimit të shkollës në gjuhën shqipe. U muar gjithashtu me teorinë e letërsisë dhe me studimin e letërsisë së huaj.

Veprat e tij të botuara dhe të pabotuara janë të shumta. Përmbledhjet e tregimeve filluan të botohen që nga vitet '30: „Kunorë rinije" (1934), „Në krahët

e një femre" (1934), „Nusja pa duvak" (1944), „Të fala nga fshati" (1958), „Sokolesha" (1966), „Kronika e jetës së Gegë Llesh Ndout" (tregime të shpërndara në shtypin e kohës), „Skandal!" (pamflete e proza alegorike të shpërndara në shtypin e kohës), „Jam voglush i madh" (Tregime për fëmijë). Janë të njohura edhe novelat: „Pasqyra magjike" (1957), „Simfoni e pambaruar" (1962), „Banori i yllit Vega në Tokë (Superfuqia) që është pamflet fantastiko-shkencor, pjesërisht i botuar në gazetën „Mësuesi" (1965). Me romanet sociale dhe historike Spasse dha kontribut të çmuar në lërimin e kësaj gjinie të vështirë, por të rëndësishme letrare. Në vitin 1935 boloi romanin e parë „Nga jeta në jetë: Pse?!", për të vazhduar pastaj me „Aferditën" (1944), „Ata nuk ishin vetëm" (1952), „Afërdita përsëri në fshat" (1955), „Buzë liqenit" (1961), „Ne jemi shumë"... (1967) që është roman — variant i shkurtuar mbi përmbytjet e botëkuptimeve në malësi, „Zjarre..." (1972), „Zgjimi", (1974), „Pishtarë" (1975), „Ja vdekje, ja liri" (1978), „Kryengritësit" etj. Romanet e fundit bëjnë pjesë në ciklin „Rilindasit" ku trajtohet lufta „me penë e armë" për çlirimin e popullit shqiptar nga zgjedha e huaj për pavarësi të plotë kombëtare.

Disa nga romanet e tij u përkthyen në më se gjashtëmbëdhjetë gjuhë të huaja si në frëngjisht, gjermanisht, rusisht, anglisht, bullgarisht, greqisht, italisht, në gjuhën kineze, në gjuhën vietnameze etj., dhe zgjuan interesim të madh të lexuesve.

Lidhur me veprën letrare të Sterjos u shkruan shumë recensione, vështrime dhe studime. Bibliografia e mendimit kritik letrar përfshin afër dyqind njësi. Kritika letrare shqiptare dhe e huaj e vlerësoi lart opusin romanesk të tij. Gjithë kjo tregon bindshëm se vepra humanitare e këtij shkrimtari, me karakterin e saj popullor, me idetë thellësisht progresive, me përjashtim të disa veprave të etapës se parë të krijimtarisë, kur autori shpreh pikëpamjet pesimiste

ndaj jetës, ka fisnikëruar lexuesin dhe ka zgjuar te ai përjetimin estetik, gjë që mund të arrihet vetëm prej veprave të realizuara artistikisht.

Gjithë opusi letrar i Spasses nuk është shkruar sipas një metode të vetme letrare, sepse kemi një krijimtari mjaft heterogjene të kushtëzuar nga faktorë të brendshëm dhe të jashtëm letrarë. Periodizimi i krijimtarisë letrare të Spasses në tri etapa kryesore[1] të zhvillimit mundëson studimin më të thellë dhe të gjithanshëm të fenomenit letrar të këtij autori dhe tregon në mënyrë më të qartë rrugën e formimit të tij.

Veprat që i krijoi deri në vitin 1936 i përkasin fazës së parë të krijimtarisë letrare. Përvoja krijuese letrare e shkrimtarit fillestar ishte mjaft e kufizuar, botëkuptimi i autorit ndaj jetës ende jostabil, qartësia ideologjike e pamjaftueshme. Mjeshtëria artistike ende nuk ishte zotëruar sa duhet. Gjuha si mjet i shprehjes artistike do të prefeksionohet disa vjet më vonë. Edhe pse vërehet fare mirë se shkrimtari posedonte talent krijues për t'u marrë me krijimtarinë letrare, prozën tregimtare të kësaj faze, si edhe romanin, e përcjellin dobësi të karakterit ideor dhe artistik.

Faza e dytë e krijimtarisë letrare të Spasses përfshin veprat e krijuara midis viteve 1936-1944. Kjo është krijimtari letrare me shumë veçori të realizmit kritik, ku është thelluar karakteri humanitar dhe utilitarist i saj. Në të shprehet optimizmi i fuqishëm jetësor, çmohet shumë njeriu si qenie shoqërore dhe paraqiten ide të shëndoshta përkitazi me progresin e gjithëmbarshëm shoqëror. Pra kemi të bëjmë me ndryshime qenësore kualitative të metodës krijuese letrare, me një evolucion të natyrshëm drejt ngritjes së përgjithshme ideore dhe estetike.

---

[1] Isak Shema, Pikëpamjet sociale në veprën e Sterjo Spasses, „Jeta e re", Prishtinë, 1969, nr. 1, f. 17—18.

Pas Luftës Nacionalçlirimtare, në krijimtarinë vijuese që bën fazën e tretë, pasuroi prozën shqiptare realiste. Ai krijoi romanin e parë të pasluftës „Ata nuk ishin vetëm", që është një roman tipik social.

Duke u bazuar në të dhëna të shumta lidhur me jetën dhe krijimtarinë letrare, pra lidhur me rrugën e formimit të shkrimtarit, në artikuj dhe vështrime të tjera ku është shtruar çështja e përhapjes së veprës letrare të Gorkit në gjuhën shqipe, do të ndriçohet problemi i ndikimit letrar të Gorkit në shkrimtarin Sterjo Spasse. Mësimi që mori duke lexuar Gorkin, sidomos gjatë fazës së dytë të krijimtarisë, për Spassen ishte vendimtar për formimin dhe afirmimin e tij të mëtejshëm. Ai pohon edhe vetë: „Elementet e realizmit në periudhën time të parë ja detyroj shkrimtarit të madh sovjetik, Maksim Gorkit, të cilin fillova ta kuptoj dhe ta dashunoj pas viteve 1935-1936".[2]

I lindur më 14 gusht 1914, në Gllomboç të Krahinës së Prespës, nga prindër të varfër fshatarë, të cilët si edhe shumë fshatarë të tjerë siguronin ekzistencën, duke punuar tokat e beut ose duke shkuar në kurbet në Turqi apo në Amerikë e gjetiu, që nga koha e fëmijërisë kaloi një jetë shumë të vështirë. Në kohën e sundimit feudalo-borgjez famëkeq të Ahmet Zogut filloi mësimet e para në shkollën greke, e pastaj mbaroi shkollën plotore në Korçë. Ishte ndër të parët nxënës nga Krahina e Prespës që kishte mbaruar shkollën plotore dhe hynte në shkollë të mesme. Shkollën Normale të Elbasanit e kreu më 1932 dhe u emërua mësues në Derviçan (të Gjirokastrës), pastaj shërbeu në Gjirokastër, në Korçë dhe në Tiranë. Studimet e larta të pedagogjisë i vijoi me

[2] Nasho Jorgaqi: Romani „Pse?!..." dhe fillimet letrare te Sterjo Spasses", „Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës" Seria: „Shkencat shoqërore", Tiranë, 1958, nr. 4, f. 143.

korrespondencë gjatë viteve 1938-1941 në Magisterin e Firencës, por nuk i përfundoi. Më vonë kreu studimet e larta për letërsi në Institutin e Lartë të Letërsisë „Maksim Gorki" të Moskës gjatë viteve 1958-1960. Punoi gjatë si inspektor i arsimit, përgjegjës i Seksionit të gjuhës e të letërsisë të Ministrisë së Arsimit, përgjegjës i seksionit të prozës në Lidhjen e Shkrimtarëve e të Artistëve të Shqipërisë, redaktor i revistave letrare „Literatura jonë" dhe „Nëntori".

Qysh heret, kur ishte normalist, me pasion lexonte shkrimtarët shqiptarë, sidomos Naim Frashërin, Mihal Gramenon, Foqion Postolin, Çajupin, Fan S. Nolin, Asdrenin, Mjedën e të tjerë. Ishte nxënës i talentuar, me një botë të pasur emocionale. I ndikuar nga letërsia jonë e traditës filloi me shkrimet e para, të cilat shquhen për frymë patriotike të tyre. Janë këto proza të shkurtëra të një të riu, i cili ende nuk kishte formuar një botëkuptim stabil mbi jetën, prandaj pikëpamjet e shprehura shpeshherë janë edhe të kufizuara. Ai e zgjeroi horizontin e diturisë duke lexuar përveç të tjerash, jo vetëm letërsinë shqiptare, por edhe atë botërore. Nga gjuhët e huaja kishte mësuar frëngjishten, italishten, bullgarishten, greqishten dhe më vonë rusishten. Në ato vite literatura e pasur botërore në gjuhën italiane, frënge etj. kishte depërtuar në qendrat më të mëdha të Shqipërisë. Në Korçë lexoheshin rregullisht revistat „Vu" dhe „Lu" e të tjera të cilat sillnin materiale ndër më të ndryshmet. Siç pohojnë edhe bashkëkohësit e Spasses — shkrimtarë, lexoheshin të gjitha veprat me përmbajtje të llojllojshme. Kjo literaturë ka ndikuar me siguri në shkrimtarët e rinj.

Deri më 1936 kishte lexuar disa vepra të klasikëve të realizmit, por edhe të disa romantikëve të njohur botërorë. Nga Tolstoi kishte lexuar veprat: „Ringjallja" „Sonata e Krojcerit", „Ana Karenina" dhe tregime të tjera; nga Dostojevski: „Demoni", Vëllezërit Karamazovë", „Shtëpia e të vdekurve" dhe ndo-

një tjetër, veprat e Turgenjevit „Etër dhe bij", „Kujtimet e një gjahtari" dhe prozën e tij poetike. Me pasion kishte lexuar Gorkin, tregimet e tij, romanin „Nëna" dhe veprën „Klim Samgini"; pastaj Balzakun, Leopardin, Pirandellon, Mopasanin, Viktor Hygonë (romanin „Të mjerët" e kishte përkthyer në shqipet si variant të shkurtuar më 1936), Shopenhauerin, romanet e Knut Hamsunit „Uria" dhe „Pan", veprën e Fridrih Niçes „Kështu foli Zaratusra", romanin „Fshatarët" të Vladislav Rejmonit, novelat e Stevan Cvajgut dhe monografitë e tij mbi Dostojevskin, Balzakun dhe Tolstoin. Nga shkrimtarët e Ballkanit i kishin lënë përshtypje më të mirë proza tregimtare e Elin Pelinit, tregimet e Jordan Jovkovit, proza e Ivan Vazovit, romani „Jeta në varr" i Stratis Mirvilisit, romani „E tatëpjeta" e Gregorios Ksenopullosit tregimet e Ivan Cankarit, poezia e Botevit dhe Javorovit.

Te Spasse, sa u përket ideve për vëllazërimin e popujve të Ballkanit kanë ndikuar, përveç Naimit me poemën „Dëshirë e vërtetë e Shqiptarëve", edhe shkrimet e Botevit, Rakovskit, Svetozar Markoviqit, pastaj ato të Stanko Vrazit, Rigas Ferreos etj.

Spasse tregoi interesim të madh edhe për studimin e folklorit. Mund të veçohet përmbledhja e punimeve nga kjo fushë me titull „Në mbretërinë e folklorit shqiptar" për shkolla të mesme. Ai pohon se për t'u marrë me pasion me folklor kanë ndikuar përveç folkloristëve shqiptarë të njohur edhe Vuk Karaxhiqi, greku Politis, bullgarët Sllavejkov, Aranudov, Shishmanov dhe maqedonët vëllezërit Miladinov.

Në fazën e parë të krijimtarisë letrare, në një pjesë të prozës tregimtare dhe në romanin e të rlut nëntëmbëdhjetëvjeçar „Nga jeta në jetë: Pse!", të botuara më 1935, vërehet sheshazi ndikimi i Tolstoit me pikëpamjet e shprehura në „Sonata e Krojcerit" dhe në romanin „Ringjallja". Mendimi filozofik i Tolstoit

një tjetër, veprat e Turgenjevit „Etër dhe bij", „Kujtimet e një gjahtari" dhe prozën e tij poetike. Me pasion kishte lexuar Gorkin, tregimet e tij, romanin „Nëna" dhe veprën „Klim Samgini"; pastaj Balzakun, Leopardin, Pirandellon, Mopasanin, Viktor Hygonë (romanin „Të mjerët" e kishte përkthyer në shqipet si variant të shkurtuar më 1936), Shopenhauerin, romanet e Knut Hamsunit „Uria" dhe „Pan", veprën e Fridrih Niçes „Kështu foli Zaratusra", romanin „Fshatarët" të Vladislav Rejmonit, novelat e Stevan Cvajgut dhe monografitë e tij mbi Dostojevskin, Balzakun dhe Tolstoin. Nga shkrimtarët e Ballkanit i kishin lënë përshtypje më të mirë proza tregimtare e Elin Pelinit, tregimet e Jordan Jovkovit, proza e Ivan Vazovit, romani „Jeta në varr" i Stratis Mirvilisit, romani „E tatëpjeta" e Gregorios Ksenopullosit tregimet e Ivan Cankarit, poezia e Botevit dhe Javorovit.

Te Spasse, sa u përket ideve për vëllazërimin e popujve të Ballkanit kanë ndikuar, përveç Naimit me poemën „Dëshirë e vërtetë e Shqiptarëve", edhe shkrimet e Botevit, Rakovskit, Svetozar Markoviqit, pastaj ato të Stanko Vrazit, Rigas Ferreos etj.

Spasse tregoi interesim të madh edhe për studimin e folklorit. Mund të vecohet përmbledhja e punimeve nga kjo fushë me titull „Në mbretërinë e folklorit shqiptar" për shkolla të mesme. Ai pohon se për t'u marrë me pasion me folklor kanë ndikuar përveç folkloristëve shqiptarë të njohur edhe Vuk Karaxhiqi, greku Politis, bullgarët Sllavejkov, Aranudov, Shishmanov dhe maqedonët vëllezërit Milladinov.

Në fazën e parë të krijimtarisë letrare, në një pjesë të prozës tregimtare dhe në romanin e të rlut nëntëmbëdhjetëvjeçar „Nga jeta në jetë: Pse!", të botuara më 1935, vërehet sheshazi ndikimi i Tolstoit me pikëpamjet e shprehura në „Sonata e Krojcerit" dhe në romanin „Ringjallja". Mendimi filozofik i Tolstoit

„Mos e kundërshto të keqen me dhunë" qe përqafuar nga shkrimtari i ri. Autori i romanit „Pse?! u ndikua edhe nga filozofi gjerman, Fridrih Niçe. Pikëpamjet pesimiste të Niçes dhe qëndrimi i tij ndaj femrës në përgjithësi kanë gjetur shtrirje edhe më të madhe. Niçe shkruante: „Përse të jetojmë? Gjithçka është smirë! ... „Por as Tolstoi dhe as Niçe nuk kanë ndikuar me tërë sistemet e tyre filozofike. Në anën tjetër, Shopenhaueri ndikoi me teorinë e tij subjektive idealiste.

Kur shtrohet çështja e ndikimeve që ka pësuar ky shkrimtar nga literatura e lexuar, duhet të kihet parasysh fakti se mbi letrarin e ri shumë më tepër ka influencuar gjendja e përgjithshme sociale e shoqërisë shqiptare të kohës dhe atmosfera shpirtërore e tij. Gjon Zaveri, personazhi kryesor i romanit „Pse?!", edhe pse nuk është figurë tipike, e marrë nga jeta shqiptare, pasqyron kaosin e rinisë intelektuale nën regjimin feudalo-borgjez në Shqipëri.

Nëpërmjet tij, edhe pse në masë të kufizuar, është shprehur gjendja shpirtërore e autorit dhe pikëpamjet e tij të përqafuara gjatë atyre viteve. Spasse ende nuk kishte përvojë të pasur letrare. Pa botëkuptim materialist të formuar plotësisht dhe stabil ndaj jetës, nuk ishte në gjendje t'u gjejë shpjegime shumë pyetjeve. Duke qenë i shqetësuar deri në kulm me jetën e atëhershme, s'pajtohet me atë gjendje dhe reagon në mënyrë të vet. Duke mos i njohur thellë kontradiktat sociale të kohës, bën shartimin e pikëpamjeve të huaja dhe kështu bie në pesimizëm dhe nihilizëm. Me moton e romanit „Bota e Hiçit, prej Hiçit, për Hiçin, rrotullohet rreth qëllimit të Hiçit", mohoi vlerën e çdo gjëje në jetë dhe të jetës vetë dhe në këtë mënyrë s'arrijti t'i shpëtojë dëshpërimit të pakufishëm. „Dëshpërimi-shkruan Lenini — është karakteristikë e klasave që janë në rënie e sipër... Dëshpërimi është karakteristikë e aty-

re që nuk i kuptojnë shkaqet e së keqes, nuk shohin rrugëdalje dhe nuk janë të zotët të luftojnë"[3]. Është plotësisht e qartë se Spasse gjendej para vështirësive të shumta me karakter objektiv dhe subjektiv për të cilat shkruan: „Jua them sinqerisht se në periudhën e parë të rendit feudalo-borgjez kur unë fillova të shkruaj, m'u desht të kapërcej shumë kontradikta të brendëshme. Këto kontradikta ishin të paevitueshme në periudhën kur letërsia e së shkruarës errësonte mendimet e shkrimtarëve"[4]. Shumë vite më vonë, kur i kishte kuptuar qartazi shkaqet dhe pasojat e dëshpërimit të thellë në jetë, shkruan: „Vështirësitë ishin të shumta e vinin nga të gjitha anët. Së pari vinin nga vehtja, nga mungesa e përvojës e nga kufizimet ideologjike, nga mospasja e një objektivi të kristalizuar. Pastaj ishin vështirësitë objektive të kushtëzuara nga rrethanat shumë të rënda të regjimit feudo-borgjez, që ishte një regjim shtypës. Jo vetëm nuk na inkurajonin, por edhe na përbuznin madje na akuzonin dhe si të rrezikshëm. Edhe lexuesit ishin shumë të paktë: mendoni se ç'lexues mund të kishim, kur atyre që e quanin veten intelektualë me prejardhje feudo-borgjeze ishin ksenomanë e përbuznin çdo gjë shqiptare, kur shtypi ishte në duart e reaksionit. Çdo gjë që kemi botuar, e kemi botuar me përpjekjet tona, me këmbënguljen tonë, me sakrificën tonë. . ."[5]

Veprën letrare të Gorkit, në të cilën bëhej thirrje për jetë e jo për vdekje, e lexoi pas përfundimit të romanit „Pse?!". Së pari kishte lexuar tregimet e tij

---

[3] Ilić Lenin, O kulturi i umetnosti, „Kultura", Beograd, 1957, f. 58.

[4] Sterjo Spasse, 10 vjet në atdheun tim të lirë, „Shqipëria e re". Tiranë. 1955, nr. 11-12.

[5] Nga jeta dhe veprimtaria e shkrimtarëve tonë (Intervistë me Sterjo Spassen), „Zëri i rinisë", Tiranë, 1973, 22 shtator.

e pastaj romanin „Nëna", të botuar në italisht. Atëherë, romanin „Pse?" ende s'e kishte dorëzuar për botim si vepër të plotë. Spasse e kuptoi se në veprën e vet nuk duhej të dominonin pikëpamjet pesimiste, por atë ta përshkonte fryma optimiste dhe te lexuesi të përcillej porosia humanitare, dashuria e madhe ndaj jetës. Me një kritik letrar të kohës, i cili kishte shkruar parathënien e romanit „Pse?!", Spasse kishte biseduar për mundësinë e disa ndryshimeve që, sipas tyre, ishin të domosdoshme. Autori ishte bindur se Gjon Zaveri nuk duhej të bënte vetëvrasje. Përfundimi i romanit dhe shumë pjesë të tjera ishte e domosdoshme të ndryshoheshin, pra romani të ripunohej. Megjithatë, autori vendosi ta dorëzojë në shtyp pa ndryshime si një vepër që ishte shkruar në rrethana të caktuara historike-shoqërore, të cilat do t'i pasqyrojë më vonë në romanet e tjera.

Me gjithë kufizimet që kishte vepra, edhe pse autorit iu bënë vërejtje si në kritikën letrare, ashtu edhe në letrat e shumta që i dërgoheshin nga lexuesit, veçanërisht lidhur me pesimizmin dhe nihilizmin që ishte i pranishëm, iu njohën meritat për tematikën e trajtuar deri atëherë. Letërsisë demokratike që kishte marrë një zhvillim më të mirë se përpara, bashkë me Spassen, po i vinin forca të reja sidomos pas vitit 1935. „Drejtimi kritik në letërsi ishte i dobët. Brezi i 35-ës s'e kish treguar akoma fizionominë e tij"[6].

Nga artikulli „Kritika letrare ndër ne" kuptojmë se në ç'masë Spasse e ka përjetuar atë atmosferë mbytëse: „...Në mes të një heshtjeje së vijueshme, në mes të një letargjie letrare del nga ndonjë kënd një vepër origjinale, a si origjinale, ose ndonjë për-

[6] Nasho Jorgaqi, Romani „Pse?!..." dhe fillimet letrare të Sterjo Spasses, B. U. SH. T., Seria: Shkencat shoqërore, 1958, nr. 4. f. 143.

kthim bajat dhe i mykur tejet... Bashkë me krizën ekonomike po kalojmë edhe një krizë mendore... një shterpësi letrare..."[7] ndërsa dy vjet më vonë shkruan: „Shtojmë se kemi krizë mendore, po, krizë letrare, shtërpësi mendore"[8].

Në rrethana të tilla të zhvillimit të kulturës dhe të letërsisë shqiptare, në vitet e krizës së përgjithshme shoqërore, kur zhvillimi i mendimit demokratik dhe revolucionar pengohej nga qeveritarët dhe shërbëtorët e tyre, vepra letrare e Gorkit pat jehonën më të madhe dhe ndikoi fuqishëm jo vetëm në zgjimin e vetëdijes socialiste të shkrimtarëve tanë përparimtarë të brezit 1935 dhe më vonë, si te Migjeni, Shuteriqi, Varfi, Musaraj, Çaçi, Stafa, Bulka etj., por edhe te lexuesit e tjerë. Disa shkrime të Gorkit qenë përkthyer në gjuhën shqipe që nga viti 1920 dhe u botuan në „Shkëndija". Por gjatë viteve '30 emri i Maksim Gorkit bëhet aq i njohur në Shqipëri, sa që veprat e tij dhe artikujt kritikë për krijimtarinë e tij letrare, ribotohen edhe në faqet e revistave zyrtare „Shekulli XX" „Diana" me gjithë se... këtu zgjedhen ato vepra të shkrimtarit që nuk kanë përmbajtje të theksuar politike"[9].

Gjatë vitit 1932, por edhe më vonë, në revistat e kohës si në „Bota e Re" „Fryma e Re", „Rilindja", „Illyria", „ABC", „Arbëria", „Minerva" etj., u shtuan dukshëm pjesët e botuara nga Gorki. Të veçojmë me këtë rast tregimet: „Dashnori i saj" „Një herë në vjeshtë", „Nëna", „Nëna e tradhëtorit", Një hero, Heroizmë", „Utopi shekullore", „Luftë... dhe kundër lufte", „Njeriu", „Khani dhe biri i tij", „Një vashë e vogël",

---

[7] Stespa (Pseud. i S. Spasse), Kritika letrare ndër ne „Demokratia", Gjirokastër, 1933, nr. 407, (4 nëndor).

[8] Sterjo Spasse, Një lesheli në letërsinë tonë, „Demokratia", Gjirokastër, 1935, nr. 449. (22 janar).

[9] V. Angoni — G. Manjkovskaja, Përkthimet e Gorkit në Shqipëri. „Nëndori", Tiranë, 1961, nr. 6. f. 108.

„Sahati", „Njëzet e gjashtë dhe një", „Një natë vjeshte", „Në burg", „Kurbatka e bukur" (variant jo i plotë i veprës „Makar Çudra"), pjesë nga „Përralla të Italisë", „Kënga e lajmëtarit të shtërngatës", „Para jetës", „Bashkëudhëtari im" dhe ndonjë poemë e tij.

Spasse, si dhe shkrimtarët e tjerë bashkëkohës, qe i impresionuar nga vepra letrare e Gorkit. Tematika e trajtuar në tregimet dhe në romanin „Nëna", idetë revolucionare, qartësia ideologjike, pra vlera e përgjithshme ideore dhe estetike, bënë që jo vetëm ta lexojnë dhe rilexojnë Gorkin, por të bëhen partizanë të denjë për zbatimin e ideve të tij. Të frymëzuar nga ai i dhanë letërsisë sonë një frymë të re, me elemente më të theksuara realiste dhe revolucionare. Andrea Varfi në mënyrë të veçantë e shtron çështjen e ndikimit që kanë pësuar nga shkrimet e Gorkit shkrimtarët tanë si edhe shumë shkrimtarë të tjerë të botës. Me Gorkin e sidomos me „Nënën" — shkruan Varfi — u edukuan të gjithë shkrimtarët e Shqipërisë së Re. Te Gorki këta, përveç mjeshtrisë..., mësuan të largohen nga idealizmet boshe dhe të shikojnë realitetin ashtu siç është. Nga dy-tri skica të shkrimtarit tonë të madh, Migjenit, mbi jetën e malësorëve shqiptarë, të shkruara sipas frymës gorkiane, lexonjësi njeh shumë më tepër realitetin e malësive tona".[10] Nga kujtimet e tij mësojmë se ndikimi i Gorkit ishte veçanërisht i madh në gjithë brezin e të rinjve letrarë të viteve '30 dhe sidomos për „edukimin revolucionar të punëtorëve dhe shkollarëve". Përveç romanit „Nëna" sa kishte lexuar tregimin „Lexonjësi" i cili kishte lënë mbresa të pashlyera. „Me atë tregim shkruan Varfi, Gorki na tregoi rrugën që duhej ndjekur në letërsi"[11].

---

[10] Andrea Varfi, Drita e Gorkit. „Nëndori", Tiranë, 1956, nr. 7, f. 137.

[11] Po aty, f. 137.

Në veprën poetike të Aleks Çaçit, i cili shkroi edhe gjatë viteve '30, gjejmë gjurmë ndikimi nga vepra letrare e Gorkit. Ai shkruan: „Lexoja „Nënën" e Gorkit dhe autorë të tjerë revolucionarë dhe doja që në shembullin e tyre të çfaqja edhe unë me shkrimet e mia solidaritetin me të varfërit dhe me të shtypurit dhe urrejtjen për shfrytëzuesit".[12] Diçka e ngjashme ka ndodhur edhe me Dhimitër Shuteriqin, Shevqet Musarajn, Petro Markon, Esad Mekulin, Vedat Kokonën etj., në formimin e të cilëve ka ndikuar pozitivisht Maksim Gorki. Spasse disa herë me radhë pohon ndikimin e drejtpërdrejtë nga Gorki. Në parathënien e botimit të romanit „Nëna" në gjuhën shqipe, të vitit 1955, ai shpreh mendimin se në kohën kur për herë të parë u përkthye romani „Mungonte eksperienca dhe qartësia ideologjike... Për të fituar një eksperiencë e për t'u sqaruar më mirë ideologjikisht — përveç faktorëve të tjerë në atë kohë e në ato rrethana ndikoi edhe përkthimi i romanit „Nëna"... Punëtorët e fshatarët tanë e të rinjtë e asaj kohe, si bleta mbi nektarin, lëshoheshin mbi faqet e këtij romani për të kërkuar të vërtetën. Përmes kësaj të vërtete, që gjenin në roman, zbulonin realitetin e regjimit shtypës, shtonin dita-ditës urrejtjen kundra atij dhe gjenin mënyrat më të përshtatura për të luftuar. Se me të vërtetë te romani „Nëna" punonjësit tanë gjenin pelinin e hidhur të jetës së tyre: vuajtjet që hiqte protagonisti i romanit Pavle Vllasovi me shokë, lshin vuajtjet dhe të zezat e tyre..., shkrimtari i madh sovjetik Maksim Gorki, si një lajmëtar i gjallë, hyri në çdo shtëpi punëtori e fshatari, në çdo shtëpi studenti dhe intelektuali shqiptar dhe përmes personazheve të romanit të vet u fli-

[12] Në krijimtarinë tonë të pasqyrojmë jetën e popullit punonjës (Intërvistë me Aleks Çaçin). Zëri i rinisë", Tiranë, 8 dhjetor 1973.

ste në gjuhën shqipe, u zbulonte të këqiat e sistemit feudo-borgjez dhe u tregonte një rrugë shpëtimi..."[13]

Gjatë fazës së dytë të krijimtarisë letrare, pasi kishte botuar romanin e mohimit „Pse?", Spasse shkroi pamflete, proza alegorike, skica, tregime, novela dhe romanin e pohimit „Afërdita". Prozën tregimtare e karakterizon përmbajtja e gjerë sociale, fryma e theksuar kritike, naracioni më i zhdërvjelltë dhe qartësia ideologjike. Në to qiten në shesh padrejtësitë shoqërore ekonomike të kohës së regjimit absolut në Shqipëri dhe goditen plagët sociale të së kaluarës. Ai bëhet zëdhënës i idealeve progresive të fshatarësisë dhe të vegjëlisë në përgjithësi. Proza alegorike dhe pamfleti, të cilat forma Gorki i quante „Letërsia jon militante" janë arterje që i dhanë gjak të ri letërsisë së shëndoshë shqiptare të viteve '30. Ky është padyshim ndikim që ka ushtruar proza gorkiane dhe ajo e shkrimtarëve të tjerë progresivë. Në prozën e këtij lloji trajtohej problematika shoqërore dhe politike aktuale. Në mënyrë alegorike çirrej maska e pseudopatriotëve të vendit, akuzohej aparati shtetëror në fuqi, stigmatizohej morali i kalbur i klasave sunduese dhe herë pas herë tregohej grushti i fortë që do ta përmbyste botën e vjetër. Megjithëse censura ishte shumë e rreptë, shumica e shkrimeve me përmbajtje të këtillë nuk botoheshin. Spasse lidhur me këtë ka thënë: „Me gjithë atë ca shkrime më dhembin akoma pse kan mbaruar në shportën e redaksive pa lënë nishan."[14]

Kur analizohet përmbajtja dhe idetë e këtyre prozave alegorike dhe e pamfleteve, mund të hetohet fare mirë kthesa e fortë pozitive që kishte bërë Spas-

---

[13] Sterjo Spasse, Parathënie, „Nëna", Tiranë, 1955, f. 34.

[14] Nga jeta dhe veprimtaria letrare e shkrimtarëve dhe artistëve tonë. Intervistë me Sterjo Spassen. „Zëri i rinisë", Tiranë, 22 shtator, 1973.

se në letërsi. Për shkrimtarin ishte hapur horizont më i gjerë pikëpamjesh, shprehen ide thellësisht progresive. Për ndryshimin e gjendjes ekzistuese luftonin jo vetëm shkrimtarët përparimtarë, por edhe shtresat e vegjëlisë shqiptare. Janë këto vite të rezistencës që i bëhet regjimit absolut me anë të krijimtarisë letrare, me demonstratat dhe në forma të tjera. Gjithë kjo tregon bindshëm për zgjimin e vetëdijes klasore dhe revolucionare.

Duke filluar nga viti 1935 Spasse botoi pamfletet dhe prozat alegorike: „Bota u çthurr?...", „Nga shënimet e një Diogjeni të Ri". „Dallëndyshe, ktheja ndryshe...", „Kushtrimi i orëve", „Skandal? Jo, as pak?", „Ajka e botës" etj. Autori ngrit zërin kundër mentalitetit, moralit dhe ideologjisë feudale-borgjeze, kundër pabarazisë sociale dhe ekonomike. Heronjtë e këtyre prozave janë dhënë nëpërmjet alegorisë, por me nota të theksuara realiste. Për të demaskuar marrëdhëniet feudale-borgjeze në pamfletin „Bota u çthurr!" Spasse i jep heroit të vet porosi të rëndësishme në jetën shoqërore, që të qëndrojë, e jo të dorëzohet ndër kundërshtime."... Ti duhet të rrosh! Të rrosh që t'i kallxosh botës të vërtetën! Të rrosh që të mësosh turmën për të shijuar të vërtetën... Të rrosh, po të rrosh si një kreshnik ndërmjet egërsirash: Puno për ideal, fol për të vërtetën, shkel mbi kërma pa mëshirë dhe lufto shpifjen, padrejtësinë, gënjeshtrën!... Të rrosh, po, po, të rrosh, si me forcë mbinjerëzore gjer sa të krijohet një jetë e re me njerëz të rinj! Pra, jeto dhe puno për idealin e caktuar".[15]

Gjendja e vështirë në të cilën gjendeshin shtresat e varfëra, e kishte shqetësuar shkrimtarin. Ai u përkiste po atyre shtresave që ishin të robëruara, prandaj bënte pyetjen: „Kur kanë për të pushuar

---

[15] Sterjo Spasse, Kurora e rinisë, Tiranë, 1963, f. 28—29.

vajet, kujet e ulurimat e popullit të robëruar shqipëtar?!" dhe bënte përpjekje të pandërprera për të gjetur rrugën e shpëtimit. Më 1936, në revistën „Bota e Re" të Korçës, kishte hapur „Shtyllën pedagogjike". Aty botonte vështrime lidhur me probleme të shumta të shkollës shqipe. Në një letër, dërguar po atë vit Taso Goshos, mikut të tij të ngushtë, shkruan: „.. Po, Korça ishte atëherë qendra e një lëvizjeje të gjerë progresive kulturale. Revistat „Rilindja", më vonë „Bota e Re" e dy gazetat e mbanin gjallë pjesërisht Korçën e vdekur ekonomikisht. Ne merrnim pjesë edhe si lexues edhe si aktivistë të kulturës". Që nga viti 1937 deri më 1941 në Shqipëri nuk u botua më asnjë krijim letrar i Gorkit. Ishte ndaluar rreptësisht përhapja e veprave të tij, por edhe literatura tjetër nëpërmjet të së cilës propogandoheshin idetë antifashiste dhe socialiste.

Spasse vazhdoi pa ndërprerje krijimtarinë letrare. Meqë më së tepërmi e preokuponin problemet e arsimit dhe të emancipimit shoqëror dhe problematika sociale, më 1936 filloi të shkruajë romanin „Afërdita". Pikëpamjet e autorit kishin evoluar. Ai më në fund kishte kuptuar të vërtetën dhe kishte përqafuar bindjen, edhe pse të kufizuar, se arsimi është faktor vendimtar për transformimin progresiv të shoqërisë shqiptare. Vepra ishte përfunduar dy vite më vonë, më 1938. „E mbaj mend si sot — shkruan Tasi Gusho — kur Sterjoja më ka ardhë në shtëpi, në pranverën e vitit 1938, me dorëshkrimin e romanit „Afërdita" nën sqetull. Atëherë i kishte vënë titullin „Mësonjësja ideale". Dhe sikur vazhduam ta lexonim romanin ditë e natë me radhë. Sterjoja e lexonte dhe unë e dëgjoja me vëmendje e mbaja shënime për të bërë pastaj vërejtjet e mia"!

Romani ishte pëlqyer nga të gjithë ata që e kishin lexuar në dorëshkrim. Spasse veprën e tij të gatshme për shtyp dhe një letër, ku jepte sqarime lidhur me heroinën Afërdita dhe rrethanat në të cilat e kishte

shkruar veprën, nga Korça ia dorëzoi Ministrisë së Arsimit për të dhënë lejen e botimit. Meqenëse përmbajtja e letrës nuk është e njohur deri më sot, po japim ndonjë pjesë më interesante të saj. Autori i drejtohet Aleksandër Xhuvanit: „... Pse e kemi zgjedhur për protagonist një mësonjëse e jo një mësonjës? — mund të më pyesni. Arsyet janë këto: Jeta shoqërore shqiptare, sidomos jeta fshatare, nuk mund të përmirësohet, po s'u fillua përmirësimi nga thelbi i familjes, më fort nga nëna e nga motra... Në përpilimin e romanit më tepër jam munduar të përshkruaj jetën e vërtetë të një arsimtari të aratisur nëpër fshatrat e mënjanuar. Shumë pjesë të romanit i kam jetuar vetë para disa vjetëve; edhe shumë pjesë të tjera janë pasqyra e vërtetë e jetës së shumë shoqeve e shokëve, që po kryejnë edhe sot (1938) misionin e tyre (andaj nëpër thellësirat) e Shqipërisë me hyllin e guximit e të shpresës në ballë". Më tutje arsyeton idealizimin që kishte bërë lidhur me triumfin e Afërditës: „Edhe pse do të shihni një shkollë të re ideale... kjo shkollë e ëndërruar është simboli i një përpjekje të parreshtur të arsimtarëve tanë të rinj, është dëshira e pashterur dhe flaka vepronjëse e kush e di të sa zemra arsimtaresh e arsimtarësh, që horvaten në heshtje përmes pengesave, për të krijuar shkollën e re, shkollën që do të pasqyrojë jetën dhe natyrën tonë, dmth. shkollën e nesërme shqiptare për nxënësin shqiptar... Jam munduar t'i jap romanit tem një frymë shqiptare, një tërësi shqiptare. Jam munduar të përshkruaj ato që ngjanë or'e çast përpara syve tanë dhe kam menduar për të ardhmen ato që mund të bëhen njëmendësi. Kam dashur AFËRDITA — protagoniste e romanit të mos jetë një mësonjëse e idealizuar shumë, por një mësonjëse që mund të dalë vërtet nga brumi thjesht kombëtar..." Autori shpreh mendimin se kontributi i arsimtarëve përparimtarë, e sidomos i atyre të qytetit, për ngritjen dhe arsimimin e fshatarësisë ka një rëndësi të

posaçme për zhvillimin e gjithmbarshëm të shoqërisë shqiptare. Kah fundi i romanit, atëherë kur ideja themelore e veprës sendërtohet plotësisht, autori vlerëson lart bashkëpunimin midis arsimtarëve përparimtarë për të kryer si duhet misionin e rëndësishëm shoqëror. Triumfi i Afërditës në Grykas e Pishas dhe mrekullitë e saj në lëmin e arsimit dhe të edukimit, për emancipimin e femrës shqiptare dhe për zgjimin e fshatit, paraqiten si fitore e tërë arsimit të ri shqiptar. Gjithë kjo entuziazmon lexuesin e romanit „Afërdita" dhe e angazhon maksimalisht për përparimin dhe lulëzimin e përgjithshëm të shoqërisë.

Pas Luftës Nacionalçlirimtare, „që në javët e që në muajt e para të çlirimit", Spasse vazhdoi të shkruajë skica e tregime me temën aktuale. Përshtypjet që kishte pasur nga leximi i veprave të Gorkit dhe nga bisedat me Ali Kelmendin, me luftëtarin e paepur të lëvizjes komuniste shqiptare kishin mbetur të pashlyeshme. Pas një dekade krijimtarie letrare në frymën e realizmit kritik, kishte fituar përvojë të pasur ideoartistike. Deri në këtë kohë Spasse kishte dhënë tablo të gjera të jetës së shoqërisë shqiptare, jetën dhe luftën e vegjëlisë e të arsimtarëve, por zgjidhjen e atyre problemeve nuk arrijti ta bëjë drejt në pajtim me ligjshmëritë e zhvillimit historik-shoqëror të shoqërisë shqiptare të kohës.

Më 1945 vazhdoi të shkruajë romanin e ri „Ata nuk ishin vetëm" me titullin e mëparshëm „Harbutët", në të cilin më tepër se në çdo vepër tjetër vërehet ndikimi i Gorkit. Romani ka një histori mjaft interesante të krijimit. Ali Kelmendi qysh në vitin 1932, duke parë gjendjen e vështirë të fshatarësisë shqiptare dhe veçanërisht pasi kishte dëgjuar për tragjedinë e goricarëve, kur Maliq bej Frashëri, me ndihmën e qeverisë, i përzuri fshatarët e pafajshëm nga çifliku, i kishte thënë Spasses: „Ti vetëm hidhe në letër këtë të vërtetë". Pas ngjitjes që i kishte bërë Ali Kelmendi, kishte filluar veprën ku dëshironte të

paraqesë ato ngjarje tronditëse. „Në mënyrë të mjegulluar dy kapituj — pikërisht „Dasmën e xha Koroveshit" dhe „Beu" — shkruan autori — i shkrova para çlirimit..., në ndërgjegjen time përpunohej ideja kryesore, përpunoheshin tablotë, rriteshin e merrnin formë edhe personazhet. Para çlirimit pata menduar që kaçaku Ismail, dalë maleve nga urrejtja që kishte për feudalët e që martonte vajzat e varfëra me paratë që ua rrëmbente të pasurve, të frymëzonte për luftë edhe fshatarin Gjikë Shpatin. Domethënë se unë kisha mpleksur idetë e reja më përparimtare të kohës me një kaçak të shekullit XIX".

Deri më 1947 kur e dorëzoi për shtyp veprën „Ata nuk ishin vetëm", të parin roman shqiptar të pasluftës, ideja kryesore ishte kristalizuar si duhet. Shkrimtari paraqiti në roman antagonizmat shoqërore dhe rezistencën që bënë fshatarët kundër marrëdhënieve skllavëruese, kundër shtypjes dhe shfrytëzimit. Romani, siç ka vënë re Jorgo Bulo, është „...provë e suksesshme e kapërcimit të dobësive e kufizimeve të romanit shqiptar të paraçlirimit, kryesisht me tipare romantiko-sentimentaliste... Si i tillë ai padyshim ka lojtur rolin e vet në rrugën e zhvillimit tonë të ri."[10]

Vepra në pikëpamje kompozicionale është ndërtuar ngjashëm me romanin „Nëna" të Gorkit. Disa pjesë janë analoge me ato të romanit „Nëna". Gjikë Shpati si personazh ka shumë veçori të Pavle Vllasovit. „Ja ky duket një Pavle Vllasov! Jo, ky është Pavel Vllasov shqiptar", thuhet për personazhin kryesor të romanit „Ata nuk ishin vetëm". Kapitulli i shtatë përmban të dhëna të shumta me të cilat shpjegohet mënyra e ndikimit të veprës së Gorkit te lexuesit shqiptar dhe në vetë shkrimtarin Spasse. Në

---

[10] Jorgo Bulo, Nga historia e lindjes dhe formimit të romanit të sotëm shqiptar. Studime filologjike, Tiranë, 1968, nr. 2, f. 166.

veprën e Gorkit u dha një vizion i zgjeruar historik mbi perspektivën më të ndritshme të shoqërisë së re, për një jetë të bukur, të gjallë dhe të ndershme".

Nëpërmjet personazhit Ana është shpjeguar fare mirë çështja e ndikimit letrar që ka pasur Spasse nga literatura e lexuar dhe veçanërisht nga „Nëna" e Gorkit. Vetëm pasi kishte lexuar veprën „Nëna" Ana „për një moment e kishte menduar lumturinë e saj të lidhur me përpjekjet për lumturinë e të tjerëve..." Episodi për demonstratat e Korçës dhe përshkrimi i atyre ngjarjeve, të kujton disa pjesë të romanit „Nëna". Dhe jo vetëm kaq, por „fshatari i panjohur me plagën e rëndë e që fliste aq kthjellтë e aq mirë, ishte tamam si personazhet e Gorkit, që përpiqeshin për një botë të re në Shqipëri". Përfundimi kuptimplotë, sendërtimi i idesë themelore të veprës, mënyra se si është paraqitur zgjimi i vetëdijes së fshatarësisë për të luftuar vendosmërisht për çlirimin e plotë, flasin bindshëm për analogjinë midis këtyre veprave letrare dhe për ndikimin letrar të Gorkit në shkrimtarin shqiptar Sterjo Spasse.

Megjithatë Spasse nuk bëri imitim të thjeshtë të veprës së Gorkit. Meqë tregoi talent të rrallë për t'u marrë me letërsi, me imagjinatë të bujshme, duke qenë njohës i mirë i jetës shqiptare, i atmosferës së përgjithshme që dominoi atëherë, gjatë atyre viteve të vështira për fshatarësinë shqiptare, arriti që në mënyrë plastike dhe me shumë ngrohtësi, të na tregojë për ngjarjet dhe njerëzit, me dashurinë më të madhe ndaj vegjëlisë dhe me urrejtjen e pashembullt ndaj shfrytëzuesve të çdo lloji, të japë vepra me porosinë e thellë humanitare dhe revolucionare, të cilat u mbeten brezave si dhuratë e çmuar.

V.

FILLIMET LETRARE TË STERJO SPASSES

„Duhet bërë thirrje për jetë dhe punë
e jo për vdekje"

Maksim Gorki

Sterjo Spasse, i riu nëntëmbdhjetëvjeçar dhe mësuesi i fshatit mjaft të prapambetur shqiptar gjatë kohës së regjimit famëkeq zogist në Shqipëri, më 1935 botoi romanin e vet të parë: „Nga jeta në jetë: Pse?! ...". Me moton e romanit:

„Bota e Hiçit, prej Hiçit, për Hiçin
Rrotullohet rreth qëllimit të Hiçit"

jo vetëm që nuk bënte thirrje „për jetë e punë" si Gorki i famshëm, por me sy të hapur, në pikë të ditës, nuk shihte as perspektivë të jetës individuale dhe shoqërore. Mohonte gjithçka të vlefshme, më në fund edhe vetë jetën. Kështu ai përqafoi idetë pesimiste, por e përlanë dhe dallgët e nihilizmit.

Autorin e romanit të mohimit „Pse?!..." pikëpamjet e përqafuara në jetë e kishin trazuar deri në atë masë sa personazhit të vet letrar i preferon vdekjen në vend të jetës. Gjon Zaveri i Sterjo Spasses nuk shihte më diellin e hënën, lulen dhe vashën, jetën dhe lumturinë. Ai kalonte jetën në andralla — atij vetëm

pyetje e mendime i vërviten në kokën që „filozofon" për çështjet ekzistenciale të botës. Edhe pse ndonjëherë shkundullohet nga ato mendime të kobshme, e duket se në fytyrë i lëviz gjaku i jetës, i hapen sytë për të parë të mirat dhe të këqiat e jetës dhe të shoqërisë, shumë shpejt mandej i mveshet syve një lëbyr dhe atëherë i turbullohet mendja dhe shpirti, por mbahet i alivanosur. Pastaj përsëri e kaplojnë mendime dhe vetëm mendime filozofike sa edhe të zezat e vdekjes, deri në fundin tragjik.

Në atë kohë fat të njëjtë tragjik kishin pësuar edhe protagonistët e disa veprave letrare të letërsisë sonë. Dija e romanit të Haki Stërmillit „Sikur t'isha djalë" nuk shpëtoi nga vdekja tragjike, por as Memli, heroi i veprës së Gërblleshit „Gremina e dashurisë" nuk i shpëtoi dot pushkës hakmarrëse. Në vend që t'u hapej rruga drejt jetës, ata në lulëzimin e rinisë i gjykon koha. Me ngashërim e buzë të shkrumuara u përfundohet jeta. Edhe disa personazhe të tregimeve të para të Spasses, të botuara para romanit të mohimit dhe mbas tij, në të shumtën e herës, i pret një mbarim tragjik. Tregimi „Dashuri e pafat", botuar në gazetën „Zëri i Korçës" më 1930, ka për subjekt fatin tragjik të bashkëshortëve. Si krijim letrar kjo prozë i paraprin një vargu hartimesh të tjera që trajtojnë plagët shoqërore. Si pasoja të jetës së vështirë sociale të shkaqeve të tjera dhe të dukurive negative rezultojnë tragjedi të ndryshme individuale. Duke u pasqyruar kështu në letërsi jeta e rëndë e vegjëlisë, prapambetja shoqërore, kurbeti, hakmarrja, skamja, varfëria, bestytnitë e kohës dhe antagonizmat klasore, trajtohet problematika sociale aktuale. Fati jetësor i këtyre protagonistëve të prozës së hershme ishte njëherit edhe fati i familjeve të varfëra shqiptare dhe i grupeve shoqërore. Fshatarësia dhe shtresat e shfrytëzuara të qyteteve „hiqnin të zitë e ullirit" dhe banin mbi kurriz të gjitha garrametet e jetës së vështirë.

Kjo ishte koha kur shkrimtari Sterjo Spasse s'kishte fituar përvojën e domosdoshme letrare dhe s'kishte arritur të njohë thellësisht kontradiktat shoqërore ekzistuese, kur leximi i disa veprave të letërsisë së huaj kishte bërë të vetën dhe kishte ndikuar negativisht në masën e duhur. Autorit, edhe pse ofronte tablo të një jete të vështirë sociale, nuk i shkoi për dore që, në hapat e parë të krijimtarisë të rreket me një tematikë komplekse shoqërore dhe të gjejë zgjidhje të pranueshme për problemet e shtruara. Në këtë prizmë duhet shpjeguar edhe devijimin e shkrimtarit në fazën e parë të krijimtarisë letrare.

Gorki, duke bërë fjalë për vështirësitë në të cilat has shkrimtari gjatë krijimit të romanit social dhe gjatë përgatitjes së tij të gjithanshme për të trajtuar tematikën sociale, midis të tjerash, shkruan: „... që në kohën tonë të shkruhet një roman i mirë social, shkrimtari duhet të ketë fuqi krijuese të gjeniut dhe njohuri të gjithanshme të jetës. Ky është njëri prej shkaqeve përse letërsia devijon prej realizmit kah misticizmi, prej realitetit kah fantazia, prej rrugës së vështirë të trajtimit të çështjeve sociale kah problemi i të qenurit individual, dhe në shkretëtirën e papërfundueshme të çështjeve botërore"[17].

Për të njëjtat vështirësi që dalin në rrugën krijuese shkruan edhe Sterjo Spasse në periudhën kur i kishte kuptuar qartazi ato kufizime të përgjithshme të cilat s'i kishte evituar shumë vite më parë.

Klima e tërësishme shoqërore e kohës kur jeton dhe vepron shkrimtari ndikon dukshëm në karakterin e veprës letrare artistike. Raportet sociale në të gjitha nivelet, kundërthënlet klasore që paraqiten janë lëndë e veprës realiste. Shkrimtari të gjitha këto nuk i jep vetëm si fakte dhe ngjarje të një kohe e të një vendi të caktuar. Nëpërmjet të mjeteve arti-

[17] Maksim Gorki, „O literaturi", Beograd, 1949, f. 324.

stike, me mjeshtri naracioni, te lexuesi zgjon ndjenjën e përjetimit të thellë të fatit të heronjve si pjesëtarë të shoqërisë. Pra, shkrimtari në mënyrë të veçantë duhet të njohë epokën kur jeton dhe të thotë atë që është qenësore për frymëmarrjen e asaj epoke. Ai, meqenëse është observues i drejtpërdrejtë i të gjitha oscilimeve të jetës shoqërore, të cilat janë objekt trajtimi në veprën letrare, në të shumtën e herës, si individ edhe vetë merr pjesë në vallen e kohës; prandaj edhe mund t'i shprehë pikëpamjet e veta sociale. Në të kundërtën, nëse shkrimtari, sidomos në fillimet e krijimtarisë letrare, nuk arrin të fitojë njohuri shumë të gjera dhe të thella lidhur me jetën shoqërore, nuk do të jetë në gjendje t'i paraqesë drejt dhe bindshëm pikëpamjet progresive të cilat i kushtëzon koha. Në këtë mes rol të rëndësishëm luajnë edhe faktorët e tjerë: zhvillimi ekonomik-social, kulturor; jeta politike në vend dhe jashtë tij; ndikimi i filozofisë së kohës; tradita kulturore dhe letrare etj.

Spasse, si edhe disa shkrimtarë të tjerë shqiptarë, e filloi krijimtarinë letrare menjëherë pas shpalljes së mbretërisë shqiptare. Si nxënës i Shkollës Normale të Elbasanit, kur nuk kishte më tepër se shtatëmbëdhjetë vjet, nis të trajtojë disa tema në frymën patriotike. Tregimi „Kreshnikja shqiptare" ka si heroinë vajzën trime shqiptare, Fatimen. Ajo me guximin e saj të pashembullt arrin të hakmerret kundër armikut grek i cili ia kishte plagosur të fejuarin, Ahmetin. Në ndonjë krijim tjetër të këtij lloji, në skicat dhe në tregimet e veta autori lartëson figurat e ndritura të patriotëve shqiptarë, luftëtarët për të drejtat kombëtare sociale. Ishte kjo koha kur Ahmet Zogu me ithtarët e vet, pasi kishte përmbysur qeverinë demokratike të Fan S. Nolit, kishte vendosur diktaturën mbretërore në Shqipëri. Në këtë mënyrë ishte zhdukur çdo rreze shprese për një progres të përgjithshëm shoqëror. Ekonomia e vendit përmby-

sej gjithnjë e më tepër. „Në buxhetin financiar të vitit 1926-1927, 75 për qind e tij parashikohej të shpenzohej për mbajtjen e forcave ushtarake dhe të aparatit shtetnor dhe vetëm 25 për qind për zhvillimin e ekonomisë, për ndërtime botore, arsim, kulturë, shëndetësi e tjera. Vetëm presidenti i Republikës, A. Zogu, shpenzonte më tepër se Ministria e shëndetësisë për gjithë shërbimin mjekësor në Shqipëri dhe Ministria e bujqësisë për gjithë nëpunësit dhe kuadrot bujqësore të vendit të marra së bashku"[18].

Fshatarësia dhe shtresat e varfëra qytetare shfrytëzoheshin pa mëshirë nga feudalët dhe nga aparati shtetëror. Edhe Sterjo bashkë me familjen e tij e kishte përjetuar dhe vazhdimisht e përjetonte atë shfrytëzim të egër. Kur ishte dhjetëvjeçar kishte kaluar jetë shumë të vështirë e në skamje. Ai, siç shkruan Fatmir Gjata me rastin e pesëdhjetëvjetorit të lindjes së autorit, „... ishte një djalosh i imët, veshur me shajak të ashpër që endet në tezgjahet fshatarake, kthehej në mbrëmje vonë nga fusha në shtëpi. Por ai nuk shtrihej në dyshek për t'u çlodhur e për të fjetur. Ngarkonte kalin me dy thasë qymyr dhe, që nga fshati me emrin Gllomboç, merrte rrugën e gjatë për në Korçë. Udhëtonte tetë orë më këmbë, natën, me hënë me shi a me dëborë dhe ndaj të gëdhirë mbërrinte në qytet. Aty pastaj gjithë ditën bridhte rrugicave duke thirrur: „Kush do qymyr!" dhe i binte bretku gjersa gjente myshterinjtë. Po ky djalosh që rrinte vazhdimisht i menduar punonte në fshat arat e beut, lëronte, mbillte e korrte grurin e beut. Po ky djalosh kulloste bagëtinë dhe tërë ditën e ditës, nga do që i hidhte sytë, vështronte vetëm ujërat e liqenit. Dhe po ky çunak, po në këtë moshë të mitur, u pajtua si shërbëtor në një han të qytetit, jo

[18] Historia e popullit shqiptar II, Botim i dytë, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë, 1969, f. 559.

me lekë, jo me rrogë, po vetëm sa për të ngrënë një kafshatë bukë e sa për të fjetur në ndonjë nga grazhdet e hanit"[19].

Që nga hapat e parë të jetës Sterjo pat shijuar mirë ithtësinë që shkakton varfëria dhe shtypja sociale. Familja e tij nuk ngihej as me bukë misri. Në fshatin e tij „kishin hedhur rrënjë të thella shtypja, uritja dhe padrejtësitë shoqërore, përbuzja dhe tirania". Aty në Gllomboç dhe në Nivicë vijoi mësimet e para në shkollën greke. Më 1925 u bë nxënës i shkollës së parë të krahinës së Prespës që u hap në Goricë të Madhe. Familja e tij shumë e varfër, si edhe familjet e tjera fshatare, mezi mbaheshin në jetë. Uria kërcënohej si asnjëherë më parë. Babai i Sterjos, kujdestar i familjes me tridhjetë e tetë anëtarë, meqenëse në vendlindje nuk gjet shtegdalje nga kjo gjendje e vështirë ekonomike, muar disa herë me radhë rrugën e gjatë të kurbetit në Greqi, në Stamboll dhe në Amerikë. Prej andej kthehej i falimentuar si edhe shumë bashkëvendas të tjerë. Taksat shtetërore, obligimet e shumta, borxhi mbi borxh dhe fajdeja që i paguhej beut dhe qifligarëve, shtoheshin për ditë e më tepër. Kjo ishte gjendja e përgjithshme e shoqërisë shqiptare gjatë viteve të regjimit feudalo-borgjez në Shqipëri. „Rrënimi i ekonomive të vogla dhe ngritja e numrit të papunëve solli shtimin e borxheve. Gjendja e borxhlinjve u bë e vajtueshme, kurse ajo e uhadhënësve jashtëzakonisht e privilegjuar, sepse kërkesat e mëdha për borxhe ngritën përqindjen e kamatës. Gjatë këtyre viteve, në mjaft raste, fajdeja arriti deri në 100 për qind. Të llogaritura për afërsisht, vetëm borxhet e fshatarëve në vitin 1933 qenë rreth 20 milion franga ari, gati sa ishte buxheti i shtetit"[20]. Këtë gjendje të mjerueshme

---

[19] Fatmir Gjata, Shkrimtari Sterjo Spasse „Nëntori", Tiranë, 1964, nr. 12, f. 34.

[20] Historia e popullit shqiptar, II, f. 580.

Spasse, si edhe Migjeni, Esad Mekuli dhe shkrimtarët e tjerë të viteve '30 e paraqitën me mjaft realizëm në veprat e veta. Prandaj shumica e krijimeve artistike të kësaj periudhe flasin për këtë jetë të vështirë të vegjëlisë së fshatit dhe të qytetit.

Në shumë tregime dhe artikuj të Sterjo Spasses është pasqyruar jeta e rëndë e skamnorëve dhe e të mërguarve. S'është e rastit paraqitja e mërgimtarit në tregimin „I mërguemi!" dhe lektisja e tij ndaj dashurisë dhe mallit për vendlindje, ndaj këngës së bukur të vashave. Si normalist i shkollës së njohur të Elbasanit, qysh atëherë u bë bashkëpunëtor i gazetave dhe revistave të kohës si: „Zëri i Korçës", „ABC", „Rilindja", „Bota e Re". Shpeshherë u nënshkrua edhe me pseudonimet: Zaveri, Stespa, Mburimi, Gj. Zaveri, Hamleti i Shqipes, Shpresa e re, Luani, etj. Duke shkruar për plagët e rënda shoqërore, kritikoi të metat e shoqërisë dhe në letërsi ndoqi gjurmët e shkrimtarëve të cilët përfaqësonin realizmin kritik. Jeta e njeriut të varfër, të mbytur në bestytnitë shekullore, tragjeditë e mërgimtarëve, fejesat dhe martesat joharmonike, ndarjet tragjike të të rinjve, preokupojnë shkrimtarin e ri. Meqenëse edhe ai jetonte jetën e skamnorit, vaji për ta i rrinte në buzë.

Fshatari mërgimtar Pavlloja dhe e shoqja, Dina, janë figura fatkeqe të tregimit „Dashuri pa fat". I njëjti fund tragjik në jetë i pret edhe të fejuarit në novelën „Përmbi varrin e dashnorit". Marjana, vajzë fshatare, për shkak të humbjes së të dashurit bën vetëvrasje, duke u hedhur në liqen. Autori s'i gjen shpëtim as Afërditës së tregimit „Në pragun e vdekjes". Gati në të gjitha tregimet e dy përmbledhjeve të para „Kunorë Rinje" dhe „Në krahët e një femre" poeti mediton për fatin tragjik që e përcjell njeriun në jetë dhe për problemet e qenies njerëzore. Gëzimi dhe hareja në jetë prishen pa dëshirën e njeriut nga rrethana të jashtme apo edhe nga faktorët subjektivë. Shqetësimi dhe ndjenja e pikëllimit shtrihet deri

në dëshpërim të plotë për të eliminuar vullnetin e mëtejshëm për jetë. Tregimi tjetër „Te varri i botës!..." tregon diçka më tepër për kredhjet filozofike të prozatorit të ri, kur fillon të shtrojë dilemat lidhur me vazhdimësinë e jetës dhe lidhur me vlerën materiale e shpirtërore të saj.

Në prozën tregimtare me tematikë nga jeta e fshatit ndeshim edhe mjaft elemente autobiografike. Jeta e mundimshme e fshatarit në novelën „Babaj" ka shumë gjasa të jetë vetë gjallërimi i plakut Kristo Spasse. Prindi i rraskapitur në jetë, nëpër mot të lig me borë e fërfëllazë, shkon në qytet për të shitur një barrë dru dhe për t'u kthyer sa më parë me pak miell, si shpëtimtar i vetëm i fëmijëve të uritur. Dhe ashtu shumë ditë me radhë, por, kur kthehet i sëmurë dhe pa fuqi, i drejtohet vetvetes: „Mirë sot po shuhet uria, po nesër si do t'i bëhet hallit?!..." Pyetja me të cilën mbyllet kjo prozë dëgjohej asokohe prej shumë e shumë skamnorëve dhe ishte bërë refren i ditës. Ishte koha kur misrit i thureshin apoteoza, siç do të vërejë Migjeni. Si të ruhej jeta, kur uria kërcënohej si një përbindësh i përrallave dhe shkurtonte pa mëshirë jetën. E tërë kjo gjendje kaotike, që ishte si pasojë e politikës aventuriste të mbretit dhe të bashkëpunëtorëve të tij, si reaksion kishte pakënaqësinë e masave e cila pakënaqësi „...filloi të shtohej e të merrte përpjesëtime të gjera në dimrin e vitit 1927-1928... Mjerimi gjatë atij dimri arrijti kulmin. Uria përfshiu të gjitha krahinat, dhe sidomos fshatarësinë e malësive të Veriut".[21] Deri më 1935, jo vetëm që nuk u përmirësua gjendja e popullsisë, por u keqësua edhe më tepër dhe „...zija e bukës mori përpjesëtime katastrofale. Atë vit me mijra veta, me gra dhe fëmijë, të zbathur dhe të zhveshur, grumbulloheshin përpara dyerve të prefekturave dhe nënprefekturave dhe kërkonin misër. Turma të uriturish dhe

[21] Po aty, f. 570.

qindra fëmijë silleshin nëpër rrugët e qyteteve duke lypur bukë. Zija e bukës preku jo vetëm krahinat e varfëra por edhe rrethet bujqësore të vendit"[22].

Mjerimin e skamnorëve të uritur Spasse e përshkroi me mjeshtri në prozën tregimtare me tematikë nga jeta e fshatit. Të ngjashme në aspektin tematik janë edhe skica e Migjenit „Legjenda e misrit", tregimi i Nonda Bulkës „Intervistë me malësorin", proza e Shevqet Musarajt „E mjera" dhe shumë krijime artistike të shkrimtarëve të tjerë. Derisa Migjeni na jep fizionaminë fizike dhe morale të malësorit, i cili bjerr cilësitë pozitive të karakterit të tij para nëpunësit që shpërndan misër, „misër për fëmijë t'untë", Nonda Bulka përshkruan mjaft dhimbshëm malësorët, të cilët me buzë të shkrumbuara nga uria nuk kanë më buzëqeshjen e dikurshme krenare dhe tradicionale. Musaraj, në anën tjetër, është preokupuar me paraqitjen e rropatjeve jetësore të nënës me tre fëmijë, të cilët mjerimi i kishte pjekur para kohës. Për fëmijë të tillë të mjeruar shkruante atëherë edhe Migjeni në poemën „Poema e mjerimit" dhe në krijimet e tjera artistike.

Duke u trajtuar në gjerësi tematika sociale, aq sa është e mundur në llojet e shkurtëra të prozës dhe në poezi, këta shkrimtarë nxitnin forcat progresive t'i bëjnë rezistencë regjimit në fuqi. Për këtë arsye, me të drejtë kjo krijimtari konsiderohej akuzë e rëndë e ngritur kundër aparatit shtetëror dhe regjimit obskurantist e gjakpirës, i cili si vegël e të huajve i mbyllte sytë para këtij realiteti të hidhur. Revista „Bota e Re" që doli deri më 1937, e në të cilën bashkëpunonin këta shkrimtarë më përparimtarë, guximshëm i shtronte problemet sociale të atyre viteve dhe çonte zërin kundër çdo shfrytëzimi të fshatarësisë nga ana e nëpunësve dhe e fajdexhinjve

[22] Po aty, f. 597.

parazitë. „Fajdexhiu — shkruante ndër të tjera revista — është bisha e fshatit dhe e qytetit. Është si shushunja e moçaleve. Barku i tij nuk ngopet kurrë. Buzë s'ka por vetëm dhëmbë. Duar s'ka por vetëm kthetra. As shpirti nuk ka por vetëm një sanduq me kambiale. Zemra e tij është një sahat që numron çastet e fajdesë". Inkarnacionin e fajdexhiut të tillë do ta gjejmë më vonë në romanet e Sterjo Spasses.

Ndër prozatorët shqiptarë Spasse konsiderohet si njohës i mirë i jetës së fshatit. Që nga viti 1932 e deri më 1939 ai qe mësues në fshatrat e rrethit të Gjirokastrës dhe të Korçës. Varfërinë e kishte përjetuar edhe vetë. As derisa ishte mësues nuk arriti ta përmirësojë gjendjen ekonomike. „Rrogën — siç pohon Fatmir Gjata — e përdorte për të paguar borxhet tregëtarëve. Kur u martua, arriti të bëjë vetëm një xhaketë të re". Por shkrimtarin nuk e tronditën vetëm vështirësitë jetësore të natyrës personale dhe familjare. Tragjeditë e natyrës së përgjithshme shoqërore atij ia falën traumën psikike më tepër se asgjë tjetër dhe lanë gjurmë të pashlyeshme në jetën dhe formimin e tij.

Reagimi i ashpër ndaj padrejtësisë ishte veti e karakterit të tij. Sa ishte nxënës i Elbasanit nuk e pat përmbajtur dot pa e shprehur urrejtjen që ndiente ndaj majorit fashist italian Defuçios, i cili ishte i ngarkuar me detyrë që të shtrinte influencën e fashizmit. Spasse në shkrimet e tij akuzoi rëndë këtë element fashist, „si njeri që sjell grindje e përçarje. Për këtë shkak qe burgosur dhe vetëm pasi nxënësit e Normales reaguan haptazi në demonstratë, u lirua nga burgu.

Zemrën e shkrimtarit të ri e lëndoi për jetë katastrofa që pësuan fshatarët e Goricës prej Maliq beut më 1931. „Vjete me radhë goricarët ngritën krye dhe nuk deshtën ta njihnin beun si zot të tyre. Por beu, me urdhër të Zogut e me dyqind xhandarë i për-

zuri goricarët nga fshati. Burra e gra, pleq e fëmijë, mbetën rrugëve, pa bukë, pa strehë, pa mbrojtje... të përbuzur nga mbreti, nga beu, nga gjyqtarët, morën arratinë jashtë shtetit, ndërsa tokat e tyre i rrëmbeu beu e fajdexhinjtë. Ky fat e priste edhe vendlindjen e Sterjos... Kjo gjendje e mjeruar e popullit e mbush zemrën e Sterjos plot urrejtje për klasat çfrytëzuese, urrejtje e cila gjeti shprehjen e vet artistike në veprën e tij. Për këto ngjarje autori do të shkruajë më vonë në romanin e vet të njohur „Ata nuk ishin vetëm".

Në një numër të konsideruar prozash të shkurtëra, të cilat autori i quan proza alegorike dhe novela, gjithashtu trajton problematikën sociale dhe shprehet për çlirimin nga ajo gjendje e padurueshme. Në prozën „Zëri i zemrës së trëndafilit", të botuar në revistën „Ars" të Korçës më 1930, shkruan: „Në krahërorin tim baj zemrën burrëreshë e trime. Zemra ime rrehë dhe zëri i saj është: Liri, Liri! Ky zë është një mijë herë më i fortë se zëri i zemrës suaj, o armiq!... „Është shumë e qartë, Spasse këtu shprehet lirisht duke kërkuar liri sociale. Trëndafili i lënduar simbolizon vegjëlinë e pafajshme e cila në të vërtetë është guximtare dhe ka një moral më të fortë se „armiqtë", shfrytëzuesit e egër. Në një prozë tjetër, të botuar më 1933 në gazetën „Kosova" të Kostancës me titullin „Përralla e lumit", me ngashërim shtron pyetjen „Kur... kanë për të pushuar vajet e ulurimet e popullit të robëruar shqiptar". Ai i urrente pa masë të pasurit që silleshin të pabrengosur duke bërë gazmend nëpër kafenetë e bulevardeve të kryeqytetit. Në anë tjetër, në formë të kontrastit i komunikon lexuesit edhe diçka më tepër për gjendjen e të varfërve dhe të uriturve të cilët dergjeshin nëpër trotuare. Këtyre skamnorëve u drejtohet: „Hej mumje egjyptiane të ekspozuara në bulevardin e plspillosur, qeshni e buzëqeshni edhe ju!".

Me kalimin e kohës, në veprën e tij vërehet rritja graduale e urrejtjes kundër shtypësve, tiranisë dhe padrejtësisë. Në tregimet e kësaj faze të krijimtarisë shfaq qëndrimin ndaj klasave shoqërore antagoniste dhe njëherit botëkuptimin e tij si intelektual.

Më 1935 u botua edhe një prozë alegorike shumë e rëndësishme, „Pellgu". Është ndër prozat më të suksesshme të këtij lloji ku shpërthen mllefi kundër kalbësirave të kohës dhe shtypësve e njëherit tregohet rruga drejt ardhmërisë më të lumtur të njerëzimit: „... sepse më së fundi, helmi do të ketë të sosur, gjembushkat dhe ferrushkat mund të hidhen në lendinë për t'u kthyer në vjollca e trëndafila dhe atëherë pellgu, ehu! — pellgu me gjëmbat e me ferat e katranosura do të mbulohet nën shkëmbenjtë e shekullit, se atje lart, sipas tyre, po ndihet pa rreshtur jehona... e njerëzisë së pastër".

Nëpërmjet të prozës tregimtare dhe të romaneve me ashpërsi luftohen të metat dhe zakonet e prapambetura të shoqërisë shqiptare të cilat ishin bërë pengesë serioze e progresit të përgjithshëm.

Spasse, si edhe disa shkrimtarë para tij, shquhet sa i përket trajtimit të tematikës shoqërore. Ai ngre zërin kundër dukurive negative. Bie fjala, në disa tregime, kritikon martesat që bëhen për interes material. Në tregime të tjera shtron shumë probleme të rëndësishme dhe jo vetëm që shprehet për zgjidhjen e tyre, po edhe i gjykon shkaktarët dhe bartësit e atyre dukurive negative në familjen dhe në shoqërinë shqiptare.

Si bir fshatari prej së afërmi e kishte parë se zakonet prapanike e bënin edhe më të rëndë jetën e fshatit. Duke reaguar ashpër kundër tyre si intelektual dhe edukator, hyri në vallen e të gjitha forcave progresive që damkosnin çdo gjë të dëmshme dhe konservative. Më 1930 botoi tregimin „A do ta shoh", ku bariu Bojko, i fejuar me një vajzë të cilën s'e

kishte parë kurrë, shqetësohet për së tepërmi për fatin e vet. Megjithëse jeta konservative në fshat është paraqitur me realizëm, dhe kjo është veçori qenësore e veprës letrare të këtij autori, në këtë prozë nuk janë dhënë edhe konfliktet e tjera të shumta në kuadër të familjes shqiptare. Lexuesi krijon përshtypjen se autori më tepër synon ta shprehë brengën dhe dilemat shpirtërore të të rinjve kur vendosin për ardhmërinë e tyre jetësore.

Shkrimtari nuk i la pa kritikuar edhe mendjelehtit e qytetëruar para kohe, sidomos ata që shkolloheshin apo kalonin një kohë më të gjatë jashtë vendit, në qytetet e Perëndimit: „... Ndërkaq qytetërimi i sipërfaqshëm përparon, të rinjtë bijnë viktimë, ditët kalojnë mënxyrë dhe qytetërimi i vërtetë ngulçon nën modhën e fundit të sjelljeve e të pispillimeve", shkruante prozatori ynë në prozën alegorike „Dallëndyshe, ktheja ndryshe, moj zonjushe!"

Pena e tij ishte e mprehtë edhe kur kritikonte hipokrizinë shoqërore të kohës. Në hartimin tjetër letrar „Te praku i dy botëve" përballë hipokritëve vë luftëtarët e denjë të hipokrizisë: „Njerëzit që luftojnë hipokrizinë janë të zbehtë, të krusur, të përburzur, të pangopur me punë, melankolikë, të ashpër dhe qëndrojnë larg dëfrimeve. Numri i antarëve është i vogël, përfundimi i djersës së tyre është fare i pakët, çpërblim hiç. Megjithë këta punojnë, vuajnë dhe luftojnë! Çudia më e madhe është se këta duan të vdesin jo për pasuri, jo për defrim, sa për prehje, por... për të vërtetën e Botës së tërë!...". Një kamxhik tjetër u bie edhe bixhozxhinjve, gazetarëve mendjelehtë e rrenacakë të asaj kohe, fajdexhinjve, nëpunësve ryshfetxhinj, studentëve mendjemëdhenj, vajzave kurtizane, mësuesve konservativë e të plogështë etj.

Kontributin e Sterjo Spasses në damkosjen e të metave individuale dhe shoqërore, i cili qe i ndieshëm edhe në prozën tregimtare të dhjetëvjetëshit të tretë të

këtij shekulli, u shtua edhe më tepër në romanet e mëvonshme. Kultivimi dhe pasurimi i mëtejshëm i prozës shqiptare është ndër meritat e posaçme të Spasses. Kur u botuan romanet e tij proza shqiptare nuk kishte bërë deri atëherë ndonjë rrugë të gjatë në krahasim me letërsitë më të zhvilluara të popujve të tjerë. „Ndoc Nikaj — shkruan Razi Brahimi — futi në historinë e letërsisë sonë vitin 1899, me botimin e të parës romancë në gjuhën shqipe. Para tij proza shqipe ishte shumë e pazhvilluar, që të mos themi se nuk ishte dukur ende në fushën letrare"[23]. Këtë rrugë të nisur e vazhduan edhe më tutje Ndoc Nikaj dhe shkrimtarët e tjerë me tregimet dhe romanet e tyre. Nikaj më 1913 vazhdoi të botojë veprat e tij në prozë, prandaj me të drejtë konsiderohet prozatori më i frytshëm deri me mbarimin e Luftës së Dytë Botërore. Që nga fillimi i shekullit XX shquhet si prozator i talentuar Mihal Grameno, i cili trajtoi problematikë interesante patriotike dhe shoqërore dhe ndikoi në shkrimtarin Spasse. „Për herë të parë njerëzit e shtresave të varfëra të shoqërisë, me brengat e tyre nisin të zënë kaq vend në letërsinë shqiptare. Novelat e Gramenos e çilnin kështu rrugën e romaneve të Nikajt që do të botoheshin menjëherë pas tyre..."[24]

Derisa në novelat „Oxhaku" dhe „E puthura" të Gramenos paraqiteshin antagonizmat shoqërore të kohës, ku shprehej bindja se marrëdhëniet ndërmjet shtresave dhe klasave shoqërore, të ashpërsuara shumë, mund të përmirësoheshin edhe nëpërmjet të martesave, në prozën e mëvonshme shfaqen pikëpamje më të avancuara sa i përket çështjes së antagonizmave klasore. Në periudhën kur sundonin marrëdhëniet shoqërore feudale martesa e të varfërvet me të pasurit dhe anasjelltas, në raste shumë të rralla, realizohej me

[23] Razi Brahimi, Shënime letrare, Tiranë, 1965, f. 315.
[24] Dhimitër S. Shuteriqi, Historia e letërsisë shqipe II, Tiranë, 1965, f. 549.

sakrifica shumë të mëdha. Ndër familjet patriarkale kishte si pasojë tragjedi të ndryshme. Duke bërë fjalë për veprën e Gramenos, Spasse shkruan se ideja qendrore e shkrimtarit në novelën „Oxhaku" ka qenë „të tregonte se bashkëpunimi dhe miqësimi i klasës feudale me fshatarësinë e varfër me anë të martesave, do të ishte paqe e lumturi në Shqipëri"[25]. Ai në fillim nuk kishte pikëpamje të njëjta si Gramenoja. Mendonte se martesat e tilla edhe më tepër shkaktojnë largimin e klasave shoqërore ndërmjet tyre, sepse ndjente urrejtje të papërmbajtur ndaj klasës shfrytëzuese feudale. Spasse e adhuronte pa masë Gramenon si patriot dhe si shkrimtar dhe veçanërisht e çmonte si pamfletist të talentuar. Prandaj, në fazën e parë të krijimtarisë letrare, synonte për të ndjekur rrugën e tij. Vetëm se, derisa autori i „Kryengritjes shqiptare" kishte më tepër pirje për të trajtuar temat patriotike, Spasse kacafytej me problematikën sociale të kohës. Këtij shtegu të hapur u nisën edhe ca shkrimtarë të viteve '30. Megjithatë, në letërsinë shqiptare si tërësi ndjehej shterpësi letrare për të cilën bën fjalë Spasse në shkrimin „Shterpësi letrare": „... Bota letrare e jonë, sot për sot, është e ndrydhur brënda në disa dhomëza të tilla të thjeshta e të shpërndara an'e kënd Shqipërisë. Këto dhomëza ruajnë nga ndonjë rreze të zbehtë të poezisë e të prozës së re kombëtare. Le t'i hapim dyert e këtyre dhomëzave dhe le t'i ndjekim çap pas çapi me kërshëri dritën e këtyre rrezeve e do të shohim pastaj se sa shumë të kënaqur kemi për të qenë nga prodhimi ynë letrar".

Në këtë periudhë kohore deri te pushtimi fashist i Shqipërisë botimet e vitit ishin shumë të rralla. Përmbajtja e tyre ishte e ndryshme, por dominonte ajo fetare. Më shumë botonte kleri katolik dhe diçka më

---

[25] Sterjo Spasse, Grameno dhe proza e tij. Parathënia e veprës „Kryengritja shqiptare", Tiranë, 1959, f. 26.

pak ai mysliman. Shumica prej tyre ishin me subjekt nga historia e fesë, ose ishin traktate fetare. „Binte në sy një kaos e ndihej atmosferë mbytëse edhe në jetën kulturore të vendit. Zhvillohej një luftë e ashpër ideologjike midis elementëve demokratikë e përparimtarë, në njërën anë, dhe atyre reaksionarë, përfaqësuesve të regjimit në fuqi, në anën tjetër. Presioni nga aparati shtetëror ishte i madh dhe i padurueshëm. Sa ishte i pamëshirshëm shfrytëzimi ekonomik dhe social në masat e gjera, aq ishte edhe presioni ideologjik e politik në radhët e intelektualëve dhe tërë kjo shkaktonte rezistencë të dukshme. Intelektualët përparimtarë ndiqeshin dhe torturoheshin zi e më zi. Letrarët e asaj kohe ishin izoluar nga jeta politike e vendit. Çajupi shkruante atëherë vargjet e fundit jashtë atdheut, Noli kishte ikur në Evropë e më vonë ishte vendosur përgjithmonë në Amerikë. Vargu mjedjan ishte ndërprerë dhe poeti merrej me gjuhësi. Për ta shuar revolucionaritetin e Migjenit, Ministria e Arsimit e kishte transferuar në një fshat të lënë pas dore, në Pukë. Por, Migjeni edhe kështu nuk u dorëzua. Shpirti i tij revolucionar nuk u shua po shpërtheu në vargje të lira.

Ndonjë shkrimtar tjetër i brezit të viteve '30, si Haki Stërmilli, ishte i mbyllur në burgun famëkeq si element i rrezikshëm. Edhe Spasse Kishte përjetuar padrejtësinë, „peshën e së cilës ai vazhdonte ta ndjente edhe më tepër".

Në letërsi bëhej „luftë ndërmjet drejtimeve të ndryshme krijonjëse, një luftë që u pasqyrua edhe në letërsi, por që u shpreh, para së gjithash në vetë krijimtarinë letrare. Kërkimi i shtigjeve të reja letrare ishte në rend të ditës dhe nuk diktohej prej ndikimeve të jashtme aq sa përcaktohej prej zhvillimit shoqëror e letrar të vendit. Ishte kohë kontradiktash të forta e të ashpra ekonomike, ideologjike dhe sho-

qërore"[26]. Në këtë atmosferë krijonin, përveç shkrimtarëve reaksionarë, të cilët ishin përfaqësues të letërsisë zyrtare pseudopatriotike, dhe ata të rrymës progresive: Gaspër Pali, Kolë Mirdita, Migjeni, Sterjo Spasse, Shevqet Musaraj, Qemal Stafa, Nonda Bulka, Dhimitër Shuteriqi, Petro Marko, Kristaç Cepa, Andrea Varfi, etj., gjithashtu në kushte shumë të vështira të jetës së popullit shqiptar në Jugosllavinë e vjetër Esad Mekuli thurte vargjet e poezisë së tij të njohur me motive sociale. Derisa këta shkrimtarë, kush më pak e kush më shumë, qanin hallet e skamnorëve dhe ngritnin zërin kundër shfrytëzimit të çdo lloji, shkrimtarët e tjerë reaksionarë më vonë i kushtonin himne trashëgimtarit të fronit mbretëror dhe fashizmit italian.

Shkrimtarët përparimtarë të letërsisë demokratike në aspektin tematik kishin sjellë freski dhe e kishin pasuruar letërsinë tonë. Ata merreshin me trajtimin e tematikës sociale, e cila „...përbën një prej kontributeve më të mëdha të letërsisë së asaj kohe, si në kuptimin ideologjik ashtu edhe në kuptimin artistik"[27]. Në veprimtarinë e tyre letrare gjithnjë e më tepër është e pranishme fryma revolucionare. Ndonjëri nga poetët si Andrea Varfi, duke shpresuar për një çlirim më të afërt nga gjendja e vështirë sociale, shkruante, më 1932 në poezinë e njohur „Shih si rreh":

„Mos je dallgë e gjithësisë,
që të vjetrën shëmb mbi dhe
për të shkrepur dit' e re,
gaz i gjithë njerëzisë?".

Poeti pak vite më vonë në poezinë „Punëtorët" guximshëm jep kushtrimin:

---

[26] Razi Brahimi, Vepra e cituar, f. 346.

[27] Po aty, f. 350.

„Të çojmë grushtin! Minat botës vjetër!
se ne do të farkëtojmë përmbi dhé
një botë më të mirë: botën tjetër!"

Nga ky grup shkrimtarësh u dallua posaçërisht Sterjo Spasse me idetë e tij të shprehura në krijimet letrare artistike. Si mësues në rrethet e Gjirokastrës, ku ishte i izoluar me atë natyrë të ashpër, „... larg ambientit të shkollës ku mësuesi i ri kishte kaluar rininë e parë, larg jetës kulturore dhe për më tepër i deziluzionuar nga realiteti i hidhur feudalo-borgjez nga shtypja dhe varfëria, autori nis e shkruan romanin „Pse?!..." të cilin e mbaroi në fillim të vjetit 1933"[28]. Në të ai bëri përpjekje të pasqyrojë gjendjen e vet dhe të intelektualëve të tjerë dhe të shfaqë qëndrimin ndaj realitetit të shoqërisë shqiptare. Në roman i dha hapësirë më të madhe trajtimit të temës sociale dhe kjo është „... Merita kryesore e Spasses... se kapi një temë me karakter shoqëror dhe i vendosi ngjarjet në kohën e tij, pa u shtyer në të kaluarën". Pas njëzet e dy vjetësh, që prej kohës kur ishte hartuar vepra, vetë shkrimtari evokonte kujtimet nga aktiviteti letrar në kohën e përënduar, e njëherit sqaronte se me çfarë motivacioni kishte shkruar romanin „Prej jetës në jetë: Pse?!..." Në vitin 1933, kur isha akoma i ri, botova romanin tim të parë „Pse?!...". Në të u përpoqa ta pasqyroj atë kaos që kish pushtuar një pjesë të rinisë intelektuale që kish humbur shpresën dhe besimin në një të ardhme më të mirë. Heroit tim kryesor jeta i dukej aq e rëndë dhe e errët sa që kjo e çoi në urrejtje ndaj gjithë njerëzimit. Ai nuk vëren disa anë pozitive të jetës dhe arrin

[28] Nasho Jorgaqi, Romani „Pse?!..." dhe fillimet letrare të Sterjo Spasses, BUSHT, Seria „Shkencat shoqërore", Tiranë, 1958, nr. 4. f. 140.

deri në nihilizëm, në vetëvrasjen, dhe duke mos u përpjekur të fillojë luftën kundër rrethit feudalo-borgjez, i cil e çoi deri në një fund tragjik".[29]

Posa doli nga bankat e shkollës, kur filloi ta shkruajë romanin, jeta i dukej më e hidhur se asnjëherë më parë. Fshati ku punonte ishte i prapambetur, ishte i zhytur në skamje dhe askush s'e gjente rrugën e shpëtimit të fshatarëve. Injoranca, padituria, konservativizmi etj., zotëronin me gjithë peshën e tyre mbi fshatarët. Në anën tjetër, kishte parë edhe vetë, shtresat e varfëra të qytetit ishin kapluar nga ajo gjendje e paduruar. „Opinga" shtrydhej nga shfrytëzuesit e pashpirt. Edhe vetë autori i romanit të mohimit kalonte po atë jetë të vështirë. Familja e tij nuk shihte ditë të bardhë. Dëshpërimi e kishte molisur të riun dhe gati e kishte hedhur nga binarët e jetës.

Jeta njerëzore është mjaft komplekse dhe plot dramacitet. Vuajtjet, gëzimi, hidhërimi, vaji, gazi, urrejtja, dashuria, dëshpërimi, shpresa etj., janë manifestimi i vetë jetës. Dëshpërimi i pamasë i njeriut, pesimizmi në jetë s'është tjetër përveç se shkrumb i pasosur, një përshëndetje e fundit me të mirat e jetës. Dëshpërimi i pafund njeriun e bën pesimist, për të nuk ka dritë, por as shteg jete të mëtejme s'gjendet kund. Spasse, duke pasur ende një botëkuptim të turbullt mbi botën dhe shoqërinë, nuk kishte arritur të kuptojë se perspektiva e re hapet vetëm kur qenia njerëzore dhe shoqëria si tërësi, duke bërë përpjekje të vazhdueshme, mposht të gjitha vështirësitë dhe marshon drejt së ardhmes më të bukur dhe më të ndritur. Por, edhe nëse vetë Spasse ka qenë i vetëdijshëm për të gjitha këto, gjatë atyre viteve ishte i bindur se çdo përpjekje e intelektualëve për hapje të perspektivës, pra për përparim të përgjithshëm, përfundonte me persekutimet që ndër-

[29] Po aty, f. 154.

mirreshin. Çdo shpresë për jetë më të lumtur ishte vetëm iluzion. Për Spassen „si edhe për të gjithë rininë intelektuale përparimtare, ishin vite kur thërmoheshin si kala prej rëre ëndrrat dhe shpresa e bukur e vendin e tyre e zinte deziluzioni i plotë e i gjithanshëm. Jeta e kish goditur rëndë Spassen dhe kish shtruar para tij pikëpyetjen e madhe: „Pse të ndodhin të gjitha këto?"..Sterjo Spasse nuk e gjeti dot dhe s'kish si ta gjente n'atë kohë përgjegjen e „pse-ve" që dilshin përpara në çdo hap që bënte"[30].

Në rrethana të tilla jetësore, i irituar nga shoqëria së cilës i takonte, para se ta shkruajë romanin pat botuar tregimin „Te varri i Botës!..." I njëjti tregim i përfshirë në përmbledhjen e parë „Kunorë Rinije", pa u ndryshuar, gjet vend në faqet e romanit „Pse?! ..." dhe pa dyshim ka shërbyer si tharm për të ardhur edhe më shpejt brumi i veprës. Autori në këtë krijim letrar shpreh skepticizmin përkitazi me jetën dhe shoqërinë njerëzore. Këtu atij për të parën herë i rrëshqet dheu nën këmbë. Jetën e sheh si një varr pa fund. Duke u kapur edhe për ndonjë degë të filozofisë dekadente të kohës i shtohet edhe më tepër dyshimi përkitazi me vlerat e jetës dhe bashkë me të edhe pesimizmi. Problemet të cilat e mundonin tani kishin formuar një rreth shumë të gjerë. Në epiqendër qëndronin çështjet e kuptimit të ekzistencës së njeriut si individ dhe të shoqërisë.

Në kritikën letrare janë bërë përpjekje që nota dominuese e pesimizmit në romanin „Pse?!..." të shpjegohet thjesht si ndikim nga filozofia evropiane e kohës. Në mënyrë të veçantë është pohuar ndikimi i filozofit gjerman Niçes në shkrimtarin e ri. Niçeja si filozof me pikëpamje të shprehura kontradiktore, të shfaqura në veprën „Ashtu foli Zaratusstra" pa dyshim ka ndikuar në autorin e romanit të mohimit.

---

[30] Po aty, f. 38-39.

Me gjithë këtë, nuk duhet konsideruar se vetëm ky është ndikimi që ka shkaktuar pesimizmin në veprën e Spasses. Në studimin „Shkaqet dhe kuptimi i një tragjedije"[31] me të drejtë është konstatuar se pesimizmi në romanin „Pse?!.." është kushtëzuar nga faktorë të shumtë objektivë dhe subjektivë".

Tani të shohim se çfarë mendimesh i sillen vërdallë në kokë heroit të romanit, Gjon Zaverit. Që nga fillimi paraqitet me bindjen se jeta e kësaj bote është kotësi e pafund. Së pari e bind vetveten se jeta, „teatri i madh i kësaj bote", si e quan ai botën me të gjitha gjallesat, jo vetëm që është e çuditshme por edhe e pakuptimtë. Deri te ky përfundim arrin duke i përcjellë ndryshimet e mëdha në natyrë dhe në shoqëri dhe duke filozofuar si një shkollar i kohës. Sipas tij çdo krijesë është e gjykuar të shkatërrohet, pra edhe njeriu. Prandaj, çka i duhet vazhdimësia e jetës. Me këtë rast duhet sqaruar një gjë: për cilën jetë aludon autori. Për jetën në tërësi? Ai në të vërtetë shpreh mendimin se çdo hap në jetë është kotësi. Por, nëse marrim parasysh edhe atë që nuk është thënë në roman, po në ndonjë krijim tjetër të tij, mund të konkludohet se kotësi është vazhdimësia e jetës së mundimshme, ku vegjëlia, në „teatrin e madh", luan rolin e atij që kinse gjallëron. Nga proza e tij „Bota u çthurr" mësojmë se autori është kundër jetës së mundimshme ku mbretëron shfrytëzimi dhe padrejtësia. Sipas tij njeriu duhet të jetë shumë i qëndrueshëm. Spasse shkruan: „Të rrosh, po, të rrosh deri sa të krijohet një jetë e re e me njerëz të rinjë... Do t'i vërtitem pyllit edhe unë, mënxyrës do t'i them stop! Ujin e turbullt do ta shterroj, gremina e kthepa, gjëmba e çdo gjë me këmbët e mia

[31] Rexhep Qosja, Shkaqet dhe kuptimi i një tragjedije. „Epizoda letrare". Botoi „Jeta e re", Prishtinë, 1967, f. 55-84.

do t'i shtyp; do ta shlyej njollën mbi ballin e vulosur dhe do të hidhen atje larg, ku valon flamuri i lavdisë..."

Për fat të keq Spasse në romanin e vet nuk arriti të paraqesë një qëndrueshmëri të tillë në jetë të heroit të veprës letrare. Zaveri, jo vetëm që nuk përpiqet të qëndrojë i pamposhtur nga stuhia, por dorëzohet vetë, pa ndërmarrë ndonjë aksion të vlefshëm.

Konflikti kryesor në vepër ngritet me shpejtësi nëpërmjet të disa ndërlikimeve të jetës familjare. Zaveri prindërve nuk ua jep pëlqimin për fejesën e tij me vajzën fshatare Afërditën. Sipas tij dashuria reale, jo vetëm që nuk përmban asgjë të vlefshme e njerëzore, por është e pakuptimtë dhe e dëmshme. Sepse mendon: „S'ka pse të hyjë në zemër dashuria e një vashe, e një femre". Dashuria ideale është e vetmja të cilës i falet Gjoni i turbulluar shpirtërisht. Në moshën e lulëzimit të rinisë ai nuk përfill dashurinë e Afërditës, fshatares së bukur, me të cilën dëshirojnë ta fejojnë dhe ta martojnë prindërit. Në të njëjtën mënyrë, duke nënçmuar femrën si qenie shoqërore, refuzon dashurinë e zonjës P., të një gruaje e cila dashuron marrëzisht. Mandej s'e përfill as dashurinë e të bukurës Polë, vajzës qytetare, së cilës i lind dashuria ndaj këtij djaloshi të pashëm. Zaveri luan rolin e një kukulle të këndshme, por e cila s'ka zemër për të dashruar. Në roman kemi edhe mjaft elemente autobiografike të gërshetuara në disa fragmente. Prandaj, ky është edhe një prej shkaqeve për të reaguar në këtë mënyrë kundër martesave të tilla, ku prindërit kishin fjalën kryesore.

Gjenci, një protagonist tjetër i romanit, i cili gjithashtu para Zaverit kishte përjetuar në jetë fatin tragjik për shkak të pakënaqësisë në jetën bashkëshortore, në moshën e rinisë kishte bërë vetëvrasje. Gjoni qe i pikëlluar shumë me rastin e humbjes së shokut. Megjithatë, nuk vajtol vdekjen e tij: „Tani nuk po vajtoj vdekjen e tij mbasi edhe unë dikur do

të bëj një gjë të këtillë", thotë Gjoni. Që nga kjo pjesë e romanit lexuesi kupton se Gjon Zaveri është në sur drejt vdekjes tragjike. Çka është edhe më keq, asnjë shpëtimtar nuk i del më përpara.

Pasi ndërprehet ditari, formë të rrëfimit të cilën e preferon shkrimtari në fillimin e krijimtarisë letrare, në epilogun e romanit, ngjarjet vijuese i tregon vetë autori. Disa ditë pas martesës Zaverin e shtrëngon edhe më tepër fantazma e vdekjes të cilën edhe vetë e dëshironte. Vdekjen e kishte vendosur me kohë. Në një letër të shkruar pak ditë para vetëvrasjes, kishte thënë: „Njeriut duhet t'i mbushet koka se shkrimtari është gënjeshtër me bisht e se filozofi është vrasës i pamëshirshëm! Po fillove të ecish pas gjurmave të filozofëvet, më mirë mos u marto, se nuk do të jesh i zoti as për bashkëshorten e as për vehten tënde, dhe, në vend që të marrish në qafë vetveten, ke për të vrarë dy e më shumë veta. Filozofia nuk është gjë tjetër, veç se një mjet vrasjeje... Ashtu, po, atëherë, por një herë tani po... shkoj, po shkoj para kohës... Unë jam penduar për këtë rrugë, por nuk e mbaj dot vehten".

Zaveri gjatë tërë rrugës së vet jetësore e deri në fundin tragjik, edhe pse nuk shihet se zhvillon ndonjë aktivitet pune të vlefshme e as që ndërmerr ndonjë aksion, meqë paraqet njerium e plogshtë, shpeshherë i shkon ndër mend t'i kritikojë të metat e shoqërisë në të cilën jeton. Madje bën aq vërejtje me vend sa që lexuesi mbetet i habitur; si është e mundur që një njeri i cill ka rrëshqitur drejt humnerës vdekjeprurëse, një njeri të cilit nuk i dhimbset as jeta e vet, të jetë i brengosur për fatin e të tjerëve dhe t'u dëshirojë atyre fatbardhësi në jetë. Këtu qëndron nota humanitare në roman. Pa dyshim ky është qëndrimi i vetë autorit si njeri dhe shkrimtar.

Nga fjala e Nasit — plakut nëntëdhjetëvjeçar, që është një personazh tjetër i romanit, kuptojmë se Zaveri ndonjëherë i braktis mendimet filozofike dhe

drejtohet me sy kah jeta reale. I intereson posaçërisht mendimi i plakut: me përvojë të madhe jetësore si duhet, sado pak, të përmirësohet jeta e mundimshme e fshatarësisë. Plaku flet: „...do të urdhëroj që pasuria ime të përdoret për punë filantropike: për shkolla, për spitale, për ngrehje katundesh, por më fort për përmirësimin e jetës së katundarëve punëtorë e bujqër. Kur kemi mënxyrën e barkut, kur shohim me mijëra njerëz po shtohen nëpër këndet e rrugëve t'uritur, të zbathur e të zhveshur dhe në mëshirë të sëmundjes, shi — atëherë marrëzi të ngrejmë xhamia e kishë për të kënaqur Zotin..."

Parazitët Spasses i janë halë në sy: „Tipi i parazitit me gojën plot të thotë: veç kafenesë s'kemi ku rrijmë dhe ku dëfrehemi". Disa të rinj të cilët ishin „helmuar" nga kultura e Perëndimit nuk kujdeseshin fare për një ngritje shoqërore apo për një jetë kulturore — pohon shkrimtari — „ata duan vetëm të shtrihen gjithë ditën nëpër kafenetë si qenjtë në kohën e vapës, ose të rendin mbas vajzave si langoj dhe të rrijnë të veshur fare mirë e të pilluar për bukuri".

Në faqet e këtij romani femra ndonjëherë jo vetëm që nuk përbuzet por përkundrazi, roli i saj në transformimin e tërë shoqërisë çmohet shumë. Në pak vende, autori nëpërmjet të heroit kryesor, shpreh mendimin se atë (femrën) duhet përkrahur. Jetën bashkëshortore Spasse e parámendon të atillë që bashkëshortët, duke ndihmuar njëri-tjetrin, të japin kontributin e tyre në ngritjen e tërë shoqërisë njerëzore: „Për mbarëvajtjen e njerëzisë, është mirë, i dituri të martohet me një të paditur, sepse i padituri a e paditura kanë nevojë për një mësonjës të përdiçëm që do të përmirësojnë jetesën. Qëllimi është që njeriu t'i hyjë në punë tjetrit...", shkruante Spasse. Megjithatë, hetojmë kontradiktën e paevitueshme, sepse personazhi kryesor vepron të kundërtën. Edhe pse vetë është intelektual i formuar, nuk sakrifikon asgjë për Afërditën, krijesën e çiltërt fshatare. Ajo,

edhe pas vdekjes së Gjonit vazhdon jetën e vet bashkë me frytin e zënë, me të cilin në roman paraqitet mjaft bukur e me humanizëm vazhdimësia e jetës.

I neveritur nga dukuritë negative shoqërore, Spasse ngrit zërin kundër martesave të bazuara në interesin material. Njëherit paraqitet edhe si mbrojtës i gruas, me kërkesë të qartë për emancipimin e gjithanshëm të saj. Me bindje të thellë pohon: „Po marr shpatën e drejtësisë në dorë, dhe po çpall kryengritje femërore, martese dhe po thërras me fuqinë time njerëzore: — Zgjo-u o vashë qytetare, se burri që pyet më parë për prikën tënde, ay nuk është për ty... Vepro, pra, o femër qytetare, se është koha t'i përbuzësh nderimet hipokrite të burrit. Është koha që të bëhesh nënë e pastër, shoqe e mbaruar, e zonjë dhe e lirë në punët tua. Zgjidh për shoq të jetës një të zotët, një burrë të vërtetë... një njeri". Romani, siç shihet, në një aspekt është edhe protestë e fuqishme ndaj gjendjes së atëhershme të gruas. Në disa faqe të veprës autori shpreh pikëpamjet e tij se dalja nga kjo gjendje e vështirë është e vetmja rrugë shpëtimi për shoqërinë shqiptare.

Me rastin e botimit të romanit „Pse?!..." në shtypin e atëhershëm pasuan shumë reagime nga ana e kritikëve dhe e lexuesve. Sa shprehej gëzimi se lexuesve u ra në dorë edhe një roman origjinal në gjuhën shqipe, aq më tepër shfaqej dëshprimi e shtrohej edhe pyetja: pse të botohej një vepër e tillë me të cilën përhapeshin pikëpamjet pesimiste të shekullit. Vepra konsiderohej shumë e dëmshme për rininë. Në kohën kur arsimi, edukimi dhe emancipimi i gruas ishte ndër problemet më akute shoqërore, në roman femra degradohej si qenie dhe paraqitej krijesë e dobët dhe e përbuzur. Shkrimtarit i drejtoheshin edhe mjaft letra protestuese. Në revistën „Diana" një vajzë i shkruante këtë letër të hapur: „....Pastaj pse jeni aq zemërgurë kundrejt femravet? Pse duke na

mbrojtur aq bukur aty-këtu nga nderimet hipokrite të burrit dhe na urreni aq fortë për natyrën tonë?... Pra, ja juve na urreni... Nuk ju mohojmë zotësinë tuaj letrare, as stilin tuaj maxhik dhe as luftën e rept që u kini hapur hipokrizisë, qytetërimit të sipërfaqshëm, zakoneve të dobëta! Nga penda tuaj e hollë presim vepra të reja që ta lartësojnë femrën shqiptare dhe atëherë të jeni të sigurtë se lulet e mirënjohjes edhe nga ana e seksit të dobët do t'i keni mbi krye".

Të gjitha këto rrethana si edhe disa faktorë të tjerë, për të cilët do të japim sqarime plotësuese, e bindën autorin e ramanit „Pse?!..." që në krijimtarinë letrare mos ta vazhdojë më rrugën që kishte ndjekur më parë. Për ta rehabilituar vetveten duhej zgjedhur një rrugë të re. Ai vetëm pas vitit 1936, kur lexoi Gorkin, erdhi në përfundim se në veprën letrare ishte e domosdoshme të shprehet optimizmi jetësor. „Nëna" e Gorkit i shërbei në këtë kohë si model i veprës letrare optimiste, ajo e entuziasmoi aq shumë sa, tri vjet më vonë do ta shkruajë romanin në të cilin do të dominojë fryma optimiste. Romani i Gorkit mbeti vepra më e adhuruar e tij, ndërsa nëna heroinë shembëlltyra e nënës, që në luftën për liri dhe barazi shoqërore, e njëherit edhe për marrëdhënie të reja në shoqëri, sekrifikon edhe jetën.

VI.

VIZIONI OPTIMIST JETËSOR NË LETËRSI

Faza e dytë e veprimtarisë letrare të Sterjo Spasses përfshin krijimet artistike të periudhës kohore 1936-1944. Autori thellohet gjithnjë e më tepër në trajtimin e temave shoqërore në letërsi. Edhe gjithë letërsinë shqiptare të viteve '30 e karakterizon tendenca për një ngjyrosje më të qartë sociale. Një dukuri të tillë, përveç të tjerash, e kanë kushtëzuar rrethanat ekonomike, shoqërore dhe politike. Prapambetja e përgjithshme e shoqërisë shqiptare, shtimi i kontradiktave antagoniste klasore në kuadër të atij sistemi të vjetruar, i cili nuk i përgjigjej më kohës, marrëdhëniet e vjetruara në familjen patriarkale në katund dhe qytet, shtypja dhe shfrytëzimi feudaloborgjez, gjendja shumë e vështirë e vegjëlisë etj. Të gjithë këta faktorë, si dhe zgjimi i vetëdijes sociale, i cili vërehet në këto vite si rezultat i ndikimit të ideve progresive dhe socialiste, nxitnin shkrimtarët përparimtarë që, jo vetëm të përqafonin një orientim të ri në letërsi, por të merrnin qëndrim të caktuar lidhur me problemet aktuale shoqërore.

Boris Ziherli duke bërë fjalë për krijimtarinë artistike dhe kushtëzimin e saj nga klima e përgjithshme shoqërore mendonte se: „...tiparet e krijimtarisë artistike të secilës epokë përherë janë të lidhura ngushë... me atë disponim shoqëror i cili shprehet në të. Ndërsa disponimi shoqëror i secilës epokë

përherë është i kushtëzuar prej marrëdhënieve të cilat i përgjigjen asaj epoke. Këtë shumë bukur e tregon tërë historia e artit dhe e letërsisë[32]. Në gjithë prozën tregimtare dhe në romanin e dytë të Spasses gjithsesi është e dukshme kjo lidhje kauzale dhe është gjithnjë më e fortë në veprimtarinë e mëvonshme.

Që nga viti 1936 Spasse filloi të shkruajë romanin „Afërdita". Në të njëjtën kohë merrej me çështje të letërsisë, me gjuhësi, me probleme të pedagogjisë dhe të arsimit, shkruante artikuj të ndryshëm polemikë. Veçanërisht shquhet proza tregimtare alegorike dhe ajo me tematikë sociale. Përshtypje të paharruar i kishte lënë edhe vepra e Migjenit edhe pse, siç pohon vetë, poetin e mjerimit s'kishte pasur mundësi ta njihte personalisht, por „të falat dhe përshtypjet e shkrimeve të njeri tjetrit" i kishin shkëmbyer herë pas here. Shumica e brezit të tridhjetës ishin afirmuar si poetë dhe prozatorë dhe Spasse, në masë të konsideruar, arrinte të njihej me kontributin letrar të tyre. Aspiratë e përbashkët e këtij brezi ishte që të venin në shërbim të popullit gjithë veprimtarinë letrare dhe të punonin me ngulm për emancipimin e përgjithshëm të shtresave të varfëra nga të cilat vinin edhe vetë.

Përveç tregimeve „Fati i Mitit", „Babaj", etj., Spasse shkroi edhe novelat e trilogjisë „Nusja pa duvak" të cilat konsiderohen ndër krijimet e realizuara mirë artistikisht në këtë fazë të krijimtarisë letrare. Ai reagon ashpër kundër zakoneve të prapambetura të jetës patriarkale, kundër martesave të kurdisura artificialisht në saje të disa kodeve të Kanunit në Malësi. Me rastin e botimit të novelës së parë „Nusja pa duvak" në „Shkëndija" të vitit 1941, është dhënë edhe ky shënim i Redaksisë: „Në disa vende

[32] Boris Ziherl, Književnost i društvo II, Sarajevë, 1958, f. 87.

të Matit ka qenë ky zakon: po t'ishin p.sh. në një shtëpi tre vëllezër e qëllonte që vdiste ndonjë nga ata më të vegjlit, atëherë të renë e tij e mirrte për grua i biri i vëllajt të madh, por duke pasur të drejtë të martohej më vonë edhe me një tjetër. Rreth këtij zakoni të rrallë Sterjo Spasse zhvillon novelën e tij".

Sa dëshpërim të madh shkaktoi vendimi i Ymer Agajt për ta martuar kunatën e vejë dyzetvjeçare, Zejnepenë, për të birin e tij, Ahmetin, i cili ishte vetëm njëzetvjeçar. Gruaja e shtyrë në moshë dhe të cilën Ahmeti e quante nënë, nuk i bën ballë këtij dëshpërimi të madh. Prandaj rrëke lotësh i shkojnë për faqesh. Në anën tjetër, të gjitha ëndërrimet e të riut, që kishte pritur me padurim të martohej me Merushen e bukur dhe të dashur, nuk realizohen dhe kështu shkatojnë dëshpërimin e papërmbajtur.

Me realizëm të fuqishëm në këtë prozë është portretizuar figura e Hoxhë Efendiut. Me formulën e tij karakteristike të klerikut „Zoti është i madh" ai lejonte një martesë të atillë të pakuptimtë që nuk garantonte kurrfarë lumturie jetësore.

Pjesa tjetër e trilogjisë, „Shemra", është karakteristike për krijimtarinë e Spasses. Tehu i kritikës shoqërore bëhet gjithnjë e më i mprehtë. Autori ishte i preokupuar përsëri me problemin e martesës. Veli Basha, një pasanik i degjeneruar moralisht, pasi kishte kaluar të pesëdhjetat, dëshiron të martohet me Merushen shtatëmbëdhjetëvjeçare, sepse sipas mendjes së plakut, duhej gjetur një grua prej oxhakut. Në këtë novelë edhe kësaj here, me ashpërsi, luftohen zakonet e mykura të jetës shqiptare të kohës. Në mënyrë të posaçme autori është përpjekur të pasqyrojë rrethanat e jetës sociale dhe në kuadër të tyre aspiratat e plakut që të realizojë me çdo kusht qëllimet e veta, pa u bazuar në normat morale të cilat me çdo kusht duhej të respektoheshin.

Mbresa të pashlyera na lë edhe pjesa e tretë e trilogjisë me titullin „Nusja". Rebiu, një i ri i padjallëzuar, ditën e dasmës, me padurim e pret shoqen e jetës, të cilën nuk e kishte parë kurrë më parë. Ai kishte shpresuar se fati do t'i ketë caktuar një nuse e cila me të vërtetë do t'i pëlqente atij. Por, në ditën e lumturisë e befasoi nusja e verbuar, e cila jo vetëm që e tronditi të riun por edhe tërë familjen. Duke u gjetur midis dy zjarresh përcëlluese: fatit të tij cub dhe kanunit fuqiplotë, i cili i mbante të gjalla normat morale dhe marrëdhëniet e tjera të familjes konservative, i kumbonin në vesh fjalët e prindit, Gani Agajt: „Mendo-e mirë nderën e oxhakut dhe gjakun para se të vendosish. Ky është fati i yt"[33].

Spasse në këtë kohë kishte korrigjuar pikëpamjet e veta lidhur me jetën shoqërore dhe kjo konsiderohet ndër meritat kryesore të shkrimtarit. Ky hap shumë pozitiv u duk posaçërisht në fragmentet e para të romanit „Afërdita", të botuara në gazetat dhe revistat e kohës që nga marsi i vitit 1939, të cilat zgjuan interesim të madh ndër lexuesit. Më 1944 vepra u botua në tërësi dhe që prej atëherë pati shumë ribotime. Edhe sot e kësaj dite, vepra konsiderohet ndër romanet më të lexuar në letërsinë shqiptare. Romani është „nji prej atyne veprave të letërsisë shqipe — shkruan një kritik letrar — që na ngazllejnë në nji mënyrë të posaçme, kryesisht me idenë e bukur dhe kuptimplote, funksionale në çdo pikëpamje, e mandej edhe me shumë elemente tjera që e shprehin dhe e nxjerrin në dritë këtë ide, me soditjen graduale dhe inventive t'asaj që duhet transformue artistikisht, që duhet thurrë për t'u krijue nji atmosferë përkatëse, me zhvillimin gradual dhe të bukur të tezës kryesore"[34].

---

[33] Sterjo Spasse, Nusja pa duvak, Tiranë, 1944, f. 32.
[34] Hasan Mekuli, Sterjo Spasse: „Afërdita", „Jeta e re", Prishtinë, 1965, nr. 3. f. 418.

Spasse kur filloi ta shkruajë „Afërditën" ishte mësues i fshatit. Problemet e arsimit të shkollës shqiptare i njihte mirë. Ai aktivisht, qoftë nëpërmjet të punës së drejtpërdrejtë arsimore ose duke shkruar artikuj të ndryshëm me përmbajtje pedagogjike, përhapte pikëpamje të avansuara të kohës. Rrethanat e vështira jetësore të fshatarëve dhe arsimi i dobët i tyre, sa e kishte shqetësuar mësuesin e ri, aq e kishte shtyrë të reagojë ndaj kësaj gjendjeje. Nga një regjistrim që kishte bërë ai vetë kuptojmë se në fshat vetëm i rralli dinte shkrim e lexim. Intelektualit dhe mësuesit Sterjo Spasse posaçërisht të shqetësuar edhe nga kjo statistikë, i lind ideja që në veprën letrare të trajtojë një temë shoqërore shumë aktuale për shoqërinë shqiptare: procesin e arsimit dhe të edukimit të masave fshatare. Kjo njëherit ishte problematikë e afërt dhe e njohur mirë nga shkrimtari, i cili, pasi i kishte shpëtuar stuhisë së filozofisë reaksionare e pesimiste, kishte braktisur edhe pikëpamjet e kufizuara përkitazi me jetën dhe shoqërinë. Autori pas të gjitha këtyre përqafon optimizmin jetësor. Për këtë arsye në romanin e tij të ri nuk është e pranishme ajo mjegulla e dendur e pesimizmit e cila qe e ndieshme në veprën e mëparshme letrare. Duke idealizuar figurën e heroinës kryesore dhe duke e konsideruar atë bartëse të gjithçkafes që është progresive, arriti të entuziazmojë lexuesit me sukseset e mrekullueshme të mësueses së re. Spasse tani nëpërmjet të veprës letrare shpreh mendimin se arsimi është faktori kryesor për transformimin progresiv të shoqërisë shqiptare. Kjo ide i shërben njëherit si bazë stabile mbi të cilën vendoset tërë subjekti i romanit. Në këtë mes nuk merr në konsiderim edhe faktorët e tjerë gjithashtu të rëndësishëm, të cilët luajnë rol vendimtar në zhvillimin e gjithmbarshëm të shoqërisë. Autori është i angazhuar maksimalisht për sendërtimin e idesë themelore të romanit. Besimin më të

madh e ka në motrat dhe vëllezërit arsimtarë, të cilëve edhe ua kushton veprën si „Kunorë adhurimi e mirënjohjeje".

Misionin e arsimit të masave, të cilin ai e çmon si faktor më të rëndësishëm në shoqëri, ia beson brezit të ri të intelektualëve që përfaqësohet me vajzën e re, Afërditën. Ajo ishte bijë e një familjeje të varfër qytetare dhe qysh në fëmijëri, bashkë me prindërit, kishte kaluar jetën në varfëri. Ditët e bukura shkollore i kishin lënë kujtime të pashlyeshme në kujtesën e saj. Me fantazi të vrullshme, sa ishte nxënëse e re, thurte ëndrra të mrekullueshme për jetën e ardhshme. Shpresonte se, posa ta kryente shkollën, jo vetëm që vetvetes do t'i siguronte një jetë të lumtur, por do t'u ndihmonte edhe prindërve të cilët kalonin ditët e vështira të pleqërisë.

Pas përfundimit të shkollës valët e jetës e kishin fërfëlluar mësuesen e re larg çerdhes familjare dhe larg Korçës që aq shumë e donte, e kishin ndarë prej shoqeve me të cilat kishte kaluar çaste shumë të bukura të jetës. Ministria e Arsimit e kishte emruar mësuese në një fshat shumë të prapambetur, në Grykas. Romani fillon me përshkrimin e udhëtimit të mundimshëm të Afërditës drejt fshatit, i cili „kado i dilte i shëmtuar, i lënë në mëshirë të zotit dhe dora e njeriut s'kishte lojtur nga vendi as një gurë".

Që nga ditët e para të punës mësuesja e re dhe pa përvojë të duhur kupton se jeta në atë rreth fshatarësh nuk do të jetë aspak e lehtë. Ajo në një farë mase demoralizohet dhe pohon: „Unë e lindur nga prindë të mjeruar, sigurisht do të mbaroj keq e më keq! Mjerimet sjellin mjerime!"

Shkrimtari me invencion ka shtruar para heroinës së vet dilemat e shumta jetësore dhe është përpjekur, në pajtim me pikëpamjet e veta, të gjejë zgjidhjen e tyre. Në linjën kryesore të romanit për këtë arsye synon të vendos aktivitetin e mësueses në fshat dhe jetën e vështirë të fshatarëve. Në këtë mënyrë je-

pet pasqyra më e gjerë e problematikës së arsimit dhe të edukimit në shoqërinë shqiptare të asaj kohe. Në atë rreth shoqëror të zymtë, ku zotëronin marrëdhënie shoqërore feudale-borgjeze, kur rrezet e arsimit dhe të kulturës depërtonin me vështirësi, ishte shumë rëndë të triumfojë kush si mësuesja e idealizuar e Spasses. Në rrugën e përpjekjeve të Afërditës paraqiten kundërthënie të shumta. Meqë jetonte dhe veproonte në fshatin ku e kaluara e vështirë kishte lënë gjurmë të pashlyeshme në ndërgjegjen e fshatarëve, çdo hap i mësueses në fillim kuptohej keq dhe kishte si pasojë reaksionin sidomos të shtresës shoqërore të privilegjuar në fshat, që ishte e lidhur këmbë e krye me qeveritarët ryshfetxhinj të Prefekturës. Që nga fillimi Afërditës njëra pas tjetrës po i mblidhnin grushtet: „...Kryeplaku ironizonte, Inspektori kërcënohej, Komisioni shkollor hidhte shkelma". Ajo bënte përpjekje për zgjidhjen e problemeve të fshatarësisë dhe, duke sakrifikuar kështu edhe gjithçka nga jeta personale më parë synonte zgjidhjen e çështjeve me karakter shoqëror dhe të përgjithshëm.

Figura e ndritur e Afërditës në roman është e pranishme që nga faqja e parë e deri në atë të fundit. Mbas disa vjetësh pune vetëmohuese, së bashku me fshatarët, në Kodrën e diturisë ndërton shkollën e re. Aty do të mësonin fëmijët e dy fshatrave të cilët, para se të vinte Afërdita, kishin qenë në hakmarrje të përgjakshme. Aty organizohet për mrekulli edhe martesa e Afërditës me Lekën. Dasma ishte gëzim i madh edhe për fshatarët, të cilët më në fund me pjesëmarrje masive kishin kaluar në anën e Afërditës, duke i dhënë krahë asaj në luftën e vendosur kundër prapambeturisë dhe mykut shekullor.

Në këtë roman janë të pranishme dy linja të paraqitjes së jetës: ajo realiste, nëpërmjet të së cilës është trajtuar jeta dhe marrëdhëniet në fshat, dhe ajo romantike, në të cilën i është dhënë hapësirë më e madhe idealizimit të figurës së Afërditës. Megjitha-

të, këto dy prirje gërshetohen dhe si të tilla kushtëzojnë sendërtimin e idesë themelore të veprës letrare. Autori nuk është angazhuar aq shumë për të transponuar realitetin e jetës shqiptare të kohës në totalitetin e saj, sepse me çdo kusht është përpjekur të realizojë idenë themelore të projektuar më parë. Prej këndej, ai edhe nuk ka arritur të na thotë diçka më tepër dhe në masën e duhur lidhur me vlimet sociale dhe kundërthëniet klasore. Duke mos bërë diferencimet klasore, nuk ngrit konflikte të ashpra të natyrës shoqëror, të cilat karakterizojnë shoqërinë me klasa antagoniste. Kritikën shoqërore nuk e drejton kundër sistemit dominues dhe aparatit shtetëror, por e kufizon si kritikë kundër konservativizmit dhe sistemit të arsimit dhe të edukimit. Figura e Afërditës, e cila përfaqëson brezin e ri të arsimtarëve përparimtarë, është idealizuar duke u dhënë pa asnjë të metë. Kjo padyshim është meritë e madhe e autorit, i cili ka pasur aftësi ta realizojë në veprën letrare figurën e një mësueseje aq të dashur. Megjithatë ajo nuk mund të ishte si mësuese tipike për realitetin e shoqërisë shqiptare të asaj kohe, po vetëm mund të dëshirohej si e tillë. Spasse me romanin e vet ka synuar të verë në dukje se arsimit dhe edukimit të deriatëhershëm jo vetëm që i kishte kaluar koha, por si i tillë ishte bërë pengesë e madhe për përparimin e mëtejshëm të shoqërisë shqiptare. Për sistemin e arsimit, mendonte ai, janë të domosdoshme ndërrime rrënjësore. Arsimi i ri, sipas tij, kërkon njerëz të rinj me botëkuptime të reja përparimtare dhe metoda të reja pune. Në Grykas dhe në fshatrat e tjera të prapambetura, të cilat i përshkruan në roman, shkollat ekzistonin vetëm sa për sy e faqe. Për shkollën e vjetër të Grykasit, ku filloi punën edhe Afërdita, në faqet e romanit është dhënë ky përshkrim: „Shkolla e fshatit është e mbuluar me thekrishte, me dy dritare, si vrima hambari, me një derë t'unjtër si derë koteci, e ngrehur gjysmë mbi murë e gjysmë mbi garth. Oren-

ditë janë shtatë banga të ndrequra si mos më keq... Katër shufra thane e xhunga-xhunga të vënë n'atë kamare simbolizojnë disiplinën e njëhershme shkollore". Mësuesi i brezit të vjetër, siç ishte ai i Grykasit, zoti Remko, jo vetëm që gjatë punës nuk kishte arritur ta shpiente përpara procesin e emancipimit dhe të transformimit pozitiv në fshat, por edhe vetë kishte rënë në nivelin e fshatarëve të paarsimuar. Mësuesi në procesin e mësimit përdorte „...metodën e vet: një shufër të gjatë thane e xhunga-xhunga e mbante si të vetmin ndihmës të tij pedagogjik. Edhe shuplaka e fortë ishte një mjet tjetër nxitës. Bota mendore për zoti Remkon kishte kaluar kufijt e përsosmënisë" Si personazh i veprës letrare figura e Remkos është paraqitur me realizëm të fuqishëm. Ai përfaqësonte njeriun e pagëdhendur, mësuesin pa takt pedagogjik dhe të degjeneruar, që i përkiste gjeneratës së vjetër të arsimtarëve. Me punën e vet pengonte zhvillimin e arsimit edhe ashtu në nivel të ulët. Si mësues me qëndrim të ashpër dhe arogant kishte futur frigën te vocrrakët e pafajshëm. Në atë jetë anemike të fshatarësisë së varfër mësuesi Remko përfaqësonte edhe një parazit tjetër që jetonte në kurriz të shtresave të shtypura të vegjlisë.

Ryshfetet që u jepeshin nëpunësve e gjindarmëve dhe detyrimet e tjera ndaj organeve të administratës shtetërore kishin kushtëzuar lindjen e pasigurisë dhe të frikës te fshatarët ndaj njerëzve të huaj, e sidomos ndaj njerëzve të qytetit. Prandaj, në fillim fshatarët kishin të njëjtin qëndrim dhe njëfarë urrejtje ndaj „daskalicës" së tyre të parë. Spasse dëshiron të theksojë me këtë rast një moment të rëndësishëm dhe karakteristik të psikologjisë së fshatarit të shfrytëzuar pa mëshirë.

Siç mund të shihet në roman janë dhënë dy shtresa shoqërore ku secila prej tyre ka botën e vet specifike. Fshatarët dhe qytetarët qeveritarë ishin në kun-

dërshtim të përhershëm ndërmjet veti. Gjendja e fshatarëve dhe e shtresave të varfëra qytetare ishte shumë e vështirë, prandaj krejt e natyrshme është edhe paraqitja e rezistencës së tyre ndaj një pozite të tillë. Megjithatë, kjo rezistencë nuk ishte e organizuar mirë.

Në roman i është lënë hapësirë e madhe paraqitjes së natyrës, bukurisë por edhe të vrazhdësisë së saj, dhe në atë natyrë karakteristike të jetës shqiptare autori ka synuar ta përshkruajë jetën e fshatit me të gjitha baticat dhe zbaticat. Mjafton të kujtojmë përshkrimin që bën shkrimtari për qiraxhiun fshatar, i cili e sjell Afërditën në Grykas: „Qiraxhiu që dukej aq i çuditshëm nga qyteti e nga fusha, tani i përshtatej natyrës së këtyre vendeve. Nëpër këto kthepa veç opingave të tija vrima-vrima, nuk mund të shkelte këpucë qytetari, sidomos taket e qytetarkavet. Rrobja e shajakët e qiraxhiut shpeshherë rrëmbehej nga ferrat e nga shkarpat, por nuk këputej. Vetëm tani Afërdita filloi të kuptojë se pse e kishte udhëheqësi i saj atë mjekërr të parruar, ato këmbë të mëdha e të mbadhuna me opinga vrima-vrima, atë veshje të shajakët e t'arnuar që më që dhe ato duar të mëdha, të zeza dhe plasa-plasa. Ashpërsia e vendit e bënte t'ashpër çdo njeri: qiraxhiu ishte tipi i gjallë i kësaj natyre kaq t'egër..."

Fshatarët e Grykasit jetonin në natyrën e ashpër e cila lente gjurmë të pashlyeshme në formimin e tyre. Në roman kemi tablo të shumta të jetës së vështirë të këtyre fshatarëve. Në shumicën e vatrave të tyre, varfëria ishte e pranishme përherë. Marrëdhëniet e vjetruara patriarkale dhe bestytnitë e dëmshme, myku shekullor si edhe shkalla e ulët e arsimit, s'i lente të mëkëmben dhe të dalin nga ajo gjendje e mjerueshme. Duke gjallëruar në oaza jetësore, larg qendrave pak më të zhvilluara dhe larg çdo ndikimi pozitiv të kulturës së kohës, meqë kujdesi i qeverisë së

atëhershme për jetën e vegjëlisë mungonte fare, ata nuk kishin mundësi të çajnë rrugën drejt përparimit shoqëror.

Ndër figurat më të realizuara artistikisht nga rrethi i fshatarëve mund të veçohen: Kryeplaku, Xha Vasili etj. Nga personazhet më të plotë të grave janë dhënë Teto Kata, Vita, Drita etj. E ëma e Afërditës, edhe pse ka ekzistuar mundësia të tipizohej më mirë dhe të ndriçohej figura kaq e dashur e kësaj nëne shqiptare, ka mbetur personazh epizodik mjaft i zbehtë. Përkundër kësaj, është tipizuar fuqishëm Teto Kata magjistare. Ajo konsiderohet ndër personazhet më të realizuara në roman pas Afërditës. Magjistarja, përfaqësuese e brezit të vjetër në fshat, që kishte marrë në sy një orientim të gabuar në jetë, me mish e me shpirt mundohet të kundërshtojë depërtimin e së resë. Afërdita i ishte bërë therrë në sy, prandaj pa zgjedhur mjete, mundohej ta paraqesë si shumë të rrezikshme në fshat. E zhytur deri në fyt në bestytnitë e mbrapshta, kurdoherë gjendej në „shërbimet" e magjistares.

Spasse, si edhe në veprat e mëparshme letrare, përqafon parimet e realizimit kritik dhe lufton dukuritë negative në shoqërinë shqiptare të kohës. Në këtë roman social të tij e ashpërson këtë kritikë deri në një shkallë të caktuar.

Në kohën kur shkrimtari shkroi romanin „Afërdita", anë e mbanë Shqipërisë, sidomos nëpër qytetet më të zhvilluara, ekzistonte një shtresë e formuar intelektualësh dhe sidomos arsimtarësh përparimtarë. Nga romani kuptojmë se arsimi në qytet kishte përparuar dukshëm në krahasim me gjendjen nëpër fshatra dhe në qendra më pak të zhvilluara. Arsimtarët përparimtarë të kohës, varësisht nga rrethanat në të cilat gjindeshin, punonin me zell për ngritjen e të gjitha shtresave shoqërore. Punë vetëmohuese në arsim kishte bërë dhe bënte atëherë edhe Sterjo Spasse. Por, sipas tij, fshati

kishte mbetur larg sferës së aktivitetit të tyre. Prandaj, në romanin e vet shpreh mendimin se, për ngritjen edhe të fshatarëve është e domosdoshme që të gjitha forcat progresive të kthehen me sy kah fshati. Sidomos rol të madh duhej të luanin arsimtarët. Për këtë arsye shkrimtari pohon: „Arsimtari në fshat është mësues i fëmijëve dhe i popullit... ay është avokat, mjek, gjykatës, agronom e ballsam i brengavet të përditshme të fshatarit. Vetëm mësuesi si një pishtar i vërtetë do t'u ndriçojë rrugën fshatarëve drejt përmirësimit të jetës, drejt çdukjes së zakoneve të këqija dhe drejt jetës së re".

Më tutje ai shfaq bindjen se kontributi i arsimtarëve, e sidomos i atyre të qytetit, për ngritjen dhe arsimin e fshatarësisë kishte rëndësi të jashtëzakonshme dhe vetëm në këtë mënyrë mund të arrihej zhvillimi i gjithmbarshëm i shoqërisë në tërësi. Për këtë arsye si kryeprotagoniste të veprës e zgjedh një mesuese të shkëlqyer të qytetit, e cila, në saje të mbështetjes që gjet te motrat dhe vëllezërit e tjerë arsimtarë të vendit, arriti të bëhet shembëlltyrë e arsimtares më të përparuar. Në raportin që kishte përgatitur „Lëvizja e Re Arsimore" për t'ia dërguar Zotit Inspektor dhe Ministrisë së Arsimit shkruhej: „...Zonjusha Afërdita Skënderaj është një mësuese ideale. Ajo është një mburje e një nderë për arsimin tonë. Çdo fjalë sado e qëlluar qoftë është e pafuqishme për të lavduar veprat e saja të shkëlqyeshme të kryera në shkollë e në gjirin e fshatarëve. Shkolla e saj është shembull pune, shembëll metode, shembëll rregulli. Është shkolla që na duhet...". Përmbajtja e kësaj pjese të tekstit është në të vërtetë një fragment i letrës të cilën Spasse ia kishte dërguar bashkë me romanin „Afërdita" Aleksandër Xhuvanit.

Duke u kurorëzuar me sukses puna e mrekullueshme e Afërditës, kritikohet sistemi i vjetër arsimor dhe afirmohet arsimi i ri. Në mënyrë të veçantë akuzohet Zoti Inspektor, i cili, jo vetëm që nuk kishte

ndihmuar për mirëvajtjen e punës së mësueses, por i kishte hedhur në rrugën e saj pengesa të pakapërcyeshme. Dënimet, inspektimet dhe masat e tjera që kishte ndërmarrë ndaj saj, bashkë me qëndrimin nënçmues që e kishte shfaqur haptazi, kishin qenë hapa të gabueshëm dhe të dëmshëm në punën e tij si inspektor i arsimit. Ai ngjashëm kishte vepruar edhe me shumë arsimtarë të tjerë dhe vetëm atëherë kur kishte arritur të kuptojë se veprimtaria e tij kishte qenë shumë e dëmshme, i tronditur thellë, shkruan dorëheqjen, duke e konsideruar veten të paaftë për punën që bënte. Me këtë veprim të inspektorit Spasse do ta paraqesë edhe paaftësinë e nëpunësve qeveritarë në kohën e sundimit të Zogut dhe degjenerimin moral të tyre. Në anën tjetër kritikohen rreptë edhe disa intelektualë të tjerë, arsimtarë të plogësht e reaksionarë, që në roman përfaqësohen nëpërmjet të Gjokës, mësuesit të dikurshëm të Afërditës dhe Cufit. Me këto dy personazhe letrare, edhe pse epizodike, autori na jep dy gjenerata të arsimtarëve. Brezin e vjetër në roman e përfaqëson një mësues i shtyrë në moshë. Ai kishte kryer qe sa vjet misionin e rëndësishëm arsimor, por nuk ishte edhe më tutje energjik të hyjë në vallen e kohës së re, ku shtroheshin kërkesa të reja revolucionare. Në anën tjetër, Cufi i takonte brezit të ri të arsimtarëve, por në roman paraqet arsimtarin i cili nuk përfillte përpjekjet e arsimtarëve të rinj për një transformim më të shpejtë shoqëror. Me qëndrimet e tij destruktive, të një mësuesi të paformuar dhe llafazan, ai më tepër është paraqitur si personazh negativ. Si antipode është dhënë figura e ndritshme e mësuesit përparimtar, Ylli, i cili shumë lehtë ka mundur të merret si kryepersonazh i kësaj vepre të suksesshme të Spasses. Autori zgjodhi si heroinë të romanit një femër të cilës, në një formë të natyrshme, ia besoi misionin shumë të lartë shoqëror; ajo do të depërtojë më lehtë edhe në botën femërore të fshatit shqiptar dhe do të ndihmojë përmirësimin e pozitës

së gruas në shoqëri. Prej këndej, Afërdita nuk është paraqitur si figurë e cila do të ishte tipike për realitetin shqiptar të asaj kohe, por është idealizuar në saje të imagjinatës krijuese të shkrimtarit.

Sterjo kishte parë edhe vetë se pozita e gruas në familjen dhe në shoqëri përgjithësisht ishte shumë e vështirë. Sidomos në fshat, gruaja ishte e ngarkuar me punë shumë të rënda edhe jashë shtëpisë. Barrtja e shkarpave për gruan ishte punë shumë e rëndë. Autori jep kushtrimin: „... litari duhet të çduket për femrën... nuk durohet më skllavëria e litarit... Poshtë skllavëria! Në zjarr — litarët". Këtu ai shprehet për një liri dhe ngritje të gjithanshme të gruas, për emancipimin e saj në shoqëri.

Kah fundi i romanit, kur ideja themelore e veprës sendërtohet në mënyrë të plotë, autori shpreh mendimin se duhet të ekzistojë bashkëpunimi i ngushtë dhe i përhershëm ndërmjet arsimtarëve përparimtarë. Prandaj, triumfi i Afërditës në Grykas e në Pishas dhe mrekullitë e saj në punën arsimore-edukative, kontributi që dha për zgjimin e gruas shqiptare, paraqitet edhe si fitore e tërë arsimit të ri shqiptar që duhej të hapte shtigje të reja. Ky fakt entuziazmon lexuesin e romanit „Afërdita" dhe e angazhon maksimalisht të kalojë në anën e progresit, për lulëzimin e përgjithshëm të shoqërisë.

VII.

ASPEKTE TË ROMANIT SOCIAL

Gjatë fazës së tretë të krijimtarisë letrare Spasse krijoi më shumë vepra, kryesisht romane. Bëri edhe një hap të madh cilësor, duke shënuar nivel të ri sidomos në zhvillimin e prozës. Pas Luftës Nacionalçlirimtare dhe më vonë, veçanërisht gjatë viteve gjashtëdhjetë dhe shtatëdhjetë, në aspektin tematik, por edhe në aspektin e realizimit të vlerave të larta ideo-estetike, dha kontribut të rëndësishëm në pasurimin dhe në lulëzimin e romanit. Në këtë mënyrë ndikoi fuqishëm që gjithë letërsia shqiptare të hyjë në fazën më të lartë të pjekurisë artistike dhe të konsolidimit të saj të mëtejshëm.

Fragmentet e romanit të parë të pasluftës me titullin „Ata nuk ishin vetëm", filluan të botohen që nga janari i vitit 1949 në revistat letrare të kohës. Nga një shënim i dhënë në revistën „Literatura jonë" mësojmë se vepra më parë kishte titullin „Harbutët". Po aty botohej fragmenti „Bereqeti i fshatarëve" dhe ky shënim i redaksisë: „... kjo pjesë është marrë nga dorëshkrimi „Harbutët", roman nga Sterjo Spasse. Në këtë roman përshkruhen vuajtjet e fshatarit e të punëtorit shqiptar nga bejlerët, nga qahallarët, nga tregtarët, nga nëpunësit, kryetari i komunës, post-komandanti, xhandari, taksidari, e nga tërë kompleksi i regjimit feudalo-borgjez të Zogut. Këtu vihej në dukje degjenerimi i klasës së bejlerëve, dekompozimi i re-

gjimit po njëkohësisht edhe rezistenca e punëtorëve dhe e fshatarëve të frymëzuar nga mendimet progresiste të Ali Kelmendit, që është një ndër protagonistët e romanit. Ngjarjet zhvillohen në Korçë dhe në një fshat të saj"[35].

Me këtë vepër Spasse zgjoi interesimin e lexuesve dhe tërhoq vëmendjen e kritikës letrare. Meqë romani ishte i përshkruar nga ndjenjat revolucionare të luftës për çlirimin social të shtresave të shtypura, me shumë elemente të trajtimit të temës, të tipizimit të personazheve dhe më në fund të realizimit të idesë themelore, ndikoi në zhvillimin e letërsisë realiste.

Ideja për të shkruar një vepër ku do të paraqitej me realizëm të theksuar jeta e fshatarësisë së varfër dhe lufta për çlirim nga shfrytëzimi i egër feudalo-borgjez autorit i kishte lindur mjaft heret, në fillim të viteve tridhjetë, kur pa me sy tragjedinë jetësore të goricarëve. Atëherë shkrimtari nuk kishte zotëruar mjeshtrinë e shtjellimit artistik të ngjarjeve aq komplekse të asaj periudhe historike e shoqërore dhe të kundërthënieve të ashpërsuara klasore. Iu deshën edhe disa vite për të formuar një botëkuptim më të avancuar, për të arritur, më në fund, që në veprën e vet, duke shfaqur pikëpamje më të qarta dhe të pranueshme lidhur me transformimin progresiv të shoqërisë. Në këtë vepër kaq të rëndësishme të letërsisë sonë jo vetëm që arrin të kuptojë vetë rrugën e çlirimit të fshatarësisë dhe të qytetarëve të varfër, por njëherit jep edhe kushtrimin që vegjëlia të çohet në luftë të rreptë kundër shfrytëzuesve dhe shtypësve shekullorë: „Mjaft nën shkllavërinë e tij! I bëjmë temenara si kafshët, si skllevërit! Na ka mbrehur si qetë: na rrëmben kafshorën e gojës, na merr nderin, na pin gjakun kurdoherë, kurse na e presim dhe e përcjellim me peçe e me hejvalla! Ai na rrah, ai na shtyp, kurse na e

[35] „Literatura jonë", Tiranë, 1949, nr. 7.

përkëdhelim. S'kemi kujt t'i ankohemi për këto të zeza. Të gjithë hajdutët me çizme janë nëpër punërat e qeverisë. Na e pamë me sy hatanë që pësuan Goricarët. Flakën njëmijë vetë nga shtëpitë e tyre, nga toka e tyre e punuar denbabaden, me djersën e me gjakun e tyre, për hatrin e një beu! Ja, kjo është qeveria! Ajo mbahet me bejlerë dhe është e bejlerëve! Hajduti hajdutin mbron, jo njerëzit e ndershëm, jo fukaranë si ne! Prandaj të mos presim shpëtim as nga Zoti, as nga qeveria. Të drejtat tona duhet t'i ruajmë ne vetë me duart tona, me djersën tonë, me gjakun tonë"![36].

Romani „Ata nuk ishin vetëm" u botua në tërësi më 1952. Spasse me këtë krijim letrar romanesk entuziazmoi edhe një herë aq shumë lexuesit sa, siç shkruan Fatmir Gjata, „...vetëm rrethet letrare të nxënësve të Shkodrës i kanë dërguar autorit 450 faqe dorëshkrime ku shprehin falënderimet e tyre".

Në këtë vepër, si askund tjetër në letërsinë shqiptare deri në vitet pesëdhjetë, shprehet dashuria e madhe e shkrimtarit ndaj popullit, ndaj shtresave të njerëzve të thjeshtë, ndaj fshatarëve që përfaqësohen me Gjikë Shpatin, Xha Koroveshin, Ndrekon dhe me shumë të tjerë, dhe njëherit shprehet urrejtja e papërmbajtur ndaj shfrytëzuesve të çdo lloji, ndaj gjakpirësve, të cilët s'u ngopën kurrë me gjakun e fshatarëve të pafajshëm dhe të mjeruar. Me mjeshtri artistike dhe me vërtetësi janë dhënë kontradiktat shoqërore. Në një ambient tipik shqiptar, me të gjitha ngjyrat e kohës, me ndjenja të dashurisë ndaj njeriut dhe të urrejtjes ndaj shfrytëzuesit, paraqiten tragjeditë e mëdha dhe të vogla, individuale dhe të përgjithshme shoqërore. Sidomos „opinga" është paraqitur në roman si shtresë shoqërore te e cila gradualisht zgjo-

[36] Sterjo Spasse, „Ata nuk ishin vetëm..." Botim i dytë, Tiranë, 1960, f. 23-24.

het vetëdija klasore. Ajo, duke pasur mbi kurriz tërë barrën e shfrytëzuesit të pamëshirshëm, jo vetëm që nuk mposhtet fizikisht dhe nuk thyhet moralisht, por përditë e më tepër bëhet më e vetëdijshme për pozitën e vet. Duke parë drejt rrugën e ndjekur edhe nga popujt e tjerë vëllezër, ringjallet, organizon radhët si klasë shoqërore. Asaj i rrah fuqishëm gjaku kryengritës, i shtohet guximi në luftë dhe shpresa për fitore. Para lexuesit në çdo faqe të romanit personazhet e realizuara artistikisht nga këto shtresa të vegjëlisë vijnë e bëhen më të dashura. Ato rriten si edhe shpresat e tyre për jetë më të mirë. Konflikti letrar është i natyrës së gjerë shoqërore dhe mbërthen në vete kontradiktat klasore. Ai zhvillohet natyrshëm dhe arrin kulmin atëherë kur fshatarët, në përleshjet e përgjakshme me beun, me qahjallarët, me përfaqësuesit e organeve të administratës dhe me të gjithë elementët e tjerë reaksionarë në fshat, arrijnë t'u japin armiqve grushtin e fuqishëm shkatërrues dhe njëherit t'u tregojnë se ishte afruar koha e re. Fshatarët atëherë do të bëheshin zot të tokës së tyre dhe do të çliroheshin. Nota optimiste që përshkon gjithë romanin dhe veçanërisht vizioni i dhënë në fund të veprës: „...të gjithë fshatarët — me Gjikë Shpatin në krye — ndonëse prisnin zbërthimin e një stuhie të furishme — ndjenin sikur u agonte në thellësirat e zemrave të tyre një mëngjez me diell..." ka ndikuar që në mënyrë adekuate të realizohet ideja themelore dhe të paraqiten në mënyrë të plotë pikëpamjet sociale të shkrimtarit.

Në romanin „Ata nuk ishin vetëm" Spasse arrijti të konsolidojë pikëpamjet e veta lidhur me transformimin progresiv të shoqërisë. Sipas tij rol vendimtar në këtë mes luan vegjëlia. Vetëm „opinga", si i quan ai këto shtresa të fshatarësisë dhe ato të qyteteve, mund ta përmbysë klasën sunduese; vetëm me luftë të organizuar mund të vehen themelet e një shoqërie të re ku nuk do të ketë shtypje as shfrytëzim. Pady-

shim, paraqitja e këtillë e pikëpamjeve të shkrimtarit tregon edhe zhvillimin progresiv ideor dhe estetik të tij. Me këtë gjerësi pikëpamjesh ai bën edhe një hap tjetër të rëndësishëm: luftën çlirimtare të vegjëlisë nuk e kufizon, nuk e konsideron të izoluar brenda fshatit apo qytetit, dhe as brenda kufijve të një shteti. Atë luftë më në fund e kupton si qërim hesapash midis klasash shoqërore antagoniste të mbarë rruzullit të planetit tonë. Prandaj edhe titulli simbolik i romanit „Ata nuk ishin vetëm" shpreh idenë e autorit se në luftën për çlirimin e plotë është e domosdoshme të ngrihen së bashku të gjitha forcat progresive të botës për të realizuar çlirimin e përbashkët. Sa i përket rrugës së ndjekur për çlirimin e vegjëlisë dhe për themelimin e sistemit të ri, Spasse ecën gjurmëve të shkrimtarëve të tjerë përparimtarë.

Derisa në romanin „Afërdita" trajtohej jeta e shoqërisë shqiptare gjatë dhjetëvjetëshit të tretë të shekullit tonë, në veprën tjetër „Afërdita përsëri në fshat" me realizëm të dukshëm paraqitet koha e luftës çlirimtare dhe ajo pas Çlirimit. Afërdita, mësuesja e dikurshme e Grykasit, në kushte të reja, vazhdon misionin e saj shumë të rëndësishëm shoqëror si mësuese dhe aktiviste e dalluar. Si kryeprotagoniste e romanit ka tiparet e një figure të çiltër revolucionare. Është kjo një nënë tipike e trollit shqiptar, intelektuale e ngritur dhe e kalitur në përpjekje të pandërprera për transformimin pozitiv të shoqërisë. Ajo jeton dhe vepron në rrethana të tjera nga ato që kishin dominuar disa vjet më parë. Afërdita ia kishte kushtuar rininë e vet ngritjes së gjithanshme të fshatarëve dhe më pak ishte kujdesur për jetën e vet. Më në fund vendi ku punonte kishte lulëzuar. Rreze të jetës së re shkëlqenin në fytyrat e fshatarëve, në fytyrën e Afërditës.

Mësueses nuk i zgjat shumë gëzimi dhe hareja, sepse asaj jete iu ndërpre hovi. Okupatori fashist kishte zaptuar atdheun e saj. Gjithçka kishte kapur flaka e luftës. Jeta e vështirë në skamje e mjerim, rën-

donte me gjithë peshën e vet dhe posaçërisht kishte kapluar vatrat e fshatarëve. Tymi i zi i luftës kishte nxirë gjithçka tjetër dhe jetën.

Gjatë viteve të LNÇ anë e mbanë vendit organizoheshin forcat revolucionare për çlirimin e atdheut. Radhët e luftëtarëve të lirisë shtoheshin ditë e për ditë më tepër. Pas shumë konflikteve familjare, edhe Afërdita kishte vendosur të marrë pjesë në lëvizjen çlirimtare. Edhe kësaj radhe në plan të parë ajo ven, jo jetën personale, por fatin e shoqërisë dhe të atdheut në tërësi.

Bashkëshorti i Afërditës, Lekë Gurakasi, ishte skeptik dhe nuk ishte i bindur se do të fitohej lufta që bënin shqiptarët kundër armikut më të fuqishëm. Ai nuk ishte i gatshëm të luftojë dhe me qëndrimin e vet dëshironte ta pengonte edhe Afërditën. Në një rast i drejtohet Afërditës: „...E kush, na që jemi një grusht e sakaq, po u kapëm fytpërfyti e mbaruam të terë! Pastaj ç'më duhet Shqipëria shkrumb e hi! Atëherë me se? me të mirë, me edukatë, me shkollë: të zgjojmë masën dhe herëherë t'u japim nga një grusht hundëve barkmëdhenjve, si ishte rasti i demostratave të mëdha të bukës në Korçë..." Këto ishin pikëpamjet që kishte Leka lidhur me luftën dhe me këto qëndrime në roman ky personazh është dhënë si figurë mjaft kontradiktore. Më tepër përfaqëson intelektualin e tërhequr nga jeta shoqërore, që më tepër brengoset për jetën e qetë familjare. Në të vërtetë pikëpamjet e tij janë ato të shkrimtarit të kësaj vepre gjatë periudhës së paraluftës. Leka në fillim nuk është paraqitur njeri i aksionit. Si i këtillë më tepër përfaqëson intelektualët e plogshtë dhe skeptikë të cilët bënin jetë të mbyllur dhe nuk i dilnin zot vendit. Ata edhe gjatë këtyre momenteve të rëndësishme të luftës për pavarësi nuk kishin arritur të përqafojnë botëkuptimin më të avansuar të kohës. Me veprimet e tij ndikon që, pa pritur dhe pa kujtuar, të shembet kështjella shumë e çmuar bashkëshorto-

re. Dy shokë të jetës: Afërdita dhe Leka, ndahen duke u nisur sejcili në rrugën e vet.

Si heroinë e romanit Afërdita është realizuar shembëllyeshëm me kryepersonazhin e veprës së mëparshme „Afërdita", por ajo ka pësuar një metamorfozë duke u pajisur edhe me virtyte të tjera pozitive. Prej këndej edhe figura e saj ideale është dhënë në mënyrë më të plotë dhe është realizuar artistikisht me shkathtësi të madhe. Varësisht nga rrethana në të cilat gjindet dhe vepron, është paraqitur edhe fizionomia fizike dhe morale e saj. Gjatë luftës çlirimtare Afërdita afirmohet si luftëtare e denjë për atdhe. Pas fitores përfundimtare, atëherë kur duhej rindërtuar vendi dhe kur kërkohej stabilizimi i pushtetit popullor, Afërdita përsëri kthehet në fshat. Në vend se të merrte ndonjë pozitë të lartë udhëheqësie në kryeqytet, vendos të shkojë atje ku kishte kaluar një pjesë të gjatë të jetës. Ajo synonte të realizojë ëndërrat dhe dëshirat e dikurshme për ta transformuar më tutje fshatin.

Romani fillon me shkuarjen e Afërditës në fshat. Jeta dhe aktiviteti i saj kuptohet nga zhvillimi i shiritit të kujtimeve të jetës së kaluar. Sa momente hidhërimi e gëzimi i kujoheshin. Ajo shqetësohet pa masë shpirtërisht kur sheh vatrat e rrënuara të fshatarëve, kur kujton vdekjen e sa e sa bashkëluftëtarëve dhe të nxënësve të vetë të dikurshëm. Tani gjendet përsëri në frontin e luftës për mëkambjen e jetës së re, për krijimin e marrëdhënieve të reja në fshat dhe në shoqëri. Ajo në këtë plan realizohet si figurë komplekse dhe lexuesi e përcjell me interesim deri në faqet e fundit të romanit, kur së bashku me të gjitha forcat e tjera progresive arrin të krijojë një jetë të re. Meqë Leka gjithashtu kishte marrë pjesë në luftën çlirimtare, Afërdita përtërin me të jetën bashkëshortore.

Autori i kësaj vepre të rëndësishme të letërsisë sonë edhe më tutje nuk braktis idenë themelore të

sendërtuar në romanin „Afërdita" se arsimi është faktori kryesor për transformimin progresiv të shoqërisë. E njëjta ide themlore është sendërtuar dhe është e pranishme edhe në romanin tjetër social „Afërdita përsëri në fshat", i cili për kah vlera artistike dhe ideore paraqet edhe një hap përpara në veprimtarinë letrare të Spasses.

Në këtë vepër shkrimtari ka qenë i preokupuar edhe me çështje të tjera. Menjëherë pas përfundimit të luftës, kur pushteti popullor nuk ishte stabilizuar sa duhet, pozita shumë të rëndësishme në udhëheqësi kishin zënë edhe njerëz pjesëmarrës të luftës, por të cilët nuk ishin të arsimuar deri në shkallën e duhur. Disa prej tyre ishin shumë të rezervuar ndaj shtresës intelektuale dhe shprehnin njëfarë mosbesimi ndaj tyre. Për një dukuri të tillë Spasse shkruan në romanin „Afërdita përsëri në fshat". Pirron, kryetarin e Këshillit të fshatit, e kishte kapluar dëshira për pozitë të lartë në shoqëri. Vetveten e konsideronte shumë më të vlefshëm se sa të tjerët. Edhe ndaj Afërditës ndjente urrejtje të papërmbajtur, por edhe ndaj intelegjencës në tërësi i kishte lindur një mosbesim i madh. Në një rast ai i thotë shokut të vet Stefanit: „More, mos u rrëmbe shumë nga fjalët e Afërditës. Ajo është me shkollë, e nga njerëzit me shkollë të mos presim shumë! Këtë luftë e bënë punëtorët e fshatarët, ata që s'dinin të shkruanin as emrin e tyre e jo këta të shkollës!... Ne e kemi për detyrë t'i bëjmë sytë katër! Më i rrezikshëm në këto kohra është një njeri me shkollë... Njerëzve të mësuar s'ua heq dot trutë e rrezikshme nga koka!" Megjithatë, autori për këtë çështje atëherë aktuale, në roman gjen një zgjidhje tjetër. Elementet si Pirroja dhe përfaqësuesit e klasës feudale-borgjeze që dekompozohej, humbnin të gjitha pozitat dhe privilegjet në shoqëri. Në atë mënyrë sigurohet forcimi i marrëdhënieve të reja dhe lulëzimi i shoqërisë së re.

Në romanin „Afërdita përsëri në fshat" Spasse shpreh pikëpamjet e veta stabile dhe të pranueshme, të kushtëzuara nga botëkuptimi më i avancuar ndaj jetës. Shkrimtari është angazhuar drejtpërdrejt të realizojë idenë themelore dhe ka shprehur bindjen se në jetë dhe punë medoemos kërkohet qëndrueshmëri e madhe. Sakrificat në këtë rrugë jetësore të vështirë janë të pashmangshme. Çdo epokë, nga përmbytjet e vogla dhe të mëdha, në saje të kundërthënieve klasore antagoniste, kur më shumë dhe kur më pak, i siguron hapësirë përkatëse depërtimit të së resë, forcës motorike që shpie zhvillimin shoqëror dhe të gjithmbarshëm përpara. Duke i pasur të qarta këto ligjshmëri të zhvillimit dialektik, ka synuar që në mënyrë realiste të paraqesë rrethanat dhe kundërthëniet e ashpërsuara pas luftës. Secila shtresë dhe klasë shoqërore, varësisht nga synimet e veta, bën rezistencë gjegjëse ndaj anës kundërshtare. Fshatarësia e varfër, siç përshkruhet në roman, së bashku me shtresat e vegjëlisë në qytete, ishte ngritur e organizuar të luftojë kundër shtypjes dhe shfrytëzimit, për barazi shoqërore. Për të ndërtuar vendin dhe për të ngritur jetën e re në fshat ishte e domosdoshme që fshatarët t'u jipnin goditjet e fundit shkatërruese të gjithë shfrytëzuesve të pashpirtë dhe të gjithë armiqve të vendit. Fitorja e tyre në fshat nuk mund të kuptohej pa patur parasysh kontributin e mësueses fisnike, Afërditës.

Meritë e veçantë e autorit është se në letërsinë tonë të sotme arriti të japë figurën mjaft komplete të Afërditës, shembëlltyrën e gruas shqiptare intelektuale. Ajo, në të vërtetë, është mësuesja e dikurshme e Grykasit, e cila kishte përjetuar peripeci të shumta në punën e saj të rëndësishme, por që ishte kalitur si luftëtare e denjë edhe gjatë luftës çlirimtare. Në punën e saj dhe në aktivitetin e gjithmbarshëm tregohet e qëndrueshme dhe vigjilente. Ajo kurdoherë gjendet në krye të detyrës, duke u dhënë ndihmë

fshatarëve me të cilët kishte lidhur fatin e vet jetësor. Ajo e mbante të gjallë idealin për arsimin dhe progresin shoqëror të fshatit. Si e tillë me të gjitha veçoritë e karakterit si personazh letrar, përfaqëson brezin e arsimtarëve përparimtarë. Nëpërmjet të saj është dhënë vizioni i qartë për të ardhmen më të bukur, për një pespektivë të shkëlqyeshme individuale dhe shoqërore.

Ndër personazhet e tjera që janë realizuar mirë artistikisht mund të veçohen Llaçi Driza, Cufe Beu, Hysen agë Tërfili, Vërtoku etj. Këto janë personazhe negative dhe përfaqësues të klasës shfrytëzuese dhe të degjeneruar. Si personazhe letrare janë tipizuar nëpërmjet të veprimeve të tyre, gjatë përpjekjeve për të mbajtur pozitat që i kishin dhe pasuritë e shumta. Ditët e vështira për ta vinin njëra pas tjetrës, por mbaheshin duke shpresuar se do t'u kthehej përsëri pushteti i tyre i rrënuar përgjithmonë. Duke qenë më të pasurit në fshat dhe njëherit fajdexhinj të rafinuar, s'dorëzohen lehtë. Katandisja ekonomike dhe shoqërore e tyre paraqet edhe shkatërrimin e tërë klasës së cilës i takojnë.

Figura e Llaçi Drizës është realizuar me mjeshtri artistike. Ai përfaqëson njerëzit e pangopur me pasuri dhe të holla. Në jetën e tij përherë ka qenë më e rëndësishme paraja dhe fajdeja se çdo gjë tjetër. I tillë është rritur dhe edukuar, si koprrac që është që zemra i bëhet mal kur numëron të hollat e shumta të fituara nga djersa e huaj. Është armik i përbetuar i depërtimit të së resë. Për t'u ikur kundërshtimeve të hapura di të përdorë taktikë të posaçme. Është përfaqësues tipik i kullakëve, bashkëpunëtor i verbër i armikut që kishte zaptuar vendin. Por, posa filloi lufta, me njërën dorë mbahej edhe me forcat e lëvizjes çlirimtare, të cilat ishin dukur në skenën e shoqërisë shqiptare të kohës. Njerin prej të bijve e kishte inkuadruar në frontin e lëvizjes për çlirim nga okupatori fashist. Driza në këtë vepër

është realizuar si tip djallëzor dhe shumë i zgjuar. Si armik kurrë nuk vepron haptazi, por si vegla të verbëta i përdor të tjerët: Vërtokun, Mitrin, Teto Katën etj. Synon madje të bëjë për vete Pirron, shërbëtorin e vet të dikurshëm, i cili me kohë kishte siguruar një pozitë të lartë në shoqërinë e re.

Karakteristike është edhe figura e Hysen agë Terfilit. Atij i ishin shembur idealet e dikurshme klasore. Megjithatë, nuk paraqitet më si mbrojtës i interesave të klasës së vet. Në ditët e pleqërisë i shtohet oreksi për jetë të lumtur dhe të rehatshme. Një brengë e vjetër e mundon atë si asnjëherë më parë: si të sigurojë trashëgimtarin e vet legjitim. Për të realizuar këtë dëshirë derdh pasurinë dhe bjerr dinjitetin e vet si një përfaqësues tipik i klasës që dekompozohej. Cenë Metës, një leckamani nga fshati, të cilin agai e njihte edhe më herët, ia kërkon të bijën shtatëmbëdhjetëvjeçare për grua. Sa shpresa të reja i lindin përnjëherë Hysen agë Tërfilit, por nuk i realizohet asnjëra prej tyre. Ky personazh negativ me natyrën e tij është dhënë mjaft kompleks. Jeta intime e tij paraqet degradimin e plotë moral të klasës sunduese. Agai edhe në kuadër të familjes së vet kalon jetë të çthurur. Si kryetar familjeje lëshohet në marrëdhënie intime me të shoqen e nipit të vet. Në ndërgjegjen e tij e kaluara kishte lënë gjurmë të pashlyeshme.

Nga radhët e fshatarësisë së varfër është realizuar me sukses figura e Xha Nelos. Jeta e vështirë dhe skamja e përhershme, sa e kishin raskapitur plakun, aq edhe e kishin bërë të qëndrueshëm. Me një optimizëm të madh ai shikonte ardhmërinë e gjeneratave të reja. Me bujarinë karakteristike të fshatarit dinte t'i afrojë njerëzit. Prej këndej figura e plakut Nelo në roman na del shumë e dashur dhe simpatike.

Idila e dashurisë në fshatin shqiptar është paraqitur me ngjyra realiste dhe me vërtetësi artistike.

Ambientet tipike të jetës shqiptare janë dhënë me mjeshtri artistike dhe veprës letrare i shtojnë vlerën e përgjithshme. Përshkrimet e natyrës me mjaft elemente lirizmi janë shumë funksionale dhe plotësojnë aspekte të caktuara të veprës, duke dhënë në këtë mënyrë atmosferën në të cilën veprojnë dhe realizohen personazhet e këtij romani social.

Tematika e jetës aktuale në veprat e Spasses është trajtuar në gjerësi. Sa kishte mbaruar së shkruari romanin „Afërdita përsëri në fshat", filloi të hartojë edhe veprën tjetër me titullin „I urituri". Historia e krijimit të kësaj vepre është mjaft interesante. Filloi ta shkruajë më 1959 gjatë udhëtimit për Bashkimin Sovjetik, ku Spasse qëndroi dy vjet. Atje studioi letërsinë në Institutin „Maksim Gorki" dhe njohu më mirë letërsinë sovjetike. Shkrimtarit posaçërisht i kishin lënë përshtypje të posaçme veprat e Gorkit, të Fedejevit, të Shollohovit etj. Me interesim të madh kishte lexuar romanin e Shollohovit „Tokat e çara", ku paraqitej procesi i vështirë i kolektivizimit. Ideja e dikurshme në këtë kohë iu kishte kristalizuar. Më 1959 filloi të botojë fragmentet e para dhe zgjoi interesim të madh te lexuesit. Që të botohej në tërësi si vepër e plotë, autorit iu desh ta ripunojë dhe më 1965 doli me titullin e ri „Buzë liqenit". Kësaj radhe Spasse trajton temën aktuale të transformimit të fshatit të Malësisë me rastin e kolektivizimit të bujqësisë gjatë viteve pesëdhjetë. Revolucioni nuk kishte përfunduar me fitoren e luftës çlirimtare. Për t'u ngritur jeta e re vazhdonte beteja e reptë për ngritjen e kooperativës në fshat.

Ngjarjet reth themelimit të kooperativës në Pishas kishin shqetësuar pleq e të rinj, të pasur dhe të varfër. Furtuna e furishme kishte kapluar gjithë fshatin, i cili pas çlirimit kishte kaluar disa vjet të qeta. Fshatarët e shtypur në mënyrë mizore, sa ishin mëkëmbur pakëz pas reformës agrare. Ata, më në fund, kishin bërë tokën e tyre, shtëpinë dhe bagëtinë.

Buka e misrit i kishte shpëtuar nga uria. Disa nga fshatarët si Spiro Gurrëmadhi, i cili në roman është personazh negativ, pas pak vjetësh kishin arritur të pasuroheshin shumë edhe ishin bërë kundërshtarë të përbetuar të kooperativës. Etja e madhe për t'u pasuruar edhe më tepër, kokëfortësia dhe brutaliteti i tepruar në jetën familjare, i japin Spiros pamjen e përbindëshit. Në anën tjetër kryetari i këshillit të fshatit, Jani Qimekuqi, meqenëse kishte kaluar në taborrin e Gurrëmadhit e të Pilo Dinakajt, duke iu kundërvënë heroit kryesor, Gjergjit, ishte bërë edhe vetë armik i sistemit të ri shoqëror.

Në roman së pari ngriten konflikte të natyrës individuale në mesin e fshatarëve, por ato pastaj marrin dimensione më të gjera dhe përfshijnë tërë fshatin, të cilin e trondisin që nga themeli. Spasse shpreh mendimin se ngritja e jetës së re bie mbi kurriz të brezit të ri dhe të elementëve progresivë. Rininë e përfaqëson Gjergji, figurë simpatike e rinisë përparimtare. Si kryepersonazh realizohet nëpërmjet të veprimeve në situata të ndryshme. Linja e dytë e veprës, ajo e dashurisë, i ka dhënë mundësi shkrimtarit që kundërthëniet ekzistuese klasore t'i paraqesë edhe më të ashpra. Konfliktet e veprës ngriten gradualisht, për të arritur pikën kulminante dhe zgjidhjen e tyre. Dashuria midis Gjergjit dhe Marinës, të bijës së Gurëmadhit, është lidhur me problemin kyç të emancipimit shpirtëror të fshatarëve. Ky material kaq i vlefshëm jetësor në roman i është dukur shkrimtarit i domosdoshëm, jo vetëm për të tipizuar në mënyrë më të plotë personazhet letrare, por edhe për të paraqitur më shumë aspekte të jetës.

Në roman, me realizëm, janë paraqitur tablo të shumta të jetës së fshatit dhe janë pasqyruar kundërthëniet ndërmjet shtresave dhe klasave shoqërore si edhe mentaliteti i fshatarit dhe prapambetja e tij. Shkrimtari edhe një herë shpreh bindjen e vet se

nuk mund të mendohet perspektiva më e ndritur individuale dhe shoqërore po qe se rinia, bashkë me të gjitha forcat e tjera përparimtare nuk hyn në vallen e jetës së re.

Për bukuri jepet edhe idila e dashurisë në fshatin buzë liqenit. Ambienti me pamjen pitoreske dhe tërheqëse i maxheps të dashuruarit, i bën të lumtur në jetë. Aspekt të veçantë paraqet në këtë vepër dashuria ndërmjet Gjergjit dhe Marinës. Historia e gjatë e kësaj dashurie të çiltër, por edhe shumë të penguar, edhe pse në shumë momente e pamotivuar sa duhet, mbetet përherë në funksion të idesë kryesore të romanit.

Autori ka synuar ta sendërtojë idenë themelore sa më bindshëm, prandaj ka ngritur shumë konflikte të tjera edhe në kuadër të familjes së Gurrëmadhit. Spiros i bëhen kundërshtarë të përjetshëm edhe fëmijët e vet, sepse hija e tij shkakton frigë urrejtje kudo që gjendet.

Përfundimi tragjik i jetës së Gurrëmadhit dhe shpëtimi i papritur i Marinës nga duart e grabitësve mund të konsiderohen zgjidhje fatlume të këtij romani me plot ngjarje dramatike. Pas fitores mbi reaksionin mjaft të fuqishëm në fshat, vëhen themelet e jetës së re. Për jetën e re lindin edhe shpresa të reja.

Vepra si tërësi është edhe një kontribut i rëndësishëm letrar, por nuk paraqet nivelin e arritur më parë në veprimtarinë letrare të Spasses. Pika kulminante në rrugën e gjatë të krijimtarisë së romansierit duhet t'i takojë ndonjë vepre të cilën do ta shkruajë më vonë, meqenëse romani „Buzë liqenit" nuk e ka vlerën artistike të arritur në veprën „Ata nuk ishin vetëm", apo edhe „Afërdita përsëri në fshat". Kompozicioni i veprës si tërësi artistike nuk është kompakt ngase janë shtuar disa pjesë të tepërta të cilat, në vend se të krijojnë lidhshmëri të natyrshme kompozicionale të ngjarjeve kryesore me ato epizo-

dike, ndërprejnë rrëfimet dhe zhvillimin e aksioneve të protagonistëve në roman. Këto janë në të vërtetë disa histori dhe parahistori të shkurtëra apo të gjata, të cilat ndriçojnë diçka nga e kaluara jetësore e personazheve të romanit, por edhe ndërprejnë zhvillimin dinamik të ngjarjeve dhe dramacitetin e domosdoshëm. Në këtë mënyrë lexuesi humb interesimin për të përcjellë fillin e ngjarjeve dhe fatin e personazheve. Autori veprën e shkroi brenda një intervali të shkurtër kohor dhe për këtë arsye nuk qe në gjendje të bëjë selektsionimin më rigoroz të materialit të zgjedhur për veprën e tij. Edhe përpjekja e shkrimtarit për të tipizuar personazhet letrare nuk ka qenë gjithnjë e suksesshme. Në disa raste shkrimtari nuk ka arritur ta bindë lexuesin me atë që synon të komunikojë. Gjergjin, personazhin kryesor, në fillim e paraqet mjaft naiv. Megjithatë, si hero i romanit mbetet mjaft simpatik, i arsyeshëm dhe mjaft energjik në aksionet konkrete. Në anën tjetër, paraqitja e shumë peripecive përkitazi me jetën dhe me fatin e Marinës nuk është motivuar sa duhet. Figurën e major Llazit autori në fillim nuk e ka tipizuar natyrshëm dhe vetëm më vonë arrin ta skalisë si ai skulptori i zhdërvjelltë skulpturën e vet. Atë e paraqet më të gjallë, jo si njeri që filozofon, por si njeri të aksionit. Në këtë mënyrë e radhit midis fytyrave më pozitive të romanit.

Me aftësi të rrallë artistike është tipizuar figura e Pilo Dinakajt, kullakut të fshatit, i cili bashkë me klasën e vet, më në fund, kishte marrë grushtin e fuqishëm dhe shkatërrues, por kishte shpëtuar i gjallë dhe si një ujk i vjetër mbahej edhe më tutje shumë i rrezikshëm. Nëpërmjet të këtij personazhi është dhënë tradhtari që mbetet përgjithmonë kundërshtar i përbetuar i vegjëlisë dhe i depërtimit të marrëdhënieve të reja në fshat. Atë e mban në jetë shpresa se përsëri do të ktheheshin ditët e tij të dikurshme. Në roman janë realizuar edhe figura të tjera komplekse,

si ajo e Nunit, të birit të Gurrëmadhit etj. Ai, i tronditur thellë nga fati i së motrës, Marinës, nga urrejtja e madhe që ndien ndaj babait, të tij grykës dhe zemërgur, i jep flakën gjithë pasurisë së Gurrëmadhit dhe në këtë mënyrë shkakton tragjedinë e tij të tmerrshme.

Romani „Buzë liqenit" në aspektin tematik dhe ideor, edhe pse ka disa të meta që u cekën, radhitet ndër romanet interesante ku trajtohet tematikë aktuale. Me paraqitjen mjaft dinamike të zhvillimit të ngjarjeve, me përshkrimet realiste të jetës së fshatit shqiptar, me stilin e rrjedhshëm dhe të natyrshëm, vepra ngazëllen lexuesin. Qëndrimi përherë humanist i autorit të angazhuar për progresin më të shpejtë shoqëror, e nxit lexuesin që të përqafojë gjithçka që është përparimtare dhe e vlefshme në jetën individuale dhe shoqërore.

Tema e transformimit socialist të shoqërisë shqiptare është trajtuar edhe në romanin tjetër të Spasses që mban titullin „Zjarre...". Kjo vepër me shumë elemente i ngjan romanit të Razi Brahimit „Kthesa të forta". Që të dy këta shkrimtarë kanë qenë të preokupuar me temën aktuale të emancipimit dhe të zhvillimit më të shpejtë të fshatit. Kuadrot nga qyteti angazhohen vullnetarisht në fshat për të ndihmuar kështu në mënyrë të drejtpërdrejtë Malësinë dhe për t'i dhënë dorë së resë në çdo kënd të vendit. Kujtimi, personazh i romanit „Zjarre"... është heroi i ditëve të reja, me pikëpamje shumë të avansuara, por si i tillë, në të njëjtën kohë, është bartës i ideve të shkrimtarit Spasse në këtë fazë të krijimtarisë letrare. Konflikti i ngritur letrar ka të gjitha veçoritë e konfliktit shoqëror të kushtëzuar nga ato marrëdhënie që zotëronin në fshatin shqiptar të kohës si edhe në qytete. Autori arrin të japë edhe një degëzim të këtij konflikti për t'u dhënë hapësirë mosmarrëveshjeve që lindin midis Kujtim Moravës dhe së dashurës Bardhës. Duke preferuar në

fillim më tepër rehatinë përsonale, Bardha nuk ishte në gjendje ta kuptojë misionin e rëndësishëm të cilit po i dilte zot Kujtimi. Si edhe më parë Spasse ka synuar të shfaqë edhe një aspekt të pikëpamjeve të veta lidhur me transformimin social. Autori mjaft heret kishte kuptuar se antagonizmat shoqërore manifestohen nëpërmjet të luftës së vazhdueshme që kushtëzon pastaj lindjen jo vetëm të së resë, por edhe themelimin e marrëdhënieve më të favorshme për zhvillimin material dhe shpirtëror të shoqërisë. Lufta e së mirës me të keqen, sipas tij është e përhershme. Kësaj radhe Spasse shpreh mendimin se duhet të luftohet dhe të zhduket e keqja edhe brenda vetes. Ajo luftë duhet të vazhdojë gjithmonë.



VIII.

Mr. Isak Shema

NDIKIMI LETRAR I MAKSIM GORKIT NË FORMIMIN E SHKRIMTARIT STERJO SPASSE

Shkrimtari shqiptar Sterjo Spasse, njëri ndër prozatorët më të shquar të letërsisë së sotme shqiptare, fillol krijimtarinë letrare me tregimin „Kush duron, trashëgon", të botuar në nëntor të vitit 1929. Që atëherë po mbushen katër decenje e gjysmë dhe shkrimtari Spasse po krijon edhe më tutje intensivisht, duke iu kushtuar kryesisht romanit. Figura poliedrike e këtij romansieri na del edhe më interesante kur, krahas veprimtarisë letrare, merret parasysh edhe kontributi i tij në fusha të tjera të kulturës dhe të arsimit shqiptar.

Ai qe mësues i dalluar, përkthyes i disa veprave të letërsisë së huaj, hartues i shumë teksteve shkollore. tregoi interes të veçantë për studimin e letërsisë popullore, shkroi artikuj dhe studime për gjuhën dhe letërsinë shqiptare, veçanërisht lidhur me letërsinë tonë të Rilindjes. U muarr me publicistikë, shkroi reportazhe dhe udhëpërshkrime, shumë kohë u interesua për probleme të pedagogjisë dhe të zhvillimit të shkollës në gjuhën shqipe.U muarr gjithashtu me teorinë e letërsisë, dhe me studimin e letërsisë së huaj.

Veprat e tij të botuara dhe të pabotuara janë të shumta. Përmbledhjet e tregimeve filluan të botohen që nga vitet '30: „Kunorë rinije" (1934), „Në krahët e një femre" (1934), „Nusja pa duvak" (1944), „Të fala nga fshati" (1958), „Sokolesha" (1966), „Kronika e jetës së Gegë Llesh Ndout" (tregime të shpërndara në shtypin e kohës), „Skandal! jo, aspak!" (pamflete e proza alegorike të shpërndara në shtypin e kohës), Jam voglush i madh" (Tregime për fëmijë). Janë të njohura edhe novelat: „Pasqyra magjike" (1957), „Simfoni e pambaruar" (1962), „Banori i yllit Vega në Tokë (Superfuqia) që është pamflet fantastiko-shkencor, pjesërisht i botuar në gazetën „Mësuesi" (1965). Me romanet sociale dhe historike Spasse dha kontribut të çmuar në lërimin e kësaj gjinie të vështirë, por të rëndësishme letrare. Në vitin 1935 botoi romanin e parë „Nga jeta në jetë: Pse?!", për të vazhduar pastaj me „Afërditën" (1944)," Ata nuk ishin vetëm" (1952), „Afërdita përsëri në fshat" (1955), „Buzë liqenit" (1961), „Ne jemi shumë"... (1967) që

është roman — variant i shkurtuar mbi përmbytjet e botëkuptimeve prapanike në malësi, „Zjarre... (1972), „Zgjimi", (1974). Romani i fundit bën pjesë në ciklin „Rilindasit" ku pasqyrohet lufta „me penë e armë" për çlirimin e popullit shqiptar nga zgjedha e huaj- për pavarësi të plotë kombëtare.

Disa nga romanet e tij u përkthyen në më se gjashtëmbëdhjetë gjuhë të huaja si në frëngjisht, gjermanisht, rusisht anglisht, bullgarisht, greqisht, italisht, në gjuhën kineze, në gjuhën vietnameze etj, dhe zgjuan interesim të madh të lexuesve.

Lidhur me veprën letrare të Sterjos u shkruan recensione, vështrime dhe studime. Bibliografia e mendimit kritik letrar përfshin afër dyqind njësi bibliografike. Kritika letrare shqiptare dhe e huaj e vlerësoi lart opusin romanesk të tij. Gjithë kjo tregon bindshëm se vepra humanitare e këtij shkrimtari, me karakterin e saj popullor, me idetë thellësisht progresive, me përjashtim të disa veprave të etapës se parë të krijimtarisë, kur autori shpreh pikëpamjet pesimiste ndaj jetës, ka fisnikëruar lexuesin dhe ka zgjuar të ai përjetimin estetik, gjë që mund të arrihet vetëm prej veprave të realizuara artistikisht.

Gjithë opusi letrar i Spasses nuk është shkruar sipas një metode të vetme letrare, sepse kemi një krijimtari mjaft heterogjene, të kushtëzuar nga faktorë të brendshëm dhe të jashtëm letrarë. Periodizimi i krijimtarisë letrare të Spasses në tri etapa kryesore[1] të zhvillimit mundëson studimin më të thëllë e të gjithanshëm të fenomenit letrar të këtij autori dhe tregon në mënyrë të qartë rrrugën e fomimit të tij.

Veprat që i shkroi deri në vitin 1935 i përkasin fazës së parë të krijimtarisë letrare. Përvoja krijuese e fillestarit ishte mjaft e kufizuar, botëkuptimi i shkrimtarit ndaj jetës ende jostabil, qartësia ideologjike e pamjaftueshme. Mjeshtria artistike ende nuk ishte zotëruar sa duhet. Gjuha si mjet i shprehjes artistike nuk ishte perfeksionuar si disa vjet më vonë. Edhe pse vërehet fare mirë se shkrimtari posedonte talent krijues për t'u marrë me letërsi, prozën tregimtare të kësaj faze, si edhe romanin, e përcjellin dobësi të karakterit ideor dhe artistik.

Faza e dytë e krijimtarisë letrare të Spasses përfshin veprat e krijuara midis viteve 1936—1944. Kjo është vepër me më tepër elementet të realizmit kritik, ku është thelluar karakteri humanitar dhe utilitarist saj. Në të shprehet optimizmi i fuqishëm i saj, çmohet shumë njeriu si qenie shoqërore dhe paraqiten ide të shë-

[1] Shema Isak: Pikëpamjet sociale në veprën e Sterjo Spasses, „Jeta e re", Prishtinë, 1969, nr. 1, f. 17-18

ndosha përkitazi me progresin e gjithëmbarshëm shoqëror. Pra kemi të bëjmë me ndryshime esenciale kualitative në metodën krijuese, me një evolucion të natyrshëm drejt ngritjes së përgjithshme ideo-estetike.

Pas luftës çlirimtare, në krijimtarinë letrare që bën fazën e tretë, Spasse përqafon parimet e metodës së realizmit socialist, dhe shkroi romanin e parë të realizmit socialist në Shqipëri, „Ata nuk ishin vetëm".

Duke u bazuar në të dhëna të shumta lidhur me jetën dhe veprimtarinë letrare, pra lidhur me rrugën e formimit të shkrimtarit, në artikuj dhe vështrime të tjera, ku është shtruar çështja e përhapjes së veprës letrare të Gorkit në Shqipëri, do të ndriçohet problemi i ndikimit letrar të Gorkit mbi shkrimtarin Spasse. Mësimi që mori duke lexuar Gorkin, sidomos gjatë fazës së dytë të krijimtarisë, për Spassen ishte vendimtar për formimin dhe afirmimin e tij të mëtejshëm. Ai pohon edhe vetë: „Elementet e realizmit në periudhën time të parë ja detyroj shkrimtarit të madh sovjetik, Maksim Gorkit, të cilin fillova ta kuptoj dhe ta dashunoj pas viteve 1935—1936".[2]

I lindur më 14 gusht 1914, në Gllomboç të Krahinës së Prespës, nga prindër të varfër fshatarë, të cilët si edhe shumë fshatarë të tjerë siguronin ekzistencën, duke punuar tokat e beut ose duke shkuar në kurbet në Turqi apo në Amerikë e gjetiu, që nga koha e fëmijërisë kaloi një jetë shumë të vështirë. Në kohën e sundimit feudalo-borgjez famëkeq të Ahmet Zogut filloi mësimet e para në shkollën greke, e pastaj mbaroi shkollën plotore në Korçë. Ishte ndër të parët nxënës nga Krahina e Prespës, që kishte mbaruar shkollën plotore dhe hynte në shkollë të mesme. Shkollën normale të Elbasanit e kreu më 1932 dhe u emërua mësues në Derviçan (të Gjirokastrës), pastaj shërbeu në Gjirokastër, Korçë dhe Tiranë. Studimet e larta të pedagogjisë i vijoi me korespondencë gjatë viteve 1938—1941 në Magisterin e Firencës, por nuk i përfundoi. Më vonë kreu studimet e larta për letërsi në Institutin e Lartë të Letërsisë „Maksim Gorki" në Moskë gjatë viteve 1958—1960. Punoi gjatë si inspektor i arsimit, qe përgjegjës i Seksionit të Gjuhës e të Letërsisë të Ministrisë së Arsimit, përgjegjës i seksionit të prozës në Lidhjen e Shkrimtarëve e të Artistëve të Shqipërisë, redaktor i revistave letrare „Literatura jonë" dhe „Nëntori". Sot është shkrimtar me profesion të lirë.

Qysh heret, kur ishte normalist, me pasion lexonte shkrimtarët shqiptarë, sidomos Naim Frashërin, Mihal Gramenon, Foqion Postolin, Çajupin, Fan S. Nolin, Asdrenin, Mjedën e të tjerë. Ishte nxënës i talentuar, me një botë të pasur emocionale. I ndi-

---

[2] Jorgaqi, Nasho: *Romani „Pse?!..." dhe fillimet letrare te Stërjo Spasses*", „Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës" Seria: „Shkencat shoqërore", Tiranë, 1958, nr. 4, f, 143.

kuar nga letërsia jonë e traditës filloi me shkrimet e para, të cilat shquhen për frymë patriotike të tyre. Janë këto proza të shkurtëra të një të riu, i cili ende nuk kishte formuar një botëkuptim stabil mbi jetën, prandaj pikëpamjet e shprehura shpeshherë janë edhe te kufizuara. Ai e zgjeroi horizontin e diturisë duke lexuar përveç të tjerash, jo vetëm letërsinë shqiptare, por edhe atë botërore. Nga gjuhët e huaja kishte mësuar frëngjishten, italishten, maqedonishten, bullgarishten, greqishten dhe më vonë rusishten. Në ato vite literatura e pasur botërore në gjuhën italishte, frëngjishte etj., kishte depërtuar në qendrat më të mëdha të Shqipërisë. Në Korçë lexoheshin rregullisht revistat „Vu" dhe „Lu" dhe të tjera të cilat sillnin materiale ndër më të ndryshme. Siç pohojnë edhe bashkëkohësit e Spasses, të cilët ishin shkrimtarë, loxoheshin të gjitha veprat me përmbajtje të llojllojshme. Kjo literaturë ka ndikuar me siguri në shkrimtarët e rinj.

Deri më 1936 kishte lexuar disa vepra të klasikëve të realizmit, por edhe disa romantikë të njohur botërorë. Nga Tolstoi kishte lexuar veprat: „Ringjallja" „Sonata e Krojcert", „Ana Karenina" dhe tregime të tjera: nga Dostojevski: „Demoni", Vëllezërit Karamazovë", „Shtëpia e të vdekurve" dhe ndonjë tjetër, veprat e Turgenjevit: „Etër dhe bij", „Kujtimet e një gjahtari" dhe prozën e tij poetike. Me pasion kishte lexuar Gorkin, tregimet e tij, romanin „Nëna" dhe veprën „Klim Samgini"; pastaj Balzakun, Leopardin, Pirandellon, Mopasanin, Viktor Hygonë (romanin „Të mjerët" e kishte përkthyer në shqipet si variant të shkurtuar më 1936), Shopenhauerin, romanet e Knut Hamsunit „Uria" dhe Pan", veprën e Fridrih Niçes „Kështu foli Zaratusta", romanin „Fshatarët" të Vladislav Rejmoniti, novelat e Stevan Cvaigut dhe monografitë e tij mbi Dostojevskin, Balzakun dhe Tolstoin. Nga shkrimtarët e Ballkanit, i kishin lënë përshtypje më të mirë proza tregimtare e Elin Pelinit, tregimet e Jordan Jovkovit, proza e Ivan Vazovit, romani „Jeta në varr" i Stratis Mirvilisit, romani „E tatëpjeta" e Gregorios Ksenopullosit, tregimet e Ivan Cankarit, poezia e Botevit dhe Javorovit.

Te Spasse, sa u përket ideve për vëllazërimin e popujve të Ballkanit, kanë ndikuar, përveç Naimit me poemën „Dëshirë e vërtetë e Shqiptarëve", edhe shkrimet e Botevit, Rakovskit, Svetozar Markoviqit, pastaj ato të Stanko Vrazit, Rigas Ferreos etj.

Spasse tregoi interes të madh edhe për studimin e folklorit. Mund të veçohet përmbledhja e punimeve nga kjo fushë, me titullin „Në mbretërinë e folklorit shqiptar" për shkolla të mesme. Ai pohon se për t'u marrë me pasion me folklor kanë ndikuar përveç folkloristëve shqiptarë të njohur, edhe Vuk Karaxhiqi, greku Politis, bullgarët Sllavejkovi, Aranudovi, Shishmanovi dhe maqedonët vëllezërit Milladnovë.

Në fazën e parë të krijimtarisë letrare, në një pjesë të prozës tregimtare dhe në romanin e të riut nëntëmbëdhjetë vjeçar „Nga

jeta në jetë: Pse!", të botuar më 1935, vërehet sheshazi ndikimi i Tolstoit me pikëpamjet e shprehura në „Sonata e Krojcerit" dhe në romanin „Ringjallja". Mendimi filozofik i Tolstoit „Mos e kundërshto të keqen me dhunë" qe përqafuar nga shkrimtari i ri. Autori i romanit „Pse?!" u ndikua edhe nga filozofi gjerman, Fridrih Niçe. Pikëpamjet pesimiste të Niçes dhe qëndrimi i tij ndaj femrës në përgjithësi kanë gjetur shtrirje edhe më të madhe. Niçe shkruante: „Përse të jetojmë? Gjithçka është smirë!... „Por as Tolstoi dhe as Niçe nuk kanë ndikuar me tërë sistemet e tyre filozofike. Në anën tjetër, Shopenhaueri ndikoi me teorinë e tij subjektive idealiste të vullnetarizmit.

Kur shtrohet çështja e ndikimeve që ka pësuar ky shkrimtar nga literatura e lexuar, duhet të kihet parasysh fakti se mbi letrarin e ri shumë më tepër ka influencuar gjendja e përgjithshme sociale e shoqërisë shqiptare e kohës dhe atmosfera shpirtërore e tij. Gjon Zaveri, personazhi kryesor i romanit „Pse?!", edhe pse nuk është figurë tipike, e marrë nga jeta shqiptare, pasqyron kaosin e rinisë intelektuale nën regjimin feudalo-borgjez në Shqipëri.

Nëpërmjet tij, edhe pse në masë të kufizuar, është shprehur gjendja shpirtërore e autorit dhe pikëpamjet e tij të përqafuara gjatë atyre viteve. Spasse ende nuk kishte përvojë të pasur letrare. Pa botëkuptim materialist të formuar plotësisht dhe stabil ndaj jetës, nuk ishte në gjendje t'u gjejë shpjegime shumë pikëpyetjeve. Duke qenë i shqetësuar deri në kulm me jetën e atëhershme, s'pajtohet me atë gjendje dhe reagon në mënyrë të vet. Duke mos i njohur thellë kontradiktat sociale të kohës, bën shartimin e pikëpamjeve të huaja dhe kështu bie në pesimizëm dhe nihilizëm. Me moton e romanit „Bota e Hiçit, prej Hiçit, për Hiçin, rrotullohet rreth qëllimit të Hiçit", mohoi vlerën e çdo gjëje në jetë dhe të jetës vetë dhe në këtë mënyrë s'arrijti t'i shpëtojë dëshprimit të pakuptshëm. „Dëshprimi-shkruan Lenini-është karakteristikë e klasave që janë në rënie sipër... Dëshprimi është karakteristikë e atyre që nuk i kuptojnë shkaqet e së keqës, nuk shohin rrugëdalje dhe nuk janë të zotët të luftojnë"[3]. Eshtë plotësisht e qartë se Spasse gjendej para vështirësive të shumta me karakter objektiv dhe subjektiv për të cilat shkruan:„ Jua them sinqerisht se në periudhën e parë të rendit feudalo-borgjez kur unë fillova të shkruaj, m'u desht të kapërcej shumë kontradikta të brendëshme. Këto kontradikta ishin të paevitueshme në periudhën kur letërsia e së shkruarës errësonte mendimet e shkrimtarëve".[4] Shumë vite më vonë, kur qartazi i kishte kuptuar shkaqet dhe pesojat e dëshprimit të thellë në jetë, shkruan: „Vështirësitë ishin të shumta e

---

[3] Lenin, Iiq: *O kulturi i umetnosti*, „Kultura", Beograd,1957, f. 58.
[4] Spasse, Sterjo: *10 vjet në atdheun tim të lirë*, „*Shqipëria e re*", Tiranë, 1955, nr. 11-12.

vinin nga të gjitha anët. Së pari vinin nga vehtja, nga mungesa e përvojës e nga kufizimet ideologjike, nga mospasja e një objektivi të kristalizuar. Pastaj ishin vështirësitë objektive të kushtëzuara nga rrethanat shumë të rënda të regjimit feudo-borgjez, që ishte një regjim shtypës. Jo vetëm nuk na inkurajonin, por edhe na përbuznin madje na akuzonin dhe si të rrezikshëm. Edhe lexuesit ishin shumë të pakët: mendoni se ç'lexues mund të kishim, kur atyre që e quanin veten intelektualë me prejardhje feudo-borgjeze ishin ksenomanë e përbuznin çdo gjë shqiptare, kur shtypi ishte në duart e reaksionit. Çdo gjë që kemi botuar, e kemi botuar, me përpjekjet tona, me këmbëguljen tonë, me sakrificën tonë..."[5]

Veprën letrare të Gorkit, në të cilën bëhej thirrje për jetë e jo për vdekje, e lexoi pas përfundimit të romanit „Pse?!". Së pari kishte lexuar tregimet e tij e pastaj romanin „Nëna" të botuar ne italisht. Atëherë, romanin „Pse?" ende s'e kishte dorëzuar për botim si vepër të plotë. Spasse e kuptoi se në veprën e vet nuk duhej të dominonin pikëpamjet pesimiste, por atë ta përshkonte fryma optimiste dhe te lexuesi të përcillej porosia humanitare, dashuria e madhe ndaj jetës. Me një kritik letrar të kohës, i cili kishte shkruar parathënien e romanit „Pse?!", Spasse kishte biseduar për mundësinë e disa ndryshimeve që, sipas tyre, ishin të domosdoshme. Autori ishte bindur se Gjon Zaveri nuk duhej të bënte vetëvrasje. Përfundimi i romanit dhe shumë pjesë të tjera ishin e domosdoshme të ndryshoheshin, pra romani të ripunohej. Megjithatë, autori vendosi ta dorëzojë në shtyp pa ndryshime si një vepër që ishte shkruar në rrethana të caktuara historike-shoqërore, të cilat do t'i pasqyrojë më vonë në romanet e tjerë.

Me gjithë kufizimet që kishte vepra edhe pse autorit iu bënë vërejtje si në kritikën letrare, ashtu edhe në letrat e shumta që i dërgoheshin nga lexuesit, veçanërisht lidhur me pesimizmin dhe nihilizmin që ishte i pranishëm, iu njohën meritat për tematikën e trajtuar deri atëherë. Letërsisë demokratike që kishte marrë një zhvillim më të mirë se përpara, bashkë me Spassen, po i vinin forca të reja sidomos pas vitit 1935. „Drejtimi kritik në letërsi ishte i dobët. Brezi i 35-ës s'e kish treguar akoma fizionominë e tij".[6]

Nga artikulli „Kritika letrare ndër ne" kuptojmë se në ç'masë Spasse e ka përjetur atë atmosferë mbytëse:"... Në mes të një heshtjeje së vijueshme, në mes të një letragjie letrare del nga ndonjë kënd një vepër origjinale a si origjinale, ose ndonjë përkthim bajat dhe i mykur tejet... Bashkë me krizën ekonomike po kalo-

[5] *Nga jeta dhe veprimtaria e shkrimtarëve tonë* (Intervistë me Sterjo Spassen), „Zëri i rinisë", Tiranë, 1973, 22 shtator.

[6] Jorgaqi, Nasho: *Romani „Pse?!..." dhe fillimet letrare të Sterjo Spasses*, B. U. SH. T., Seria: Shkencat shoqërore, 1958, nr. 4 f. 143.

jmë edhe një krizë mendore... një shterpësi letrare..."ndërsa dy vjet më vonë shkruan: „Shtojmë se kemi edhe krizë mendore, po, krizë letrare, shtërpësi mendore".[8]

Në rrethana të tilla të zhvillimit të kulturës dhe të letërsisë shqiptare, në vitet e krizës së përgjithshme shoqërore, kur zhvillimi i mendimit demokratik dhe revolucionar pengohej nga qeveritarët dhe shërbëtorët e tyre, vepra letrare e Gorkit pati jehonën më të madhe dhe ndikoi fuqishëm jo vetëm në zgjimin e vetëdijes sociale të shkrimtarëve tanë përparimtarë të brezit 1935 dhe më vonë, si te Migjeni, Shuteriqi, Varfi, Musaraj, Çaçi, Stafa, Bulka etj., por edhe te lexuesit e tjerë. Disa shkrime të Gorkit qenë përkthyer në gjuhën shqipe që nga viti 1920 dhe u botuan në „Shkëndija". Por, gjatë viteve 30 emri i Maksim Gorkit bëhet aq i njohur në Shqipëri, sa që veprat e tij dhe artikujt kritikë për krijimtarinë e tij letrare, ribotohen edhe në faqet e revistave zyrtare „Shekulli XX" dhe „Diana" me gjithë se... këtu zgjidhen ato vepra të shkrimtarit që nuk kanë përmbajtje të theksuar politike".[9]

Gjatë vitit 1932, por edhe më vonë, në revistat e kohës si në „Bota e Re", „Fryma e Re", „Rilindja", „Ilyria", „ABC", „Arbëria", „Minerva" etj., u shtuan dukshëm pjesët e botuara nga Gorki. Të veçojmë me këtë rast, tregimet „Dashnori i saj, „Një herë në vjeshtë", „Nëna", „Nëna e tradhëtorit", Një hero, Heroizmë", Urotopi shekullore", „Luftë... dhe kundër lufte", „Njeriu", „Khami dhe biri i tij", „Një vashë e vogël", „Sahati", „Njëzet e gjashtë dhe një", „Një natë vjeshte", „Në burg", „Kurbatka e bukur (variant jo i plotë i veprës „Makar Çudra"), pjesë nga „Përralla të Italisë", „Kënga e lajmëtarit të shtërngatës", „Para jetës", „Bashkëudhëtari im" dhe dhe ndonjë poemë e tij.

Spasse, si dhe shkrimtarët e tjerë bashkëkohës, që i impresionuar nga vepra letrare e Gorkit. Tematika e trajtuar në tregimet dhe në romanin „Nëna", idetë revolucionare, qartësia ideologjike, pra vlera e përgjithshme ideore dhe estetike, bënë që jo vetëm ta lexojnë dhe rilexojnë Gorkin, por të bëhen partizanë të denjë për zbatimin e ideve të tij. Të frymëzuar nga ai i dhanë letërsisë sonë një frymë të re, me elemente më të theksuara realiste dhe revolucionare. Adrea Varfi në mënyrë të voçantë e shtron çështjen e ndikimit që kanë pësuar nga shkrimet e Gorkit shkrimtarët tanë si edhe shumë shkrimtarë të tjerë të botës. Me Gorkin e sidomos me „Nënën" — shkruan Varfi-u edukua të gjithë shkrimtarët e Shqipërisë së Re. Te Gorki këta, përveç mjeshtrisë,

---

[8] Stespa (Pseud: S. Spasse): *Kritika letrare ndër ne.* „Demkroatia", Gjirokastër, 1933, nr. 407, (4 nëndor)

[9] Spase, Sterjo: *Një lesheli në letërsinë tonë.* „Demokratia". Gjirokastër, 1935, nr. 449. (22 janar),

[10] Angoni, V- Manjkovskaja G: *Përkthimet e Gorkit në Shqipëri.* „Nëndori", Tiranë, 1961, nr. 6, f. 108.

mësuan t'i duan me gjithë zemër njerëzit e thjeshtë, mësuan të largohen nga idealizimet boshe dhe të shikojnë realitetin ashtu siç është. Nga dy-tri skica të shkrimtarit tonë të madh, Migjenit, mbi jetën e malësorëve shqiptarë të shkruara sipas frymës gorkiane, lexonjësi njeh shumë më tepër realitetin e malësive tona".[10] Nga kujtimet e tij mësojmë se ndikimi i Gorkit ishte veçanërisht i madh në gjithë brezin e të rinjve letrarë të viteve 30 dhe sidomos për „edukimin revolucionar të punëtorëve dhe shkollarëve". Për veç romanit „Nëna" sa kishte lexuar tregimin „Lexonjësi" i cili i kishte lënë mbresa të pashlyera. „Me atë tregim-shkruan Varfi Gorki na tregoi rrugën që duhej ndjekur në Letërsi".[11]

Në veprën poetike të Aleks Çaçit, i cili shkroi edhe gjatë viteve 30' gjejmë gjurmë ndikimi nga vepra letrare e Gorkit. Ai shkruan: „Lexoja „Nënën" e Gorkit dhe autorë të tjerë revolucionarë dhe doja që nën shembullin e tyre të çfaqja edhe unë me shkrimet e mia solidaritetin me të varfërit dhe me të shtypurit dhe urrejtjen për shfrytëzuesit".[12] Diçka e ngjashme ka ndodhur edhe me Dhimitër Shuteriqin, Shevqet Musarajn, Petro Markon, Esad Mekulin, Vedat Kokonën etj., në formimin e të cilëve ka ndikuar pozitivisht Maksim Gorki. Spasse disa herë me radhë pohon ndikimin e drejtëpërdrejtë nga Gorki. Në parathënien e botimit të romanit „Nëna" në shqipet të vitit 1955, ai shpreh mendimin se në kohën kur për herë parë u përkthye romani „Mungonte eksperienca dhe qartësia ideologjike... Për të fituar një eksperiencë e për t'u sqaruar më mirë ideologjikisht-përveç faktorëve të tjerë në atë kohë e në ato rrethana ndikoi edhe përkthimi i romanit „Nëna"... Punëtorët e fshatarët tanë e të rinjtë e asaj kohe, si bleta mbi nektarin, lëshoheshin mbi faqet e këtij romani për të kërkuar të vërtetën. Përmes kësaj të vërtete, që gjenin në roman, zbulonin realitetin e regjimit shtypës, shtonin dita-ditës urrejtjen kundra atij dhe gjenin mënyrat më të përshtatura për të luftuar. Se me të vërtetë te romani „Nëna" punonjësit tanë gjenin pelinin e hidhur të jetës së tyre: vuajtjet që hiqte protagonisti i romanit Pavle Vllasovi me shokë, ishin vuajtjet dhe të zezat e tyre..., shkrimtari i madh sovjetik Maksim Gorki, si një lajmëtar i gjallë, hyri në çdo shtëpi punëtori e fshatari, në çdo shtëpi studenti dhe intelektuali shqiptar dhe përmes personazheve të romanit të vet u fliste në gjuhën shqipe, u zbulonte të këqiat e sistemit feudo-borgjez dhe u tregonte një rrugë shpëtimi..."[13]

Gjatë fazës së dytë të krijimtarisë letrare, pasi kishte botuar romanin e mohimit „Pse?", Spasse shkroi pamflete, proza alegori-

[10] Varfi, Andrea: *Drita e Gorkit.* „Nëndori", Tiranë, 1956, nr. 7, f. 137.

[11] *Po aty, f. 137.*

[12] *Në krijimtarinë tonë të pasqyrojmë jetën e popullit punonjës* (Intërvistë me Aleks Çaçin). „Zëri i rinisë", Tiranë, 8 dhjetor 1973.

[13] Spasse, Sterjo: *Parathënie.* Në veprën e Maksim Gorkit „Nëna", Tiranë, 1955, f. 3-4.

ke, skica, tregime, novela dhe romanin e pohimit „Afërdita". Prozën tregimtare e karakterizon përmbajtja e gjerë sociale, fryma e theksuar kritike, naracioni më i zhdërvjelltë dhe qartësia ideologjike. Në to qiten në shesh padrejtësitë shoqërore ekonomike të kohës së regjimit absolut në Shqipëri dhe goditën plagët sociale të së kaluarës. Ai bëhet zëdhënës i idealeve progresive të fshatarësisë dhe të vegjelisë në përgjithësi. Proza alegorike dhe pamfleti, të cilat forma Gorki i quante „Letërsia jonë militante" janë arterje që i dhanë gjak të ri letërsisë së shëndoshë shqiptare të viteve 30. Ky është padyshim ndikim që ka ushtruar proza gorkiane dhe ajo e shkrimtarëve të tjerë progresivë. Në prozën e këtij lloji trajtohej problematika shoqërore dhe politike aktuale. Në mënyrë alegorike çjerrej maska e pseudopatriotëve të vendit, akuzohej aparti shtetëror në fuqi, stigmatizohej morali i kalbur i klasave sunduese dhe herë pas herë tregohej grushti i fortë që do ta përmbyste botën e vjetër. Meqenëse cenzura ishte shumë e rreptë, shumica e shkrimeve me përmbajtje të këtillë nuk botoheshin. Spasse lidhur me këtë thotë: „Me gjithë atë ca shkrime më dhembin akoma pse kanë mbaruar në shportën e redaksive pa lënë nishan".[14]

Kur analizohet përmbajtja dhe idetë e këtyre prozave alegorike dhe e pamfleteve, mund të hetohet fare mirë kthesa e fortë që kishte bërë Spasse në letërsi. Për shkrimtarin është hapur horizont më i gjerë pikëpamjesh, shprehen ide thellësisht progresive. Për ndryshimin e gjendjes ekzistuese luftonin jo vetëm shkrimtarët përparimtarë, por edhe shtresat e vegjelisë shqiptare. Jarë këto vite të rezistencës që i bëhet regjimit absolut me anë të krijimtarisë letrare, me demostratat dhe në forma të tjera. Gjithë kjo tregon bindshëm për zgjimin e vetëdijes klasore dhe revolucionare.

Duke filluar nga viti 1935 Spasse boti pamfletet dhe prozat alegorike „Bota e çthurr?...", „Nga shënimet e një Diogjeni të Ri", „Dallëndyshe, ktheja ndryshe ..." „Kushtrimi i orave", „Skandal? Jo, aspak?", „Ajka e botës " etj. Autori ngreh zërin kundër mentalitetit, moralit dhe ideologjisë feudalo-borgjeze, kundër pabarazisë sociale dhe ekonomike. Heronjtë e këtyre prozave janë dhënë nëpërmjet alegorisë, por me nota të theksuara realiste. Për të demaskuar marrëdhëniet feudalo-borgjeze në pamfletin „Bota e çthurr!" Spasse i jep heroit të vet porosi të rëndësishme në jetën shoqërore, që të qëndrojë, e jo të dorëzohet ndër kundërshtime"... Ti duhet të rrosh! Të rrosh që t'i kallxosh botës të vërtetën! Të rrosh që të mësosh turmën për të shijuar të vërtetën... Të rrosh, po të rrosh si një kreshnik ndërmjet egërsirash: Puno për ideal, fol për të vërtetën, shkel mbi kërma pa mëshirë dhe lufto shpifjen, padrejtësinë, gënjeshtrën!.. Të rrosh,

---

[14] *Nga jeta dhe veprimtaria letrare e shkrimtarëve dhe artistëve tonë.* (Intervistë me Sterjo Spassen), „Zëri i rinisë", Tiranë, 22 shtator, 1973.

po, po, të rrosh, si me forcë mbinjerëzore gjer sa të krijohet një jetë e re me njerëz të rinj! Pra, jeto dhe puno për edealin e caktuar".[15]

Gjendja e vështirë në të cilën gjendeshin shtresat e varfëra, e kishte shqetësuar shkrimtarin. Ai u përkiste po atyre shtresave që ishin të robëruara, prandaj bënte pyetjen: „Kur... kanë për të pushuar vajet, kujet e ulurimet e popullit të robëruar shqipëtar?!" dhe bënte përpjekje të pandërprera për të gjetur rrugën e shpëtimit. Më 1936, në revistën „Bota e Re" të Korçës, kishte hapur „Shtyllën pedagogjike". Aty botonte vështrime lidhur me probleme të shumta të shkollës shqipe. Në një letër, dërguar po atë vit Taso Gushos, mikut të tij të ngushtë, shkruante: „... Po, Korça ishte atëherë qendra e një lëvizjeje të gjerë progresive kulturale. Revistat „Rilindja", më vonë „Bota e Re" e dy gazetat e mbanin gjallë pjesërisht Korçën e vdekur ekonomikisht. Ne merrnim pjesë edhe si lexues edhe si aktivistë të kulturës". Që nga viti 1937 deri më 1941 në Shqipëri nuk u botua më asnjë krijim letrar i Gorkit. Ishte ndaluar rreptësisht përhapja e veprave të tij, por edhe literatura tjetër nëpërmjet së cilës propogandoheshin idetë antifashiste dhe socialiste.

Spasse vazhdoi pa ndërprerje veprimtarinë letrare. Meqë më së tepërmi e preokuponin problemet e arsimit dhe të emancipimit shoqëror dhe problematika sociale, më 1936 filloi të shkruajë romanin „Afërdita". Pikëpamjet sociale të autorit kishin evoluar. Ai më në fund kishte përqafuar bindjen, edhe pse të kufizuar, se arsimi është faktor vendimtar për transformimin progresiv të shoqërisë shqiptare. Vepra ishte përfunduar dy vite më vonë më 1938. „E mbaj mend si sot-shkruan Tasi Gusho — kur Sterjoja më ka erdhë në shtëpi, në pranverën e vitit 1938, me dorëshkrimin e romanit „Afërdita" nën sqetull. Atëherë i kishte vënë titullin „Mësonjësja ideale". Dhe sikur vazhduam ta lexonim romanin ditë e natë me radhë. Sterjoja e lexonte dhe unë e dëgjoja me vëmendje e mbaja shënime për të bërë pastaj vërejtjet e mia".

Romani ishte pëlqyer nga të gjithë ata që e kishin lexuar në dorëshkrim. Spasse veprën e tij të gatshme për shtyp dhe një letër, ku jepte sqarime lidhur me heroinën Afërdita dhe rrethanat në të cilat e kishte shkruar veprën, nga Korça ia dorëzoi Ministrisë së Arsimit për të dhënë lejen e botimit. Meqenëse përmbajtja e letrës nuk është e njohur deri tani, po japim ndonjë pjesë më interesante të saj. Autori i drejtohet Aleksandër Xhuvanit:"... Pse e kemi zgjedhur për protagonist një mësonjëse e jo një mësonjës? — mund të më pyesni. Arsyet janë këto: Jeta shoqërore shqiptare, sidomos jeta fshatare, nuk mund të përmirësohet, po s'u fillua përmirësimi nga thelbi i familjes, më fort nga nëna e nga motra... Në përpilimin e romanit më tepër jam munduar te për

[15] Spasse, Sterjo: *Kurora e rinisë*, Tiranë, 1963, f. 28-29.

shkruaj jetën e vërtetë të një arsimtari të aratisur nëpër fshatrat e mënjanuar. Shumë pjesë të romanit i kam jetuar vetë para disa vjetëve; edhe shumë pjesë të tjera janë pasqyra e vërtetë e jetës së shumë shoqeve e shokëve, që po kryejnë edhe sot (1938) misionin e tyre (andaj nëpër thellësirat) e Shqipërisë me hyllin e guximit e të shpresës në ballë". Më tutje arsyeton idealizimin që kishte bërë lidhur me triumfin e Afërditës:" Edhe pse do të shihni një shkollë të re ideale... kjo shkollë e ëndërruar është simboli i një përpjekje të parreshtur të arsimtarëve tanë të rinj, është dëshira e pashterur dhe flaka vepronjëse e kush e di të sa zemrave arsimtaresh e arsimtarësh, që horvaten në heshtje përmes pengesave për të krijuar shkollën e re, shkollën që do të pasqyrojë jetën dhe natyrën tonë, dmth. shkollën e nesërme shqiptare për nxënësin shqiptar ... Jam munduar t'i jap romanit tem një frymë shqiptare, një tërësi shqiptare. Jam munduar të përshkruaj ato që ngjanë or'e çast përpara syvet tonë dhe kam menduar për të ardhmen ato që mund të bëhen njëmendësi. Kam dashur AFËRDITA-protagoniste e romanit — të mos jetë një mësonjëse e idealizuar shumë, por një mësonjëse që mund të dalë vërtet nga brumi thjesht kombëtar..." Autori shpreh mendimin se kontributi i arsimtarëve përparimtarë, e sidomos i atyre të qytetit për ngritjen dhe arsimimin e fshatarësisë ka një rëndësi vitale për zhvillimin e gjithëmbarshëm të shoqërisë shqiptare. Kah fundi i romanit, atëherë kur ideja themelore e veprës sendertohet plotësisht, autori vlerëson lart bashkëpunimin midis arsimtarëve përparimtarë për të kryer si duhet misionin e rëndësishëm shoqëror. Sepse, triumfi i Afërditës në Grykas dhe Pishas dhe mrekullitë e saj në lëmin e arsimit dhe të edukimit, për emancipimin e femrës shqiptare dhe për zgjimin e fshatit, paraqiten si fitore e tërë arsimit të ri shqiptar.Gjithë kjo entuziasmon lexuesin e romanit „Afërdita" dhe e angazhon maksimalisht për përparimin dhe lulëzimin e përgjithshëm të shoqërisë.

Pas Luftës Nacionalçlirimtare, „që në javët e që në muajt e para të çlirimit", Spasse vazhdon të shkruajë skica e tregime me temën aktuale. Përshtypjet që kishte pasur nga leximi i veprave të Gorkit dhe nga bisedat me Ali Këlmendin, me luftëtarin e paepur të lëvizjes komuniste shqiptare, kishin mbetur të pashlyeshme. Pas një dekade krijimtarie letrare në frymën e realizmit kritik, kishte akumuluar përvojë të pasur ideo-artistike. Deri në këtë kohë Spasse në prozën e tij kishte dhënë tablo të gjera të jetës së shoqërisë shqiptare, jetën dhe luftën e vegjëlisë, të fshatarëve e të arsimtarëve, por zgjidhjen e atyre problemeve nuk arriti ta bëjë drejt, në pajtim me ligjshmëritë e zhvillimit historik-shoqëror dhe me rrethanat e përgjithshme sociale të shoqërisë shqiptare.

Më 1945 vazhdoi të shkruajë romanin e ri „Ata nuk ishin vetëm" me titullin e mëparshëm „Harbutët", në të cilin, më tepër

se në çdo vepër tjetër, vërehet ndikimi i Gorkit. Romani ka një histori shumë interesante të krijimit. Ali Kelmendi qysh në vitin 1932, duke parë gjendjen e vështirë të fshatarësisë shqiptare dhe veçanërisht pasi kishte dëgjuar për tragjedinë e Goricarëve, kur Maliq bej Frashëri, me ndihmën e qeverisë dhe të oborrit mbretëror, i përzuri fshatarët e pafajshëm nga çifliku, i kishte thënë Spasses: „Ti vetëm hidhe në letër këtë të vërtetë". Pas nxitjes që i kishte bërë Ali Kelmendi, kishte filluar veprën, ku dëshironte të pasqyrojë ato ngjarje tronditëse. „Në mënyrë të mjegulluar dy kapituj-pikërisht „Dasmën e Xha Koroveshit" dhe „Beu" — shkruan autori — i shkrova para çlirimit..., në ndërgjegjen time përpunohej ideja kryesore, përpunoheshin tablot, rriteshin e merrnin formë edhe personazhet. Para çlirimit pata menduar që kaçaku Ismail, dalë maleve nga urrejtja që kishte për feudalët e që martonte vajzat e varfëra me paratë që ua rrëmbente të pasurve, të frymëzonte për luftë edhe fshatarin Gjikë Shpatin. Dométhënë se unë kisha mpleksur idetë e reja më përparimtare të kohës me një kaçak të shekullit XIX".

Deri më 1947 kur e dorëzoi për shtyp veprën „Ata nuk ishin vetëm", të parin roman shqiptar të pasluftës, ideja kryesore ishte kristalizuar si duhet. Shkrimtari, meqenëse kishe përqafuar parimet e metodës së realizmit socialist, në roman pasqyroi antagonizmat shoqërore dhe rezistencën që bënë fshatarët kundër marrëdhënievet skllavëruese, kundër shtypjes dhe shfrytëzimit. Romani, si ka vënë re Jorgo Bulo, është „provë e suksesshme e kapërcimit të dobësive e kufizimeve të romanit shqiptar të paraçlirimit, kryesisht tipare romantiko-sentimentaliste, dhe e kalimit në romanin e realizmit socialist. Si i tillë ai padyshim ka lojtur rolin e vet në rrugën e zhvillimit të romanit tonë të ri".[16] Romani, si për nga forma ashtu edhe me përmbajtjen që ka, me vlerën e lartë ideoartistike, shënon një hallkë të rëndësishme në rrugën e zhvillimit të romanit tonë të sotëm.

Vepra në pikëpamje kompozicionale është ndërtuar shëmbëllyeshëm me romanin „Nëna" të Gorkit. Pjesë të tëra janë analoge me ato të romanit „Nëna". Gjikë Shpati si personazh ka shumë veçori të Pavle Vllasovit.. Ja ky duket një Pavle Vllasov! Jo, ky është Pavel Vllasov shqiptar", thuhet për personazhin kryesor të romanit „Ata nuk ishin vetëm". Kapitulli i shtatë përmban të dhëna të shumta me të cilat shpjegohet mënyra e ndikimit të veprës së Gorkit te lexuesit shqiptarë dhe në vetë shkrimtarin Spasse. Sepse, në veprën e Gorkit u dha një vizion i zgjeruar historik mbi përspektivën më të ndritshme të shoqërisë së re, për një jetë „të bukur, të gjallë, dhe të ndershme".

[16] Bulo, Jorgo: *Nga historia e lindjes dhe formimit të romanit të sotëm shqiptar* („Ata nuk ishin vetëm" i S. Spasses). „Studime filologjike", Tiranë, 1968, nr. 2, f. 166.

Nëpërmjet të personazhit Ana është shpjeguar fare mirë çështja e ndikimeve që ka pësuar Spasse nga literatura e lexuar dhe në veçanti nga „Nëna" e Gorkit. Vetëm pasi kishte lexuar „Nënën" Ana „për një moment e kishte menduar lumturinë e saj të lidhur me përpjekjet për lumturinë e të tjerëve..." „Materiali për demostratat e Korçës dhe përshkrimi i atyre ngjarjeve është dhënë në ngjashmëri me disa pjesë të romanit „Nëna". Dhe, jo vetëm kaq, por „fshatari i panjohur me plagën e rëndë e që fliste aq kthjellтë e aqë mirë, ishte tamam si personazhet e Gorkit, që përpiqeshin për një botë të re në Shqipëri". Përfundimi kuptimplotë, sendërtimi i idesë themelore të veprës, mënyra se si është dhënë zgjimi i vetëdijes së fshatarësisë për të luftuar vendosmërisht për çlirim të plotë, flasin bindshëm për analogjinë midis këtyre veprave letrare dhe për mësimin e dobishëm që Spasse mori nga shkrimtari Maksim Gorki.

Megjithatë, Spasse nuk bëri imitim të thjeshtë nga vepra e Gorkit. Meqë tregoi talent të rralë për t'u marrë me letërsi, me imagjinatë të bujshme, duke qenë njohës i mirë i jetës shqiptare, i atmosferës së përgjithshme që dominonte atëherë, gjatë atyre viteve të vështira për fshatarësinë shqiptare, arriti në mënyrë plastike e me shumë ngrohtësi, të na tregojë për ngjarjet dhe njerëzit, me dashurinë më të madhe ndaj vegjëlisë dhe me urrejtjen e pashembëllt ndaj shfrytëzuesve të çdo lloji, të japë vepra me porosinë e thellë humanitare dhe revolucionare, të cilat u mbeten brezeve si një dhuratë e çmuar.

FONDACIONI KULTUROR „HARPA"
STERJO
SPASSE
AUTOR I
MBI 1000
PERSONAZHEVE
1914 - 2014
PANAIRI I LIBRIT
„FIERI 2014"
6 MAJ - 11 MAJ 2014

IX.

TRAJTIMI I TEMËS SË RILINDJES KOMBËTARE SHQIPTARE NË ROMANIN TONË TË SOTËM

Epoka e Rilindjes Kombëtare Shqiptare është gurrë shumë e pasur tematike, nga e cila shkrimtarët tanë bashkëkohës mund të zgjedhin lëndë interesante për ta trajtuar në veprat e tyre letrare. Lidhja e Prizrenit si ngjarje me rëndësi të madhe historike kombëtare, që pati jehonë të fuqishme edhe jashtë viseve shqiptare, si edhe luftërat e mëvonshme të popullit shqiptar për liri nacionale deri më shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë më 1912, kanë frymëzuar krijuesit popullorë, shkrimtarët e letërsisë së Rilindjes, të periudhës së pavarësisë midis dy luftërave botërore dhe ata të letërsisë së sotme shqiptare që duke trajtuar tema të ndryshme, të përjetësojnë në letërsi këtë epokë të ndritur dhe të sendërtojnë në një plan më të gjerë idenë patriotike të pathyeshmërisë popullore.

Në letërsinë tonë të sotme, gjatë të gjitha fazave të zhvillimit të saj, veçanërisht gjatë këtij viti jubilar të njëqindvjetorit të Lidhjes së Prizrenit, ky burim i pashterrshëm motivesh dhe temash pjesërisht është shfrytëzuar për realizime artistike në poezi, në prozë dhe në dramaturgji. Në kuadër të prozës së sotme, posaçërisht gjatë viteve të fundit, janë krijuar edhe disa romane ku në gjerësi epike është synuar të jipet frymëmarrja e epokës së Rilindjes sonë Kombëtare.

Pas fitores së madhe të Luftës Nacionalçlirimtare, me qëllim të ndriçimit sa më të gjithanshëm shkencor të periudhës së Rilindjes, për historiografinë e re shqiptare u shtruan detyra të rëndësishme, ndërsa për historinë e letërsisë kërkesa të ngutshme që të studiohet thesari kulturor dhe letrar i traditës. Duhej mbledhur dhe studiuar materialet e shumta folklorike, dokumentet e shkruara, shtypin dhe veprat e tjera, që i përkisnin Rilindjes. Në të njëjtën kohë duhej gjallëruar aktivitetin e përgjithshëm kulturor dhe shkencor për të ndriçuar më mirë figurat historike dhe letrare të Rilindjes. Në saje të kësaj kthesa pozitive në tërësi, u shtua interesimi për të trajtuar tematikën e Rilindjes në vepra gjinish të ndryshme letrare dhe sidomos në romane.

Në kohën kur romani shqiptar për kah niveli sasior dhe cilësor nuk ishte konsoliduar, brezi i shkrimtarëve me përvojë më të pasur letrare, që kishin filluar krijimtarinë letrare gjatë vite-

ve tridhjetë, u tregua më i shkathtë dhe për krijimin e disa poezive, të tregimeve dhe të disa romaneve, iu kthye kësaj epoke të së kaluarës sonë heroike. Këta shkrimtarë, si edhe krijuesit e brezave të mëvonshëm, të vetëdijshëm për vështirësitë e shumta që dilnin në rrugën e krijimtarisë, me që ky brumë nuk ishte shtjelluar në vepra romaneske, nuk e patën të lehtë realizimin e projekteve më voluminoze të prozës me të cilat tematika dhe idetë nga historia e Rilindjes transponoheshin në formën artistike. Për krijuesit e romaneve historike dhe sociale ishte e domosdoshme përgatitja e gjithanshme: njohja e historisë, të kuptuarit drejt të synimeve shekullore të popullit tonë gjatë shekujve, njohja e kulturës materiale dhe shpirtërore, njohja e atmosferës së përgjithshme shoqërore-politike brenda dhe jashtë vendit, pra njohja e të gjitha rrethanave në të cilat janë zhvilluar ngjarjet e rëndësishme të kohës. Në anën tjetër, autorët e këtij lloji romanesk kanë si obligim që këtë materie kaq komplekse nga e kaluara ta transponojnë artistikisht me vërtetësi historike.

Shkrimtarët më të njohur që në romane trajtuan temën e Rilindjes Kombëtare janë: Sterjo Spasse, Thoma Kacori, Maksut Shehu, etj. Veprat e tyre: „Zgjimi", „Pishtarë", „Për mëmëdhenë", „Qielli i përflakur", „Dielli lind në jug", etj., shtjellojnë lëndën e zgjedhur nga historia dhe, në saje të imagjinatës krijuese, sjellin aspekte të ndryshme të jetës së shoqërisë shqiptare të kohës. Prej këndej edhe personazhet e këtyre veprave janë figura të njohura historike ose personazhe të imagjinuara, të realizuara në mënyrë realiste gjatë procesit të organizimit të subjekteve të veprave letrare.

Shkrimtari veteran, Sterjo Spasse, gjatë fazës së tretë të krijimtarisë artistike, pas shumë romaneve sociale, vazhdoi të krijojë edhe vepra të tjera për të cilat shfrytëzoi tematikën historike. Përvoja e gjatë dhe e pasur krijuese e autorit, përpjekja e pandërprerë shumëvjeçare për të ndriçuar epokën e lavdishme të Rilindjes, bënë të mundur që t'i realizohet dëshira për të kristalizuar idetë dhe për të sintetizuar njohuritë lidhur me luftën e gjatë dhe të vështirë të popullit shqiptar për pavarësi kombëtare në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX. Prirja e theksuar për trajtimin e tematikës sociale është shprehur përsëri në procesin krijues. Edhe pse autori kishte synuar të krijojë romane historike, pra ciklin e romaneve me këtë tematikë, ka ngjizur edhe mjaft elemente të jetës sociale, duke i dhënë kështu veprës së vet veçori të romanit historik-shoqëror.

Romanet „Zgjimi" dhe „Pishtarë" që shquhen ndër veprat më të suksesshme të fazës së fundit të pjekurisë artistike të letërsisë së sotme, bëjnë hallkën e përbashkët të ciklit „Rilindasit" dhe kanë një tërësi të rrumbullaksuar kompozicionale. Në aspektin tematik dhe kohor vepra „Zgjimi" ngërthen në vete fazën e parë të Rilindjes brenda viteve 1885 dhe 1887 dhe ngjarjet më karakteristike të luftës për çlirimin kombëtar nga zgjedha otomane. Gjatë zhvillimit të subjektit është bërë edhe degëzimi tjetër për të paraqitur format e ndryshme të rezistencës kundër politikës shovi-

niste greke. Kjo është lufta për ..gjimin e vetëdijes kombëtare dhe në mënyrë të veçantë për përhapjen e shkrimit dhe të leximit të gjuhës amtare, pra për hapjen e shkollës shqiptare. Zhvillimi i ngjarjeve është vendosur në Korçë dhe në fshatrat e tjera rreth saj. Autori, duke dhënë atmosferën e përgjithshme sociale dhe politike në mbarë Shqipërinë dhe duke evokuar frymën patriotike pas Lidhjes së Prizrenit, në kolonitë e mërgimtarëve shqiptarë dhe në qendrat e jashtme ku prekej çështja shqiptare e shfaqeshin edhe aspirata të ndryshme ndaj tokave shqiptare, arrin të bëjë përgjithësimet artistike për këtë periudhë të lavdishme të historisë sonë. Në romanin „Pishtarë" kapen nyjet e tjera të rezistencës së organizuar dhe të luftës deri në prag të shpalljes së Hyrjetit, për të vazhduar pastaj në romanet e tjerë, për acarimin e gjendjes gjatë Hyrjetit, për kryengritjet e mëdha shqiptare në Veri dhe në Jug, sidomos për ndeshjet vendimtare të vitit 1911 dhe deri me ngritjen e flamurit në Vlorë më 1912. Shpallja e Republikës së Korçës është veçuar si „ngjarje me shumë rëndësi për pjekurinë e mendimit përparimtar shqiptar të kohës... kur njëri nga protagonistët e ciklit, Themistokli Gërmenji, bie therror në altarin e kombit me vetëdije të plotë se kështu e donte interesi i lartë i atdheut dhe i „opingës", si quanin rilindasit përparimtarë fshatarësinë dhe vegjelinë e qyteteve".

Realizmi në këto vepra të Spasses thellohet edhe më tej dhe si prirje e shtjellimit artistik fiton veçori të reja që i përgjigjen pjekurisë më të plotë. Rrëfimi epik bëhet më i zhdërvjellët dhe më i gjithanshëm, ndërsa zbërthimet lidhur me jetën, lidhur me karakteret, shtrihen në të gjitha koordinatat jetësore. Duke i qëndruar besnik parimit të trajtimit realist, arrin të bëjë përgjithësimet e duhura artistike dhe të realizojë vepra letrare me të cilat zgjerohet horizonti i njohjes sonë për jetën e shoqërisë shqiptare gjatë epokës së Rilindjes... Prosedeu romanesk i këtyre romaneve është prosede realist tradicional. Shkrimtari, me që ka grumbulluar material të pasur jetësor, me invencion ka zgjedhur temat, ka shtruar çështjet kryesore, dhe duke mos lënë anash faktet dhe fenomenet e realitetit të kohës, duke e soditur atë jetë nga pozitat e caktuara ideo-estetike dhe klasore, ka dhënë zgjidhje adekuate të problemeve të shtruara. Në këtë plan mjaft të gjerë ka lidhur ngushtë temat dhe idetë në tërësi kompakte kompozicionale.

Është pohuar me të drejtë se problemet e mëdha dhe idetë e mëdha janë karakteristikë e veprave të mëdha letrare të çdo epoke. Në rastin konkret kjo është veçori edhe e romaneve epope të Sterjo Spasses, ku i është kushtuar kujdes i madh organizimit të subjektit. Maksim Gorki, duke u bazuar në përvojën e krijuesve të tjerë dhe në atë personale, mendonte se subjekti përfshin... „lidhjet, kontradiktat, antipatitë e në përgjithësi marrëdhëniet reciproke të njerëzve, historinë e rritjes dhe të organizimit të këtij ose të atij karakteri". Ndërsa vetë karakteri social-historik i subjekteve e ka shtyrë këtë autor të përqëndrojë vëmendjen në ngjarjet dhe në konfliktet më të rëndësishme.



Një portret i panjohur
http://prizrenpress.com/kulture/sterjo-spasse-nje-portret-panjohur-nga-mikesha-ruse/ (16.02.2016)

Me ciklin e romaneve për Rilindjen Kombëtare Spasse ka dëshmuar edhe një herë aftësitë e mëdha krijuese për të realizuar vepra të mëdha dimensionesh të gjera kuptimore dhe është përpjekur të japë me vërtetësi shpirtin e popullit dhe fyrmën e vërtetë të historisë. Lufta patriotike për pavarësi dhe lëvizja autoktone iluministe janë dhënë të gërshetuara në një linjë duke rrezatuar herë-herë të degëzuar dhe kështu deri në fund ndikojnë fuqimisht për të realizuar karakteret tipike në ato rrethana tipike. Kur është fjala për sendërtimin e ideve themelore, duhet vënë në dukje edhe pikëpamjet e shkrimtarit të shfaqura qartazi. Sipas tij... „luftën e Rilindjes e bënë masat popullore të fshatit e të qytetit e se feudalët e borgjezia e pasur shqiptare, me ndonjë përjashtim të vogël, në tërësi kanë qenë me njëqind flamuj në xhep. Ideja tjetër e këtij cikli është vënia në dukje e karakterit mbifetar dhe mbikrahinor të lëvizjes kombëtare të Rilindjes, karakterit thellësisht demokratik, duke vënë njëkohësisht në pah se edhe të tërë veprimtarinë kulturore e arsimore e përshkonte karakteri a fryma laike përparimtare dhe iluministe...".

Shkrimtari është interesuar që jetën dhe historinë ta paraqesë „nga poshtë", pra ta paraqesë jetën e shtresave të gjera popullore. Në veprën e tij të njohur „Romani historik" Llukaçi ka pohuar se: ...„populli e përjeton historinë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Historia është lulëzimi dhe rënia e tij, zinxhir i gëzimeve dhe i vuajtjeve të tij. Nëse autori i romaneve historike arrin të gjejë njerëz dhe fate të atilla në të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë paraqiten përmbajtje të rëndësishme shoqërore-njerëzore, problemet, rrymimet etj., të një epoke, atëherë ai mund ta paraqesë historinë „nga poshtë", në bazë të jetës popullore".

Me qëllim të konstruktimit artistik të së kaluarës, në këtë cikël janë përfshirë të dhëna të shumta nga historia e Rilindjes, ngjarje dhe konflikte reale e të imagjinuara. Nga gjithë galeria e personazheve, disa prej tyre janë përjetësuar në letërsi si figura historike. Të kujtojmë me këtë rast Themistokli Gërmenjin, Jovan Kosturin, Mihal Gramenon, Bajram Currin, Gjok Mokrarin, Thimi Markon, Orhan Pojanin, Nikolla Naçon, Spiro Bellkamenin, Papa Kristo Negovanin dhe shumë të tjerë. Nga historia janë marrë gjithashtu edhe disa figura negative si, bie fjala, Maliq bej Frashëri, Mitropoliti Fillotheu etj. Autori nuk ka synuar të shkruajë biografitë e këtyre personave historikë, por të japë veçori të personazheve tipikë dhe nëpërmjet të këtyre personazheve të tjera, të paraqesë klasat dhe shtresat e ndryshme shoqërore. Në një intervistë, duke iu përgjigjur pyetjes se „Ç'përfaqësojnë heronjtë e romanit Zgjimi", Spasse pat thënë: „Heronjtë e romanit përfaqësojnë shtresa të ndryshme të shoqërisë sonë dhe të armiqve tanë. Personazhet pozitivë i bashkon jo vetëm gjaku, por edhe akubetet e përbashkëta. Fshatari nga Mokra, Gjok Shqiptari, e malësori nga Gora, Ali Zboqi, kaçaku Marko e me dhjeta fshatarë të tjerë të shtypur e të shfrytëzuar gjer në palcë nga feudalët vendas, memurët osmanllinj dhe nga klerikët, lidhen me mish e me shpirt me djaloshin korçar të shtresës së mesme, Themistokli

Gërmenjin, me punëtorin Vaskë Suvaxhiun, me kovaçin nga Kosova Rexho Dragobijan, me kovaçin vendas Hamit Efendinë, me të bijën e punëtorit Spiro Suvaxhiut — Margën... e me dhjeta të tjerë".

Brenda kornizave kaq të gjera të veprave autori ka përfshirë çdo gjë që i është dukur interesante dhe e rëndësishme: ngjarje të njohura dhe të panjohura, raporte dhe dukuri, mentalitete dhe psikologji, dashuri njerëzore me të gjitha finesat e holla të tyre, urrejtje të pakufishme, qëndresen dhe vdekjen heroike, sakrificat mbinjerëzore, shpresa dhe dështime, ngritje dhe rënie morale, fitore dhe disfata, barbarizma dhe rrënime, besën dhe tradhëtinë, gazin dhe vajin, të vërtetën dhe gënjeshtrën. Në kuadër të kësaj paraqitjeje epike të gjendjes sociale dhe të kushteve historike, në të cilat gjallërojnë shqiptarët në periudhën menjëherë pas Lidhjes së Prizrenit, rrëfimi përqëndrohet lidhur me ngjarjet aktuale të kohës. Fshatarët dhe zejtarët e varfër qajnë hallin e vet, sepse i kishte mbytur varfëria dhe shtypja e pamëshirshme, por qanin edhe hallin e rediféve të cilët luftonin dhe humbnin jetën, jo për atdheun e tyre të dashur po për „të sëmurin e Bosforit i cili i kishte ditët e numruara". Vend i rëndësishëm në roman i është dhënë Misto Gërmenjit, figurës së njohur historike. Për bukuri është paraqitur koha e fëmijënisë dhe formimi gradual i karakterit të tij. Nxënësi i dikurshëm, i cili adhuronte artin dhe kulturën helene, dikur pa vetëdije të zgjuar sa duhej, bëhet pastaj luftëtar i paepur për çështjen e atdheut dhe për përhapjen e alfabetares së shqipes. Krahas tij janë realizuar me sukses edhe personazhe të tjera siç janë: Rexho Dragobija, Gjok Mokrari, Ali Zboqi, Kaçaku Marko, Spiro Suvaxhiu etj. Veçanërisht spikat figura e Margës e cila është paraqitur si vajzë e bukur dhe e dashur, e kthjellitë në mendime, guximtare dhe e pajisur me ndjenja të zjarrta të atdhedashurisë. Bota e saj emocionale është shumë e pasur. Si vajzë e re dhe si grua, jetës i ka dhënë një kuptim themelor: të jetojë për të luftuar për përhapjen e shkrimit dhe leximit të shqipes si dhe për fitimin e pavarësisë kombëtare.

Personazhet pozitive tipizohen në mënyrë të gjithanshme: në rrethin familjar, në lagjet e banimit, në qytete dhe në fshatra si dhe në ambiente të tjera ku i sillte detyra patriotike dhe shoqërore për çlirimin e vendit nga Turqia: në luftë kundër aneksionit grek, kundër Mitropolisë e klerit në përgjithësi, kundër feudalëve dhe elementeve të borgjezisë së re. Miston e gjejmë me fshatarët, me mërgimtarët, e gjejmë në përpjekje të vazhdueshme për t'i sqaruar shumëçka vetvetës dhe të tjerëve dhe gjithnjë të brengosur për fatin e atdheut. Ndjenja e atdhedashurisë e lidh të riun edhe më tepër me patriotët e tjerë. Gjithë kjo bën që zemra t'i gufojë për gjuhën shqipe dhe për „atë librin jastëk, që e barti njëzet ditë në kurriz Gjok Mokrari në konizmën e çuditshme". Atij gjithnjë e më tepër i shtohet guximi për t'u ndeshur ballë për ballë me armiqtë shekullorë, me bejlerët e agallarët, me dhespotin gjakpirës Fillothe, me kryemurgeshën Evdhoksinë dhe

me arkimadritin. Në të njëjtën kohë lufton ashpër kundër borgjezëve korçarë siç janë paraqitur në roman Taqi Mangaleci dhe Petraq Kanduraj etj. Figura e Mistos nuk mund të mendohet e izoluar nga breza të tërë luftëtarësh të periudhës së Rilindjes siç janë: Marga, Rexho Dragobija, Seloja, Nasi Gurra, Xoxe Qirazhiu, Kolë Dika, Muço Berberi, Mihal Grameno, Spiro Bellkameni, Bajram Curri, Bajo Topulli, Papa Kristo Negovani, etj. Në kundër të antagonizmave të ashpërsuara shoqërore dhe politike, janë skalitur me mjeshtri personazhet e veprave letrare dhe janë spikatur idetë që përmblidhen në lidhjen e pasqyrimit të luftës për liri. Përveç kësaj, edhe tablotë e dendura të jetës sociale i kanë ndihmuar që personazhet t'i karakterizojë edhe në planin e gjerë shoqëror.

Krahas personazheve është bërë edhe tipizimi i ambienteve. Nëpërmjet të përshkrimeve funksionale që lidhen me aspekte të rëndësishme të veprës, jipet atmosfera e plotë jetësore. Tipat e realizuar në ambientet tipike të kohës shquhen me tiparet e përgjithshme, por edhe me ato individuale. Fshati dhe jeta në të është paraqitur në mënyrë plastike me të gjitha veçoritë karakteristike. Përveç ambienteve familjare, kemi në këto romane edhe pamje më të plota të fshatit, të qytetit dhe të zonave malore. Në disa fragmente të romaneve janë dhënë tablo murale ku me përpikëri, si në hartat gjeografike topografike, janë fiksuar lokalitetet, shtëpitë, monumentet, malet, lumenjtë dhe gjithçka tjetër që ka mundur të jetë funksionale në kuadër të përmbajtjes ose të formës artistike. Lexuesi i ndjen emocionalisht oscilimet e jetës shpirtërore të fshatarësisë dhe të vegjëlisë në përgjithësi: gëzimin, pikllimin, shpresat për jetë më të mirë dhe të lumtur, dashurinë në kuptimin e gjerë të fjalës, por edhe frigën e pasigurinë në atë jetë të trazuar. Ndjenja e krenarisë kombëtare se janë shqiptarë, se janë të varfër por të ndershëm, u jep atyre forcë dhe i bën më të guximshëm për të luftuar dhe për të rënë për atdhe. Të kujtojmë episodet rrënqethëse të fundit tragjik të jetës së Gjok Shqiptarit, të kaçakut Marko, të Nasi Gurrës, vrasjen mizore të Papa Kristo Negovanit, vdekjen e dhimbshme të Pandeliut, të Kristo Oparakut etj. Megjithëse në romane flijimet dhe tragjika njerëzore zënë hapësirë të gjerë, jetës i është thurur apotheozë që lë mbresa të pashlyeshme. Pamjet e natyrës shqiptare, jeta e njerëzve pjesëtarë të të gjitha shtresave dhe klasave shoqërore, procesionet fetare në mitropoli dhe në tempuj të tjerë të fesë, shkëlqimi i rrejshëm dhe pompoz në to, errësira dhe vrazhdësia e jetës në manastire, atmosfera e rëndë në burgje dhe torturimet e tmerrshme të xhelatëve anadollakë e të fanarit grek, të bejlerëve etj., në një anë, dhe pafajsia e njerëzve të thjeshtë, rritja e idealit kombëtar të lirisë, e revoltit dhe e heroizmit të çetave të para që formoheshin si zjarrishte, forcimi i moralit të ri të kryengritësve, në anën tjetër, janë pikturuar me forcë emocionale dhe impresionojnë si faqet e zgjedhura të prozës sonë më

të bukur. Këto janë disa nga meritat e mëdha të këtij shkrimtari dhe vlerat kryesore ideore dhe estetike të këtyre romaneve-epope ku trajtohet me sukses tema e Rilindjes Kombëtare.

Në dy romane të tjera ku gjithashtu është trajtuar me sukses tematika e Rilindjes sonë Kombëtare, përfshihen ngjarjet që nga viti 1906 dhe deri më 1912. Derisa vepra „Për mëmëdhenë" e Thoma Kacorit ka si përmbajtje luftën e popullit shqiptarë kundër Turqisë dhe pushtuesve grekë në Shqipërinë e Jugut (në krahinën e Kolonjës), romani i Maksut Shehut „Dielli lind në jug" përjetëson artistikisht luftën patriotike për pavarësi të shqiptarëve të Kosovës gjatë korrikut dhe gushtit të vitit 1912.

Thoma Kacori, para se të krijojë romanin e parë të letërsisë së sotme me temën e Rilindjes, u shqua me tregimet në të cilat shtjelloi tema patriotike dhe sociale. Pasi fitoi përvojë të duhur letrare, me përkushtim të madh krijues filloi të shfrytëzojë temën historike. Ai përqëndroi vëmendjen e vet në paraqitjen e gjendjes sociale të popullit shqiptar dhe të luftës për çlirimin definitiv nga Turqia. Meqenëse edhe pas shpalljes së pavarësisë, gjatë vitit 1913, vazhdohej lufta për ruajtjen e tërësisë së tokave shqiptare, autori i kushtoi hapësirë të duhur rezistencës kundër synimeve pushtuese greke. Nëpërmjet të dy linjave kryesore të paraqitjes së jetës e jep luftën patriotike për pavarësi kundër të huajve dhe kundër tradhtarëve të vendit dhe dashurinë midis dy të rinjve.

Pjesët më të realizuara artistikisht janë ato ku në gjerësi paraqitet trimëria dhe heroizmi i luftëtarëve për ruajtjen e dinjitetit njerëzor dhe për çlirimin e mëmëdheut, fati i familjes së Resul Çelimarës, pjesëmarrja e çetave shqiptare dhe e shtresave të gjera në luftë, trimëria e gruas shqiptare dhe patriotizmi i saj, antipatriotizmi i klasës sunduese, shtypja, shfrytëzimi dhe masakri i të huajve në popullsinë e pafajshme etj.

Disa ngjarje, fakte dhe personazhe të kësaj proze njihen mirë nga historia, prandaj bazën e përmbajtjes e bën materiali dokumentar. Edhe vetë subjekti letrar është organizuar duke u mbështetur në realitetin e kohës. Me që shkrimtari, në saje të imagjinatës ka trilluar dhe ka krijuar ngjarjet dhe personazhet e tjera dhe të gjitha këto i ka gërshetuar brenda tërësisë kompozicionale, vlera e romanit nuk është cenuar.

Nga galeria e tërë personazheve me shkathtësi të madhe janë tipizuar fshatarët dhe zejtarët. Ata nëpërmjet të veprimeve shquajnë tiparet më qenësore të karakterit, të tyre. Posaçërisht spikat figura e Resul Çelimarës, e realizuar në mënyrë graduale prej një fshatari pa vetëdije plotësisht të zgjuar sociale dhe patriotike, sepse hallet e jetës së vështirë kishin lënë vrragë, deri te luftëtari i zjarrtë për çlirimin e Atdheut. Personazhet e tjera më të realizuar janë: Tafili, Hodoja, Zaloja, Kapedani (Nuçi Martina), Nënë Zadeja, Symeja etj. Nga radhët e armiqve dallohen: Caco Beu, Sherif efendiu, Zoti Anastas, Copuros etj.

Romani „Për mëmëdhenë" ka vlerë të lartë ideore dhe artistike. Ai shquhet ndër veprat e këtij lloji me karakterin e thek-

suar emocional dhe figurativ, me stilin dhe gjuhën e pasur si dhe me shkallën e motivimit të materialit jetësor. Megjithatë, pas analizës së vëmendshme, kemi përshtypjen se kjo vepër ka të meta të natyrës kompozicionale. Përsëritja dhe shprehja jo aq e kondensuar, përfshirja e disa elementeve melodramatike, e disa skenave dhe përshkrimeve të pamotivuara sa duhet etj., gjithsesi kanë ndikuar në vlerën e përgjithshme të këtij romani të rëndësishëm të letërsisë sonë bashkëkohëse.

Romani i Maksut Shehut „Dielli lind në jug" në aspektin tematik kap ngjarjet më dramatike të kryengritjes shqiptare në Kosovë kundër Turqisë. Lënda e kësaj vepre është mjaft e pasur dhe është mbarështruar nëpërmjet të një linje qendrore. Në të, me vërtetësi historike, me përjashtim të disa episodeve, duke u bazuar në faktografinë e njohur historike, janë veçuar vetëm disa aspekte të luftës së përgjithshme popullore kundër zaptuesit shekullor. Zhvillimi i ngjarjeve është lokalizuar në Prishtinë dhe në rrethin e saj, pra vetëm në një cep të Kosovës, ku kryengritjet kishin marrë përpjesëtime të mëdha. Autori ka bërë përgjithësime të atilla artistike për të paraqitur atmosferën e përgjithshme që ka zotëruar në ato vite, në prag të fitimit të pavarësisë së shtetit shqiptar. Në këtë vepër autori ka synuar të organizojë një subjekt të atillë ku logjika e zhvillimit të ngjarjeve i sjell njerëzit në sprova të shumta dhe në këtë mënyrë realizohen personazhet dhe idetë. Ndër këto personazhe që përfaqësojnë shtresa të ndryshme shoqërore dhe klasore dallohen: Metë Kosova, Ibë Rrahimi, Metë Kulina, Suta, Gjergji, Hasan Prishtina, Xhemë Begu, Pashk Bardhi i Janjës, Myftar Xhanallani, Himë Shurdhani, Pavli i Janjës etj. Midis tyre, si personazh më i plotë, lexuesit i lë mbresa Metë Kosova, udhëheqës i kryengritësve dhe luftëtar i paepur për çlirimin e vendit. Shkrimtari është përpjekur të japë fizionominë fizike dhe morale të këtyre personazheve dhe të realizojë me sukses idenë themelore të veprës letrare.

Rilindja Kombëtare në tërësi, dhe veçanërisht Lidhja e Prizrenit, ka pasur rëndësi të jashtëzakonshme për pavarësinë dhe emancipimin kombëtar të popullit shqiptar. Nga gjithë historia jonë kombëtare në këtë epokë gjejmë nyje dhe kthesa të forta të luftës për ekzistencë kombëtare. Dimensionet e kësaj lëvizjeje shumë të gjerë, që pati jehonë të fuqishme në të gjitha periudhat e mëvonshme historike, kalojnë suazat e kufinjve kombëtarë. Prej këndej edhe interesimi dhe synimi i përhershëm i krijuesve tanë letrarë që mu aty të gjejnë frymëzimin dhe temat, pra të përjetësojnë në letërsi Rilindjen tonë Kombëtare. Romanet e krijuara deri tash me këtë tematikë, me gjithë vështirësitë dhe të metat e pranishme, paraqesin kontribut të rëndësishëm për letërsinë tonë të sotme. Kjo krijimtari, ku tema e Rilindjes trajtohet në gjerësi epike, duhet të vazhdohet dhe të intensifikohet edhe në të ardhmen, sepse zgjeron dhe begaton në shumë aspekte romanin tonë dhe letërsinë tonë kombëtare në tërësi.

Sterjo Spassse, autor i romanit “Pse?!”, 1935

X.

Isak Shema

VEPRA LETRARE E STERJO SPASSES NË KRITIKËN E HUAJ LETRARE

Shkrimtari veteran, Sterjo Spasse, duke vazhduar krijimtarinë letrare intensivisht, sivjet shënon pesëdhjetëvjetorin e veprimtarisë letrare. Që nga botimi i krijimeve të para më 1929 dhe deri më sot pa ndërprerje ai i dhuroi letërsisë shqiptare vepra dinjitoze dhe e afirmoi atë në suaza kombëtare dhe ndërkombëtare. Kontributi i tij në lëmin e letërsisë, të arsimit dhe të kulturës shqiptare është jashtëzakonisht i madh. Veprat e tij të botuara dhe të pa botuara janë të shumta. Proza e tij tregimtare është përfshirë në përmbledhjet „Kunorë rinije" (1934), „Në krahët e një femre" (1934) „Nusja pa duvak" (1944), „Të fala nga fshati" (1958) „Sokolesha" (1966) „Kronika e jetës së Gegë Llesh Ndout" (tregime të shpërndara në shtypin e kohës), „Jam vogłush i madh" (tregime për fëmijë) etj. Janë të njohura novelat: „Pasqyra magjike" 1957. „Simfonia e pambaruar" (1962), „Banori i Yllit Vega në Tokë" (Superfuqia), që është pamflet fantastik shkencor. Romanet e tij janë: „Nga jeta në jetë: Pse?! „AFËRDITA" (1944) „Ata nuk ishin vetëm" (1952) „Afërdita përsëri në fshat" (1955), „Buzë liqenit" (1961), „Ne jemi shumë"!... (1967) që është roman-variant i shkurtuar, i botuar më vonë me titullin, „Zjarre" (1972). Romanet e fundit „Zgjimi" (1974) „Pishtarë", (1975), „Ja vdekje, ja liri" 1978, bëjnë pjesë në ciklin „Rilindasit", ku trajtohet lufta „me penë e armë" në kohën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Disa nga veprat letrare të Sterjo Spasses u botuan në shumë gjuhë të huaja si: frengjisht, gjermanisht, rusisht, anglisht, bullgarisht, greqisht, italisht, arabisht, në gjuhën kineze në gjuhën vietnameze etj. dhe zgjuan interesim të madh te lexuesit.

Të japim këtu disa të dhëna lidhur me botimet e Sterjo Spasses në gjuhët e huaja:

— Nusja pa duvak — (bullgarisht), Otecestven Frout; Sofje, 11. X. 1945.
— Sulmonjësi i hekurudhës (ukrainisht). Botuar në përmbledhjen, „Tregime shqiptare" (Allbanski opovidanja), Kiev 1945, f. 129-140.
— Ata nuk ishin vetëm (bullgarisht), Sofje, 1954.
— Afërdita përsëri në fshat (bullgarisht), Sofje 1956

— Kështu duhesh bërë — tregim (mongolisht), në rev. Cog, nr.2, f. 63-67 Ulan Bator 1957.
— Molla e lumturisë (kinezisht) në përmbledhjen tregime shqiptare Shanghaj 1956.
— Taksidari në fshat, gjermanisht në librin „Albanien Erzuhlt (Shqipëria tregon), Berlin, 1956., fragment nga romani „Ata nuk ishin vetëm".
— Ata nuk ishin vetëm (frengjisht) Tiranë, 1958.
— Ata nuk ishin vetëm (rusisht), Botuar nga „Inostranija Literatura", Moskë 1958.
— Afërdita përsëri në fshat (greqisht) Tiranë; 1958.
— Vajza rebele (arabisht). Botuar si broshurë në gjuhën arabe, Shqipëria e Re, 1959.
— Jeta e re (greqisht) — roman, Tiranë; 1959.
— Ata nuk ishtin vetëm (gjermanisht), Botoi Varlag Volk Und Welf. Berlin, 1960. Përkthyer nga botimi frengjisht.
— Ata nuk ishtin vetëm (në gjuhën kineze). Përkthyer nga botimi frengjisht, Pekin, 1959.
— Afërdita përsëri në fshat (në gjuhën bjelloruse) Minks, 1960.
— Vajza rebele (rusisht) tregim, në „Albanskije raskazi". Moskë, 1960.
— Unë të shkruaj ty nga Kallamasi (rusisht) tregim për fëmijë. Moskë, 1960.
— Liri nën qiellin e lirë, në gazetën e Kazakistunit Kazak edebneti, nr. 49, 4. XII. 1959.
— Dielli i lirisë (rusisht), intervistë — „Trud", Moskë 27.XI.1959.
— Afërdita përsëri në fshat — roman (në gjuhën ukrainase, Kiev, 1960
— Ata nuk ishin vetëm (gjermanisht), botimi i dytë, Berlin, 1961.

Lidhur me botimet e veprave të S. Spasses më gjersisht shih bibliografinë tematike mbi krijimtarinë e Sterjo Spasses, të Jup Kastratit, Arsimi Popullor, Tiranë 1963. nr.

Botuesit, kritikët, studiuesit dhe lexuesit e huaj kanë dhënë mendime mjaft afirmative për veprën letrare të Sterjo Spasses.

Në gazeta, në revista, në botime të veçanta, në parathënie dhe pasthënie, në enciklopedi të ndryshme të letërsisë së huaj, janë përfshirë shënime lidhur me jetën dhe krijimtarinë letrare të Sterjo Spasses. Në vështrime kritike lidhur me prozën e tij dhe në studimet përkitazi me letërsinë e sotme shqiptare. atij i është caktuar vend i merituar.

Mendimi kritik letrar në tërësi ka qenë shumë afirmativ. Vepra letrare e Sterjo Spasses është konsideruar si arritje e përgjithshme e letërsisë sonë. Janë paraqitur edhe mjaft të dhëna lidhur me jetën e popullit shqiptar në të kaluarën dhe janë vënë në dukje aspekte të transformimit progresiv në jetën aktuale. Aftësia e shkrimtarit dhe talenti i tij prej shkrimtari të rryer për të trajtuar tema të mëdha dhe për të shtruar

— Kështu duhesh bërë — tregim (mongolisht), në rev. Cog, nr.2, f. 63-67 Ulan Bator 1957.
— Molla e lumturisë (kinezisht) në përmbledhjen tregime shqiptare Shanghaj 1956.
— Taksidari në fshat, gjermanisht në librin „Albanien Erzuhlt (Shqipëria tregon), Berlin, 1956., fragment nga romani „Ata nuk ishin vetëm".
— Ata nuk ishin vetëm (frengjisht) Tiranë, 1958.
— Ata nuk ishin vetëm (rusisht), Botuar nga „Inostranija Literatura", Moskë 1958.
— Afërdita përsëri në fshat (greqisht) Tiranë; 1958.
— Vajza rebele (arabisht). Botuar si broshurë në gjuhën arabe, Shqipëria e Re, 1959.
— Jeta e re (greqisht) — roman, Tiranë; 1959.
— Ata nuk ishtin vetëm (gjermanisht), Botoi Varlag Volk Und Welf. Berlin, 1960. Përkthyer nga botimi frengjisht.
— Ata nuk ishtin vetëm (në gjuhën kineze). Përkthyer nga botimi frengjisht, Pekin, 1959.
— Afërdita përsëri në fshat (në gjuhën bjelloruse) Minks, 1960.
— Vajza rebele (rusisht) tregim, në „Albanskije raskazi". Moskë, 1960.
— Unë të shkruaj ty nga Kallamasi (rusisht) tregim për fëmijë. Moskë, 1960.
— Liri nën qiellin e lirë, në gazetën e Kazakistunit Kazak edebneti, nr. 49, 4. XII. 1959.
— Dielli i lirisë (rusisht), intervistë — „Trud", Moskë 27.XI.1959.
— Afërdita përsëri në fshat — roman (në gjuhën ukrainase, Kiev, 1960
— Ata nuk ishin vetëm (gjermanisht), botimi i dytë, Berlin, 1961.

Lidhur me botimet e veprave të S. Spasses më gjerisht shih bibliografinë tematike mbi krijimtarinë e Sterjo Spasses, të Jup Kastratit, Arsimi Popullor, Tiranë 1963. nr.

Botuesit, kritikët, studiuesit dhe lexuesit e huaj kanë dhënë mendime mjaft afirmative për veprën letrare të Sterjo Spasses.

Në gazeta, në revista, në botime të veçanta, në parathënie dhe pasthënie, në enciklopedi të ndryshme të letërsisë së huaj, janë përfshirë shënime lidhur me jetën dhe krijimtarinë letrare të Sterjo Spasses. Në vështrime kritike lidhur me prozën e tij dhe në studimet përkitazi me letërsinë e sotme shqiptare. atij i është caktuar vend i merituar.

Mendimi kritik letrar në tërësi ka qenë shumë afirmativ. Vepra letrare e Sterjo Spasses është konsideruar si arritje e përgjithshme e letërsisë sonë. Janë paraqitur edhe mjaft të dhëna lidhur me jetën e popullit shqiptar në të kaluarën dhe janë vënë në dukje aspekte të transformimit progresiv në jetën aktuale. Aftësia e shkrimtarit dhe talenti i tij prej shkrimtari të rryer për të trajtuar tema të mëdha dhe për të shtruar

probleme të rëndësishme të kohës, është vënë në dukje niveli ideor dhe estetik i veprave të caktuara, karakteri edukativ i tyre, si dhe veçoritë e tjera që lidhen me tipizimin e personazheve dhe të ambienteve, me stilin dhe gjuhën etj. Këto veçori janë spikatur gati në të gjithë artikujt kritikë.

Të veçojmë me këtë rast disa fragmente nga gjithë ai material i pasur kritik që është vjelë në periodikun e huaj dhe në botime të ndryshme, të përgatitur në gjuhën shqipe nga vetë autori.

Në GRAND LAROUSSE ENCYCLOPEDIQUE — SUPPLEMENT Edition 1969. LIBRAIRE LAROUSSE, Paris, 1969, f. 807. është shkruar:

SPASSE STERJO — shkrimtar shqiptar (lindur në rrethin e Korçës më 1914). I ka konsakruar në romanet e tij evokimet e vuajtjeve të fshatarëve (AFËRDITA), të rinisë intelektuale (PSE?!...) në Shqipërinë feudale, edhe forcave të transformimeve ekonomike dhe sociale të vendit të tij („ATA NUK ISHIN VETËM", AFËRDITA PËRSËRI NË FSHAT"? „BUZË LIQENIT").

Henri Boissin në ENCYCLOPEDIE GENERALE — LAROUSSE, Paris, 1967, Vëllimi I, në pjesën ku flitet për letërsinë shqipe, shkruan: „Një shkrimtar shumë i talentuar është Sterjo Spasse (i lindur më 1914), që trajton në romanet e tij probleme të ndryshme të aktualitetit. f. 766.

Rene JOUGLET në revisten e përmuajshme „EUROPE", maj-qershor 1959, Paris (shih edhe rev. „Nëntori" 19... nr.) ka shkruar vështrimin me titull „Libri i Sterjo Spasses „ATA NUK ISHIN VETËM" është një libër humanitar. Aty gjejmë disa mendime mjaft afirmative:

„Ky libër, roman i një autori shqiptar, është botuar i përkthyer në frëngjisht në Tiranë. Subjekti është gjendja e mjerueshme dhe vartësia e fshatarëve në kohën e paraçlirimit të vendit nga padronët e tyre, beu dhe sejmenët e tij. Naracioni herë-herë është aq i llahtarshëm sa që të le me gojë hapur dhe unë për veten time jam bindur për karakterin e tij të vërtetë. Sepse as që mund të merret me mend, megjithëse gjendja e punëtorëve nuk ka qenë aspak e shkëlqyeshme ndër ne, po as që mund të bëhet ndonjë krahasim, pasi një shtazërim i tillë është më i rëndë se ai që rëndën mbi kafshët.

Fshatari ishte pronë e beut, ashtu si çdo plaçkë tjetër. Ai punonte për të si kau i parmendës, nuk shpërblehej kurrë dhe ishte vazhdimisht i uritur. Drejtësia e këtij zotërie ishte ashtu si ja donte qejfi atij. Ai mund të të burgoste pa faj, të të rrihte, të të plagoste, të të nxirrte një sy dhe të të varte. Një fshatar, që ndërtoi një oxhak mbi çatinë e kasollës së tij e pagoi shtrenjtë këtë guxim. Shtëpinë ja bënë rrafsh me tokën. Sepse vetëm beu kishte të drejtë ta kishte shtëpinë me oxhak. Ky nuk është veçse një shembull i vogël. Të dhjetat që u merreshin fshatarëve nga të korrat e paka, — megjithëse ata ishin mbytur gjithnjë në borxh për shkak të kamatës shumë të lartë që merrej e që arrinte gjer në 160 përqind — u linin atyre aqë pak drithë sa që s'mund të nxirrnin vitin. Këto ligje ishin në fuqi edhe më pak se një gjysmë shekulli më parë. Ca fshatarë kundravepruan, ngritën krye, një

këtu, një atje dhe shkuan fshat më fshat për të ndezur sedrën në shpirtin e njerëzvet. Pak nga pak nisi të rritet shpirti i rezistencës. Në fillim i ndrojtur, sepse druajtja dhe friga nuk janë aspak maja të mira në zemrën e njeriut. Ato duheshin mposhtur. Po tani ai që qe vetëm nuk ishte më vetëm. Bashkimi ishte organizuar. E drejta po konkretizohej në shpirtrat e njerëzve dhe vendosmëria kolektive po afrohej gjithnjë e më shumë.

Libri i Sterjo Spasses është një libër humanitar. Ai është plotë me ato detaje, që formojnë elementet kryesore të një tablloje: zakone dhe pejsazhe. Ai do të jetë diçka e re (një revalasion) për shumë lexues. Sepse ne e kemi njohur keq Shqipërinë. Atë ne e njihnim vetëm nga disa kostume pitoreske dhe nga epopera luftërash; por për jetën e saj të përditshme nuk kishim fare dijeni. Gazetat na tregonin, sidomos, pas mënyrës së tyre, për mbretin Zog. Kjo ishte fare pak.

Tani ne jemi në gjendje, veçanërisht me anën e kësaj vepre me cilësi, e cila do të kishte përfituar akoma më shumë, po të shikohej nga afër kualiteti i përkthimit të saj, — jemi në gjendje të formojmë një ide të saktë për prapambetjen shoqërore të popullit shqiptar në të kaluarën, të vetmuar në malet dhe në mjerimin e tij, në padijen e tij, jashtëzakonisht i prapambetur në krahasim me popujt e perëndimit. Ai vazhdonte t'i përkiste epokës së feudalizmit.

Do të bindemi për kërcimin vigan që ai ka bërë përpara, duke kaluar përnjëherësh prej epokës së feudalizmit në socializëm. Nuk ishte fjala vetëm për të transformuar një sistem të tërë shfrytëzimi dhe grabitjeje të përhershme, po edhe për të vendosur një botëkuptim krejt të ri: çlirohej mendja e njeriut. Kjo nuk është një punë që bëhet vetëm me lëshimin e një dekreti. Kjo kërkon këmbëngulje, një vullnet shumë të madh dhe një kurajo po aq të madhe".

Në shtypin gjerman gjithashtu kemi mjaft të dhëna lidhur me veprën e këtij autori: Në Berlin revista „ROMAN — CAJTUNG (Roman-gazetë) ribotoi romanin e Spasses „Ata nuk ishin vetëm..." në përkthim të Karl Hajnrihut. Në „BERLINER CAJTUNG: „Spasse, djalë fshatari, krijon figura dhe situata nga ngjarje të jetuara vetë. Kështu që libri i tij vazhdimisht ka diçka të freskët e të afërt. Gjuha e tij është e thjeshtë, pak e ashpër si vetë njerëzit, të cilët na i përshkruan me dashuri të thellë. Por ajo, që na tregon ai mbi jetën e tyre, merr formën e një tablloje të gjallë të Shqipërisë në njerën prej epokave më të zymta të saj." (Shih Gazetën „Drita", Tiranë, 30 korrik 1961).

„NOJES DOJCLAND" (Gjermania e Re): „Sterjo Spasse është një bir i vërtetë i popullit të tij... Romani i tij përshkohet nga besimi i patundur për të ardhmen, për lirinë, për fuqinë e popullit të tij..., përshkohet nga dashuria ndaj këtij populli dhe bijve të tij trima, bijve të shqipes, — siç i mishëron ai në figurën e të riut GJIKË... Dhe bukur dhe ëmbël di të flasë ai për vashat e popullit të tij, për rininë e tyre, për hirin e tyre, për dashurinë e tyre".

„SONTAG" (E DIELA) — Berlin: „Spasseja e njeh nga vetë përvoja e tij jetën e këtyre të vuajturve, të cilët më në fund ngrihen peshë... Vepra e tij ka edhe një meritë tjetër, sepse bashkë me përshkrimin e kontradiktave shoqërore, ai jep edhe një tablo të dokeve dhe zakoneve të vjetra, të cilat kanë mbetur gjallë edhe sot e kësaj dite".

„VORVÄRTS" (Përpara) — Bazel: „... ai ka arritur të krijojë njerëz me mish e me gjak si figura të kësaj lufte, kështu që ne tërhiqemi pa masë nga tendosja e brendëshme e romanit..."

Bullgari Marko GANCEV, në gazetën „LITERATUREN FRONT" (Fronti letrar) të Sofjes (31. I. 1957) ka botuar artikullin „Miq buzë Adriatikut" Pasi përshkruan përshtypjet nga vizita në Shqipëri, jep disa tipare të portretit të shkrimtarit S. Spasse: „...Sterjo Spasse ka një fytyrë të gjerë të buzëqeshur dhe deri diku i ngjan Aleksej Tolstoit... Si një mësues-shkencëtar shumëvjeçar Sterjo Spasse ka njohur thellë jetën e fshatit shqiptarë të viteve '30 e këtej. Edhe te dy romanet të botuara pas çlirimit të Shqipërisë nga fashizmi, përshkruajnë luftërat e fshatarësisë për tokë e liri. Lexuesit tanë e njohin romanin „Ata nuk ishin vetëm..." edhe së shpejti del në bullgarisht libri i ri shumë më i bukur i shkrimtarit „Afërdita përsëri në fshat". Ndoshta një krijues përjeton një kënaqësi më të madhe kur vepra e tij e fundit është më e mirë se e para. Rruga e Sterjo Spasses gjer më tani është vetëm në ngjitje. Në romanet e tij të paraçlirimit („Pse?!" dhe „Afërdita") është përkundur nga nihilizmi intelektual në iluzionet utopike për gjithëpushtetësinë e personalitetit kulturor. Vetëkuptohet se simpatitë e autorit gjithnjë kanë qenë nga ana e popullit punonjës. Tjetra ishte vetëm një tërheqje e përkohshme nga rruga e tij e vërtetë. Fillimi realist, që doli në krye që në romanin „Afërdita", pas çlirimit krejtësisht natyrshëm e shpuri autorin drejt realizmit socialist..."

Disa shënime lidhur me jetën dhe veprën letrare të Spasses janë botuar në „KRATKAJA LITERATURNAJA ENCIKLOPEDIA (Enciklopedia e vogël letrare) Vëllimi 7, Moskë, 1972. Kah fundi i artikullit pohohet ndikimi që ka pësuar shkrimtari nga Tolstoi dhe Gorki. Emri i autorit përmendet edhe në Vëllimin e parë të kësaj Enciklopedie letrare (Shih LETËRSIA SHQIPE, fq. 134-135), pastaj në „BOLLSHAJA SOVJETSKAJA ENCIKLOPEDIA (ENCIKLOPEDIA E MADHE SOVJETIKE), vëllimi 40, në MALKA LITERATURNA ENCIKLOPEDIA të Sofjes, I, në ENCYCLOPEDI DE LA PLEIADE, Paris, 1968 (Shih tekstin lidhur me letërsinë shqipe f 1513-1521.), në MALLAJA SOVJETSKAJA ENCIKLOPEDIA Moskvë, 1960, Tom 8, f 973, në ENCICLOPEDIA DEI POPOLI D'EUROPA, Romë, 1964, Vëllimi II etj.

Ursula HUNOLD ka botuar vështrimin „Romani i parë nga Shqipëria (Gazeta „NEUES DEUTSHLAND", Berlin, 28 maj 1960):

„Para disa javësh u duk në libraritë tona një libër i autorit shqiptar Sterjo Spasse me titullin „Ata nuk ishin vetëm..." Përveç një vëllimi të vogël me përralla dhe vjersha, që u botua para disa vjetësh nga botuesi „Volk und Wissen, është ky roman e para vepër, e cila lexuesit gjerman i

jep mundësinë që të njihet me letërsinë shqiptare. Duke çmuar meritat e mëdha që ka arritur letërsia e re shqiptare në luftën nacionalçlirimtare të vendit të saj dhe në luftën kundër fashizmit, ne e përshëndesim me gjithë zemër në librarítë tona gjermane. Gjithashtu ne e përshëndesim autorin shqiptar të këtij libri... i cili, si edhe aférsisht të gjithë shokët e tij shkrimtarë, ka qenë pjesëmarrës aktiv në këtë luftë... Gjithmonë në veprat e tij Spasse ka qenë besnik i popullit dhe fshatarëve. Në mënyrë realiste dhe të bindshme ai përshkruan mjerimin e fshatarëve, vuajtjet e tyre urinë e tyre, dhunën e tmerrshme dhe dënimet që pësuan. Romani i tij „Ata nuk ishin vetëm..." është shkruar në frymën e bindjes së papërkulur tek e ardhmja, te liria, te forcat e popullit; është shkruar në frymën e dashurisë ndaj popullit, ndaj bijve trima, ndaj shqiptarëve, bijve të shqiponjës, siç tregon me figurën e Gjikës së ri: bukur dhe me përkëdheli flet për vajzat e popullit të tij, për rininë e tyre, për bukurinë e tyre... Penda e shkrimtarit të ri shqiptar nuk rëshqet gjithmonë lehtazi nëpër letër. Por ajo që thotë, hyn në zemër të lexuesit. Na tregon fare natyrshëm luftërat, punën, jetën, shpirtin e popullit shqiptar dhe ne nuk na mbetet veçse këtë populi ta dashurojmë dhe ta respektojmë.

Letrsia e re shqiptare lindi në fund të shekullit të kaluar drejt si pjellë e Luftës Nacionalçlirimtare dhe që në frymëmarrjen e parë u bë armë e kësaj lufte..."

Në LITERATUREN FRONT (Sofje, 1957, 17 korrik) Boris DELLCEV botoi artikullin „Migjeni dhe letërsia përparimtare shqiptare":

„...Megjithëkëtë në Shqipëri duken paraqitjet e para të një letërsie tjetër, të kthyer me fytyrë nga populli dhe armiqësore për reaksionin. Kjo letërsi, së cilës i përket emri dhe vepra e Migjenit, kishte edhe disa botime, si revistën „Bota e Re" dhe numëronte forca shpresëdhënëse si Dhimitër Shuteriqi, Sterjo Spasse dhe Aleks Çaçi. Kjo letërsi kërkonte rrugë të reja dhe përpiqej të çante udhishte drejt së ardhmes.

...Po atë duhet thënë edhe për të tretin prej këtyre shkrimtarëve, për Sterjo Spassen. Në romanin e parë që mban pyetjen shumë kuptimplote „Pse?!.." mbizotërojnë arsyetime morale-filozofike. Ky roman është ndërtuar mbi themele pesimiste-nihiliste, gjë që del edhe nga fakti i heroit kryesor, i cili ka gjetur rrugëdalje në vetëvrasje. Dhe në të jeta reale është vënë në plan të dytë dhe humbet larg nga vështrimi i lexuesit.

...Gjatë vitit 1944, pas kapitullimit të Italisë, në Shqipëri u krijuan përkohësisht mjaft mundësira për një zhvillim të letërsisë legale. U botuan dhe u lëshuan në shitje libra, si përmbledhja e ndaluar dikur „Vargje të lira" të Migjenit, botimi i të cilit më parë as që mund të mendohej. Nga këto libra legale të botuara, që nuk i përket letërsisë zyrtare, vepra më e rëndësishme është romani „Afërdita" nga Sterjo Spasse.

Romani i Sterjo Spasses rikrijon në plan real jetën dhe aktivitetin e mësueses së fshatit „Afërdita". Në këtë roman është pasqyruar injoranca ku ajo punon, dhe mosbesimi, me anën e së cilës sillen për përpjekjet e saja që ta përmirësojë jetën e njerëzve të thjeshtë. Njerëzit e pushtetit e presin

me armiqësi të hapur dhe e pengojnë në punën e saj. Më në fund mësuesja ngadhnjen: përpjekjet e saja u kurorëzuan me sukses, fshati ecën drejt lulëzimit. Kundërshtimi i organeve shtetërore është dërmuar dhe ata venë ta urojnë. Me këtë mënyrë, në lidhje me të vërtetën e me drejtimin e përgjithshëm realist të romanit, ai mbron me utopi dhe me një kompromis të paarsyetuar. Prandaj figura lisnike dhe bukur e menduar e Aferditës nuk të shpie në një përgjithësim të përgjithshëm e në fund tek lexuesit mbetet njëfarë ndjenje kënaqësie. Pavarësisht nga këto tërheqje para kushteve politike të momentit, romani i Sterjo Spasses mbetet një nga veprat narative më të rëndësishme të letërsisë progresiste shqiptare të viteve të paraçlirimit."

Jehonë të gjerë në shtypin sovjetik pati veçanërisht romani „Ata nuk ishin vetëm...". G. POMERANC në artikullin „E kaluara revolucionare e Shqipërisë" (Rev. INOSTRANAJA LITERATURA Nr. 3. Moskë. 1959) ka shkruar: Romani i Sterjo Spasses i është dedikuar së kaluarës, e cila për Shqipërinë e sotme është bërë qëkur e largët. Ngjarjet zhvillohen në vitin 1936, në ditët e turbullimeve agrare dhe të demostratave të papunëve të Korçës, një qytet jo i madh, që ishte përkohësisht në qendër të jetës politike të të varfërve, të fajdexhinjve, të bejlerëve e të nëpunësve të vendit.

Lëvizja revolucionare atëherë ishte mbytur me forca të armatosura. Por masat nuk harruan mësimin që muarrën. Në konflikt me ushtrinë e me xhandarmërinë, në demostrata, mbledhje e në burgje kaliteshin karakteret e udhëheqësve popullorë të së ardhmes, zhdukeshin demoralizimi shekullor, edhe përulja skllavëruese, që shkaktonte mosbesim në forcat e veta. Heronjtë e Sterjo Spasses nuk ishin vetëm: përpara tyre shkonte populli. Prandaj aqë episode të luftës klasore në mbretërinë e vjetër shqiptare e përzjerë me luftë me ide politike, pranohet si një tregim mbi luftrat e së kaluarës, që e ndërtojnë tani Shqipërinë e re popullore.

Shkrimtari nuk e lidh veten me linjat e rrepta të subjektit: romani ndërtohet si një kronikë e jetës së Shqipërisë së Jugut. Ngjarjet zhvillohen në fshatin jo të madh pranë Korçës, pjesërisht edhe në vetë qytetin. Pothuaj në mes të shekullit XX fshatarët shqiptarë ishin pa asnjë të drejtë si në shekujt e mesjetës. Atyre u përkasin vetëm kafshët. Toka i përkiste beut. Të korrat fillonin vetëm kur jepte lejen ai dhe nën mbikqyrjen e njerëzve të besuar të tij, të qehajllarëvet, duke numëruar çdo duaj. Qehajllarëve nuk i pengonte asgjë që të shkruanin disa duaj më shumë ose (duke marrë dy shishe raki) të shkruanin më pak. Ardhja në fshat të rojtarëve pyjorë të kujton dyndjen e furinë hajdute: fshatarin, që i gjen ndonjë qereste të prerë, e arrestojnë dhe e lirojnë vetëm me një rushfet të madh (ose gjobë të madhe). Tagrambledhësi, duke shfrytëzuar analfabetizmin e plotë të popullsisë, i detyrojnë t'i paguajnë dy herë e tri herë po një taksë. Bile as dëftesën e taksës nuk duhet ta marrësh, në qoftë se vete në qytete të ankohesh pa marrë me vete edhe qengjin...

Në përgjithësi romani është i ngjeshur me motive folkloristike. Këngët popullore, përshkrimi i gjallë i zakoneve fshatare ndihmojnë për të

kuptuar botën e brendshme të gjithanëshme të fshatarit shqiptar për të kuptuar jetesën e fshatit shqiptar, që ruan gjer në ditët tona shumë karakteristika të shumëngjyrshme të lashtësisë. Në stilin e romanit gjithashtu ndihet tërheqja e epiteteve e të hiperbolave të zakonshme të përvetësuara nga poezia popullore. Tek lexuesi, jo gjithnjë të mbetet një përshtypje e përgjithësimit folkloristik me përshkrimet realiste që autori përpiqet t'i shkrijë njëra me tjetrën. Në parathënien e veprës A. Sipoviç me të drejtë vëren një farë përngjasie karakteristikash të disa personazheve të dytë.

A. SIPOVIÇ sjell fakte të vërteta nga historia e letërsisë shqipe dhe karakterizon rrugën e krijimtarisë së Sterjo Spasses, i cili ka filluar krijimtarinë letrare në vitet '30. Por, parathënia e tij do të kishte rëndësi në qoftë se ai, në vend që të tregonte përmbajtjen e romanit, të jepte një analizë të stilit dhe të figurës të shkrimtarit duke u munduar që t'i sqaronte këto, por jo thjesht të numëronte arritjet e mosarritjet e veprës..."

Në parathënien e përkthimit bullgarisht të veprës „Afërdita përsëri në fshat" për autorin dhe librin, Marko GANÇEV shkruan:

„Një nga vendet e para midis shkrimtarëve bashkëkohës zë Sterjo Spasse.

...Letrari i ri atëherë, nën ndikimin e librave pesimiste e duke mos mundur të gjente rrugëdalje nga realiteti feudaloborgjez, e shpie heroin e tij në vetëvrasje. Tragjedia e heroit kryesor të romanit „Pse?!... është tragjedia e intelektualëve të rinj të kohës së mbretit Zog, të cilët e urrejnë rendin shoqëror, por të shkëputur nga lëvizja e vetme, që shpie drejt shkatërrimit të këtij rendi të padrejtë, arrin në përfundim se jeta nuk ka kuptim. Problemi, megjithëse ishte i zgjidhur në mënyrë nihiliste, tregon se shkrimtari i talentuar vuan për fatin e shoqërisë shqiptare nën regjimin absolut gjysmëfeudal.

I dëshpruar nga perspektiva jo e mirë, të cilën e paraqet në librin e parë, autori gjen rrugëdalje të lumtur në romanin e tij të dytë të titulluar „Afërdita", i botuar gjatë vitit 1944. Heroina, mësuesja e re Afërdita, një idealiste e frymëzuar, lufton kundër satrapisë, fanatizmit, zakoneve barbare etj... Pikëpamja e tij ideore prej artisti i jep mundësi që ta paraqesë jetën drejt, edhe luftrat e fshatarësisë shqiptare të viteve '30. Këto ngjarje janë të njohura nga lexuesi me anën e romanit të Spasses „Ata nuk ishin vetëm...". Tregues i lumtur për një shkrimtar është, nëqoftëse çdo vepër e mëvonshme është më e mirë se e mëparshmja. Prandaj është një gëzim që të theksohet se romani i fundit i Sterjo Spasses, paraqitur tani lexuesit bullgar „Afërdita përsëri në fshat" është një arritje edhe më e madhe e autorit...

Njohës i madh i jetës së fshatit shqiptar, i huaj për çdo të kallaisur, Sterjo Spasse, që në faqet e para të romanit na paraqet bindshëm dhe gjallë realitetin në Grykas.

Kritiku letrar shqiptar Razi Brahimi për lexuesit e huaj në rusisht, frëngjisht dhe anglisht (rev. „Shqipëria e Re", Tiranë, 1957, nr. 5) ka dhënë disa mendime interesante lidhur me rrugën e krijimtarisë së Sterjo Spasses.

„Pse? Këtë pyetje ia bëri vetes dhe gjithë shoqërisë shqiptare 20 vjet më parë shkrimtari Sterjo Spasse, duke u përpjekur të gjente rrugëdalje, të gjente rrugë drejt së ardhmes së ndritshme. Sipas fjalëve të tij, ai përpiqej i etur të çante në errësirë, por nuk mundi.

„Pse-ja"?! e lodhëshme, që u bë titulli i romanit, tregon pavendosmërinë e heroit të tij kryesor dhe që e shpuri gjer në vetëvrasje. Lumturi ai nuk fitoi, po pse? Shkaku kuptohet nga konteksti: ishte jeta e çrregullt e rendit shoqëror. Ky mendim është i spikatur midis rendit" dicka abstrakte.

Si? Është një stad i rëndësishëm evolucioni ideoartistik i Sterjo Spasses, që duke sqaruar veten të ndryshohet e tërë struktura e marrëdhënieve njerëzore në Shqipërinë feudale.

Romani „Afërdita" e bën këtë problem krejt hapur, ajo vendos jo sipas linjës së kërkesës individuale të heroinës, por në lidhje të ngushtë me faktin e të gjithë figurave vepronjëse, e të gjithë popullit.

Mësuesja e re dhe e thjeshtë e popullit punon në një fshat të varfër të lënë me „Zakone stërgjyshore" të rrënjosur, me zakone patriarkale. Afërdita lufton me ashpërsi me këtë prapambetje, me paragjykimet dhe ëndërron të shohë fëmijë të pastër, të gëzuar, të mësuar. Ajo nuk ka as hije të rëndë dhe as egoizëm, ajo nuk kërkon lumturi personale, mirëqenie... (si ishte heroi i romanit të parë). Kjo figurë e re dhe me kualitet në krijimtarinë e Sterjo Spasses, është heroi aktiv, kërkues i së drejtës, i pajisur me zemër të madhe burrërore. Shumë gjera përfitohen nga tradita. Asaj iu dha mundësia të ndryshojë jetën e shumë njerëzve, të krijojë „një oazë lumturie", por kjo është aq e vogël në shkretëtirën e madhe, — midis fshatrave të tjera dhe qytetarëve që jetonin me zakonet, me himnizimet, me mizerijen.

Spasse e ndjente se „oaza" e Afërditës ishte një mirazh romantik, mizerje e së bukurës te e cila do duhesh kohë për të vajtur. E megjithatë, ky roman, me ato pikëpamjet e tija humanitare, me koloritin e përgjithshëm realist, me skena shumë të bukura zakonore, ka bërë një punë të madhe në kohën e vet. Ai roman u mësonte për të luftuar për një jetë më të mirë, për të kërkuar të drejtën, për të besuar te ajo e për të mos e lëshuar kurrë nga duart.

Kaluan vite... Ëndrrat e shkrimtarit u realizuan. Ai pa vendin e tij të lirë e të lumtur, si një oazë u bë e tër „shkretëtira". Lufta e popullit... i tregoi shkrimtarit rrugën, zgjidhjen e tërë problemeve të pazgjidhura në të kaluarën.

Pas çlirimit të vendit Spasse shkruan romanin „Ata nuk ishin vetëm ku problemi i lumturisë dhe i lirisë është paraqitur në afërsi të ngushtë me luftën me armiqtë e popullit. Me shembullin e fshatarit të ri Gjikë Shpati, Spasse tregon se si shkallë-shkallë në luftë me armiqtë e atdheut piqet, rritet edhe ndërgjegja revolucionare e masave, se si kolektivi arrin kulmin mbi individualizmin, fshatarët e lindur me punëtorët, çirakët, me ustallarët e kështu me radhë.

Duke u kthyer përsëri në ato pyetje të mundimshme „si"dhe „pse", Sterjo Spasse gjen përgjigje në të dy pyetjet të përpikta dhe të qarta duke i treguar lexuesit shkaqet e të gjitha fatkeqësive dhe rrugët e shpëtimit.

Po Afërdita? Shkrimtari nuk e harroi edhe të dashurën e tij. Pas përvojës së mirë, të bukur, ai përsëri u kthye tek ajo, tek ëndërruesja dhe e dashura, tek e guximshmja dhe e thjeshta bashkëpunëtore e shkollës jo të madhe fshatare në romanin „Afërdita përsëri në fshat". Pas shumë përvojave të periudhës së luftës, Afërdita kthehet në fshatin e saj, po atë e gjen gati të bërë shkrumb e hi. Duhet filluar jeta nga e para... Por tani pa asnjë utopi, pa asnjë miraz. Dhe ja, tani, qerpiç, mbi qerpiç ndërtohen shkolla, shtëpitë; tek ato erdhën fëmijtët. Ata rriten, venë në shkollë. Mësuesja e re atyre u mëson përsëri të lexojnë, të shkruajnë, të duan atdheun, jetën dhe të përpiqen për të ecur përpara.

Në roman nuk ka hiperbola, fantazi, utopi. Çdo gjë është e thjeshtë lakonike, e drejtë. Në çdo gjë ndihet gjallë e drejta e madhe e jetës, që është e drejta e artit të ripërtrirë të njerit nga artistët më të mirë shqiptarë. Prandaj, vepra e Sterjo Spasses gëzon një dashuri të tillë nga populli shqiptar, sidomos nga të rinjtë.

Sterjo Spasse është laureat i çmimit të Republikës, dhënë atij për romanin „Ata nuk ishin vetëm...", përkthyer qëkuri në gjuhën bullgarishte dhe rumunishte. Shkrimtari bën edhe një punë të madhe shoqërore...

Revista gjermane „SUDOSTEUROPA MITTEILUNGEN (MÜNCHEN, 1977, nr 2, f 83) sjell shënimin e Nikollaj K. DUTSCHE:

„Si përfaqësues i prozës do të ishte për t'u përmendur Sterjo Spasse, autori i romanit „Nga jeta në jetë: Pse?!..." dhe „Afërdita përsëri në fshat" që kanë lindur para e gjatë çlirimit, ose romanet e botuara pas çlirimit „Ata nuk ishin vetëm..." dhe „Buzë liqenit" Spasse është një nga prozatorët më produktivë i njohur përmes angazhimit të tij social. Por edhe bindës në shprehjen e tij gjuhësore.

E përditshmja „Nova Makedonija" (Shkup, 29 IV 1973 boton prozën e S. Spasses „NUSJA", të përkthyer në maqedonishte dhe jep disa shënime për shkrimtarin.: „Në tregimet e tij jep tabllora plastike dhe realiste të fshatit të sotëm shqiptar, duke stërholluar zakonet e pashkruara, më shumë prapanike, që zotërojnë në jetën e fshatarëve."

Botimit të romanit „Ata nuk ishin vetëm" në rusisht i prin parathënia mjaft e plotë e A. Sipoviçit. Përveç të tjerash ai ka shkruar „Që në titullin e romanit është dhënë çelësi për të kuptuar idenë e tij themelore: solidariteti vëllazëror i jpunonjësvet është zëri i vërtetë i fitores.

Autori, duke vështruar të kaluarën, flet mbi heronjtë e tij: „Ata nuk ishin vetëm". Dhe heroi i romanit të tij, fshatari i thjeshtë shqiptar, i mbushur me besim për fitoren e ardhme, të së drejtës së tij, përsërit fjalët e kësaj të vërtete të madhe: „Ne nuk jemi vetëm". Dhe kjo temë, tema e solidaritetit të punonjësve përfton tërë vazhdueshmërinë e tij logjike. Jo vetëm fshatarët e punëtorët shqiptarë e ndjejnë këtë dhe me bindje e pohojnë se ato nuk janë vetëm. Këto fjalë i përsërisin të huajt, marinarët

bullgarë e grekë me anijet që vijnë në limanin e Durrësit: „Ne nuk jemi, vetëm, ne jemi milionë!" Ky mendim që e përshkon tërë romanin, si një lejtmotiv i tij, në kapitullin e fundit shkrihet me parullën e madhe: „Proletarë të të gjitha vendeve bashkohuni!".

„Lindje!" — tingëllon mbyllja e frazës së romanit dhe jo rastësisht, që Tirka i vogël, — i biri i Gjikës — i zgjat doçkat drejt dritës që del në horizont: Dielli i nesërm i takon atij."

G. MALINCEV bëri një vështrim interesant („Literaturnaja Gazeta" Moskë, 13 IV. 1957) me titullin „Roman mbi njerëzit e fshatit shqiptar" dhe i njeh merita të mëdha autorit të veprës „Aferdita përsëri në fshat".

Për shkrimtarin Sterjo Spasse janë shkruar edhe shumë artikuj të tjerë që kanë rëndësi për të kuptuar më mirë përhapjen e veprës së tij letrare në kushtet e një komunikimi letrar në suaza ndërkombëtare.

Mendimi i kritikës së huaj letrare lidhur me veprën letrare të Sterjo Spasses si edhe lidhur me autorët e tjerë të letërsisë shqiptare, i shfaqur në shumë gjuhë të botës, pranohet sot si argument i fuqishëm për zhvillimin e gjithanshëm të letërsisë sonë kombëtare në tërësi, për mundësitë edhe më të mëdha të lulëzimit të mëtejshëm, për t'u bërë kështu, me vlerat e saj universale, gjithnjë e më tepër pronë kulturore progresive e mbarë njerëzimt.

Shënimi i 100 vjetorit të lindjes së Sterjo Spasses

XI.

MONOGRAFI ME VLERË PËR HISTORINË E LETËRSISË SHQIPTARE

(Ilinden SPASSE: "IM ATË, STERJO!", Tiranë,1995)

Më 1995 në Tiranë është botuar edhe një vepër interesante monografike për shkrimtarin Sterjo Spasse. I biri, Ilinden Spasse, pas katër vjetësh pune (1990-1993), arriti ta botojë librin "IM ATË, STER JO!", në të cilin përmes arkivit vetiak, përfshin material të pasur lidhur me jetën dhe krijimtarinë letrare të Sterjo Spasses. Në këtë vepër me vlerë të llojit biografik kanë gjetur vend edhe të dhëna interesante për jetën dhe veprimtarinë e disa shkrimtarëve të tjerë të letërsisë shqiptare dhe të letërsisë së huaj.

Arkivi i shkrimtarit ka qenë shumë i pasur dhe i sistemaur mirë vite me radhë, prandaj kjo ka ndihmuar, që në këtë vepër voluminoze, në 419 faqe, të shkruhet gjerësisht për shumë aspekte të jetës, që nga lindja, më 14 gusht të vitit 1912, në Gllomboç të Prespës dhe deri në vdekjen e Sterjo Spasses, më 12 shtator të vitit 1989 në Tiranë. Krijimtaria letrare gjashtëdhjetëvjeçare, puna arsimore pedagogjike dhe ajo studimore në përgjithësi, paraqiten edhe me disa dëshmi të panjohura më parë.

Në parathënien e kësaj monografie me vlerë për Historinë e letërsisë shqiptare, Zisa Cikuli ka shkruar: "Në këtë libër, lexues i nderuar, do të njihesh me Sterjon, që në lind-jen e deri në vdekjen e tij, do të ndjekësh evolucionin e një jete të trazuar, të një njeriu të thjeshtë dhe shpirtmadh, të etur për dituri, të dashuruar deri në marrëzi me vendin e tij, me fshatin e tij, me kulturën, historinë dhe gjuhën e popullit. Do të njihesh me aq shokë të tij të penës dhe të halleve…".

Lënda e pasur e këtij libri është mbarështruar në tetë pjesë që bëjnë një tërësi kompozicionale të jetëshkrimit dhe të krijimtarisë së këtij shkrimtari veteran të letërsisë shqiptare.

I. Fëmijërinë Sterjo e ka kaluar në vendlindje. Datëlindja e saktë e tij është l4 gushti i vitit l9l2, pra jo l4 gushti i vitit l9l4, siç është shkruar më parë. Shkollën fillore e ka filluar në Gllomboç dhe pastaj e ka vazhduar në Nivicë. Më l924 fshatrat e krahinës së Prespës: Gllomboçi, Gorica, Tumineci etj., iu bashkangjitën Shqipërisë. Nivica kishte mbetur në kuadër të Greqisë. Vendosja e kufijve atëherë ishte bërë me ndërmjetësimin e fuqive të mëdha. Në Goricë të Madhe Sterjo ndoqi mësimet në shkollën e re shqipe, ku filloi të mësojë shqipen. Më vonë shkollën e vazhdoi në Korçë. Për fëmijërinë dhe për ambientin e vendlindjes në këtë monografi janë përfshirë shumë të dhëna të reja, me të cilat kompletohet jetëshkrimi i shkrimtarit.

II. Pjesa e dytë paraqet kohën e rinisë. Sterjo ishte nxënës i Shkollës Normale të Elbasanit. Jeta shkollore zë vend të konsiderueshëm. Gjendja sociale dhe kulturore e Elbasanit dhe e Shqipërisë gjatë viteve njëzet dhe tridhjetë, është paraqitur në bazë të dëshmive të dorës së parë dhe zgjon interesim të veçantë te lexuesit. Njihemi këtu edhe me punën e palodhshme të profesorëve të njohur të Shkollës Normale siç janë: Sotir Papakristo, Aleksandër Xhuvani, Simon Shuteriqi etj. Më l928 me insistimin e babait, Sterjo ishte fejuar me një vajzë fshatare të quajtur Nikolina. Në kujtimet e veta Sterjo ka shkruar: "Jam fejue më l2 gusht l928. Atëherë unë ishjem l6 vjeç, kurse e fejumja e eme … l5 e gjysmë. Jam fejue më tepër me dashjen e prindërve se sa me dëshirën time…".

Mësimi me zell i lëndës mësimore dhe leximi i literaturës, i gazetave, i revistave dhe i librave të ndryshëm në gjuhën shqipe i hapi horizontin e diturisë. Shkrimet e lexuara në "Përlindja e Shqipërisë" (1913-1914), gazetë e parë e shtetit të pavarur shqiptar, "Përparimi", koleksion i së përmuajshmes së jezuitëve të Shkodrës, "Kopshti letrar", revi-stë e Aleksandër Xhuvanit, "Ylli i mengjesit", që kishte dalë në Boston të SHBA më 1917, "Vllaznia" (1919), "Zani i ri", organ i Tiranës, "Shkolla e re" e Shkodrës (1921) etj., i lanë mbresa të paharrueshme. Me interesim të veçantë lexonte edhe shkrimet e "Norma-

listit", në të cilën revistë Sterjo do të bashkëpunojë më vonë. Më 1929 aty ka botuar tregimin e parë "Kush duron - trashëgon". Për novelën "Kryengritësi shqiptar" Sterjo kishte marrë një shpërblim në konkursin për novela, të shpallur nga Drejtoria e Përgjithshme e Entit Kombëtar "Djelmënia Shqiptare" të Tiranës. Sterjo ka shkruar me pseudonime të ndryshme: Hamleti i Shqipes, Gjon Zaveri, Galiçica, P. Leci, B. Petriti, K. Lame, N. Miti, M. Sh., Dip-Ama, A-jo, Z. Str., M. Kume, P. Bega, Luani etj. Më 2.VII.1932 është diplomuar në Shkollën Normale si "I aftë për t'u emëruar mësues në shkollat fillore të shtetit…".

III. Sterjo një kohë priste emërimin për mësues. Gjendja e atëhershme ishte shumë e vështirë. Vitet tridhjetë ishin shumë të rënda për fshatarsinë e varfër shqiptare. Gorica-rët, bashkëfshatarë të Sterjo Spasses, ishin detyruar me dhunë të largoheshin nga vendlindja sepse beut duhej paguar borxhet për tokën. Takimi me Ymer Dishnicën e pastaj edhe me Ali Kelmendin, i kishte lënë përshtypje të posaçme shkrimtarit të ri. Aliu i kishte thënë Sterjos: "A ka dramë më të madhe se kjo rezistencë e Goricarëve për një vepër të gjatë, për shembull, për një roman? Brumin e ke gati. Ti je edhe biri i atij vendi. Ti vetëm shkruaj të vërtetën. Ti vetëm hidhe në letër këtë të vërtetë." Sterjo atëherë nuk e kishte të qartë "të vërtetën artistike", por këtu e gjeti idenë për të bërë më vonë romanin "Ata nuk ishin vetëm".

Shumë vjet pastaj Sterjo do të shërbejë si mësues, duke pasur gjithnjë ato idealet iluministe të rinisë së kohës. Së pari në zonën e Dropullit, në Derviçan, që kishte 300 shtëpi dhe 1700 banorë. Aty ai përjetoi gëzimet e jetës së fshatit, por edhe brengat që sjell kurbeti në jetën e njerëzve. Duke kundruar me vëmendje fenomenet e jetës sociale dhe gjallë-rimin e fshatarëve, i shfaqet dëshëprimi si disponim shpir-tëror dhe shtron pyetjet: "Pse lind? Pse vdes?, Pse martohesh?, Pse vuajnë njerëzit?, Pse ajo? etj." dhe "revoltohej duke protestuar me pesimizëm dhe nihilizëm". Ai përpiqej të zbërthente në vetvete dy anë të fuqishme jetësore të kësaj Pse-je: jetën dhe dashurinë" Në këtë atmosferë të jetës sociale të fshatit shqiptar të viteve tridhjetë, më 1933, filloi të krijojë romanin "Nga jeta, në jetë, Pse?" Në ditarin e datës 1 tetor 1933…ka shkruar: "…një errësirë e frikshme ka mbuluar katundin…Po mendohem me të vërtetë dhe nuk e di se sa mendime e çpojnë këtë minutë kokën time. S'di se si: zemra më vuan keq

pa ditur "pse-në", kurse truri pyet dhe përcjell pa pra mendime dhe asgjë tjetër…"

Në Derviçan kishte ardhur si mësuese vajza R.B…Ajo ishte e hareshme, e bukur dhe lozonjare. "Sterjo e kundronte atë femër, si mësuese, si shoqe dhe si personazh". Ajo u bë Pola, personazh i romanit "Pse?!". Më 25 nëntor 1933 Sterjo e kishte përfunduar romanin e tij të parë. Vangjel Koça një fragment të romanit në dorëshkrim: "Nga zakonet tona: Nata e bisedimit" nga Sterjo Spasse, e botoi në gazetën "Demokracia", me një shënim në fund: "Nga një roman i pabotuar …Rreze të perëndueme".

Miqësia midis shkrimtarëve të viteve '30, siç janë Nonda Bulka, Petro Marko, Vangjel Koça, Mitrush Kuteli, Sterjo Spasse etj, spikat në mënyrë të veçantë dhe lexuesve ua forcon bindjen se dashuria dhe miqësia e tillë përjetëson në jetë dhe në krijimtari atë që është kujtimi më i çmuar i jetës së kaluar. Krijuesit e letërsisë shqiptare, të cilët krijo-nin vepra me frymë të thellë demokratike të kohës, i bashkonte puna e përbashkët, ideali përparimtar, atdhedashuria dhe më në fund ajo ndjenja e sinqertë njerëzore dhe miqësia e përjetshme.Vangjel Koça është shprehur: "…Edhe miqësia është një nga format e dashurisë, e cila përben një nga pro-ket e jetës njerëzore …".

Sterjo Spasse më vonë edhe më shumë do ta zgjerojë rrethin e miqve dhe të lexuesve të cilët e adhuronin. Si mësues në Voskopojë, në Korçë dhe më 1939 në Tiranë, si sekretar i Ministrit të Arsimit, Ernest Koliqit, afirmohet edhe më shumë. Pas botimit të romanit "Pse?!" nga Shtyp-shkronja "Drita" të Korçës, u botuan edhe disa artikuj në gazetat "Drita", "Besa", "Koha e re" dhe në revistat: "ABC", "Diana", "Ylliria","Bleta","Java","Populli" të Tiranës; në gazetën "Shtypi", në revistat "Leka", "Fryma","Hylli i dritës" të Shkodrës; në gazetat: "Zëri i Korçës", "Gazeta e Korçës" të Korçës etj. Autorët e këtyre shkrimeve janë: Vangjel Koça, (Vangjo Nirvana), Kapa (Kristaç Cipo), Faredin Angoni, Demo Koti (Petro Marko), Zalvi (Dr.Zef Valentini), Fiqri Llagami, Skenarius (Skënder Arza) etj. Shumë letra i janë drejtuar shkrimtarit të ri 22-vjeçar nga lexuesit, të cilët e lavdonin por edhe e shanin. Fatime Frashëri, përveç tjerash, i ka shkruar: "Kur e mbarova së kënduari, mënd u hodha në zjarr! Më parë e pëlqenja

Sterjon, tashti e urrej!". Për romanin kanë shkruar edhe albanologë të huaj: Andre Mazon, profesor i Parisit, shkencëtari i Vjenës, Norbert Jokli etj.

Një vajzë, emrin e së cilës as shkrimtari nuk e mësoi kurrë, i ka shkruar një letër mjaft interesante. Ajo kah fundi i letrës ka shkruar: "Nuk ju mohojmë aspak zotësinë tuaj letrare, as titullin tuaj magjik dhe as luftën e rreptë që u keni hapur hipokrizisë, qytetrimit të sipërfaqshëm e zakoneve të dobëta. Në të shprehur të ndjenjave ju jeni një artist dhe mendoni shumë thellë…".

Më 1936 Sterjos i kishte lindur ideja për të shkruar romanin tjetër "Mësonjësja ideale". Shkrimtari ishte frymëzuar edhe nga puna e disa arsimtareve të shquara në shkollat shqipe të Korçës. Kishte kujtuar edhe figurat e motrave Qiriazi Parashqevinë dhe Sevastinë. "Kush më mirë, se një më-suese e re idealiste si këto mund të njohë vuajtjet e idealet e fshatarëve tanë? ", ka shkruar Sterjo Spasse.

Në pranverën e vitit 1937 shkrimtari e kishte përfundu-ar romanin "Afërdita", ndërsa më 20.X.1939 bashkë me një letër, dorëshkrimin ia ka dërguar Aleksandër Xhuvanit. Për shkak të pushtimit fashist të Shqipërisë, romani është botuar më vonë, në maj të vitit 1944. Në kopertinë fytyra e Afërditës së bukur është ilustrim i një piktori italian. Romani i ri zgjoi interesim të madh te lexuesit dhe te kritikët letrarë. Shkrimet e para ishin ato të gazetës "Fryma" dhe të revistës "Bleta". Mendime interesante për veprën shfaqen: Liu Caku

(Mustafa Greblleshi), Qemal Draçini, Manush Peshkëpia (nën pseudonimin S.B.), Drita Kurtezi ("Drita") etj.

Katër shkrimtarë dhe miq të pandarë: Mitrush Kuteli, Vedat Kokona, Nexhat Hakiu dhe Sterjo Spasse, më 13 shkurt 1944 botuan numrin e parë të "Revistës letrare". "Revista është themeluar nga katër të rinj…që patën kujdes të madh të vinin emrin e tyre në majë të fletushkës, nga frika se mos nuk binin mirë në sytë e leçitësit …".

Më 1944 doli nga shtypi edhe përmbledhja e novelave "Nusja pa duvak", në të cilën, në mënyrë realiste është trajtuar tema sociale.

Në rrethanat e ashpërsuara të zhvillimit të luftës, Sterjo, si edhe disa shkrimtarë të tjerë, bashkëpunonin me "Revistën letrare". Ajo ishte gëzimi dhe shqetësimi i tyre. Pas botimit të trembëdhjetë numrave, revista u ndërpre së botuari, sepse bëhej presion i madh ndaj anëtarëve të redaksisë. Nexhat Hakiu ishte në rrezik, sepse ndiqej në çdo hap. Mitrush Kuteli kishte ikur, sepse edhe ai ndiqej nga oficerët gjermanë, "për ta arrestuar për sabotimin e emisionit të monedhës së re kombëtare". Nonda Bulka ishte mbyllur në shtëpi dhë përgatitej për të ikur, gjithashtu i frigësuar nga arrestimi. Edhe Sterjo Spasse, më 17 tetor 1944, në valën e arrestimeve, të aksionit të vrasjeve, të bastisjeve dhe të burgosjes së intelektualëve, doli në mal. Atje takohet përsëri me disa shokë të penës, siç janë: Mitrush Kuteli, Shevqet Musaraj, Kolë Jakova, Zihni Sako, Andrea Varfi etj.

Më 8 nëntor 1944 Sterjo kthehet në Tiranë dhe angazhohet për botimin e "një buletini të përditshëm sipas gjurmëve të gazetës". Më 15 nëntor, bashkë me 25 delegatë të tjerë, është nisur për të marrë pjesë në Kongresin e Arsimtarëve Antifashistë, që është mbajtur në Korçë më 25 nën-tor 1944. Në Kongres diskutoi "për problemet e reja që i dilnin shkollës së fshatit, për detyrat dhe të drejtat e arsimtarëve, për njohjen e vendlindjes, si një domosdoshmëri, për t'u ngulitur kështu nxënësve dashurinë për çdo gjë shqip-tare".

IV. Mbas luftës Sterjo takohet përsëri me shokët e tij në "Kasollën e Xha Tomit" me fjalët "Fitore dhe Paqe"; "…u përshëndetën…Nexhati, Mitrushi, Nonda, Vedati, Petro Marko, Andrea Varfi, Manol Konomi, Petër Elezi, Mustafa Greblleshi, çunaku më i ri etj.

Sterjo filloi punën si mësues në Shkollën Pedagogjike të Tiranës së bashku me Vasil Vinjaun, Nonda Bulkën dhe Fatbardha Gegën.

Më 8 korrik të vitit l945, si delegat i grupit të pjesë-marrësve shqiptarë, ka marrë pjesë në Kongresin e Parë të Rinisë Antifashiste të Ballkanit në Beograd. Kongresi është mbajtur në sallën e Universitetit të Kollarcit dhe ka zgjatur tri ditë.. Me atë rast, në parakalimet folklorike "secili popull u paraqit… me zakonet, vallet, këngët e kostumet e veta… djemtë me kostume të krahinave të ndryshme të Shqipërisë dhe vashat më kostumet e madhërishme të grave… Ky parakalim u shoqërua nga kori shqiptar ku spikati zëri i tenorit Kristaç Antoni …

Pas kësaj atmosfere, kori nën drejtimin e Konstandin Trakos, krijoi atmosferën e këngës popullore…".

Më l945 në Tiranë është formuar Komisioni nismëtar për themelimin e organizatës së shkrimtarëve shqiptarë. Anëtarë të komisionit kanë qenë: Imzot Vinçenc Prenushi, prof. Sejfulla Malëshova, prof. Aleksandër Xhuvani, z. Ali Asllani, prof. Skënder Luarasi, Dr.Lasgush Poradeci, Dr. Dhimitër Pasko, z. Selim Shpuza, z. Sterjo Spasse, zotëri Dhimitër Shuteriqi, dhe z. Shevqet Musaraj. Në organizatën e shkrimtarëve të Shqipërisë janë pranuar 74 anëtarë.

Që nga viti l946 ka punuar në Ministrinë e Arsimit. Si redaktor ka dhënë kontributin e veçantë me shkrime në revistën pedagogjike "Shkolla e re". Në grupin profesional, ku merrnin pjesë: prof. Aleksandër Xhuvani, Dhimitër Shuteriqi, Skënder Luarasi dhe më vonë edhe Mahir Domi, ka punuar për hartimin e programeve dhe të teksteve mësi-more.

Në fund të vitit l952 është botuar romani "Ata nuk ishin vetëm", i cili u prit shumë mirë nga lexuesit dhe nga kritika letrare. Me atë rast u botuan vështrimet kritike të autorëve: Dalan Shapllo, Jakov Xoxa, Javer Malo, Muzafer Xhaxhiu, etj. Për këtë roman social autori fitoi çmimin e Republikës të shkallës II dhe shpërblimin l00 mijë lekë.

Sterjo Spasse ka mbajtur rregullisht ditarin, ku ka përfshirë shumë ngjarje, përjetime dhe vlerësime. Gjatë vizitave në vend dhe në botën e jashtme ka shënuar gjerësisht përshtypjet e udhëtimit dhe të qëndrimit në vende të ndryshme. Janë shumë interesante shënimet që ka mbajtuar gjatë vizitës në Bashkimin Sovjetik, në Kinë, në Suedi etj.

Taki-met me shkrimtarë të njohur të lëtërsisë botërore i kanë lënë përshtypje të jashtëzakonshme.

Më l955 në revistën "Nëndori" në vazhdime është botuar romani "Për jetën e re", që më vonë mori titullin "Afërdita përsëri në fshat". Kësaj vepre iu dha çmimi i parë në Konkursin Letrar Kombëtar. Menjëherë pas botimit shkrime kritike për këtë vepër kanë shkruar: Mark Gurakuqi, Koço Bihiku, Javer Malo, Razi Brahimi etj.

Në periudhën 5 shtator l958 dhe deri më 6 korrik l960, për qëllime studimi, Sterjo ka qëndruar në Bashkimin Sovjetik. Në Institutin "Maksim Gorki", së bashku me Ismail Kadarenë dhe me disa shkrimtarë të tjerë, ka studiuar letërsinë. Për kohën e kaluar në Bashkimin Sovjetik ka shkruar edhe Ismail Kadare në librin e vet: "Ftesë në studio". Gjatë kësaj kohe Sterjo ka krijuar romanin që kishte titullin "I uri-turi", i cili pas ripunimit është botuar me titullin e ri "Buzë liqenit", pastaj pamfletin "Zonjëza - Zonja - Hijerëndë - Marrëzi", etj.

I kësaj kohe është edhe romani që ka mbetur në dorë-shkrim "Dashuria". Miqësia, dashuria, respekti i madh dhe sinqeriteti shprehen edhe në epistolarin dhe në korrespondencën me familjen, me farefisin, me miqtë dhe sidomos me shokët dhe me shkrimtarët siç janë: Ziaudin Kodra, Zisa Cikuli, Nonda Bulka, Mustafa Greblleshi, Mitrush Kuteli, Petro Marko, Mahir Domi, Nasho Jorgaqi etj.

Më 1960 papritmas Sterjo qe shumë i sëmurë. "Puna e stërmundimshme krijuese, mësimore, … klima e ftohtë e Moskës, malli i madh për familjen, shokët, Shqipërinë, kishin ndikuar tepër në shëndetin e tij. E ndiente veten mjaft të trullosur dhe të lodhur. Ndiente një shtrëngim në gjoks". Një kohë mbeti për t'u shëruar në spitalin "Botkin" të Moskës. Në disa letra të shokëve nga Tirana Sterjo informohet për Plenumin e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë, ku ishte kritikuar ashpër romani i tij "I urituri". Mitrush Kuteli, përveç të tjerash i ka shkruar: "… Të kritikuan në një mbledhje shkrimtarësh për disa dobësi. Ti gjendesh larg vendit, pra më shkon mendja se mund të jesh pikëlluar, aq më shumë se kritika u bë në mungesë. Nga larg njeriut mund t'i duken të mëdha edhe gjërat më të vogla sepse mund të punojë subjektivizmi që zmadhon edhe zvoglon.

Prandaj, po të shkruaj këtë letër, duke hapur një muhabet që s'e kemi prekur kurr as me gojë, as me shkrim…".

VI. Periudha e viteve 1960-1969 përfshin shumë ngjarje të jetës familjare dhe aspekte të ndryshme të krijimtarisë letrare. Pas ripunimit të prozës "I urituri", përfundoi së shkruari novelën "Simfoni e pambaruar". Në qarqet letrare novela u vlerësua si arritje e novelistikës sonë, por pati edhe mendime se "Sterjo këtu është i "Pse-së". Dikush tjetër shkrimtarin e quante sentimentalist, ndërsa veprën e vlerë-sonte si krijim artistik pa vlerë edukative.

Më 7 e 8 dhjetor të vitit l962 në Tiranë është mbajtur Plenumi tjetër i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë. Në referatin kryesor , të paraqitur nga Razi Brahimi, por edhe në disa diskutime, veprat "Buzë liqenit" dhe "Simfoni e pambaruar" u kritikuan për të meta ideologjike. Me atë rast Nonda Bulka në diskutimin e vet, përveç tjerash, ka thënë: "Është shumë zor ta godasësh një shok të ngushtë kur bën gabime në shkrimet e tija, por është akoma më vështirë ta mbrosh, kur ai është goditur padrejtësisht nga kritika … Më falni që guxova e mbrojta një shok të luftës… të luftës së penës… qe tridhjetë vjet militant…".

Sterjon e kishte pikëlluar thellë vdekja e babait, e pastaj edhe e Ziaudin Kodrës, më l0 shtator l965 dhe e Mitrush Kutelit. "Patëm një zi të madhe në gjirin e shokërisë. Më 4 maj l967 na vdiq Dhimitër Pasko, alias Mitrush Kuteli, me të cilin patëm ndarë e jetuar aq shumë halle, më shumë halle se gëzime. Një humbje e madhe kjo e shokërisë, një humbje e madhe e kulturës shqipe, se Mitrush Kuteli ishte një kokë e madhe e kulturës dhe e ekonomisë shqiptare. E varrosëm më 5 maj në varrezat e Sharrës, jo larg babait tim, me dhim-bje të madhe e me thjeshtësi të madhe", ka shkruar Sterjo në kujtimet e asaj kohe.

Më l968 Sterjo pati një gëzim të madh. Redaksia e Boti-meve të "Rilindjes" në Prishtinë kishte botuar kompletin e veprave të këtij shkrimtari në tetë vëllime. "Janë shtypur me pajisjen më moderne teknike e pothuajse krejtësisht janë shitë me parapagim. Kjo është hera e parë që botohen kompletet e të gjitha veprave të ndonjë shkrimtari", ishte shkruar në gazetën "Rilindja" të datës 22 maj të vitit l968.

Që nga viti 1970, por edhe më parë, Sterjo kishte të birin. autorin e kësaj monografie, edhe bashkëpunëtor, i cili e ndihmonte në çdo pikëpamje dhe veçanërisht për daktilo-grafime të materialeve të ndryshme të krijimtarisë letrare.

Gjatë vitit 1970 vazhdoi krijimin e romanit "Ne jemi shumë", të cilin Sterjo e kishte filluar gjashtë vjet më parë. Në këtë vepër, që u botua më vonë me titullin "Zjarre …", ka trajtuar temën e transformimeve të jetës së fshatit shqiptar në Malësinë e Veriut. Autori kishte pasur shumë vështirësi gjatë procesit krijues, prandaj ka pohuar: "… ta heqim sa më parë nga dora këtë roman, se ma mori shpirtin".

Një pikëllim të madh kishte përjetuar Sterjo kur kishte marrë lajmin për vdekjen e Nonda Bulkës, më 14 nëntor 1972, Sterjo ka shkruar: "… vdiq i shumëdashuri ynë, Non-da Bulka, një nga figurat e mëdha të kulturës dhe të letërsisë sonë, prijësi i shquar krahëpërkrahë me Migjenin, i le-tërsisë përparimtare të viteve '30".

Krijimi i pesë romaneve të ciklit "Rilindasit" gjatë fazës së fundit të krjimtarisë letrare, ka një historik shumë interesant. Në fillim, fjala "Zjarr" nga amaneti i Themistokli Gërmenjit, e shqiptuar para togës së pushkatimit, i botuar në revistën "Ylli i mëngjesit":

" Të vishem me rroba shqiptare.

-Të mos m'i lidhin sytë e duart.

-Të jap vetë urdhërin: Zjarr!",

ishte ngulitur në mendje me forcë të veçantë emocionale. "Qëndresa! Të jap vetë urdhërin Zjarr!, për t'i treguar botës se si vdes shqiptari për liri dhe pavarësi! …". Dhe pastaj mendimi: "Duhet filluar nga zgjimi, nga zgjimi i ndërgjegjes kombëtare …" Kështu filloi krijimi i ciklit të romaneve, së pari me romanin "Zgjimi", për të vazhduar pastaj me veprat: "Pishtarë", "Ja vdekje , ja liri", "Kryengritësit" dhe "O sot, o kurrë". Në fund të prillit të vitit 1973 përfundoi romanin "Zgjimi" ose "Zgjimi i ndërgjegjes kombëtare".

Në rrethana të atilla komplekse të jetës dhe të krjimtarisë intensive letrare, gjendja shëndetësore e Sterjos keqësohej gjithnjë e më tepër. Pas trembëdhjetë vjetësh i ndodhi edhe goditja tjetër në zemër,

prandaj ishte detyruar të shtrohej në spitalin e Tiranës, në pavijonin e kardiologjisë.

Gjatë vitit 1973 në Shqipëri vazhdoi fushata e luftës kundër liberalizmit në art dhe në letërsi. Dënimet, persekutimet, internimet e shkrimtarëve dhe të artistëve, si edhe të njerëzve të tjerë, s'kishin të ndalur. Për çështje ideologjike dhe për dukuri të liberalizmit qenë dënuar: Minush Jero, Ib-rahim Oruçi, Todi Lubonja, Fadil Paçrami, Thoma Deliana, Sadik Bekteshi etj.

Në fillim të vitit 1974 doli nga shtypi romani "Zgjimi". Në shtator të atij viti në Korçë u organizua një mbledhje e Degës së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe me atë rast u dha vle-rësim afirmativ për krijimtarinë letrare të Spasses dhe veçanërisht për romanin "Zgjimi".

Për të njohur vendet ku ishin zhvilluar shumë ngjarje historike, për të grumbulluar lëndën e nevojshme dhe për qëllime studimi të literaturës dhe të dokumenteve etj., që nga 5 marsi deri më 13 prill të vitit 1975, Sterjo bëri një vizitë në Maqedoni dhe në Kosovë, i shoqëruar nga Hamit Boriçi, bashkëpunëtor shkencor pranë Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë. Kjo vizitë i ka ndihmuar shumë shkrimtarit për krijimin e romaneve të tjera ku trajtohej gjithnjë tematika e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Ai ishte mysafir i Universitetit të Prishtinës, pra i Fakultetit Filozofik. Gjatë gjithë vizitës në Kosovë e kam shoqëruar së bashku me kolegët e tjerë dhe më ka lënë përshtypje interesimi i jashtëzakonshëm i shkrimtarit për të parë dhe për të mësuar sa më shumë. Sterjon e kisha njohur disa vjet më parë. Takimi im i parë me të është ai i vitit 1970. Vizita ime në Shqipëri ishte realizuar që nga 6 korriku dhe deri më 9 shtator të vitit 1970. Shkrimtarin e kam njohur mirë edhe me rastin e takimeve të mëvonshme, por vizita e tij në Kosovë më ka lënë përshtypje të paharrueshme. Edhe për shkrimtarin qën-drimi në Kosovë do të mbahet në mend dhe do të veçohet nga të gjitha vizitat dhe udhëtimet e mëparshme. Përshtypjet e qëndrimit në Maqedoni dhe në Kosovë janë përfshirë në veprën-ditarin që ka lënë në dorëshkrim me titullin "Letra nga Maqedonia e Kosova", dërguar nipit të vet Arian në Tiranë. Nipi i Sterjos atëherë ishte fëmijë 4 vjeçar, por shkrimtari i dërgonte letra me shpresë se ai kur të rritej do

t'i lexonte me kureshtje. Atëherë ai do të mësojë për aq shumë gjëra për të cilat i ka shkruar gjyshi shkrimtar.

Më 1975 doli nga shtypi romani "Pishtarë", në 576 faqe. Recensentë ishin Fatmir Gjata dhe Nasho Jorgaqi, ndërsa re-daktor Llazar Siliqi. Vepra zgjoi interesimin e lexuesve dhe të kritikës letrare. Vështrimet kritike që iu bënë romanit e patën shqetësuar edhe më tepër autorin e kësaj vepre. Ai nuk ishte në gjendje t'i pranojë si të tilla, sepse sipas tij, çështjet duhej shikuar dhe analizuar në kuadrin e ciklit të romaneve në tërësi. Në revistën "Nëntori" të vitit l977 historiani Gazmend Shpuza botoi shkrimin "Mendime rreth pasqyrimit të realitetit historik të kohës në romanin "Pishtarë". Autori, "përveç anëve pozitive për romanin në fjalë, vinte në dukje edhe anët negative". Gjatë atij viti, prej l2-14 mars, në një raport të Kryesisë së Lidhjes së Shkrimtarëve, Dritëro Ago-lli ka shfaqur edhe këto mendime: "Dihet kontributi që ka dhënë dhe po jep ky shkrimtar (Sterjo Spasse) në letërsinë tone. Vitet e fundit ai i hyri një pune serioze, për të nxjerrë një cikël romanesh nga periudha e Rilindjes … dhe vazhdon të bëjë katër vërejtje kryesore për romanin "Pishtarë": a/ -Lëvizja patriotike popullore e një krahine nuk është parë sa duhet me tërë lëvizjen kombëtare …; b/- se duhet të zotëronte më qartë e më mirë problemi nacional … dhe se nuk duhej të kishte vend një avancim jashtë historizmit, që vërehet disa herë në vepër; dhe c/-… me romanin "Pishtarë" duhet të dilte më qartë e më mirë mendimi se burimi i lëvizjes së masave popullore ka qenë në Shqipëri dhe nuk erdhi si një afsh i flakëve përtej kufirit …". Anëtarët e Kryesisë: Llazar Siliqi, Fatmir Gjata dhe Ismail Kadare shfaqën vlerësime pozitive për romanin "Pishtarë". Megjithatë, u krijua një komision i posaçëm për të vlerësuar këtë vepër për të cilën ishin zhvilluar disa polemika letrare. Vërejtjet më të ashpra kritike i ka bërë Skënder Luarasi.

Në vlerësimet kritike të paraqitura në katër raporte të hartuara lidhur me këtë roman, dilte vlerësimi i përgjithshëm pozitiv. Sterjo pas këtij satisfaksioni vazhdoi të krijojë romanet e tjera. Romani vijues kishte dy vëllime: "Acar" dhe "Ja vdekje, ja liri". Për veprën shumë voluminoze, të dorëzuar për botim, redaksia e Shtëpisë Botuese "Naim Frashëri", "… filloi redaktimin jo me laps, por me "shpatë", duke hequr linja të tëra të romanit, duke hequr fjalë e fjali shumë të bukura

…". Megjithatë, Sterjo lejoi botimin e veprës "Ja vdekje, ja liri", që kishte 552 faqe. Si ilustrim i kopertinës ishte zgjedhur piktura e Kel Kodhelit, "Një malësor me pushkë kraheqafë", që i përshtatej përmbajtjes së romanit: Lufta e Malësisë së Madhe 1910-1911 kundër hordhive të Durgut Pashës".

Më 1978 Sterjo krijoi novelën "Rrëfimi i një kurbetliu", për të cilën lënda është marrë nga rrëfimet e të vëllait, që kishte mërguar në Australi.

Pas redaktimit të sërishëm të të gjitha veprave të botuara më parë, shkrimtari përgatiti materialet për botimin e veprave të plota në nëntë vëllime. Bashkë me redaktorin, Ali Dhrimën, bënë disa ndryshime dhe plotësime: "… e hoqën kapitullin e fundit të romanit "Afërdita", për të ulur "dozat e utopisë së këtij romani; e rishikuan paragrafin e parë të romanit "Pishtarë", duke hequr takimin e Misto Gërmenjit me Goce Delçevin, kryetarin e komitëve maqedonas, … ndërsa romani "Pse?!" , "… ishte i mallkuar, ai nuk u përfshi në seri …", ka shkruar autori i monografisë.

Më 1979 Sterjo u nda përgjithmonë nga dy shokët e tij të dashur: më 19 qershor vdiq Nexhat Hakiu dhe më 1 tetor Petër Elezi. Pikëllimin e thellë Sterjo e ka shfaqur edhe në kujtimet që kanë mbetur në dorëshkrim. Gjatë këtij viti Sterjo ka shkruar edhe dy artikuj përkujtimorë: për profesor Aleksandër Xhuvanin, me rastin e 100-vjetorit të lindjes dhe për 35-vjetorin e krijimit të Lidhjes së Shkrimtarëve; pastaj bëri një recension për romanin "Mic Sokoli" të Sulejman Krasniqit. Në mënyrë të veçantë iu përkushtua krijimit të dy romaneve të tjera me të cilat kompletohej pentologjia romaneske kushtuar Rilindjes Kombëtare.

Botimi i veprave të plota në tetë vëllime: Sterjo Spasse "Vepra letrare", Sterjon e gëzoi shumë. "Seria kap gjithësej 3680 faqe të shtypura në letër të mirë, të bardhë dhe çdo vëllim është lidhur, duke pasur kapak ngjyrë gri".

VIII. Gjatë dekadës së fundit të jetës dhe të krijimtarisë letrare Sterjo bënte përpjekje të realizojë projektet letrare dhe të sistematizojë vazhdimisht dorëshkrimet dhe materialet e tjera. Herë pas herë vizitonte vendlindjen, shokët dhe miqtë me të cilët kishte kaluar kohë të

gjatë. Pasi përfundoi romanin "Kryengritësit", në fund të dhjetorit e dorëzoi për shtyp në Shtëpinë Botuese "Naim Frashëri".

Ashtu i sëmurë, kohën e kalonte duke lexuar materiale të ndryshme dhe duke biseduar me pleq dhe njerëz të tjerë lidhur me çështje të rëndësishme, për të krijuar romanin e fundit. Bëri edhe një vizitë në Turqi, ku kishte në plan të vizitojë Stambollin, Ankaranë, Antalian, Izmirin dhe Edrenën. Pas dy javësh, më datë 22 shtator 1983, u kthye në Tiranë, me shumë përshtypje të mira, por edhe me shqetësime të natyrshme për kohën. Pak ditë më parë i kishte dalë nga shtypi romani "Kryengritesit" dhe, si zakonisht, shkrimet e para shënonin botimin e kësaj vepre letrare. Shënimit të 70-vjetorit të lindjes iu dha vend në gazetat dhe në revistat shqipe. Sterjo bëri edhe një vizitë në vendlindje, për t'u çmallur në rrethin familjar dhe të miqve të shumtë. Kujdesi ndaj familjes, ndaj nipave dhe mbesave dhe ndaj të gjithë njerëzve të tjerë, ishte përherë shumë i madh. Në kujtimet e veta ka shkruar hollësisht për të gjitha këto udhë-time në vendlindje, por edhe për dashurinë e brengat familjare. Përshkrimet e Sterjos janë të mrekullueshme, por edhe porosia e thellë humanitare thellësisht njerëzore është porosi e madhe.

Më 22 shtator 1984 përvjetori i lindjes së shkrimtarit u festua në Korçë. Me atë rast është organizuar një manifestim shkencor dhe kulturor. Një ditë më vonë, në Pustec, Gllom-boç, në Goricë të Vogël, pra në brigjet e Liqenit të Prespës, u organizua manifestim i gjerë kulturor. "Aty - ka shkruar Sterjo - na pritën me këngë, valle, muzikë, brohori … Një nder për mua, si një ëndërr e ëndërruar tërë jetën, një surprizë shumë e bukur për shokët e miqtë, një gaz i zemrës së fshatarëve".

Pikëllim të thellë kishte ndier Sterjo për vdekjen e skulp-torit Odhise Paskalit, më 13 shtator 1985. Me të ishte njohur gjatë viteve '30, që nga viti 1934. Me rastin e vdekjes së artistit të popullit, këtij krijuesi të madh, i bëri homazhe gjithë Shqipëria …".

Në fillim të janarit po të këtij viti Sterjo ishte pensio-nuar, por trajtohej gjithnjë si shkrimtar profesionist. Kujtimet për Nonda Bulkën, për shkrimtarin dhe mikun e respektuar, e nxitën të bëjë librin "Nonda Bulka - njeri krijues". Përveç shkrimeve të veta, mblodhi edhe disa

punime të autorëve të tjerë kushtuar Nondës dhe, me rastin e 80-vjetorit të lindjes, i dorëzoi për botim.

"Më 26 maj, ulur në një karrige në ballkonin e tij, duke lexuar librin e Monteskiesë *"L'esprit des Lois"* (Fryma e ligjeve), me laps në dorë …", kishte vdekur Mustafa Greblleshi. Kur mori këtë lajm, Sterjo u trondit shumë. Ai u shkri në lotë, i pikëlluar për mikun dhe shkrimtarin "… që nuk u ankua kurrë nga jeta, që nuk e shoi kurrë buzëqeshjen nga buza dhe shpresën…".

Me rastin e 100-vjetorit të Mësonjëtores Shqipe të Kor-çës, më 1987, botoi librin me artikuj pedagogjikë "Reflekse pedagogjike". Sterjo pak kohë më parë kishte bërë një vizitë në thellësi të Mirditës, me qëllim që të bisedonte me njërëzit për disa ngjarje të rëndësishme historike, sepse punonte pa ndërprerje në romanin "O sot, o kurrë". Me shoqëruesit që kishte zgjedhur në këtë udhëtim, së pari vizituan Klosin, si qendër të Rrjepsit. Pastaj udhëtuan për Skrapar dhe Berat. Disa ditë i kaluan në Shqipërinë e Jugut: në Derviçan, në Gjirokastër, Delvinë, Sarandë, Konispol, Butrint dhe në qy-tetin e ri të Ksamilit.

Gjatë muajit të letërsisë, së bashku më Fatmir Gjatën, më 3 tetor kishte shkuar në Buçimas të Poradecit dhe pastaj në Prespë. Ata vazhduan këtë udhëtim të këndshëm, kudo të pritur me përzemërsi të madhe, në drejtim të Korçës. Në Korçë, Ersekë, Leskovik, Vërnik etj., gjithashtu është organizuar pritje e përzemërt për shkrimtarin e adhuruar. "Kuj-tuan shumë ndodhina, u çmallën shumë për të mos u takuar më kurrë …", ka shkruar autori i monografisë.

Krijimi i romanit, pas këtyre udhëtimeve në shumë vise të Shqipërisë, përparonte dukshëm. Gjendja e acaruar shëndetësore bëhej pengesë e madhe në punën krijuese dhe në jetën e shkrimtarit të moshuar. Në maj të vitit l988 detyrohet të shtrohet në spitalin e Tiranës, ndërsa në fillim të korrikut dërgohet në Budapest, në spitalin e urologjisë. "Vetmia e shëmtuar", gjatë qëndrimit në spital, e shqetësonte edhe më shumë këtë pacient-shkrimtar, i cili vazhdimisht mendonte për dorëshkrimet e pabotuara.

Në vazhdim shënimet për këto dorëshkrime i japim ash-tu si i ka lënë autori:

l. ”Qesh e ngjesh”- Roman satirik. Kritikoj e ironizoj të metat e shoqërisë së kohës. Kam botuar dy fragmente në revisten “Hosteni”.

2. “Superfuqia” - Roman satiritk. Një pjesë e mirë e këtij romani është botuar në gazetën “Mësuesi” të datave l0, l7, 24 dhjetor l975 dhe si novelë në serinë e veprave, në vë-llimin I, me titull “Banori i Yllit Vega në Tokë”.

3. Reportazhe - Duke udhëtuar nëpër Shqipëri në kohë të ndryshme. Është një vëllim me shumë reportazhe që kam shkruar e botuar para e pas Çlirimit.

4 .”Gjenia popullore” - (Komente e mendime për pasurinë folklorike). Një pjesë të këtyre shkrimeve mund t’i botoja në librin “Reflekse pedagogjike”, por harrova ta ka-pja rastin.

5. “Heroika” - Tregime për të rinj (si për Themistokli Gërmenjin, Shote Galicën, Gjokë Mokrarin, e tregime të tjera të pabotuara në vëllim të veçantë, ku mund të futet edhe një përallë e gjyshes e botuar në vitet ’30 në revistën “Shko-lla Kombëtare”

6. “O sot ,o kurrë!”- Roman. Është i pesti dhe i fundit i ciklit “Rilindësit”. Është dorëzuar që më 1986 në Shtëpinë Botuese “Naim Frashëri”.

7. “Grimca” - Mendime për letërsinë shqipe. Shkrime të ndryshme të shpërndara nëpër gazetat e kohës.

8. “Grimca”- Idem, por për letërsinë e huaj.

9. “Letra nipit tim Arian" (Përshtypje udhëtimi nga Maqedonia e Kosova).

Si vëllime të veçantë në dorëshkrim autori i la edhe këta tituj:

10. “Intrevista” - të shpërndara në shtypin e kohës e që përbëjnë një vëllim më vete.

11. “Përshtypje udhëtimi” - nga udhëtimet që ka bërë jashtë shtetit e që janë të pabotuara.

l2. ”Korrespondenca” - që ndahet në tre vëllime:

a). Letra të zgjedhura drejtuar Sterjo Spasses për krijimtarinë e tij.

b).Letra të zgjedhura drejtuar Sterjo Spasses nga fa-miljarë, shokë e miq, shqiptarë e të huaj.

c).Letra të zgjedhura të Sterjo Spasses dërguar familjarëve, shokëve e miqve në Shqipëri dhe jashtë atdheut.

l3. "Kritika" - Edhe ky libër në tre vëllime:

a) Kritika shqiptare për Sterjo Spassen.

b) Kosova për Sterjo Spassen.

c) Kritika e huaj për Sterjo Spassen.

l4. "Kujtime" - (përzgjedhje e ditarëve të tij).

l5. "Këngë popullore maqedonase" - (kënduar nga Nikolina Spasse dhe të mbledhura nga Sterjo Spasse).

16 ."Studime" - Që lidhen më marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe shteteve fqinje të Ballkanit.

17. "Bibliografi".

18."Monografi - Sterjo Spasse", është kjo monografi e hartuar nga I. Spasse, ku janë shfrytëzuar shumë materiale të Sterjo Spasses të lëna në dorëshkrimet e tij.

Më 14 korrik 1988 Sterjo doli nga spitali i Budapestit për t'u kthyer në atdhe, duke thënë: "Lamtumirë Budapest, që më pe e nuk të pashë!"

Në Tiranë u prit me gëzim nga familja dhe nga miqtë e shumtë ." ... dhe mua - ka shkruar Sterjo - balta më e ëmbël se mjalta m'u duk balta e shtëpisë sime në rrugën *"Hilmi Kolli"* nr. l2".

Shkrimtari kohën e lirë e kalonte duke pritur të afërmit dhe miqtë në vizita. Me intersim përcillte shkrimet që botoheshin në shtypin dhe në periodikun e kohës për veprat e reja të botuara. Më së shumti interesohej për botimin e romanit "O sot, o kurrë!", sepse Redaksia e kishte shtyer procedurën e botimit. Lidhur me këtë autori ka reaguar me shkrimin, ku përveç tjerash, ka shkruar: "… Unë jam i indinjuar nga qëndrimi e nga përgjigja e redaksisë … që më ka dhënë për romanin dorëshkrim "O sot, o kurrë!". Me-gjithatë, në fund të gushtit ky roman doli nga shtypi, duke e gëzuar pa masë edhe vetë autorin.

Më vonë Sterjo vizitoi për herë të fundit vendlindjen, për t'u takuar me të dashurit e vet! Me atë rast vizitoi varret e Mitrushit dhe të Nonda Bulkës. Sterjo dhe Zisa Cikuli, pasi fshinë pllakën e mermertë

të varrit të Nondës, lexuan mbishkrimin: "Jam arbër dhe arbëri është gjithmonë i lashtë, gjithmonë i ri".

Mbas udhëtimit të gjatë e të qëndrimit në Prespë, ku përkujtoi shumë ngjarje dhe përjetime, Sterjo u kthye në Tiranë. Si edhe herave të tjera, bëheshin vizita, bisedime… në rrethin familjar.

Më 12 shtator 1989, Sterjo ishte shumë i sëmurë. Atë ditë në mbrëmje vdiq, duke lënë të pikëlluar familjen, shokët, miqtë dhe të gjithë ata që e kishin njohur dhe kishin lexuar veprën e këtij shkrimtari veteran të letërsisë shqiptare.

Jamilja e Sterjo Spasses

Lajmi për vdekjen e shkrimtarit u prit me pikëllim të thellë në Shqipëri, në Kosovë, në viset e tjera shqiptare dhe në diasporë. Nderimet e fundit iu bënë në sallën e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë në Tiranë. Sterjo Spasse u varros në varrezat e Sharrës, më 3 shtator, me nderime të mëdha që i bëhen njeriut të dashur, shkrimtarit të adhuruar…

Shkrimtari Nasi Lera, sekretar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë, i dha lamtumirën e fundit me fjalët që shprehnin pikëllim të thellë dhe krenari:

"Na mblodhi këtu vdekja e shkrimtarit tonë të shquar, Sterjo Spasse, një prej themeluesve të letërsisë sonë dhe të romanit tonë. Po, ai kishte më shumë se një gjysmë shekulli, që na kishte pranë, që na mblidhte bashkë me veprat e tij, që bisedonte me ne, që jetonte me ne.

Tërë jeta e shkrimtarit Sterjo Spasse është një bashkëbisedim me popullin, është një jetë brenda jetës së popullit, nga i cili nuk e ndan dot asnjë çast. Do kalojnë vite dhe përsëri ne dhe brezat që do të vijnë, do të vazhdojnë bisedën me shkrimtarin tonë të nderuar.

Sterjo Spasse, Vedat Kokona,Nexhat Hakiu dhe Mitrush Kuteli

Jeta e shkrimtarit Sterjo Spasse u udhëhoq nga misioni që t'i shërbente letërsisë dhe kulturës shqiptare. Krijuesi i apasionuar për çështjen e popullit, ai mori prej tij optimizmin dhe dashurinë dhe e derdhi këtë në tërë veprën e tij të gjerë. Individualitet i padiskutueshëm i letërsisë shqiptare dhe njeri me zemër të madhe e bujare, ai iu përkul me respekt kulturës së vendit dhe tokës sonë. Romanet e tij janë pjesë e pandarë e historisë sonë, e luftrave, përpjekjeve, aspiratave të popullit, janë dëshmi letrare të shpirtit të etur për liri, kulturë dhe një jetë të

bukur të njerëzve të thjeshtë, janë një homazh që shkrimtari ua përcillte me respekt gjithë atyre që sakrifikuan për këtë tokë… Te Sterjo Spassja ynë i paharruar njeriu dhe shkrimtari përbëjnë një simbol të vetëm. Nuk është vetëm krijimtaria letrare e Sterjo Spasses një shkollë për ata që i janë përkushtuar dhe do t'i përkushtohen letërsisë shqiptare, por është edhe jeta e tij një shkollë po aq e madhe.

Së bashku me ne ndiejnë dhimbje edhe personazhet të cilëve shkrimtari u dha jetë dhe ua përcolli kohërave. Ata janë shumë dhe më shumë do të ishin sikur krijuesi i tyre të jetonte më gjatë. Deri në çast të fundit Sterjoja punonte. Personazhet, të cilëve ai u dha jetë, kanë ardhur t'i japin atij lamtumirën e fundit, por edhe të shprehin mirënjohjen e thellë dhe, së bashku me ta, emri i tij të kapërcejë vitet. E tillë është jeta e krijuesit të vertetë, që me veprën e tij sfidon ligjet e natyrës, si ishte dhe jeta e shkrimtarit Sterjo Spasse.

Na mblodhi këtu vdekja e tij, po ne kishim një gjysmë shekulli bashkë. Do të kalojnë vitet dhe Sterjo Spasse do të jetë pranë nesh ashtu si e kujtojmë të gjithë, të dashur, me buzëqeshjen e jetës, që nuk i ndahej kurrë nga fytyra e tij fisnike", tha midis tjerash Nasi Lera.

Monografia "Im atë, Sterjo!", është vepër që përjetëson idealet e njeriut dhe të shkrimtarit, është dëshmi letrare për epokën në të cilën ka jetuar dhe ka krijuar veprat letrare shkrimtari Sterjo Spasse. Kjo monografi me vlerë ka rëndësi të veçantë për historinë e lëtërsisë shqiptare.

PJESA E DYTË

Sterjo Spasse
Zgjimi
roman

Prof. Dr. Ilinden Spasse

BIBLIOGRAFIA

STERJO SPASSE

Bibliografi
(1929-2014)

Tiranë 2014

Botohet me rastin e 100 vjetorit të lindjes (1914-2014)

Prishtinë 2016

PËRMBAJTJA

HYRJE

KREU I

KRIJIMTARIA LETRARE

1. Romane
2. Vëllime me tregime
3. Novela
4. Tregime, skica, fejtone, alegori etj.
5. Kompleti " STERJO SPASSE" (1968)
6. Seria: Vepra letrare (1980)

KREU II
KRIJIMTARIA PUBLICISTIKE

1. Fjala e kohës
2. Reportazhe
3. Përshkrime
4. Portrete
- Autorë shqiptarë
- Autorë të huaj
5. Intervista
6. Kronika (sociale, artistike, sportive)

KREU III
KRIJIMTARIA SHKENCORE

1. Monografi
2. Studime

a. Për letërsinë shqipe

b. Për letërsinë e huaj
c. Për folklorin
3. Referate
4. Diskutime
5. Tekste shkollore (autor, bashkautor dhe redaktor)
6. Tekste për shkollat e minoritetit maqedonas (redaktor)
7. Vëllime të tjera (redaktor)

KREU IV
PËRKTHIME NGA LETERSIA E HUAJ NË GJUHËN SHQIPE

a. Romane
b. Vëllime me tregime
c. Novela, tregime, poezi dhe publicistikë

KREU V
VEPRA E STERJO SPASSES NË GJUHË TË HUAJ

a. Romane
b. Përmbledhje tregimesh
c. Novela dhe tregime
d. Publicistikë

KREU VI
VLERËSIMI I EMRIT DHE VEPRËS SË STERJO SPASSES

1. Nga kritika shqiptare
2. Nga shtypi i huaj
3. Në enciklopedi dhe vepra të tjera kryesore

KREU VII
INFORMACIONE KU CITOHET EMRI DHE VEPRA E SHKRIMTARIT

1. Në shtypin shqiptar
2. Në shtypin e huaj

KREU VIII
PUNIME DIPLOME DHE MBROJTJE DOKTORATE MBI VEPRËN E STERJO SPASSES

KREU IX
LISTA E INICIALEVE DHE PSEUDONIMEVE TË PËRDORURA NGA STERJO SPASSE

KREU X
PERSONAZHET E ROMANEVE TË CIKLIT “RILINDËSIT”

HYRJE

Sterjo Spasse ka lindur më 14 gusht 1914 në fshatin Gllomboç, buzë liqenit të Prespës, Qarku i Korçës. Lindi nga një familje fshatare e varfër, shumë e varfër. Që në fëmijëri njohu e përjetoi mjerimin dhe prapambetjen ekonomike të bashkëfshatarëve të tij, çka ushtroi ndikim të madh në formimin në jetën e tij të mëvonshme si mësues dhe shkrimtar. Shkollën fillore e kreu në qytetin e Korçës, të mesmen në Normalen e Elbasanit, ndërsa arsimin e lartë dhe specializimin në Universitetin e Tiranës dhe në Institutin Gorki në Moskë.

Me formimin pedagogjik dhe vetëdije të lartë humane, hyri në jetën dhe veprimtarinë shtetërore dhe shoqërore, si mësues. Shërbeu fillimisht në Derviçan të Gjirokastrës, pastaj në rrjedhën e viteve, në Voskopojë, në Korçë e në Tiranë, duke dhënë ndihmesë të shumëvlerësuar në fushën e arsimit e të letërsisë. U shqua sidomos në letrat shqipe, si krijues deri në ditët e fundit të jetës së tij, dijetar e mendimtar e organizator aktiv i fletorarizmit shqiptar. Që në vitet '30 e në vijimësi shkroi, drejtoi e redaktoi disa organe të shtypit shqiptar si: *"Normalisti", "Shkolla shqiptare", "Shkolla e re", "Bota e re" "Arsimi popullor", "Letërsia jonë" dhe "Nëntori*".

Në vitet 1960 doli në profesion të lirë, duke krijuar një varg romanesh, që janë mirëpritur dhe vlerësuar si nga lexuesit, ashtu dhe nga qarqet letrare e shkrimtarë autoritarë në letrat shqipe, nga institucionet studimore, kërkimore-shkencore të gjuhësisë e të letërsisë të Akademisë së Shkencave, si dhe nga organet shtetërore, me nderimet dhe atributet më të larta të shoqërisë bashkëkohëse.

Romani "*Ata nuk ishin vetëm"* (1954) u laurua me çmimin e "Republikës të Shkallës së Dytë"; ndërsa për romanet "*Aferdita përsëri në fshat*", "*Buzë liqenit*", "*Zgjimi*" dhe për vëllimin me tregime "*Të fala nga fshati*" ka fituar çmime të para kombëtare për letërsinë.

Për merita të veçanta është dekoruar me Urdhrin e punës kl.II, me Urdhrin e Flamurit të kuq të punës të klasit I, më 3. XII. 1975. DEKRET Nr. 5361; me "Urdhrin "Naim Frashëri të kl, II", me Urdhrin "Naim Frashëri i artë" (Pas vdekjes) (më 18.07.2000) etj.

Për hartimin e kësaj bibliografie janë shfrytëzuar si burime kryesore, kryesisht: bibliografia kombëtare e librit dhe e artikujve të periodikut shqip, skedarët e Bibliotekës Kombëtare dhe të sektorit të Letërsisë në Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë të Akademisë së Shkencave; është konsultuar me bibliografi të tjera tematike si ajo e Jup Kastratit (Bibliografia tematike mbi krijimtarinë e S.Spasses: Buletini "Shkodra", nr. 1-5, 1965), të Isak Shemes- Ibrahim Rugova,: Bibliografia e kritikës letrare shqiptare 1844-1974, Prishtinë, 1976), me punimin e diplomës të Zhaklina Naqellarit (Krijimtaria e Sterjo Spasses (Bibliografi) 1979 etj.

Gjithë materiali është ndarë në 9 kapituj dhe disa nënkapituj.

Kreu I përmbledh krijimtarinë letrare të Sterjo Spasses: Romane, vëllime me tregime, novela, tregime, skica, fejtone, alegori etj. (Gjithsejt 11 romane, 9 vëllime me tregime, rreth 30 novela dhe mbi 100 e ca tregime)

Romani i parë para çlirimit është "Nga jeta në jetë, Pse?!..." Botuar më parë si nënfletë në Gazeta e Korçës, pastaj si libër më vete më 1935.

Romani i dytë para çlirimit është "Afërdita", botuar më 1944.

Mbas çlirimit romani i tij i parë është "Ata nuk ishin vetëm" botuar në Tiranë 1952.

Romanet "Afërdita", "Afërdita përsëri në fshat", "Ata nuk ishin vetëm", "Zgjimi" janë botuar nga disa herë në Shqipëri e në Kosovë.

Më 1968 në Kosovë u botua Kompleti "Sterjo Spasse" me tetë vëllime.

Më 1980 në Shqipëri u botua Seria e veprave letrare "Sterjo Spasse" në nëntë vëllime.

Si botime të tjera të veçanta janë monografia me titullin "Prespa e vogël", shtypur në Konstancë të Rumanisë më 1932; përmbledhjet me tregime "Kunorë rinie", botuar në Korçë 1934, "Nusja pa duvak", botuar më 1944 në Tiranë; "Të fala nga fshati", 1958, "Në tokën kineze" (bashkë me Fatmir Gjatën) 1958, "Kurora e rinisë" më 1963; "Sokolesha", 1966; "Reflekse pedagogjike" më 1978 dhe "Kuvendim me Nipin" më 2002. Tre shkrimet e para të tij janë: "Kush duron

trashëgon", botuar në revistën "Normalisti" nr. 1, 1929; "Ligjëratë mbi durimin", që ka karakter pedagogjik, botuar po në të njëjtin numër të "Normalistit" dhe "Problema" botuar Në: "Ora", Tiranë, 26 qershor 1929.

Kreu II përmbledh krijimtarinë publicistike. Ky kapitull është ndarë në 6 nënkapituj: Fjala e kohës, reportazhe, përshkrime, portrete autorësh shqiptarë e të huaj, intervista dhe kronika si brenda ashtu dhe jashtë vendit.

Në Kreun III përfshihet krijimtaria shkencore e ndarë në nënkapituj që kanë të bëjnë me monografi, studime, referate, diskutime dhe tekste shkollore. Si arsimtar, S. Spasse ka dhënë një ndihmesë të gjerë edhe në përpilimin e teksteve shkollore si autor, bashkautor dhe redaktor në dekadën e parë të Reformës arsimore; tekste këto që i kanë shërbyer shkollës sonë të re për dekada të tëra.

Sterjo Spasse është marrë edhe me përkthime letrare nga letërsia e huaj, që përfshihen në kreun IV. Përkthimi i tij i parë është romani "Të mjerët" i Viktor Hugoit, në mënyrë të përmbledhur e botuar si nënfletë në shumë numra të Gazetës së Korçës janar - shkurt 1935. Përkthimet e tij janë romane, vëllime me tregime, novela, poezi etj.

Kreu V përmbledh veprën e Sterjos të përkthyer në rreth 20 gjuhë të huaja. Romani "Ata nuk ishin vetëm" është përkthyer në frëngjisht, gjermanisht, rusisht, bullgarisht, polonisht, kineze, vietnameze etj. Romani "Afërdita përsëri në fshat" në greqisht, bullgarisht, rusisht etj.; "Afërdita" në turqisht; "Zgjimi" në anglisht; "Pse?!" në maqedonisht, ndërsa disa tregime në disa gjuhë edhe në arabisht etj.

Në kreun VI përfshihet vlerësimi i krijimtarisë së Sterjos si në shtypin shqiptar ashtu dhe atë të huaj; vlerësim i bërë nga figura të shquara të shkencës, letërsisë dhe politikës së kohës si dhe vlerësim i bërë nga organe të rëndësishme si enciklopedi, dhe vepra të tjera kryesore. Në këto materiale Sterjo Spasse vlerësohej si ndër shkrimtarët më të përmendur të letërsisë shqipe.

Në kreun X janë vendosur emrat e personazheve të ciklit të romaneve "Rilindësit"

Në fund janë vënë inicialet dhe pseudonimet, që janë përdorur nga Sterjo Spasse në botimin e shkrimeve të tij.

Si përfundim, e tërë bibliografia e Sterjo Spasse përmbledh mbi 2600 zëra, ku lëvrijnë mbi 1500 personazhe. Vetëm cikli i romaneve "Rilindësit" ka mbi 1000 të tillë (1119).

A është e plotë kjo bibliografi? Mendoj se jo, por është më e plota. Duke qenë krijimtaria e Sterjo Spasses një minierë e tërë, me siguri brenda saj do të kenë mbetur edhe shkrime ende të paeksploruara sidomos në shtypin e huaj...Por sidoqoftë, kryesoret janë...Duke i bërë një analizë të hollësishme gjithë krijimtarisë së tij si atë të botuar ashtu dhe të pabotuar, duke parë edhe korrespodencat e shumta intime me shokë, miq, të afërm, nxënës, studentë etj. të bije menjëherë në sy, se ai nuk ka ndenjur një ditë pa hedhur në letër qoftë krijimtari letrare apo shkencore, qoftë edhe ndonjë korrespodencë, gjë që e bëjnë një shembull për brezat e rinj që duan t'i futen kësaj gjinie sa të vështirë aq edhe të lodhshme.

Prof. Dr. Hamit Boriçi

KREU I

KRIJIMTARIA LETRARE

I

Romane:

1935

1. NGA JETA NË JETË: PSE?!... (Botim si nënfletë). - Në: "Gazeta e Korçës", Korçë, nr. 2228-2302, 9 maj - 9 gusht 1935, f. 2.

2. NGA JETA NË JETË: PSE?! / parath. Vangjo Nirvana (pseud. i Vangjel Koça). - Korçë : Lib. "Drita", 1935. - XII + 193 f. [Përmbajtja: Nëpërmjet personazhit kryesor, Gjon Zaverit, pasqyrohen kontradiktat midis shtresës shoqërore, fshatarëve tradicionalë, në tërësi dhe grupit të fshatarëve që kanë hyrë në integrimin qytetar; dramë kjo e të gjitha vendeve dhe e gjithë kohrave, që e bën lexuesin ta përjetojë në kushtet e vendit të tij].

1943

3. NGA JETA NË JETË: PSE?! (botimi 2-të) / parath. Vangjo Nirvana (pseud. i Vangjel Koça. - Tiranë, "Kristo Luarasi", 1943. - 192 f.

1944

4. AFËRDITA. - Tiranë : "Luarasi", 1944. - 191 f. [Përmbajtja: Pasqyron rolin që mund të luajë një mësuese e përkushtuar jo vetëm në edukimin e fëmijëve, por edhe në emancipimin e mjedisit ku ajo punon].

1952

5. ATA NUK ISHIN VETËM. - Tiranë : "Naim Frashëri", 1952. - 272 f. [Përmbajtja: Bën fjalë për revoltën e fshtarësisë Shqiptare kundër regjimit feudo-borgjez të kohës (Vitet '30)].

1954 *

6. PËR JETËN E RE. - Në: ”Nëntori”, nr. 11, 1954, f. 129-165 ; nr. 12, 1954, f. 13- 85; nr. 1, 1955, f.14-88.

1955

7. AFËRDITA PËRSËRI NË FSHAT. - Tiranë : SHB “N. Frasheri”, 1955. - 266 f. [Përmbajtja: Bën fjalë për përpjekjet, punën e luftën për realizimin e Reformës Agrare në Shqipëri në periudhën e pasçlirimit (1946); tregon se sa të lidhur ishin njerëzit me tokën, dhe ç’luftë e ashpër e klasave bëhej atëherë për të siguruar punën e lirë, pa çifligarë]

1956

8. AFËRDITA. - Prishtinë: Shtëpia Botuese ”Mustafa Bakija”, 1956. - 188 f.

1960

9. ATA NUK ISHIN VETËM. (Botim i 2-të). - Tiranë: Botim i Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës, Tiranë, 1960. - 271 f. (Biblioteka shkollore).

1961

10. BUZË LIQENIT. - Në: “Nëntori”, nr. 1, 1961, f. 10-30; nr. 2, 1961, f. 8-81; nr. 3, 1961, f. 73 - 138. [Përmbajtja: Shtjellon një nga periudhat më të rëndësishme të fshatit, kthesën e madhe revolucionare drejt kolektivizimit, që u bë me përpjekje, luftë, me konflikte të thella shoqërore. Personazhet e veprës janë të shumtë.

* Duke filluar nga ky numër rendor, për organet e shtypit (revista e gazeta) të botuara në Tiranë, për të mos rënduar njësitë bibliografike, nuk do të shënohet vendi i botimit, i cili, në këto raste, do të nënkuptohet.

Këta personazhe mbajnë një qëndrim të caktuar kundrejt kolektivizimit në bazë të botëkuptimit dhe interesit dhe veprojnë sipas karakterit të tyre].

1962

11. ATA NUK ISHIN VETËM. (Botim i 3-të). - Tiranë : Drejtoria e Botimeve Shkollore, 1962. - 260 f. (Biblioteka shkollore)

1964

12. ATA NUK ISHIN VETËM. (Botim i 4-të). - Tiranë : Drejtoria e Botimeve Shkollore, 1964. - 279 f.

13. AFËRDITA. (Botimi i 2-të). - Prishtinë : "Rilindja", 1964. - 166 f.

1965

14. BUZË LIQENIT / red. Mark Gurakuqi. - Tiranë : Sh.B."Naim Frashëri", 1965. - 364 f.

1967

15. AFËRDITA. (Botimi i 3-të). - Prishtinë : "Rilindja", 1967. - 180 f. (Biblioteka Agimi).

16. AFËRDITA PËRSËRI NË FSHAT. (Botim i 2-të). / red. Dilaver Dilaveri. - Tiranë : Sh.B. "Naim Frashëri", 1967. - 320 f.

1968

17. NE JEMI SHUMË...(Variant i shkurtuar). - Në: "Nëntori", nr. 1, 1968, 105-140; nr. 2, 1968, f. 3-39; nr. 3. 1968, f. 3-32.

1972

18. ZJARRE. [Redaktor: Dilaver Dilaveri]. - Tiranë : Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", 1972. - 356 f. [Përmbajtja: Pasqyron periudhën e ndryshimeve të thella të jetës në malësinë e veriut gjatë

viteve 1966-1970, që në gjuhën politike të kohës, u quajt periudha e revolucionarizimit të vendit].

1973

19. ATA NUK ISHIN VETËM (Botimi i 5-të). - Tiranë : Sh.B. "Naim Frashëri", 1973. - 335 f.

1974

20. ZGJIMI. (Nga cikli i romaneve "Rilindësit"). - Tiranë : Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", 1974. - 501 f. [Përmbajtja: Është romani i parë i ciklit të romaneve "Rilindësit". Ai ngërthen fazën e parë të Rilindjes brenda viteve 1885-1887 dhe ngjarjet më karakteristike të luftës për çlirimin kombëtar nga zgjedha osmane. Pasqyron luftën për zgjimin e vetëdijes kombëtare dhe në mënyrë të veçantë për përhapjen e shkrimit dhe të leximit të gjuhës amtare; pra, për hapjen e shkollës shqipe. Ngjarjet janë vendosur në qytetin e Korçës e në rrethinat e saj].

1975

21. ZGJIMI (Nga cikli i romaneve "Rilindësit"). - Prishtinë : "Rilindja", 1975. - 501 f. (B-ka Romani shqiptar)

22. PISHTARË (Nga cikli i romaneve "Rilindasit"). - Tiranë : Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", 1975. - 584 f. [Përmbajtja : Është romani i dytë i ciklit të rilindësve. Në këtë roman kapen nyje të tjera të rezistencës së organizuar dhe të luftës deri në prag të shpalljes së Hyrjetit]

1977

23. AFËRDITA (Botimi i 5-të). - "Rilindja", Prishtinë, 1977. - 201 f. (B-ka, Lekturë shkollore klasa 8 fillore).

1978

24. JA VDEKJE, JA LIRI (Nga cikli i romaneve "Rilindësit"). - Tiranë : Sh.B."Naim Frashëri", 1978. - 552 f.[Përmbajtja: Është

vazhdim i romaneve të parë të ciklit "Rilindësit". Ngjarjet zhvillohen në trevat e Shqipërisë së Veriut në vitet 1911-1912....Krahas personazheve të mëparshëm ndërthuren edhe personazhe të tjerë të rinj historikë, si Dedë Gjo Luli, Mehmet Shpendi etj.

25. ZGJIMI (Botimi 3-të). - Tiranë : Sh.B. "Naim Frashëri", 1978. - 468 f.

1980

26. AFËRDITA PËRSËRI NË FSHAT : lekturë shkollore, Klasa VIII / red. biblioteke Rifat Kukaj; kopert. Shyqyri Nimani; pasthënie Ali Jasiqi. Botim i dytë. - Prishtinë : Rev. "Rilindja", Redaksia e botimeve, 1980. - 312 f., tir. 10000.

1981

27. ATA NUK ISHIN VETËM. (Përshtatur për fëmijë) / piktor: Safo Marko; red. K. Leli. - Tiranë : Sh.B. "Naim Frashëri", 1981. - 161 piktura, tir. 10000.

1983

28. KRYENGRITËSIT (Nga cikli i romaneve "Rilindësit) / red. Zenel Sula. - Tiranë : Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", 1983, 368 f., tir. 12000. [Përmbajtja : Ky roman ka për subjekt kryengritjet e mëdha të Kosovës më1912, pasqyron si tipa shoqërorë historikë e karaktere letrare figura të udhëheqësve të shquar si Hasan Prishtina, Bajram Curri, Isa Boletini si dhe udhëheqës popullorë (simbol) si Bestar Kosovën, trima dhe luftëtarë të thjeshtë, patriotizmin dhe heroizmin e masave. Trajton me mjeshtëri lëvizjet dhe betejat masive kundër armiqve dhe tradhëtarëve..].

1985

29. JA VDEKJE, JA LIRI (Nga cikli i romaneve "Rilindësit") bot. 2. / red. Rozeta Uçi. - Tiranë,: Sh.B. "Naim Frashëri", 1985. - 556 f. (VEPRA LETRARE, vëll. 9)

1986

30. AFËRDITA PËRSËRI NË FSHAT. (Botim i tretë). / red. Nazmi Rrahmani; pasthënie Ali Jasiqi (f. 313-326); kopert. Salih Lutolli. - Prishtinë : "Rilindja", Redaksia e botimeve, 1986. 312 f., tir. 10000 (Biblioteka "Romani shqiptar").

31. NGA JETA NË JETË - PSE?!...". (Botimi II) / red. Nazmi Rahmani; kopert. Salih Lutolli. - Prishtinë : "Rilindja", Redaksia e botimeve. 1986. - 183 f., tir. 10.000. (Biblioteka "Romani shqiptar"). Mbasthënia nga Nasho Jorgaqi: "Krijimtaria e Sterjo Spasses para çlirimit. f. 184-209. Me shënime për autorin f. 211 nga redaksia

1988

32. AFËRDITA PËRSËRI NË FSHAT Botim i katërt / red. Nazmi Rahmani; kopert. Salih Lutolli. - Prishtinë : "Rilindja", Redaksia e botimeve, 1988. - 312 f., tir. 10.000. (Biblioteka: "Romani shqiptar"). Mbasthënie nga Ali Jasiqi, f. 313-326.

1989

33. O SOT, O KURRË! (Nga cikli i romaneve "Rilindësit) / red. Natasha Dulakaj. - Tiranë : Sh.B. "Naim Frashëri", 1989. - 356 f., tir. 5000. [Përmbajtja: Nën jehonën e kryengritjes së armatosur të vitit 1912, ky roman trajton aspektet kryesore të shpalljes së pavarësisë kombëtare në Vlorë. Me këte roman mbyllet edhe cikli i romaneve "Rilindësit"].

34. AFËRDITA. - (Botim i 5-të). - Prishtinë : Rilindja, 1989. - 201 f., tir. 5000 kopje. (Biblioteka: Romani shqiptar).

1995

35. PSE ?!.... - (Botimi i 6-të) / red. Ilinden Spasse. - Tiranë : "Ardita", 1995. - 181 f.

2002

36. PSE?!.... - (Botimi i 7-të) / red. Ilinden Spasse; parath. Konstandin Papaj; pasthënie: Arian Spasse. - Tiranë : Shoqata Kulturore "Sterjo Spasse"& Sh.B. Erik, 2002. - 206 f.

2004

37. PSE!.... - (Botimi i 8-të). / red. Ilinden Spasse; parath. Konstandin Papaj; pasthënie: Arian Spasse. - Tiranë : Shoqata Kulturore "Sterjo Spasse"& Sh.B. Erik, 2004. - 206 f.

38. AFËRDITA. - (Botim i 5-të). / red. Ilinden Spasse. - Tiranë : Sh. B. "Medaur", 2005, 219 f.

39. AFËRDITA. - (Botim i 6-të) / red. Ilinden Spasse- Tiranë : Weso, 2009. - 171 f.

2010

40. PSE/ red. Ilinden Spasse; parathënie Konstandin Papaj; pasthënie: Arian Spasse. - Tiranë : Sh.B. Erik, 2010. - 206 f.

2012

41. AFËRDITA PËRSËRI NË FSHAT / red. Ilinden Spasse, pasthënie Ali D. Jasiqi]. - Tiranë : Sh,B. "Edlora", 2012. - 287 f.

2013

42. PSE?!...Botimi 9 / red. Ilinden Spasse, Parathënie: Konstandin Papaj, Pasthënie: Arian Spasse. - Tiranë : Sh.B. "Edlora", 2013. - 156 f.

2. Vëllime me tregime

1934

43. KUNORË RINIJE / parath. P (Postol) Tanefi. - Korçë : Shtyp. Kartoleria"Pepo e Marko", 1934. - 29 f. (Biblioteka e të rinjve nr. 1);

ndodhet edhe në librin "Novela të zgjedhura", 1935. Përmbajtja: 1) I mërguemi, f. 5-8, 2) Te varri i botës, f. 9-12; 3) A kam me e pa?..., F. 13 - 15; 4) Lëngimi i shokut të ri V.V., F. 15 - 20; 5) Çou e vdekur, f. 20 - 25; 6) Vjollcës së vyshkun!, f. 25 - 29] - Në Gi de Mopasan dhe Sterjo Spasse "Novela të zgjedhura", Kartoleria "Pepo-Marko", Korçë 1935.

44 - NË KRAHËT E NJIJ FEMNE. - Korçë, shtyp. Kartoleria "Pepo-Marko", 1934, 32 f. (Biblioteka e të rinjve, nr. 3) Bashkëlidhur me librin "Novela të zgjedhura", 1935. [Përmbajtja : 1) Në krahët e njij femne, 2) Ferexheja e nuses]

1944

45 - NUSJA PA DUVAK. - Tiranë : "Kristo Luarasi", 1944. - 180 f. [Përmbajtja: 1) Martesa, 2) Nusja pa duvak, 3) Veli Basha (Shemra), 4) Nusja, 5) Kristina, 6) Profeti, 7) Lotë kurbeti, 8) Guri i unazës].

1957

46 - TË FALA NGA FSHATI. - Në: "Nëntori", nr. 10, tetor 1957. f.11-59.

1958

47 - Në TOKËN KINEZE (Kujtime dhe tregime) / [Autorë: S. Spasse, F. Gjata. - Tiranë : NBSH, 1958. - 254 f. [Përmbajtja: I-Kujtime: 1)Pekini - zemra e Kinës së re, 2) Muri i madh kinez, 3) Kina verilindore - zemër e Republikës Popullore të Kinës, 4) Shanghai - metropoli i imperialistëve në lindjen e largët dhe djep i revolucionit proletar kinez, 5) Hanxhou - parajs i tokës!, 6) Shaoxhin - vendlindja e shkrimtarit të madh Lu Sin, 7) Kantoni, qytet tropikal me histori të gjallë, 8) Në brigjet e lumit Janci; 9) Provinca e Menanit - djep i kulturës së lashtë kineze; 10) Kooperativa bujqësore "Miqësia shqiptaro-kineze"' 11) Portrete: a) E vdekur e gjallë: Fshatarja Lju Hu-Lan, b) Lu Sin, flamurtar i kulturës kineze, c) Go Mo Zho, mendimtar, shkencëtar dhe shkrimtar i Kinës së re; ç) Pararojë të ndërtimit të socializmit: punëtori i Anshanit Mefn Taj; d) Të dy

shoqet nga Çençou. II. TREGIME: 12) Rruga e mundimeve: a) Babai, b) Fillimi i jetës; c) Përmes stuhisë. 13) Në majë të shkëmbit, 14) Tibetasit; 15) Plaku budalla. III- 16. Lamtumirë, o Kinë].

48 - TË FALA NGA FSHATI (Tregime për pionierë e te rinj). - Tiranë : Shtyp. "Mihal Duri", 1958. - 248 f. [Përmbajtja: 1) Një letër nga kryeqyteti, 2) Familja ime, 3) Babi im, 4) Shokët e mi, 5) Turp, turp që je pionier!, 6) Psherëtima të dhimbshme , 7) Fshati im, 8) Kërr, kërr, bëllduf, 9) Kohë të vështira, 10) Ju faleminderit, shokë, 11) Fotografia e përmendores së partizanit, 12) Puna është gëzim, 13) Gëzuar festat kombëtare!, 14) Dëbora e parë, 15) Gëzuar Vitin e Ri!, 16) Vërtetë Sokol, paskam vëlla, 17) Një gabim, 18) Vasoja, zogjtë dhe qeni i Pirros, 19) Më shpëtuat, 20) Gjyshja ime, 21) Gjergji, Angjelina dhe kuçedra - njeri, 21) Gëzimi i punës në kopsht, 22) Hajdutët e vegjël, 23) Një marrëzi, 24) Dallëndyshe faqekuqe, 25) Po bëhet fshati kooperativë, 26) Si në përralla, 27) Pionierët për kooperativën, 28) Një shuplakë e dhimbshme, 29) Kur?, 30) Filmat "Skënderbeu" dhe "Letër nga fshati", 31) "Më thuaj, pse? Pse?", 32) Sihariq, 33) Kryengritje për jetën e re, 34) Kuvendim me nënën, 35) Festa e abetares, 36) Shëtitjet tona, 37) Unaza, 38) Festa e luleve, 39) Hajt, përjashta, 40) Meri, 41) Ura, përpara!, 42) Natën në kullota, 43) O malet e Shqipërisë, 44) Garat e notit dhe trimëria e Vasos, 45) Dëshira fisnike e nënës, 46) Te Vasoja në spital, 47) Korça, histori e gjallë, 48) Shtatëvjeçaras të parë jemi, 49) "Pionieri hero", 50) Telegramet].

1963

49 - KURORA E RINISË (Shkrime të zgjedhura) / parath. Nasho Jorgaqi; Bibliografi nga Jup Kastrati. - Tiranë : Sh.B."Naim Frashëri", 1963. - 274 f. [Përmbajtja: 1) Bota u shthurr, 2) Nga shënimet e një Diogjeni të ri, 3) Dallëndyshe, ktheje ndryshe, 4) Kushtrimi i orave, 5) Skandal, jo aspak, 6) Dy të vdekur, 5) Zëri i zemrës së trëndafilit, 6) Vjollca dhe gjembi, 7) Vjollcës së vyshkur, 8) Ankimi i lumit, 9) Ajka e botës, 10) Ferexheja e nuses, 11) I mërguari, 12) Profeti, 13) Babai, 14) Neta), 15) Fati i Mitit, 16) Kristina, 17) Kujtimet e fundit,

18) Mësuesi, 19) Lot kurbeti, 20) Nusja pa duvak, 21) Malësori i vogël, 22) Shemra, 23) Te korijëza, 24) Lehona, 25) Nusja.

1966

1487 - LUBOTENI, GANI. Romani shqiptar. Në: "Teoria e letërsisë për shkollat e mesme". - Beograd, 1964, f. 382. ***[Romancierët tanë më të njohtun janë Haki Stërmilli, me romanin "Sikur të isha djalë" (1936); Sterjo Spasse me romanet "Pse?!...", (1934), "Afërdita"(1944), "Ata nuk ishin vetëm" (1953) dhe "Afërdita përsëri në fshat" (1955); Sinan Hasani me romanet "Rrushi ka nisë me u pjekë" (1957), "Një natë e turbullt" (1960), "Ku ndahet lumi" (1963); Azem Shkreli me romanin "Karvani i bardhë" (1960); Rexhai Surroi me romanin "Besniku" (1961) etj***].

1488 - LUBOTENI, GANI. - Në: "Teoria e letërsisë për shkollat e mesme", Beograd, 1964. [Stili i gjanë, në f. 191-192, merren shembuj nga romani "Ata nuk ishin vetëm; Fjala si mjet individualizimi, në f.152-153, merren shembuj nga roman "Afërdita"Individualizimi i personazheve, shih f. 153, Diferencimi i gjuhës së veprës letrare, shih f. 157-158, E folme e tregimtarit, f 164-165; Neologjizmat, f. 171-173.

1489 - VINÇANI, VANDUSH: Libri shqip në këta 20 vjet. - Në: "Drita", 22 nëntor 1964.

1965

1490 - KASTRATI, JUP. Bibliografi tematike mbi krijmtarinë e Sterjo Spasses [1929-1960]. (Në ndihmë të historisë së letërsisë shqipe". - Në Buletini "Shkodra", nr. 1, 1965, f.265-319.

1491 - MEKULI, HASAN. S. Spasse, "Afërdita", Roman. - Në: "Jeta e re", Prishtinë, nr. 3, maj-qershor 1965, f.475.

1491 - STUBLLA, SH. "Afërdita" dhe "Mësuesja e katundit" (Romane të Sterjo Spasses dhe të Svetalik Rankoviqit) (Hymje për asaj). - Në: "Zani i rinisë" Prishtinë, nr, 3, 4, 1965, f. 20.

1492 - NJË ROMAN TËRHEQËS PËR KOLEKTIVIZIMIN E BUJQËSISË : **"**Buzë liqenit" - roman . - Në: "Libri", nr. 4, 1965.

1493 - STERJO SPASSE: "Afërdita", roman, botim i dytë. - Në: "Jeta e re", Prishtinë, nr. 4, 1965.

1494 - AFËRDITA PËRSËRI NË FSHAT - Roman nga S.Spasse. - Në: "Libri", Tiranë, 1965.

1495 - GURAKUQI, MARK. "Për jetën e re" (Buzë liqenit). Roman i S.Spasses . - Në: "Nëntori" nr. 8, 1965, f.165-186.

1496 - ALIA, RAMIZ. - Mbi rritjen e rolit të letërsisë dhe arteve për edukimin komunist të masave. - Në: "Rruga e Partisë", nr. 11**,** 1965, f. 111. ***["Në veprat më të mira të Sterjo Spasses etj... si dhe të gjithë shkrimtarëve dhe artistëve tanë, i thurret lavdi popullit tonë, i cili me vetmohim e sakrifica ndërton socializmin"].***

1497 - HOXHA, S. : Përpjekje për një fjalor terminologjik të leximit letrar. – Në: "Buletini shkencor" i Institutit Pedagogjik dyvjeçar të Shkodrës, 1965, f. 343. ***[Një kontribut të çmueshëm në përhapjen e njohurive të teorisë së letërsisë dhe të mjeshtërisë letrare dhanë, qoftë me punime origjinale, qoftë me adaptime në organet tona letrare shkrimtarët dhe publicistët Sterjo Spasse ..].***

1966

1498 - MELO, VASIL. Mbi koherencën e karakterit në roman (Për romanin "Buzë liqenit"). - Në: "Drita", 10 prill 1966.

1499 - GURAKUQI, MARK. [Të merrni si shembull Sterjo Spassen..]. - Në: "Autorë dhe probleme të letërsisë përparimtare shqipe të viteve 30'". – Tiranë : Sh.B. "Naim Frashëri", 1966, f.17-18.

1500 - QOSJA, REXHEP. Retrospektiva mbi veprën e Migjenit. – Në: "Përparimi", Prishtinë , nr. 4, 1966, f. 334-349. ***[...Nga veprat me një aksent të këtillë dominues shquhet romani "Pse?" i Spasses, që asht dëshmia e nji kohe për atmosferën specifike të një kohe të caktueme shoqnore...edhe romani i Spasses asht shprehja e asaj gjendje, e sidomos shprehja e depresionit shpirtëror t'intelektualve që dëshirofshin të largoheshin n'imagjinatë nga realiteti i randë dhe shtypës...".***

1501 - AKTIVITET KUSHTUAR 100 VJETORIT TË LINDJES SË NDRE MJEDËS. – Në: "Bashkimi", 20 nëntor 1966. ***[Elbasan...foli***

anëtari i Komitetit drejtues të lidhjes së shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë Sterjo Spasse..].

1502 - NJË SHKOLLE 8-VJEÇARE TË KRYEQYTETIT I JEPET EMRI I FAN S. NOLIT. - Në: "Zëri i popullit", 25 nëntor 1966. ***[Fjalën e rastit e mbajti shkrimtari Sterjo Spasse, anëtar i këshillit popullor të kryeqytetit..].***

1967

1503 - PODRIMJA, ALI. Të huajt për Sterjo Spassen (Kronika). - Në: "Jeta e re", Prishtinë, nr. 2, 1967, f. 389-390.

1504 - MEKULI, HASAN. Në marginat e revistës "Jeta e re". - Ne "Jeta e re", Prishtinë, nr. 2, mars - prill 1967. f.34. ***[Pra prej Naim Frashërit deri te Migjeni dhe Fan Noli, deri te Sterjo Spasse...dhe një varg të tjerësh për veprimtarinë e të cilëve duhet të dijmë..].***

1505 - BERISHA, RUSTEM. Plejada e letrarëve. - Në: "Zani i rinisë", Prishtinë, nr. 6,
1 mars 1967. ***[...Kemi në dorë "Hasta La vista" të Petro Markos, "Ata nuk ishin vetëm" të Sterjo Spasses, "Gjenerali i ushtrisë së vdekur të Ismail Kadaresë"....]***

1506 - NIKAJ, V. Intervistë e vogël**:** Tema e parë nga Letërsia shqipe**:** Tematika sociale në veprat e Sterjo Spasses. - Në: "Rilindja", Prishtinë, 24 prill 1967.

1507 - QOSJA, REXHEP. Vallet poetike të Lasgush Poradecit. -Në: "Jeta e re", Prishtinë, nr. 3, maj- qershor 1967, f. 456. ***[...Tue shkrue për PSE-hin e Spasses kam theksue se filozofia e Zaverit mbështetet në idealizmin gjerman dhe s'është për t'u çuditun edhe në idealizmin kantian..].***

1507 - PODRIMJA, ALI**.** Sterjo Spasse dhe vepra e tij. (Vështrime). - Në: "Rilindja", Prishtinë, 9 korrik 1967, f. 11.

1508 - EDHE DISA MARGARITARË (Bisedë rase me Ramiz Kelmendin, kryeredaktor i Redaksisë së botimeve "Rilindja". - Në: "Zani i rinisë", Prishtinë, nr. 21, 10 shtator 1967, f. 14. ***[..."Rilindja" botoi deri më tani 28 libra të ndryshme, ndër të cilat edhe "Afërditën" e Sterjo Spasses (Botim i tretë)....Kasollja e xha Tomit"..].***

1509 - LIBRA TË REJA : Sokolesha. - Në: "Zëri i popullit", 20 shtator 1967; në: "Zëri i rinisë", 20 shtator 1967. ***[...Penda e shkrimtarit tonë të mirënjohur , ka tërhequr gjithmonë vemendjen dhe shijen e lexuesve..].***

1510 - QOSJA, REXHEP. Epope e Luftës së Spanjës (Petro Marko: "Hasta la vista"- roman. Botim i "Rilindjes": - Prishtinë 1967....". - Në: "Jeta e re", Prishtinë, nr. 5, shtator-tetor 1967, f, 1057. ***[Petro Marko asht romancier i vërtetë dhe, me siguri, përkrah Spasses, Shefqet Musarajt e Ismail Kadaresë, romancieri ma i çquem e ma i fort shqiptar...].***

1511 - QOSJA, REXHEP. Haki Stërmilli : "Sikur të isha djalë". - Në: "Jeta e re", Prishtinë, nr. 5, shtator - tetor 1967, f.1076**. *[...romani i Haki Stermillit shpreh një tragjikë ma të madhe , se sa romani i Sterjo Spasses..].***

1512 – SHËNIME. Këshilli botues i "Rilindjes" aprovoi projektplanin për vjetin e ardhshëm... - Në: "Jeta e re", Prishtinë, nr. 5, shtator - tetor 1967, f.1117**. *[Rilindja do të botojë të gjitha veprat e Sterjo Spasses ("Pse?!...", "Afërdita", Afërdita përsëri në fshat", Ata nuk ishin vetëm", "Buzë liqenit" dhe përmbledhjet e tij të tregimeve) - dhe krijimet origjinale të Nolit..].***

1513 - U MBLODH KONFERENCA E TALENTEVE TË REJA. – Në: "Drapër e çekan", Fier, 25 nëntor 1967. ***[...Në mbledhje foli edhe shoku Sterjo Spasse, i cili shtroi një sërë detyrash të rëndësishme***

për zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë dhe arteve në rrethin e Fierit…].

1514 - JASIQI, ALI. Përpara veprave origjinale. - Në: "Rilindja", Prishtinë, 29 tetor 1967, f. 9. ***[...me ndërmarrjen e parë të kësaj shtëpie botuese "Rilindja", për botimin e veprave komplet të një shkrimtari parashihen t'u prezantohen publikut lexues me të gjitha veprat dy krijues të dalluem shqiptarë: Të gjitha romanet dhe tregimet e deritashme të Sterjo Spasses ...dhe të Nolit..].***

1515 - LIBRA TË REJA. "Sokolesha"(Recension). - Në: "Zëri i popullit", 25 nëntor 1967.

1516 - SHEMA, ISAK. Për jetën e re. Përshtypje mbi romanin e Sterjo Spasses "Buzë liqenit". - Në: "Rilindja", Prishtinë, 26 nëntor 1967, f. 10.

1517 - QOSJA, REXHEP. Shkaqet dhe kuptimi i nji tragjedije (Mbi romanin "Pse?!..." të S. Spasses). - Në librin: "Qosja, R. Episode letrare (Pseja?!..". - Prishtinë, "Rilindja", 1967, f. 112.

1968

1518 - KOMPLETI STERJO SPASSE : [Foto e shkrimtarit]. – ***Në:*** rev. "Zëri i rinisë", Prishtinë, nr. 8, 24 fror, 1968. ***[Për të parën herë në literaturën shqipe. KOMPLETI STERJO SPASSE Për të parën herë në bibliotekën tuaj KOMPLETI STERJO SPASSE. Për të parën herë në përgatitje ma moderne botue nga SGB"Rilindja"-Prishtinë. ...Asht një prej ndërmarrjeve të para dhe ma serioze të kësaj shtëpie botuese, që paraqet krijimtarinë komplet të njanit nga romancierët ma të njoftun dhe shkrimtarët ma të frytshëm të letërsisë shqipe... -- Përfshin të gjitha romanet dhe përmbledhjet e tregimeve, që ka shkrue ky shkrimtar prej fillimit deri sot. ... Shtypet në letrën ma të mirë, me një përkujdesje teknike të jashtëzakonshme, format modern, lidhë me kartuç vendosë në një***

kuti dekorative mbrojtëse.Paraqet pasqyrën ma të begatshme të krijimtarisë së këtij letrari dhe kontributin ma të frytshëm të romanit shqiptar në përgjithësi, botohet në tetë vëllime, që përfshijnë këto romane dhe përmbledhje tregimesh: 1. Pse?!... 2. Afërdita, 3. Ata nuk ishin vetëm, 4. Afërdita përsëri në fshat, 5.Të fala nga fshati, 6. Kurora e rinisë, 7. Buzë liqenit, 8. Sokolesha e tregime të tjera.... [Shënim: Kjo është reklama e botuar në rev. "Zëri i rinisë", nr. 8, Prishtinë 24 fror 1968, në tërë faqen e tretë të kapakut, bashkë me fotografinë e shkrimtarit. Korniza e tërë faqes së tretë të kapakut është bërë me shirit të kuq e brenda tij me të zeza është shkruar tetëmbëdhjetë herë: Kompleti Sterjo Spasse. (I.S.)].

1519 - LEGJENDA ME FUNDAMENT REAL (Me rastin e botimit të legjendës të Sterjo Spasses, Sokol Torviolli). - Në: "Flaka e vëllazërimit", Shkup, 29 shkurt 1968, shtojcë nr. 9, f.1.

1520 - QOSJA, REXHEP. Teoria e një romani. – Në: "Fjala", Prishtinë, nr. 2, 1968, f. 11-12. ***[...Edhe pse vepër e shkrueme simbas një metode të re, "Dasma" (e Ismail Kadaresë) nuk mund të krahasohet me romanet e Sterjo Spasses, Fatmir Gjatës, Petro Markos e as me romanin e vetë Ismail Kadaresë "Gjenerali i ushtrisë së vdekur].***

1521 - KOPSHTI LETRAR: Sterjo Spasse. - Në: "Fjala", Prishtinë, nr. 2, 1968, f. 11.

1522 - KOMPLETI STERJO SPASSE. - Në: "Libri", Prishtinë, viti I, nr. 1, mars 1968. [b. Sterjo Spasse: Ata nuk ishin vetëm(fragment) c...Buzë liqenit (koment) d) Fjalëkryq nr. ..horizontalisht: 37-Roman i njoftun i Sterjo Spasses].

1523 - BULO, JORGO. Nga historia e lindjes dhe e formimit të romanit të sotëm shqiptar: "Ata nuk ishin vetëm" të S. Spasses". - Në: "Studime filologjike", nr. 2, 1968, f.149-168, përmbl. frëngj].

1524 - JASIQI, ALI D. Legjenda në realizimin artistik : meditime rreth prozave të përmbledhjes "Sokolesha" të Sterjo Spasses). - Në: "Fjala", Prishtinë, nr. 2, mars 1968, f. 10. ***[...Këto elemente të legjendave shqipe i ka hetue mjaft mirë edhe romancieri ynë i mirënjoftun Sterjo Spasse..."].***

1525 - JASIQI, ALI D. Romani i ri i Sterjo Spasses "Ne jemi shumë.." botuar në: "Nëntori". - Në: "Rilindja", Prishtinë, 7 prill 1968, f. 12.

1526 - HOXHA, HYSNI: Teoria e një romani (Pro e contra). - Në: "Fjala", Prishtinë, nr. 3, 1968, f. 14. ***[...Unë me këtë rast nuk due të nënçmoj veprat e Sterjo Spasses,Fatmir Gjatës, Petro Markos...,por jam kundër një vlerësimi të guximshëm dhe aspak të argumentuar të Rexhep Qoses, i cili i çmon romanet e shkrimtarëve të përmendur dhe nënçmon romanin e ri të Ismail Kadaresë].***

1527 - JASIQI, ALI D. Për transformimin socialist të fshatit. Sterjo Spasse "Afërdita përsëri në fshat" (Roman). – Në: "Rilindja", Prishtinë, 28 prill 1968, f. 9.

1528 - QOSJA, REXHEP. Dialog i imagjinuar. - Në: "Fjala", Prishtinë, nr. 4, maj 1968, f. 10 - 11. ***[...Prej këtij numri asht e natyrshme të dalin edhe talente, ashtu dhe sikur kanë dalë e prej të cilëve mund të dallohen Sterjo Spasse, Fatmir Gjata, Hivzi Sulejmani, Jakov Xoxa, Naum Prifti, Ramiz Kelmendi, Ismail Kadare, Azem Shkreli, Petro Marko, Andon Pashko, Shefqet Musaraj..].***

1529 - M.R: KOMPLETI STERJO SPASSE. - Në: "Rilindja", Prishtinë, 22 maj 1968. ***["...Kjo është hera e parë që botohen kompletet e të gjitha veprave të ndonjë shkrimtari shqiptar].***

1530 - KOMPLETI STERJO SPASSE. - BOTIM I SH.B. "Rilindja", Prishtinë, 1968.

Vëll 1. Pse?!... f. 224
Vëll. 2. Afërdita... f. 204
Vëll. 3. Ata nuk ishin vetëm. f. 334
Vëll. IV. Afërdita përsëri në fshat. f.328
Vëll. V. Të fala nga fshati. f.284
Vëll. VI. Kurora e rinisë..... f.154
Vëll. VII. Buzë liqenit. f. 358
Vëll. VIII. Sokolesha e tregime të tjera. f. 312
Gjithsej f. 2198.

1531 - STUDIME TË BOTUARA SI PARATHËNIE E PASTHËNIE NË KOMPLETIN "STERJO SPASSE***". Në vëll. I: - Rexhep Qosja; Shkaqet dhe kuptimi i një tragjedie, f. 9-41; Nasho Jorgaqi: Krijimtaria letrare e Sterjo Spasses para çlirimit....f. 119-123; IV: Ali D. Jasiqi: Mbasthënie (Afërdita përsëri në fshat), f. 315-328; V: Hysni Hoxha: Mbasthënie (Të fala nga fshati), f. 275-279; VI: Fatmir Gjata: Shkrimtari Sterjo Spasse f. 7-22; VII: Jup Kastrati: Bibliografia tematike e prozës së Sterjo Spasses, f. 271-292; VIII: Ali D. Jasiqi:- Mbasthënie (Sokolesha e tregime të tjera), f. 293-309. Shënim: Gjithsej studimet e botuara si parathënie e si pasthënie në: "Kompletin Sterjo Spasse" kapin 122 faqe***. - Në: "Rilindja", Prishtinë, 22 maj 1968.

1532 - JASIQI, D, ALI. Veprat e plota të Sterjo Spasses : [foto e shkrimtarit]. - Në: "Rilindja", Prishtinë, 25 maj 1968, f. 13.

1533 - MEHMETI, N. "Ne jemi shumë". Rreth një romani të ri të S. Spasses. - Në: "Nëntori", nr. 5, 1968, f.160-161.

1534 - MUÇAJ, F. Pasqyrë e realitetit dhe agjitator i flaktë : "Ne jemi shumë". - Në: "Nëntori" nr 5, 1968, f. 165-168.

1535 - KODRA, KLARA: Pasqyrimi i aktualitetit dhe bota shpirtërore e heronjve. (Shënime kritike rreth romanit "Ne jemi

shumë" të S. Spasses dhe "Kthesa të forta" të R. Brahimit). - Në: "Drita", 14 korrik 1968.

1536 - SHEMA, ISAK. Pikëpamjet sociale në veprimtarinë e Sterjo Spasses [punim i mbajtur për magjistraturë]. - Në: "Rilindja", Prishtinë, 27 korrik 1968, f.12.

1537 - KOMPLETI STERJO SPASSE. - Në: "Zëri i rinisë", Prishtinë, nr. 8, 1968.

1538 - KRISTO, STAVRI. Diku në këndin e këtij trualli. (Mbi romanin "Ata nuk ishin vetëm"). - Në lib. "Artikuj kritikë. Letërsia e sotme shqipe". - Tiranë, 1968, f. 175-201.

1538 - GJATA, FATMIR. Shkrimtari Sterjo Spasse. – Në: Vëllimin me tregime "Kurora e rinisë". - Prishtinë, 1968, f. 7-22.

1539 - HOXHA, H. Mbasthënie (Në librin Sterjo Spasse, "Të fala nga fshati"). – Prishtinë, 1968, f. 275-279.

1540 - JORGAQI, NASHO. Krijimtaria e Sterjo Spasses para çlirimit. - Në: "Kompleti Sterjo Spasse: Nga jeta në jetë: Pse?!..., Vëll. I, f. 199-223". [Redaktor:Ramiz Kelmendi] Tirazhi: 6000 copë. Sipërmarrja gazetare botuese: "Rilindja", Prishtinë, 1968.

1541 - JASIQI, ALI D.:- Mbasthënie në librin "Sokolesha dhe tregime të tjera". - Prishtinë, 1968, f. 293-309.

1542 - JASIQI, ALI D. Mbasthënie në librin "Afërdita përsëri në fshat". - Prishtinë, 1968, f. 315-328.

1543 - QOSJA, REXHEP. Shkaqet dhe kuptimi i një tragjedie. - Në librin: Sterjo Spasse: "Nga jeta në jetë, Pse?!". - Prishtinë, 1968, f. 9-41.

1544 - GJATA, FATMIR: Shkrimtari Sterjo Spasse. - Në: "Kurora e rinisë". – Prishtinë : SH.B. "Rilindja", 1968, f.7-22.

1969

1545 - SHEMA, ISAK. Pikëpamjet sociale në veprën e Sterjo Spasses**.** - **Në**: "Jeta e re", Prishtinë, nr. 1, janar-shkurt 1969, f.17-49; nr. 2, mars-prill 1969, f. 256-276.

1546 - QOSJA, REXHEP. Shkaqet dhe kuptimi i një tragjedie. (Romani "Pse?!" i Sterjo Spasses). - Në: "Jeta e re", Prishtinë, nr. 4, 1969, f. 503-533.

1547 - SHEMA, ISAK. Ngritja e ndërlikimeve dhe e konflikteve në veprën letrare "Ata nuk ishin vetëm". - Në: "Fjala", Prishtinë, nr. 6, 1969.

1548 - BULO, JORGO. Një vështrim rreth romanit "Ata nuk ishin vetëm" i S. Spasses. - Në: "Lëndët shoqërore në shkollë", nr. 6, 1969.

1549 - SHABANI, RESUL. Pasqyrimi i një realiteti të hidhët : Sterjo Spasse "Ata nuk ishin vetëm" (Roman), Prishtinë, 1968. - Në: "Zëri i rinisë", Prishtinë, nr. 26, 1969, f. 11.

1550 - XOXA, JAKOV. Dy probleme kompozicionale në prozë. - Në: "Fjala", Prishtinë, nr. 12, 1969, f. 3. [Rreth romaneve "Buzë liqenit" të S. Spasses, "Në valët e jetës" të Vedat Kokonës dhe "Një vjeshtë në stuhi" të Ali Abdihoxhës].

1970

1551 - HALIMI, MEHMET. Një roman i idealizuar. (Mbi romanin "Afërdita" të Sterjo Spasses. - Në: "Fjala", Prishtinë, nr. 3, mars 1970, f.14.

1552 - FETAHU, R.Tregime të shkurtëra me kuptim më të gjerë : "Kurora e rinisë", recension. - Në: "Bota e re", Prishtinë, nr. 7, 1970, f. 12.

1553 - VINCA, AGIM. Dy heronj, një ideal (Analizë përqasëse e fytyrës së Pavël Vlasovit dhe të Gjikë Shpatit). – Në: "Fjala", Prishtinë, nr. 8, gusht 1970, f. 16.

1971

1554 - JANURA, PETRO. Koncepsionet letrare të Gligor Perliçevit në poemën "Skënderbeu". - Në: "Jehona", Shkup, nr. 2, 1971, f. 21-35.

1555 - ALIÇKAJ, XHAVIT. Pikëpamjet didaktiko-metodike në "Afërditën" e S. Spasses. - Në: "Shkëndia", Prishtinë, nr. 4, 1 maj 1971, f. 14.

1556 - PEDAGOGU SPASSE DHE AJO. - Në: "Shkëndija", Prishtinë, nr. 5, 15 maj 1971, f. 2.

1557 - 25 VJETORI I SHKOLLËS NORMALE NË KOSOVË. - Në: TJB (Televizioni Jugosllav i Beogradit, në emisionin shqip). Beograd, 17 tetor 1971, ora 8.10', e dielë. ***[Romani "Afërdita" i Sterjo Spasses ka qenë i vetmi bagazh në këtë jetë të vështirë e shumë të vlefshme për mësuesit e tij].***

1558 - JASIQI, ALI, D. Transformimi socialist i fshatit. (Mbi romanin "Afërdita përsëri në fshat"). - Në: Jasiqi, A. D., "Pesha e fjalës". - Prishtinë, Rilindja, 1971, f. 84-98.

1559 - HOXHA, REXHEP. Epo ku jemi? (Broshurë), Prishtinë, 1971, 32 f. ***[...Me gojën e Omer Khajamit, të Bajronit, të Migjenit, të Spasses, ka folë njeriu i të gjitha kohrave, i të gjitha breznive..].***

1972

1560 - KARIKATURA MIQËSORE NGA DHIMITËR S. SHUTERIQI. - Në: "Drita", 1 janar 1972 ***[S. Spasse, N. Bulka, , A. Varfi, Ll. Siliqi].***

1561 - STERJO SPASSE (Bibliografi). - Në: "Pionieri", nr. 6, Tiranë, 1972, f 6-7. [b. Foto: S, Spasse me të nipin Arian].

1562 - HOXHA, E. - Fjala e mbylljes në Plenumin XIII të KQ të PPSH "Mbi punën ideologjike të Partisë dhe masat për përmirësimin e saj", 27 prill 1955. - Në: Hoxha, E. "Vepra 12". - Tiranë, 1972, f.301. [Janë shkruar romane ose libra të bukura, siç janë ato të Sterjo Spasses etj...Për veprat e tyre këta shkrimtarë duhen inkurajuar e përgëzuar..].

1563 - JASIQI, ALI. D. Legjendat aktuale (Mbi tregimet "Sokolesha dhe tregime të tjera). Në: Jasiqi, A. D. "Shfletime". - Shkup, 1972.

1973

1564 - STERJO SPASSE: "Zjarre..." roman (Recension). – Në: "Libri", janar 1973.

1565 - VINCA, AGIM. Shkrimtarë të dy epokave. - Në: "Gjurmime albanalogjike. Seria e shkencave filologjike", Prishtinë, nr. 3, 1973. ***[..Më të shquarit ndër ta Sterjo Spasse, Petro Marko dhe Dhimitër Shuteriqi, vepruan aktivisht në periudhën e viteve' 30..].***

1566 - HASANI, HASAN: Sterjo Spasse (1914). (Ju paraqesim shkrimtarin). - Në: "Shkëndija", Prishtinë, nr. 3, 15 shkurt 1973, f.10.

1567 - NGA LETËRSIA BALLKANIKE: STERJO SPASSE: (Shënim bibliografik). - Në: "Nova Makedonia", Shkup, 29 prill 1973.

1568 - MARTINI, XHAFER. Mbi romanin "Zjarre...". – Në: "Drita", 3 qershor 1973, f. 3.

1569 - HOXHA, E. "Të thellojmë luftën ideologjike kundër shfaqjeve të huaja e qëndrimeve liberale ndaj tyre". - Në Raport i mbajtur Plenumin IV të KQ të PPSH, 26 qershor 1973, f. 389. ***[Në romanet më të mira të Sterjo Spasses e të Ismail Kadaresë, të Fatmir Gjatës e të Jakov Xoxës, si dhe të prozatorëve të tjerë, pasqyrohet me një madhështi të veçantë epike lufta e popullit për çlirimin nga shtypja e të huajve e shfrytëzimi shekullor, për ndërtimin e shoqërisë së re socialiste, për formimin dhe për edukimin e njeriut të ri].***

1570 - HOXHA, ENVER. "Te populli është burimi më i madh i frymëzimit". Nga biseda e zhvilluar me një grup shkrimtarësh dhe artistësh në prag të Kongresit të parë të Shkrimtarëve dhe artistësve të Shqipërisë më 15 maj 1957. - Në lib. Hoxha, E.,"Vepra 14". - Tiranë, 1973, f.432.

1571 - DILAVERI, DILAVER (inic. D. D.). "Roman nga Sterjo Spasse "Zjarre" (Botime të reja). - Në: "Nëntori", nr. 6, 1973, f. 164-165.

1572 - LEZHA, NEKI. Flaka e zjarrit revolucionarizues (Shënime kritike mbi romanin "Zjarre" të S. Spasses). - Në: "Nëntori", nr. 8, 1973, f. 50-58.

1573 - FISHTA (HOXHA), FATBARDHA. Gruaja shqiptare për letërsinë. Në: Buletini "Shkodra", Shkodër, nr. 13, 1973, f. 146.

1574 - UÇI, ALFRED. Realizmi socialist-themeli i paluajtur i artit tonë. - Në: "Zëri i popullit", 28 tetor 1973. ***[...Për epërsitë e padiskutueshme të metodës së realizmit socialist flasin edhe veprat më të mira të shkrimtarëve tanë S. Spasses dhe I. Kadaresë, të F. Gjatës dhe J. Xoxës..] .***

1575 - SHKRIMTARË TË RINJ PËRPARIMTARË DHE REALISTË TË VITEVE ‘30. – Në: “Historia e Letërsisë Shqipe për shkollën e mesme të përgjithshme”. – Tiranë : Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, 1973.

1576 - STERJO SPASSE, JETA, VEPRA. - Në: “Historia e Letërsisë Shqipe I, për shkollat e mesme”, (maket). - Tiranë, 1973, f.169.

1577 - ROMANI “ATA NUK ISHIN VETËM”. - Në: “Historia e Letërsisë Shqipe për shkollat e mesme të përgjithshme” (Maket). – Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, 1973.

1578 - BIHIKU, KOÇO. Takimi me Afërditën (Mbi romanin “Afërdita përsëri në fshat”. - Në: “Bihiku, K. “Probleme letrare”. - Tiranë, 1973, f. 271-280.

1579 - SHAPLLO, Dalan. “Ata nuk ishin vetëm” nga S. Spasse. - Në: “Historia e letërsisë shqiptare” (maket). - Tiranë, 1973, f. 144.

1580 - HOXHA, ENVER. Fjala në mbledhjen e komisionit iniciator për kremtimin e 45 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Tetor 1957. – Në: Hoxha, E., “Vepra 15”, Tiranë 1973, f. 113. [Shoku Enver: Atëhere jeni dakort që të ngrihet një komision për drejtimin e gjithë punëve të festës? Ky komision kemi menduar të përbëhet nga: Sterjo Spasse..].

1974

1581 - LIBRA TË REJA: “ZGJIMI”. - Në: “Puna”, 3 maj 1974.

1582 - DEDE, MIHAL (Mekanik Sarandë); ZENELI, MUSA (Punonjës në Uzinën Elektromekanike-Tiranë). Nga vepra të tilla mësojmë shumë. (Romani “Zgjimi”). - Në: “Drita”, 28 korrik 1974, f.5.

1583 - BREGU, NATASHA. Një roman që të lë mbresa ("Zgjimi"). - Në: "Përpara", Korçë, 25 shtator 1974.

1584 - DISKUTIM KRIJUES RRETH ROMANIT "Zgjimi" TË STERJO SPASSES. - Në: "Përpara", Korçë, 28 shtator 1974.

1585 - HYSO, RIZA. Romani "ZGJIMI". - Në: "Drita", 27 tetor 1974, f. 3, 13.

1586 - SHEMA, ISAK. Ndikimi letrar i Maksim Gorkit në formimin e shkrimtarit Sterjo Spasse. – Në: "Gjurmime albanologjike. Seria e shkencave filologjike". – Prishtinë, nr. 4, 1974 (1975), f.143-156.

1587 - DILAVERI, DILAVER. Vitet e Rilindjes në faqet e një romani. (Mendime për romanin "Zgjimi" të Sterjo Spasses). - Në: "Nëntori", nr. 12, 1974, f. 30-40.

1588 - XHAXHO, MUHARREM. Epoka e Rilindjes Kombëtare në një roman. (Mendime për romanin "Zgjimi" të S. Spasses). - Në: "Përpara", Korçë, 21 dhjetor 1974.

1589 - SHEMA, ISAK. Tri faza në krijimtarinë e Sterjo Spasses. - Në: "Rilindja", Prishtinë, 28 dhjetor 1974, f.12.

1590 - SHAPLLO, DALAN. Mbi romanin "Ata nuk ishin vetëm". – **Në:** Shapllo, D. "Dukuri dhe vepra letrare". - Tiranë, 1974, f.153-166.

1975

1591 - FITUESIT E KONKURSIT LETRARO ARTISTIK PËR ROMANIN DHE VEPRAT SKENIKE MUZIKORE. -Në: "Zëri i popullit", 12 janar 1975. ***[Për romanin: Çmimi i parë: Ismail Kadare: "Nëntori i një kryeqyteti", Sterjo Spasse: "Zgjimi"..].***

1592 - U SHPALLËN FITUESIT E KONKURSIT LETRARO-ARTISTIK PËR ROMANE DHE GJINI TË MËDHA MUZIKORE. -

Në: "Drita", 12 janar 1975. ***[Çmimi i parë: Ismail Kadare: "Nëntori i një kryeqyteti", Sterjo Spasse "Zgjimi"..].***

1593 - SHEMA, ISAK. Si u shkrua "Afërdita" e "Ata nuk ishin vetëm" (Shënime mbi letërsinë shqipe). - Në: "Rilindja", Prishtinë, 11 janar 1975, f. 13.

1594 - VIT I PASUR LETRAR DHE ARTISTIK. - Në: "Fjala", Prishtinë, nr. 2, , 15 janar 1975, f. 11. ***[...Kryetari i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, poeti Dritëro Agolli, në intervistën që i dha gazetës "Drita" në mesin e shumë veprave letrare ai ndau romanin më të ri të Sterjo Spasses "Zgjimi" që flet për luftën e Rilindësve tanë, mandej poezitë e të riut Ndoc Papleka "Ecim" etj]***

1595 - SILIQI, LLAZAR (Kryetar i jurisë së romanit). Vërshim i gëzueshëm i romanit. - Në: "Drita", 19 janar 1975.

1596 - PËR NJË KRIJIMTARI EDHE MË TË BEGATSHME, TË FRYMËZUAR NGA VEPRA E MREKULLUESHME E POPULLIT DHE E PARTISË: Bisedë në redaksi me shkrimtarë dhe artistë. - Në: "Zëri i popullit", 25 janar 1975.

1597 - SHEMA, ISAK. Ndikimi letrar i Maksim Gorkit në formimin e shkrimtarit Sterjo Spasse . – Në: "Seminari i kulturës shqiptare për të huaj", nr. 1, Prishtinë, 1975. (Botim i Universitetit, Fakulteti i Filozofisë).

1598 - KABASHI, XH., HATIPI, MYZAFERE. Pedagoge dhe revolucionare e tipit të "Afërditës". - Në: "Shkëndia", Prishtinë, nr. 18, 1975.

1599 - DJE NË TIRANË : Takim me shkrimtarin Sterjo Spasse. - Në: "Bashkimi", 21 shkurt 1975.

1600 - TAKIME ME LEXUES: [Foto në Pallatin e Kulturës]. Takim për romanin "Zgjimi". Ll. Siliqi, S. Spasse, N. Prifti. - Në: "Drita", 23 shkurt 1975.

1601 - SILIQI, LLAZAR. "Zgjimi"- një roman historiko-shoqëror me vlera të mëdha ideo-artistike. – Në: "Bashkimi", 23 shkurt 1975.

1602 – BUXHOVI, JUSUF (inic. J. B.). Sterjo Spasse vizitoi Edicionin e botimeve të "Rilindjes". - Në: "Rilindja", Prishtinë, 12 prill 1975. ***[Shkrimtari i njohur Sterjo Spasse ishte mysafir i Universitetit të Prishtinës dhe gjatë qëndrimit disaditësh në vendin tonë, vizitoi Kosovën dhe Maqedoninë; Foto: Isak Shema, St, Spasse, Deda, J. Buxhovi].***

1603 - PLAKA, ARISTIDH. LIBRI SHQIPTAR NË BOTË (Il libro albanese nel mondo) - italisht. - Në: "Nuova Albania", Tiranë, nr. 4, 1975.

1604 - TAKIM ME LEXUESIT I SHKRIMTARIT STERJO SPASSE. - Në: "Pararoja", Gjirokastër, 17 maj 1975.

1605 - MORINA, TAFIL. Figura e Afërditës në romanet e Sterjo Spasses. - Në: "Shkëndija", Prishtinë, nr. 18, 1 dhjetor 1975; f. 24; nr. 19, 15 dhjetor 1975, f. 24; nr. 20, 30 dhjetor 1975, f. 24; nr. 1-2, 15 janar 1976, f. 24.

1606 - SUKSES I ROMANIT TONË. - Në: "Drita", 20 qershor 1975**.** ***[Midis tyre ka vepra te një niveli të lartë ideoartistik: "Zgjimi" i S. Spasses, "Skënderbeu" i S. Godos..].***

1607 - SANEJA, MAZLLUM. Figura e femrës në veprën e Sterjo Spasses. - Në: "Flaka e vëllazërimit", Shkup, nr. 1702, 25 korrik 1975, f. 12; nr. 1703, 27 korrik 1975, f. 12.

1608 - RAMABAJA, RUSHIT. "Ulu mal, të dalë hëna" (Ju prezantojmë shkrimtarët tuaj [Sterjo Spasse]). - Në: "Rilindja", Prishtinë, 8 gusht 1975, f. 14.

1609 - BOTIME: Sterjo Spasse: "Zgjimi". - Në: "Rilindja", Prishtinë, 25 tetor 1975.

1610 - SILIQI, LLAZAR. Festë për të gjithë. - Në: "Ylli", nr. 10, 1975, f. 12-13.

1611 - BUXHOVI, J. Koha e zgjimit kombëtar (Mbi romanin "Zgjimi"). - Në: "Rilindja", Prishtinë, 1 nëntor 1975, f. 14.

1612 - NGA CIKLI I ROMANEVE "RILINDASIT" - "PISHTARË", roman nga Sterjo Spasse. (Recension). - Në: "Libri", Tiranë, nëntor 1975.

1613 - BEQIRI, SABRI. E vërteta historike përballë së vërtetës artistike - romani "Zgjimi". - Në: "Fjala", Prishtinë, nr. 21, 1 dhjetor 1975, f. 4.

1614 - DEKOROHEN SHKRIMTARË DHE ARTISTË. Në: "Drita", 21 dhjetor 1975. ***[...Me Urdhërin Flamuri i kuq i punës të klasit I u dekoruan:Dritëro Riza Agolli, Llazar Risto Siliqi, Sterjo Spasse, Fatmir Isuf Gjata, Jakov Thanas Xoxa..."].***

1976

1615 - XHAXHO, MUHAREM. "Zgjimi" : Tabloja epike dhe realizimet e një romani. - Në: "10 korriku", nr. 1, 1976, f. 28- 29.

1616 - XHAXHO, MUHAREM. Figura e gruas në romanin me temën e fshatit të sotëm. - Në: "Studime filologjike", nr. 1, 1976.

1617 - KALLULI, ADRIATIK. Thellimi i dramacitetit në romanin e kohëve të fundit (Zgjimi etj**.)**. - Në: "Nëntori", nr. 1, 1976.

1618 - GRAZHDANI, MIÇO (punëtor, Korçë). "Pishtarë". - Në: "Drita", 28 mars 1976, f.5.

1619 - JORGAQI, NASHO. Kontribut në romanin tonë historik të realizmit socialist (Romani "Pishtarë"). – Në: "Nëntori", nr. 4, 1976, f.116-120.

1620 - PUNËTORË DHE STUDENTË DISKUTOJNË PËR PROBLEME TË ROMANIT "Zgjimi". - Në: "Nëntori", nr. 4, 1976.

1621 - DEVA, NAXHIJE. Gruaja në veprimtarinë letrare të Sterjo Spasses. - Në: "Fjala", Prishtinë, nr. 3, 1 shkurt 1976, f. 12; nr 4, 15 shkurt 1976, f. 12.

1622 - KABASHI, EMIN. Aspekte në romanin "Zgjimi". - Në: "Fjala", Prishtinë, nr. 6, 15 mars 1976, f. 4.

1623 - VELIU, IBRAHIM. E kaluara e rëfyer në kohën e tashme (Mbi romanin "Zgjimi"). - Në: "Flaka e vëllazërimit", Shkup, nr. 1843, 13 qershor 1976, f. 21; nr. 1844, 16 qershor 1976, f. 20; nr. 1845, 18 qershor 1976, f. 20.

1624 - VINCA, AGIM. Dy heronj-një ideal: Pavël Vllasovi-Gjikë Shpati. - Në: "Fjala", Prishtinë, nr. 8, 1976, f. 16.

1625 - GOGAJ, ILJAZ. Kontributi pedagogjik i revistës "Bota e re" në vitet tridhjetë të shekullit 20. (Me rastin e 40 vjetorit). – Në: "Revista pedagogjike", nr. 2, prill-qershor 1976. f. 110-121.

1626 - JORGAQI, NASHO. Krijimtaria letrare e Sterjo Spasses para Çlirimit. – Në: Sterjo Spasse, Kurora e rinisë (Shkrime të zgjedhura). - Tiranë 1963, f. 3-24; Në: Nasho Jorgaqi, "Silueta letrare". - Tiranë

1976, f. 43-66; Në: "Vëzhgime kritike". – Prishtinë : Rilindja, 1978, f. 176-190.

1627 - LEZHA, NEKI. "Flaka e zjarrit revolucionarizues" (Për romanin "Zjarre" të Sterjo Spasses). - Në: Lezha, N. "Hulumtime letrare". - Tiranë, 1976, f.116-127.

1977

1628 - SHPUZA, GAZMEND. "Mendime rreth pasqyrimit të realitetit historik të kohës në romanin "Pishtarë". - Në: "Nëntori", nr. 1, 1977, f.160-175; Në: G. Shpuza, Në vazhdën e gjurmimeve për epokën e Rilindjes Kombëtare.-Tiranë : Toena, 1997, f. 324-340.

1629 - SHEMA, ISAK. Frymëmarrje e epokës së Rilindjes Kombëtare (në romanet "Zgjimi" dhe "Pishtarë" të Sterjo Spasses). - Në: "Jeta e re", Prishtinë, nr. 2, mars - prill 1977, f. 269-280.

1630 - KELMENDI, RAMIZ: Vajzat. - Në: "Flaka e vëllazërimit", Shkup, 6 mars 1977. ***[...Lexonin atëhere (para çlirimit ose në vitet e para gjer nga vitet 50 në Pejë) dhe e pëlqenin mbi të gjitha..."Afërditën" e Sterjo Spasses..].***

1631 - RRAHMANI, ZEJNULLAH. Libri ynë nuk ka krizë për lexues. - ***Në***: "Fjala", Prishtinë, nr. 8, 15 prill 1977. ***[...Kështu kompleti i veprave të Spasses është grabitur në tërësi..].***

1632 - BOTIME: STERJO SPASSE. "Afërdita". - Në: "Rilindja", Prishtinë, 7 maj 1977. ***[Në bibliotekën e lekturës shkollore redaksia e botimeve të "Rilindjes" botoi romanin e popullarizuar të shkrimtarit të njohur Sterjo Spasse "Afërdita". Ky është botimi i katërt i kësaj vepre, që decenie me radhë ishte i pranishëm në të gjitha meset e lexuesve tanë, gjithnjë duke luajtur rol edukativ nga një anë, por edhe duke u shijuar si një vepër e realizuar letrare-artistike..].***

1633 - HOXHA, E. "Letërsia dhe artet të shërbejnë për kalitjen e njerëzve me ndërgjegjen e klasës për ndërtimin e socializmit"**.** Fjala e mbylljes mbajtur në Plenumin XV të KQ të PPSH, 16 tetor 1965. – Në: Hoxha, E. "Mbi letërsinë dhe artin". - Tiranë, 1977, f. 214. ***["Romanet dhe shkrimet e Sterjo Spasses etj. janë për ne vepra me vlerë të madhe edukuese, frymëzuese..."].***

1634 - DEMOLLI, ARIF. Kthim nga e shkuara. Arsyet letrare e jashtëletrare. **– Në:** "Fjala", Prishtinë, 1 nëntor 1977. ***[...Nga letërsia jonë na duken më të përshtatshme të përmendim romanet e S. Spasses "Afërdita" dhe "Afërdita përsëri në fshat"..].***

1635 - BERATI, LUMIRA. "Pasqyrimi i jetës së fshatit socialist në romanin tonë. – Në: "Studime filologjike"**,** nr. 4, 1977, f. 55-79. " [Romanet "Afërdita përsëri në fshat" dhe "Buzë liqenit" të S. Spasses].

1636 - DILAVERI, DILAVER. "Vitet e rilindjes në faqet e një romani ("Zgjimi"). - Në: "Dilaveri, Dilaver. Nëpër faqet e prozë sonë". – Tiranë : Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", 1977, f. 87-99.

1978

1637 - FOTO: Shkrimtari Sterjo Spasse në studio. – Në: "Drita", 24 shtator 1978.

1638 - BERISHA, ANTON. Transformimi i strukturës së letërsisë gojore me ato të letërsisë së shkruar. - Në: "Rilindja", Prishtinë, 7 tetor 1978**.** ***[...Për një shkallë të lartë asimilimi të strukturës dhe të gjuhës poetike të krijimeve gojore në krijimet e shkruara përmendim: Naim Frashërin, Darën e Ri, Mjedën,Asdrenin; pastaj Spassen, Xoxen, Kadaren, B.Dedjen,Pashkun etj] .***

1639 - GËRVALLA, JUSUF. Një dokumentaritet i përshtatshëm : "Risto Siliqi". - Në: " Rilindja", Prishtinë, 21 tetor 1978.

[...Këtu mund të permend konkretisht kombinimin e fatosave të vjetër të Risto Siliqit...me fjalën e dy shkrimtarëve të shquar shqiptarë, Sterjo Spasse dhe Lasgush Poradeci..].

1640 - BOTIME: STERJO SPASSE: Novela (Recension). - Në: "Rilindja", Prishtinë, 18 nëntor 1978.

1641 - "JA VDEKJE, JA LIRI" - Roman nga Sterjo Spasse. - Në: "Libri", nëntor 1978.

1642 - LEKAJ, HASAN. Jehona e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në romanin tonë historik të realizmit socialist.(Romani "Zgjimi"). - Në: "Lidhja Shqiptare e Prizrenit" (1878-1881). – Shkodër : Botim i Institutit të Lartë Pedagogjik, 1978, f. 41-46.

1979

1643 - BRAHIMI, RAZI. - Historia i flet të sotmes (Për romanet "Zgjimi" dhe "Pishtarë"). - Në: "Drita", 15 prill 1979.

1644 - DISKUTIM PËR ROMANIN "JA VDEKJE, JA LIRI". - Në: "Jeta e re", Shkodër, 12 maj 1979.

1645 - VITRINA E LIBRIT: Sterjo Spasse: "Zgjimi". – Në: - Prishtinë : "Rilindja", 2 qershor 1979.

1646 - NJË VEPËR E RE E CIKLIT "RILINDËSIT" (Diskutim krijues rreth romanit "Ja vdekje, ja liri" të Sterjo Spasses). - Në: "Drita", 10 qershor 1979.

1647 - LIBRI SHKOLLOR: Mahir Domi - Sterjo Spasse: Letërsia e Huaj (I). - Në: - "Rilindja", Prishtinë, 11 korrik 1979.

1648 - STERJO SPASSE - Për jetën e re (Mbi romanin "Afërdita përsëri në fshat). - Në: "Nëntori", nr. 7, 1979, f. 161.

1649 - LEZHA, NEKI. “Në qendër të romanit është lufta e popullit për liri” (Për romanin “Ja vdekje, ja liri”). – Në: ”Drita”, 19 gusht 1979.

1650 - VITRINAT E LIBRIT: Sterjo Spasse: “Të fala nga fshati”**.** - **Në**: “Rilindja”, Prishtinë, 1 shtator 1979.

1651 - JORGAQI, NASHO. Një nga romanet e protestës kundër realitetit të hidhur. (Pjesë nga parathënia e romanit “Pse?!...” të Sterjo Spasses në botim të redaksisë së botimeve Rilindja). - Në: “Rilindja”, Prishtinë, 25 shtator 1979.

1652 - BRAHIMI, RAZI. Përfytyrime artistike të historisë tonë kombëtare (Për romanet “Zgjimi”, dhe “Pishtarë”). - Në: “Nëntori”, nr. 9, 1979, f.113-115.

1653 - DOMI, MAHIR. Sterjo Spasse. - Intervistë dhënë televizionit të Prishtinë më 8 nëntor 1979, me rastin e 50 vjetorit të krijimtarisë së S.Spasses. [Intervistues: Ali Llunji; operator: Rudolf Sopi].

1654 - BULO, JORGO. Sterjo Spasse. - Intervistë dhënë televizionit të Prishtinë më 8 nëntor 1979, me rastin e 50 vjetorit të krijimtarisë së S.Spasses. [Intervistues: Ali Llunji; operator: Rudolf Sopi].

1655 - GJIKA, THANAS. Jeta shqiptare e Rilindjes në faqet e romanit “Ja vdekje, ja liri”. - Në: “Nëntori”, nr. 9, 1979, f.129-136.

1656 - KËSHILLI BOTUES I REDAKSISË TË BOTIMEVE GBG “RILINDJA” Jep për diskutim publik projektin e planit botues për vitin 1980: BIBLIOTEKA KOMPLET VEPRASH: TË STERJ0 SPASSES NË 10 VËLLIME. - Në: “Rilindja”, Prishtinë, 25 nëntor 1979. [Shënim: Ky ishte projekti për botimin e dytë të veprave komplet të Sterjo Spasses në Kosovë. I pari u realizua më 1968, (I.S.)].

1657 - JORGAQI, NASHO. Sterjo Spasse, "Vaje" e Çajupit. - Në Antologji e mendimit estetik shqiptar 1504-1944. – Tiranë : Shtëpia Botuese "Naim Frashëri, 1979, f.383-389, 488.

1980

1658 - PËR NJË KULTURË E ART MILITANT REVOLUCIONAR (Për romanin "Ja vdekje, ja liri!"). - Në: "Radio-Tirana", 8 shkurt 1980, ora 10. 45'.

1659 - SUTAJ, A. Sterjo Spasse - tradita e punës krijuese. - Në: "Rilindja", Prishtinë, 27 shkurt 1980, f. 11.

1660 - SHEME, ISAK. Vepra letrare e Sterjo Spasses në kritikën e huaj. - Në: "Seminar ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare". – Prishtinë : Botim i Universitetit të Prishtinës, Fakulteti Filozofik, nr. 6, 1980, f. 237-245.

1661 - SHAPLLO, DALAN. Mbi romanin "Ata nuk ishin vetëm" të Sterjo Spasses. – Në: Artikuj dhe studime mbi romanin. – Tiranë : Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, 1980, f. 122-132. - (Biblioteka e nxënësit).

1662 - BULO, JORGO. Mbi romanin "Ata nuk ishin vetëm" të Sterjo Spasses. – Në: Artikuj dhe studime mbi romanin. – Tiranë : Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, 1980, f. 133-149. - (Biblioteka e nxënësit).

1663 - HOXHA, ENVER. Letër drejtuar shokut Sterjo Spasse, Tiranë, 30 dhjetor 1980. - - Në: "Juaji Enver Hoxha". (Letra të zgjedhura). - Tiranë, 1985, f. 443-444. ***[... Gjithë krijimtarinë tënde letrare ti,shoku Sterjo, ia ke kushtuar vuajtjeve e luftërave të gjata e kreshnike të popullit tonë trim e heroik për çlirim kombëtar e shoqëror, për mbrojtjen e nderit, të zakoneve e të besës që e ka karakterizuar kurdoherë shqiptarin. Si e tillë ajo i ka shërbyer jo vetëm ngritjes në art dhe pavdeksisë së këtyre luftërave e përpjekjeve shekullore, por edhe edukimit të brezit të ri me frymë patriotike e***

devotshmëri ndaj atdheut.Unë të uroj që, ashtu si deri tani, të vazhdosh të krijosh vepra të reja, të denja për epokën tonë të lavdishme, me partishmëri proletare e që të përjetësojnë historinë e lashtë, të re dhe atë të tanishme të Shqipërisë sonë të dashur, luftën dhe punën e popullit tonë për ndërtimin dhe mbrojtjen e socializmit.Të dërgoj me këtë rast urimet e mia më të mira për Vitin e Ri 1981.Enver Hoxha Firma].

1981

1664 - PËR NJË KULTURË DHE ART MILITANT REVOLUCIONAR (Romani "Zgjimi"). - Në: "Radio-Tirana", 17 prill 1981, ora 7.50'.

1665 - DIZDARI, ISLAM. Figura e mësuesit në veprimtarinë letrare të Sterjo Spasses. - Në: "Jeta e re", Shkodër, 17 qershor 1981.

1666 - DISKUTIM KRIJUES PËR SERINË E VEPRAVE LETRARE TË STERJO SPASSES. - Në: "Jeta e re", Shkodër, 17 qershor 1981.

1667 - KRIJIMTARI QË PASQYRON GJERËSISHT JETËN E POPULLIT (Diskutim krijues për serinë e veprave letrare të Sterjo Spasses në Shkodër më 15 qershor 1981). - Në: "Drita", 28 qershor 1981. [Përmbajtja: 1. Jup Kastrati: Gjerësia problemore e krijimtarisë; 2. Laboratori krijues; 3. Vlerësimi i krijimtarisë; 4) Neki Lezha: Ndihmesë në romanin e realizmit socialist; 5) Hasan Lekaj: Lufta për liri e pavarësi në rilindasit; 6) Skënder Drini: Proza e shkurtër, kronikë e zhvillimeve të vrullshme të shoqërisë së re; 7) Fatbardha Fishta: Figura e gruas së ditëve tona në veprën e Sterjo Spasses; 8) Ana Jovani: Figura e Margës te romani "Zgjimi"; 9) Selami Tabaku: Evoluimi i botëkuptimit të autorit vështruar në romanet "Afërdita" dhe "Afërdita përsëri në fshat"; 10) Simon Pepa: Veçori të leksikut në romanet e fundit të Spasses; 11) Islam Dizdari: Figura e mësuesit në romanet e Spasses; 12) Mina Gero: Çështje të gjuhës në Serinë e veprave letrare].

1668 - TRUPA, DHURATA. Fjalia shkakore në romanin "Zgjimi" të shkrimtarit Sterjo Spasse. - Në: "Buletini shkencor", Shkodër, nr. 2, 1981, f. 213-215.

1669 - BULO, JORGO. Tradita dhe risi letrare. - Tiranë : Naim Frashëri, 1981. a) Zhvillimi i letërsisë shqiptare të realizmit kritik e të realizmit socialist; b) Vështrim historik mbi romanin shqiptar; c) Nga historia e lindjes dhe formimit të romanit të sotëm shqiptar "Ata nuk ishin vetëm***".[...Është një brez i tërë autorësh si S. Spasse, H.Stërmilli, N. Bulka, Sh. Musaraj, A. Çaçi. Kapa e të tjerë që pasqyruan në veprën e tyre prapambetjen e thellë të shoqërisë, gjendjen e mjeruar të bujkut dhe të punëtorit, aspiratën për emancipimin e vërtetë të njeriut e sidomos të femrës shqiptare.Krjiimtaria e tyre përshkohet nga nota të forta kritike kundër rendit anakronik në fuqi dhe aparatit burokratik të korruptuar, kundër normave morale të vjetëruara dhe konservatore***...] (f. 147). Krijimtaria e Sterjo Spasses citohet në faqet: 1, 147, 154, 178, 209-210, 213, 241-272].

1670 - FLETË VOLANTE: Shkrimtarë të realizmit socialist: Seria:Vepra letrare. Në f. 3: STERJO SPASSE - VEPRA LETRARE 1-8: Këngëtar i fshatit. – Tiranë : L'entreprise de la diffusion de livre, 1981.

1671 - FLETË VOLANTE: Sterjo Spasse, Vepra letrare 1-8: - Tiranë : Ndërmarrja e përhapjes së librit, 1981.

1982

1672 - BORIÇI, HAMIT. Publicistika letrare. - Tiranë, 1982. [S. Spasse: shih faqet: 44.108, 132, 152, 182, 193].

1673 - FISHTA, FATBARDHA. Figura e gruas së ditëve tona në veprën e Sterjo Spasse. - Në: "Shqiptarja e re", nr. 1, 1982.

1674 - VOZGA, RAMAZAN. Vërtetësia artistike dhe tingëllimi aktual. – Në: "Nëntori", nr. 11, 1982, f. 45-59. (Për romanet "Zgjimi" dhe "Pishtarë" shih f. 51-52).

1983

1675 - SHEMA, ISAK. Pasqyrimi i epokës së Rilindjes Kombëtare në romanet "Zgjimi" dhe "Pishtarë" të Sterjo Spasses. (Marrë me shkurtime nga rev. "Jeta e re", Prishtinë, nr. 2, 1977). - Në: "Studime filologjike", nr. 1, 1983, f. 135-144.

1676 - SHEMA, ISAK. Frymëmarrja e epokës së Rilindjes Kombëtare: *Zgjimi, Pishtarë.* – Në: Studime filologjike, nr. 1, 1983, f. 135-144; Në: Studime dhe kritikë letrare (Nga autorë shqiptarë të Kosovës, Maqedonisë e të Malit të Zi) / përg. Ramazan Vozga. - Tiranë : Naim Frashëri, 1983, f. 350-365.

1677 - SHERIFI, FATMIR. - Në: "Bota e re", Prishtinë, 1 maj 1983. ***["Kush e lexon "Botën", pohon se i pëlqejnë më shumë shkrimtarët T. Drajzer dhe Sterjo Spasse"].***

1678 - HYSA, RIZA. Tradita jone e re letraro-artistike : krijimtari e frymëzuar nga dashuria për popullin dhe historinë tonë. (Vepra letrare e Sterjo Spasses). - Në: "Zëri i popullit", 23 korrik 1983.

1679 - LIBRA TË RINJ: "KRYENGRITËSIT". - Në: "Zëri i popullit", 20 gusht 1983.

1680 - LIBRA TË RINJ: "KRYENGRITËSIT". - Në: "Drita", 4 shtator 1983.

1681 - GJIKA, THANAS. Galeri tipash dhe karakteresh – romani "Kryengritësit" i Sterjo Spasses. - Në: "Drita", 27 nëntor 1983.

1984

1682 - GASHI, ELHANE. Kush e lexon "Botën"?! - Në: "Bota e re", Prishtinë, (organ i KU të LRS të Universitetit të Kosovës), nr. 2, 15 janar 1984. ***[Në pyetjen: Cili shkrimtar ju pëlqen më shumë? - Përgjigjet shkurt: Sterjo Spasse. Cila vepër? - "Zgjimi"].***

1684 - TURHANI, NEVRUZ: Shkrimtari ynë Sterjo Spasse. - Në: "Shqipëria e re", nr. 2, 1984, f. 22 - 23. [Edhe foto e shkrimtarit dalë në kabinetin e punës]. (Kjo revistë është botuar në disa gjuhë të huaja).

1685 - XHUVANI, DHIMITËR. Gjini e gjerë dhe e dashur. - Në: "Ylli", nr. 2, 1984, f. 17. ***[Pionierët e parë të romanit si Dh. Shuteriqi, Sh. Musaraj, S. Spasse, F. Gjata ,J . Xoxe etj. Janë bërë sot klasikë të kësaj gjinie..].***

1686 - DILAVERI, DILAVER. Skena të mëdha të historisë. Romani "Zgjimi" i Sterjo Spasses. - Në: "Drita", 1 prill 1984, f. 5.

1687 - GREVA, FLUTRA. Sterjo Spasse**:** Bibliografi e shkurtër. - Në: "Drita", 24 qershor 1984.

1688 - BERATI, LUMIRA. Sesion shkencor me rastin e 70 vjetorit të lindjes së shkrimtarit Sterjo Spasse. - Në: "Studime filologjike" nr. 3, 1984. f. 192-194.

1689 - PAPAJ, KONSTANDIN. Sterjo Spasse dhe Pse-ja shqiptare. Palermo-Itali, 14 korrik 1984. **–** Në: "Dielli", Boston, Mass., nr. 12, 1 gusht 1984, f. 4. [Foto me diçiturën: "Shkrimtari Sterjo Spasse duke shkruar romanin "Afërdita përsëri në fshat**"*... U përpoqa vetëm të them një të vërtetë, se përpara një vërtetari o radiografisti të botës shqiptare, siç është SterjoSpassja, të gjithë duhet të mësojmë ta shohim të vërtetën në sy dhe të flasim me zemër në dorë. Si të parët, si pleqtë, si më të urtët e të urtëve***].**

1690 - HYSO, RIZA. Gjysmë shekulli me penë në dorë. (Me rastin e 70 vjetorit të lindjes së shkrimtarit. - Në: "Përpara", Korçë, nr. 76, 22 shtator 1984. [Edhe foto me diçiturën: Shkrimtari Sterjo Spasse].

1691 - U FESTUA 70 VJETORI I LINDJES SË SHKRIMTARIT STERJO SPASSE**.** - Në: "Përpara", Korçë, nr. 77, 26 shtator 1984.

1692 - SKËNDAJ, BUJAR. Jeta e popullit në qendër të veprës letrare. (Sesion shkencor për krijimtarinë e Sterjo Spasses). - Në: "Drita", nr. 42, 30 shtator 1984, f. 12. [Foto: shkrimtari midis vajzave fshatare veshur me kostum të krahinës së Prespës).

1693 - ISMAILI, XHAFER. Sterjo Spasse mbi edukatën e punës. - Në: "Shkëndija", Prishtinë, nr. 16, 15 tetor 1984, f. 9. ***["Në aspektin pedagogjik, Spasse mund të krahasohet me pedagogët më eminentë përfaqësues të shkollës së punës: Kërsheshtajner, Zajnikun, Maria Montesorin, Aleksandër Xhuvanin etj...Edhe foto e shkrimtarit].***

1694 - THANASI, SPASSE. Jetë krijuese gjithnjë e re. (Në 70 vjetorin e lindjes së Sterjo Spasses). – Në: "Studenti i bujqësisë", 19 tetor 1984.

1695 - ROBO, SOTIR-ZIKO, VANGJUSH. Diell e dritë kjo jeta jonë. Duke përkujtuar një jubile (70 vjetori i lindjes së Sterjo Spasses). - Në: "Përpara", 10 nëntor 1984.

1696 - KAPEXHIU, BUJAR. [Krijuesit tanë në konkursin e madh artistik. Karikatura]. - Në: "Hosteni", nr. 21, 12 nëntor 1984.

1697 - GJATA, FATMIR. Artist i shquar i fjalës (Në 70-vjetorin e lindjes së Sterjo Spasses). - Në: "Nëntori", nr. 12, 1984. f. 29-42.

1698 - HYSO, RIZA. Vepra letrare e Sterjo Spasses, vendi dhe rëndësia e saj në letërsinë shqiptare. - Në: "Nëntori", nr. 12,1984, f. 33 - 42.

1699 - KASTRATI, JUP. Vlerësimi i krijimtarisë së Sterjo Spasses. – Në: "Nëntori", nr. 12, 1984, f. 43-46.

1985

1700 - HASANI, HASAN. Sterjo Spasse. - Në: "Rilindja për fëmijë", Prishtinë, 22 janar 1985, f. 7. (Shtojcë në: "Rilindja"). [Jeta dhe krijimtaria letrare e shkrimtarit nga RPSSH,Sterjo Spasse, lindur në Gllomboç të Korçës më 1914. Foto e shkrimtarit].

1701 - HYSENI, GAFUR**.** E dua punën me nxënës. – Në: "Shkëndija", Prishtinë, nr. 10, 15 maj 1985. ***[...Nxënësve u flisja për "Afërditën e Sterjo Spasses, por edhe vetë isha "Afërditë". Bile më quanin "Afërdita e Veleshtes"].***

1702 - SPASSE, STERJO. (Prozë e zgjedhur nga letërsia në RPSSH). - Në: "Rilindja", Prishtinë, 6 tetor 1985, f. 3.

1703 - JAKOVA, KOLË. Kur formohej organizata e Lidhjes (Kujtime**).** - Në: "Drita", 6 tetor 1985.

1704 - FOTO: Në 50 vjetorin e shpalljes së Pavarësisë. - Në: "Drita, 6 tetor 1985.
[Foto: Jakov Xoxa, Nonda Bulka, Sterjo Spasse, Ismail Kadare].

1705 - QAFËZEZI, LUAN. Veteranët e letërsisë. - Në: "Zëri i popullit", 11 tetor 1985.

1706 - AGOLLI, DRITERO. Të ardhmen e letërsisë dhe artit rinia e përgatit. - Në: "Drita", 27 tetor 1985. ***[Mësues plot pasion kanë qenë Nonda Bulka, Sterjo Spasse, Aleks Buda e të tjerë, që siç tregojnë moshatarët e mi ,kur shpjegonin në orën e lëndës së letërsisë, ndizej***

fantazia dhe kapërcente muret e ftohtë të klasës, duke fluturuar larg në një botë të madhe, që quhet art..].

1707 - JAKOVA, KOLË. Kur krijuam lidhjen tonë (40 vjet më parë). - Në: "Ylli", nr. 10, 1985, f. 16-17.

1708 - KRASNIQI, BAJRAM. Poetika e romanit historik shqiptar**.** – Prishtinë: Instituti Albanologjik, 1985. [Recenzentë: Akademik Rexhep Qosja, Këshilltar shkencor i Institutit Albanologjik të Prishtinës; Latif Berisha, ligjërues i lartë i Fakultetit të Prishtinës. (Sterjo Spasse citohet në f. 18, 45, 55, 77, 223, sidomos në kapitujt: 1) Rreth metodës së hulumtimit artistik të historisë; 2) Romani epope- Totaliteti si ideal poetik; 3) Personazhi dhe personaliteti historik; 4) Poetika dysore; 5) Demitizmi i historisë; 6) Struktura e tipit; 6) Përfundimi.

1709 - SHEMA, ISAK. Në: "Aspekte të letërsisë". Biblioteka "Hejza". Redaktor biblioteke: Sabri Hamiti; shkrimtarë: Rexhep Smajli-Nazmi Rahmani. "Rilindja", Redaksia e botimeve. Prishtinë, 1985. 1) Krijuesi, vepra letrare dhe shoqëria; 2) Fillimet letrare të Sterjo Spasses; 3) Vizioni optimist jetësor në letërsi; 4) Aspekte të romanit social; 5) Trajtimi i temës së Rilindjes Kombëtare në roman; 6) Ngritja e konflikteve letrare. - [Për krijimtarinë e Sterjo Spasses: f. 131-149, 150-175, 176-189, 190-206, 207-219, 250-254].

